UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË

Buletini shkencor

Numër 2, Vëllimi 1, 2014
ISSN 2310-6719

BULETINI SHKENCOR
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Numër 2, Vëllimi 1, 2014
ISSN 2310-6719

Bordi Editorial

Redaktore e gjuhës angleze:
Ma. Erida Prifti

Redaktore letrare:
MSc. Etjona Hoxha

Person Kontakti:
Ma. Erida Prifti

Editore:
MSc. Roksana Nowak
MSc. Ajola Çobani

Bordi Shkencor

Prof. Dr. Albert Qarri, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri (Kryetar)
Prof. David M. Kemme, University of Memphis, Tennessee, USA
Prof. Ronald W. Spahr, University of Memphis, Tennessee, USA
Prof. Dr. Dhori Kule, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Jorgo Kaçani, Universiteti Politeknik i Tiranës, Shqipëri
PhD. Bill Croft, Sandhills Community College, North Carolina, USA
Prof. Dr. Llukan Puka, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Shezai Rrokaj, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Genci Burazeri, Universiteti i Mjekësisë, Shqipëri
Prof. Dr. Sulo Hadërri, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
PhD. Aleks Konomi, Seattle University, Washington, USA
Prof. Dr. Sherif Bundo, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Bardhosh Gaçe, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri
Prof. Asoc. Kristofor Lapa, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri
Prof. Asoc. Mira Shehu, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Shqipëri
Dr. Arjan Gjonça, the London School of Economics and Political Science, Londër, Angli
Prof. Dr. Fatmir Mema, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Mynyr Koni, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Pranvera Lazo, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Kozeta Sevrani, Universiteti i Tiranës, Shqipëri

Buletini shkencor / Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Email: buletini.shkencor@univlora.edu.al / Tel. 00355 33 22 49 52

INFORMACION

Buletini Shkencor boton punime origjinale që sjellin njohuri të reja dhe të rëndësishme për avancimin e shkencës.

Ky organ botues është krijuar me idenë fillestare të promovimit të gjetjeve shkencore të akademikëve shqiptarë brenda dhe jashtë mjedisit universitar shqiptar. Rëndësia e botimit të buletinit disa herë në vit qëndron në dhënien e mundësisë për të gjithë kërkuesit akademik dhe jo vetëm të bëjnë të njohura gjetjet më të reja në fushat përkatëse të tyre si dhe në përditësimin në kohë të gjetjeve të mëparshme.

Dërgimi i dorëshkrimit nënkupton që punimi i paraqitur në të nuk është botuar më parë (përveçse në formën e një përmbledhjeje, leksioni apo tezave akademike), nuk është në shqyrtim për t'u botuar gjetkë dhe se botimi është aprovuar nga të gjithë autorët, si dhe autoritetet përgjegjëse ku hulumtimi është kryer. Autorëve do t'ju kërkohet që të paraqesin, nëse ka ndonjë konflikt interesash, si dhe ndonjë burim financiar të veçantë të përdorur për kryerjen e kërkimit. Nëse dorëshkrimi pranohet për botim ai nuk mund të botohet në të njëjtën formë diku tjetër pa marrë më parë leje me shkrim nga Bordi i Buletinit Shkencor.

Plagjiatura nuk lejohet dhe do t'u raportohet si autorit, ashtu edhe autoriteteve përkatëse. Konkluzionet duhet të justifikohen nga skema eksperimentale dhe të dhënat e paraqitura. Informacioni duhet të jetë i detajuar në mënyre që të lejojë përsëritjen e punës nga shkencëtarë të tjerë të së njëjtës fushë. Autorët duhet t'i ruajnë të dhënat eksperimentale dhe t'ia paraqesin Këshillit Botues, nëse u kërkohen. Shkrimi duhet të jetë i qartë, i kuptueshëm, konçiz dhe korrekt nga ana gramatikore. Autorët mbajnë përgjegjësi për anën shkencore dhe formale të materialeve që paraqesin, si dhe për çdo korrespondencë me redaktorët.

Të interesuarit të paraqiten me arritjet më të reja nga fushat e angazhimeve të tyre profesionale – shkencore.

Artikujt duhet të jenë origjinale (të pakumtuara në ndonjë aktivitet tjetër), të pabotuara dhe jo në proces vlerësimi ose botimi (në ndonjë redaksi tjetër).

Autorët janë përgjegjës për redaktimin gjuhësor të tekstit të përmbledhjeve të tyre, qoftë në shqip, qoftë në anglisht.

Të gjithë autorët e interesuar për të botuar në Buletinin Shkencor të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë mund të na kontaktojnë në adresën email: buletini.shkencor@univlora.edu.al

Përmbajtja

SHAREHOLDERS ACTIVISM: EVIDENCE FROM ALBANIAN JOINT STOCK COMPANIES
Amali Çipi, Shyqyri Llaci, Prof. Dr. Albert Qarri

EUROPEAN ECONOMY UNDER AUSTERITY AND THE ALBANIAN ECONOMIC PERSPECTIVE
MSc. Florian Miti, Prof. Dr. Albert Qarri, Msc. Blerina Dervishaj

PËRDORIMI I RAPORTEVE FINANCIARË NË IDENTIFIKIMIN E RISQEVE TË BRENDSHËM FINANCIARË TË SHOQËRIVE. RAST STUDIMI: NJË SUBJEKT JURIDIK NË QYTETIN E VLORËS.
MSc. Blerina Dervishaj

MODELE TË RINJ TË VOLATILITETIT NË TREGJEY FINANCIARE: ZBATIM NË RENDIMENTE AKSIONARË TË RAJONIT TË BALLKANIT
PhD. Visar MALAJ, PhD. Vincenzo Gentile

ZGJIDHJA NUMERIKE E NJË PROBLEMI JOLINEAR TË DOBËT QË MODELON LËKUNDJET NË LINJAT ELEKTRIKE
MSc. Valmir Bame, MSc. Oltiana Toshkollari

BARRIERS TO INNOVATION AND PUBLIC POLICE IN ALBANIA
MSc. Dorjana Feimi, Prof. Dr Vasilika Kume

INSTITUTI I SHPALLJES SË PERSONIT TË ZHDUKUR APO TË VDEKUR SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR DHE LEGJISLACIONIT RUS
Valbona Alikaj

LEGJISLACIONI SHQIPTAR MBI LIRINË KONTRAKTORE DHE MIRËBESIMIN
MSc. Ergysa IKONOMI

DISIPLINA E BASHKIMIT FAMILJAR PËR SHTETASIT E VENDEVE TË TRETA NË LEGJISLACIONIN E BASHKIMIT EUROPIAN
Ervis Moçka, Sokol Bana

FORMAT E REJA TË PËRCAKTIMIT TË ATËSISË (Rasti i Shqipërisë dhe përqasja e tij me sfidat e reja)
Jonada Zyberaj

E DREJTA E PRONËS SI NJË E DREJTË KUSHTETUESE NË RAPORT ME INTERESIN PUBLIK SI NJË KUFIZIM KUSHTETUES
MSc. Oljana Hoxhaj

MBROJTJA E TË DREJTAVETË PUNËTORËVE NË BASHKIMIN EVROPIAN
Stela MEÇAJ, Uarda ROSHI

RIVENDOSJA NË AFAT NË PROCEDIMIN PENAL
Artur Malaj

NJOHJA E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE NË BE
Belinda HALILAJ

EUTHANASIA IN RELATION TO THE RIGHT TO LIFE AS THE MOST BASIC HUMAN RIGHT
PhD. Arjana Llano

GRID COMPUTING DHE CLOUD COMPUTING. Cilat janë ndryshimet në zgjidhjet e sigurisë ne këto dy teknologji?
Fjoralba Sota

MODELIMI I UDHËTIMEVE TË GJENERUARA DHE TË TËRHEQURA NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË VLORËS
Ing. Pëllumb Cacaj, Prof.As. Kristofor Lapa

VLERSIMI I ANIJEVE DHE MBROJTJA E MJEDISIT DETAR NË GJIRIN E VLORËS
MSc. Shkëlcim Sinanaj

TE MESUARIT GJATE GJITHE JETES
MSc. ARANIT GJIPALI

SFIDA TË REJA PËR PROCESIN E MËSIMDHËNIES, DHE TË MARRËDHËNIES MËSUES-NXËNËS, NË SHOQËRINË E RE TË DIJES, TEKNOLOGJISË DHE INFORMACIONIT
Albano Zhapaj

INTEGRIMI I NXËNËSVE TË ARDHUR NGA JASHTË SHTETIT , REALITETI I RI ARSIMOR ,PROBLEME TË DY GJUHËSISË
Eglantina Gerveni

RËNDËSIA E GABIMEVE NË MËSIMNXËNIEN E GJUHËVE TË HUAJA.QËNDRIMI MËSUESIT NDAJ TYRE
Eglantina Gerveni

AFTËSIMI PRAGMATIK DHE KOMUNIKATIV I NXËNËSVE TË GJUHËS SË HUAJ
PhD. Marsela Harizaj

LEKSIKU NË KANUNIN E LABËRISË, NJË OBJEKT STUDIMI PËR HISTORINË E GJUHËS SHQIPE.
MSc. Zamira Alimemaj

KONTRIBUTI I UILLIAM MARTIN LIKUT NË FUSHËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
Bukuroshe Isufaj

FIGURA E QAZIM KOCULIT NË HISTORI E KËNGË

MSc. Albert Habazaj

STRATEGJITË E PËRMBLEDHJES SË NJË TEKSTI ZHVILLUAR NGA STUDENTË TË NIVELEVE TË NDRYSHËM
Lavdosh Malaj

STRATEGJITË E TË NXËNIT TË FJALORIT NË LIDHJE ME MOSHËN DHE INDIVIDIN
Phd. Kozeta Hyso

TE NXËNIT E BAZUAR NË PROBLEME: ÇFARË DHE SI E MËSOJNË STUDENTËT ANGLISHTEN PROFESIONALE?
PhD. Veneranda Hajrulla

NDIKIMI I STANDARDIT DHE MARRËDHËNIET GJUHË E NJËSUAR / NËNDIALEKT / IDIOLEKT
MSc. Doriana Klosi

IMPAKTI I RRITJES SE NJE FEMIJE ME CRREGULLIME ZHVILLIMI NE CILESINE E JETES SE PRINDERVE: SHQYRTIM LITERATURE
Erjona Dervishaliaj

HIV AIDS DHE SJELLJET RISKANTE TE ADOLESHENTEVE
Emirjona Kiçaj, Rudina Çerçizaj, Ela Peto, Emiljana Coraj

PREVALENCA E SËMUNDJEVE KARDIOVASKULARE NË SPITALIN E VLORËS PËR VITET 2009-2011, DEPISTIMI DHE PARANDALIMI I TYRE
MSc. Juljana Xhindoli, MSc. Rezarta Petani, MSc. Denada Selfo, MSc. Mimoza Llavdaniti, MD. Kreshnik Shehu

FREKUENCA E INFEKSIONEVE TË RRUGËVE RESPIRATORE TEK FËMIJËT E NDJEKUR AMBULATORISHT NË VLORË NË PERIUDHËN JANAR 2013 - JANAR 2014
MSc. Saemira Durmishi, MSc. Rozeta Luci, MSc. Glodiana Sinanaj, MSc. Bruna Subashi, MSc. Denada Selfo

IMPLEMENTIMI I NJE MODELI TE RI TE KARTELES INFERMIERORE NE REPARTIN E PEDIATRISE SPITALI RAJONAL VLORE
MSc. Evis Alushi, Doc. Majlinda Zahaj, MSc. Sonila Nika

EVIDENTIMI I PERDORIMIT TE MASAVE TE BIOSIGURISE NGA PERSONELI INFERMIEROR NE SPITALIN RAJONAL VLORE
MND. Denada Selfo, Skender Skenderi, Brunilda Subashi, Juliana Xhindoli, Rozeta Luci, Yllka Bilushi

DUHANPIRJA TE STUDENTËT E FAKULTETIT TË SHËNDETIT PUBLIK TË UNIVERSITETIT TË VLORËS
Rudina Çerçizaj, Emirjona Kiçaj , Ela Peto, Neritan Qirici

SFIDA TË REJA PËR PROCESIN E MËSIMDHËNIES, DHE TË MARRËDHËNIES MËSUES-NXËNËS, NË SHOQËRINË E RE TË DIJES, TEKNOLOGJISË DHE INFORMACIONIT.

ALBANO ZHAPAJ
Ministria e Arsimit dhe Sportit
Sekretar i Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë
Mail: albano.zhapaj@arsimi.gov.al
Tel : 00355 (0) 69 40 80801

Ashtu si edhe në kohët më të hershme, pranohet nga shumë vetë edhe sot, se misioni i mësuesit, lektorit apo kujtdo mësimdhënësi të kontekstit që jetojmë është sa i rëndësishëm aq edhe delikat. Janë pikërisht mësimdhënësit ata të cilët hedhin bazat mbi formimin e fëmijës, njeriut, pjesëtarit të ardhshëm të shoqërisë sonë demokratike.

Shoqëria e sotme, me arritjet e mëdha të shkencës, teknologjisë dhe informacionit, kërkon njerëz të formuar të pajisur me kompetencë, personale e profesionale, në mënyrë që, sot edhe nesër në jetë, të jenë të aftë dhe kompetitivë, jo vetëm në vendin e tyre të punës, por edhe në shoqëri.

Për të arritur qëllimet e edukimit apo transmetimit të dijeve tek nxënësit, ka ardhur koha që të hedhim hapa konkretë për një pedagogji që vë në lëvizje ambicien për të formuar nxënës (lexo njerëz) për të përballuar sfidat e reja në botën post-moderne, në të cilën janë aktive shumë forca që i kundërvihen këtyre qëllimeve.

Nisur nga këto premisa, lind natyrshëm nevoja për një formim të vazhdueshëm për të gjithë, sidomos për mësimdhënësit, në mënyrë që të jenë të aftë të realizojnë këtë pedagogji të re, që përveç transmetimit të dijes, ka qëllim të mbështetet mbi kolonat e komunikimit dhe bashkëbisedimit, dhe që ecën drejt një formimi personal e profesional të njeriut, si domosdoshmëri e kërkuar nga tregu i sotëm i punës dhe shoqëria njëkohësisht.

Duke aplikuar një mësimdhënie bazuar mbi modelin e bashkëbisedimit dhe argumentimit të njohurive dhe këndvështrimeve të ndryshme në marrëdhëniet mësues-nxënës, natyrisht dhe përgjegjshmërisht do të jetë *roli i parë* i mësuesit, ai i cili do të lehtësojë një raport në rritje midis nxënësve dhe dijes, veçanërisht për sa i përket dijes që studiohet nën drejtimin e mësuesit të lëndës përkatëse.

Në këtë mënyrë fillojnë e vihen edhe bazat e përvetësimit të komunikimit pedagogjik të përgjegjshëm, duke futur mësuesit në praktikat e teknikat e *reflektimit*. Rrjedhimisht këtu futen në punë kujtesa, inteligjenca, imagjinata e ndjenjat për të kuptuar domethënien dhe vlerën thelbësore të asaj që quhet filozofi e komunikimit edukativ, për të zbuluar lidhjen me aspekte të tjera të njohjes së aktivitetit njerëzor, për të çmuar implikimet në një kërkim të vazhdueshëm të dijes dhe së vërtetës.

Reflektimi nën dritën e komunikimit pedagogjik të përgjegjshëm duhet të jetë një proces formimi e çlirimi që formon ndërgjegjen e mësuesve, qëndrimet e tyre,

vlerat e bindjet e zakonshme, ashtu dhe mënyrën e tyre të të menduarit, në mënyrë që ata të jenë të shtyrë të kalojnë nga të diturit e njohurive komunikuese në *veprime konkrete*.

Arritja e një rezultati të tillë, të veprimeve konkrete të komunikimit pedagogjik, në punën e përditshme me nxënësit, do të jetë ai i simulimit të rasteve apo shëmbujve që ngjallin imagjinatën dhe vullnetin e tyre në mënyrë që të zgjedhin formën e veprimit më të përshtatshëm e të nxjerrin pasojat e asaj që kanë marrë dhe të mund ta kthejnë në realitet.

Ajo që mësuesit apo edukatorët do të bëjnë me nxënësit nga kjo pikëpamje, natyrisht nuk mendoj se do të mund të transformojë menjëherë botën e tyre të diturisë, por sigurisht do të ndikojë në hedhjen e një hapi në këtë drejtim, dhe do të çojë në përvoja të reja, në reflektime të tjera e në veprimet që ndjekin.

Lidhja reciproke konstante në mes *komunikimit, pervojes, reflektimit dhe veprimit konkret* në dinamikën mësues-nxënës të një ambienti mësimor është dhe duhet të jetë "kali i betejës", për arsye se mësuesi apo edukatori, pa krijuar marëdhënie autentike me nxënësin, pra ku ai të jetë vet person i parë i komunikimit të vetvetes, nuk mund të arrijë të transmetojë dije, reflektim, bashkëbisedim dhe formim.

Duhet të pranojmë të gjithë se formimi i njeriut vjen nga bashkëbisedimi, bashkëtrajtimi i temave, bashkëndarja e koncepteve, pra vjen si diçka e pa ndarë nga marrëdhëniet ndërpersonale.

Në rastin e output-teve mbi nxënësit, mënyra se si trajtohen këto marrëdhënie është e një rëndësie të veçantë. Mos të harrojmë se nxënësi më shumë se kushdo është në një ambient mësimor aty ku mëson se ç`është personi tjetër dhe fillon të pranojë që tjetri është njësoj si ai, por edhe ndryshe nga ai. Po nuk e kuptoi një mësues apo edukator këtë element, nuk mund të pretendojmë dot që ta kuptojnë nxënësit

Me fjalë të tjera më filozofike, duke i'u referuar filozofit të edukimit Martin Buber, tjetri është një njeri si unë por është i ndryshëm nga unë dhe për këtë meriton mirënjohjen dhe respektin tim. Unë duhet të njoh vlerat e tjetrit dhe t`ia pranoj ato. Kjo s`do të thotë që unë ti përvetësoj vlerat e tjetrit se duke bërë s`është njoh vetveten dhe sa më shumë unë njoh atë (tjetrin) aq më shumë njoh veten time.

Natyrisht që ky proces duhet të jetë reciprok, tjetri duhet të mendojë për mua në të njëjtën mënyrë pak a shumë. Askush nuk duhet ti imponohet tjetrit. Përndryshe tjetri vihet në vështirësi dhe nuk e dallon dot vetveten. Vënia në vështirësi e vlerave dhe personalitetit të tjetrit ndikon negativisht në marrëdhënien ndërpersonale

Një marrëdhënie autentike dhe e vërtetë në mes mësuesit dhe nxënësit ka nevojë për t`u zhvilluar nga një besim dhe respekt, që rriten në një përvojë të vazhdueshme të tjetrit si të një miku të çiltër në angazhimin për të përvetësuar. Kjo sjell dhe një dije të plotë e perceptim të ambientit të dijes, dhe nga ana e jonë si mësimdhënës, një hapje dhe vëmendje në rrjetën komplekse e shpesh të hollë të normave, të parashikimeve, të sjelljeve e të marrëdhënieve, që përbëjnë atmosferën në të cilën zhvillohet përvetësimi i dijes.

Në këtë kontekst pedagogjik të formimit të vazhduar natyrisht që mësimdhënësi përveç se vetes dhe nxënësve, duhet patjetër të punoj edhe me anëtarët e tjerë të stafit pedagogjik apo akademik, në mënyrë që të gjithë të jenë pjesë dhe të kenë në

konsideratë kontekstin real në të cilin jeton nxënësi, d.m.th. familja, kushtet shoqërore, vetë universiteti, politika, ekonomia, klima kulturore etj.

E gjitha kjo do të sjellë sigurisht pasoja pozitive edhe mbi vetë mësuesimdhënësit, pasi do të jetë e dobishme dhe e rëndësishme këta të nxitin shpesh herë nxënësit të reflektojnë mbi përvojën e tyre, mbi ndikimin që kanë elementët e kontekstit në të cilin jetojnë mbi qëndrimet e tyre, mbi mënyrën e tyre të të kuptuarit, të gjykuarit, e të zgjedhjes. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur trajtohen tema që ngjallin paraprakisht reaksione të forta sensibilizuese.

Në mungesë të marrëdhënieve të tilla një pjesë e madhe e forcës së të shkëlqyerit të mësimdhënësit/edukatorit, do të humbiste. Në të vërtetë, një marrëdhënie vërtetë besimi e korrektësie në mes mësuesit dhe nxënësit është kusht dhe qëndrim i domosdoshëm për çdo progres në një angazhim në mësim-nxënie.

Për këtë, kujdesi personal i mësimdhënësit, ose e thënë ndryshe një përkushtim i vërtetë i një vëmendje personale për secilin nga nxënësit është thelbësore për të krijuar një ambient që favorizon modelin pedagogjik të propozuar deri më tash.

Një ndër sfidat më të mëdha që mësuesi takon në këtë stad të mësimdhënies është të arrijë të formulojë pyetje që zgjerojnë marrjen e dijeve të nxënësve dhe i shtyjnë të marrin në konsideratë pikëpamjen e të tjerëve. Por, mbetet sfida në hapjen e ndjeshmërisë së studentëve në implikimet njerëzore të asaj dije që përvetësojnë, në mënyrë që të kapërcejnë përvoja të brendshme dhe të provokojnë në ta një rritje personale që në një të nesërme të shpejtë t`iu shërbejë në jetën e tyre.

Nga përvoja ka ndodhur që, edhe pas këtij proces reflektimi, mësimdhënës të veçantë kanë të vepruar në mënyrë egoiste, duke keq përdorur marrëdhëniet autentike, apo shpërdoruar besimin e kolegëve të tjerë apo edhe nxënësve apo studentëve.

Një reflektim i mbështetur mund të forcojë, provokojë, nxisë një konsideratë dhe të japë një siguri më të madhe që veprimi që ndërmerret (në nivel individual apo grupi) të jetë më koherent me atë që do të thotë të jemi njerëz për të tjerët.

Termat *pervoje dhe reflektim* mund të përcaktohen në mënyra të ndryshme sipas shkollave të ndryshme të pedagogjisë, dhe ne jemi dakord me tendencën në përdorim të tyre dhe të termave të tjerë të ngjashëm për të shprehur apo për të nxitur një mësimdhënie të personalizuar dhe aktive, qëllimi i së cilës të mos jetë vetëm asimilimi i lëndës por zhvillimi i personit.

Në traditën tonë të arsimit, megjithatë këto terma janë veçanërisht kuptimplotë sepse shprehin një "mënyrë procedimi" që është më efikase për të arritur "formimin integral" të nxënësit, d.m.th. një mënyrë eksperimentimi dhe reflektimi që çon nxënësin jo vetëm të gërmojë në thellësi të lëndës që studion, por të kërkojë kuptimin për jetën e të plotësojë zgjedhje personale *(veprim)* në bazë të një vizioni të saktë të botës.

Nga ana tjetër, duhet ta pranojmë që përvoja dhe reflektimi nuk janë fenomene të ndashëm. Nuk është e mundur të kesh përvojë pa njëfarë shkalle reflektimi, dhe në çdo rast *roli i mësimdhënësit është themelor* .

Në misionin e përditshëm të mësimdhënies bazat e pedagogjisë dhe filozofisë së edukimit mund të jenë të një ndihme të madhe në fitimin e mendjeve dhe zemrave të nxënësve dhe studentëve të rinj. Pedagogjia duhet përqendrohet në të vërtetë

mbi formimin e nxënësit në tërësi, mendje, vullnet, komunikim, reflektim, argumentim, dhe pse jo intelekt.

Të jemi të sigurt se gjërat më të mira të një ambienti mësimor nuk janë vetëm ato që thuhen, por ato që jetohen e mësohen nga marrëdhëniet ndërpersonale, bashkëveprimi i nxënësve apo studentëve në të. Kusht themelor në arritjen e rezultateve konkretë është dhe mbetet i bazuari në procesin e një punë frytdhënëse dhe shkencore, ku kërkohet një integrim midis teorive pedagogjike dhe punës praktike. Integrim si një proces ku për të arritur rezultate është e nevojshme të punohet njëherazi në ato drejtime të cilat më lart, në një mënyrë apo një tjetër, reflektojnë personin, profesionin, pra filozofinë e punës së çdonjërit.

Bibliografia

Giuseppe Milan, *Edukim në Dialog. Pedagogjia e Martin Buber*, qytet i ri, roma 1994.

K.R. Popper, *Një patentë për të bërë tv*, tek K.R. Popper, J. Condry, *Televisioni mësues i keq*, Reset, Milano

Giuseppe Milan, *La dimensione "tra", fondamento pedagogico dell'interculturalità*, Cleup, Padova 2002.

Giuseppe Milan, *Disagio giovanile e strategie educative*, Città Nuova, Roma 2001.

Giuseppe Milan, aceti e., *epoka e shpresave të mundura. Adoleshentët sot.* Roma: Qytet i Ri (monografi), 2010

Giuseppe Milan, *moshë e vështirë dhe e mrekullueshme. Çfarë arsimi?, në "Studium Educationis"* Lecce-2012,

Giuseppe milan., gasperi emma, *Një qytet i mirëbërë. Edukimi i qytetit duke filluar nga themelet*, mendo multimedia, Lecce 2012.

THE FIGURES OF THE QAZIM KOCULI IN THE HISTORY END SONG

FIGURA E QAZIM KOCULIT NË HISTORI E KËNGË

MSc. ALBERT HABAZAJ*

Biblioteka Qendrore "Nermin Vlora Falaschi",

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, ALBANIA

albert_abazi_tr@yahoo.com

bertbiblioteka@gmail.com

Abstrakt

Ndoshta për herë të parë, nëpërmjet kësaj kumtese, mund të prezantojmë një fashë vagëlluese për figurat me dritë hije në historinë e Luftës së Vlorës, 1920 dhe folklorin për ta, sipas Epikës Historike të Luftës së Vlorës. Në fokus do të kemi figurën komplekte të Qazim Koculit, si rasti më tipik i, të paktën, dhjetë nga dymbëdhjetë anëtarëve të komitetit të "Mbrojtjes Kombëtare" të Luftës së Vlorës. Grafiku historik dhe folklorik i figurave të tilla të njohura nuk ecën në trajtë lineare, por me një kolorit kontrastesh të forta, që, duke i interpretuar në kontekst rrethanat lehtësuese dhe rënduese, japin efekte deri kombëtarisht. Shumë prej figurave të LV, të cilëve u këndohen këngë, se bënë histori, patën nga regjimi monist një përfundim tragjik, u pushkatuan, u burgosën ose vdiqën në burgjet e zeza komuniste, u internuan nga fashistët dhe komunistët dhe u mbuluan me harresë, u lanë në heshtje apo u qëlluan me rrufe shpifjesh e falsifikimesh. Ata, që dikur i kishin shërbyer me përkushtim pavarësisë kombëtare dhe shtetit, u bënë jetë të harruara. Ja pra, se përse është e domosdoshme për të shkruar, për të thënë të vërtetën dhe për t`i kthyer historisë personazhet e saj të merituara. Për hir të së vërtetës historike, në mirënjohje të kujtesës njerëzore të komuniteteve ku kanë lindur, jetuar dhe vepruar personazhet historikë, mendojmë se ngjarjet dhe personazhet që i bënë këto ngjarje në kohën që ndodhën dhe në hapësira konkrete, të caktuara e reale, duhen paraqitur e shkruar ashtu siç kanë qenë, siç kanë menduar dhe vepruar, me anët pozitive dhe negative të tyre.

Fjalët çelës: Histori, folklor, Lufta e Vlorës, figura të denigruara, Qazim Koculi.

Hyrje

Punimi ynë ngushtohet vertikalisht, duke patur në optikë: raportin histori - epikë historike, për figurat me dritë hije në histori dhe folkor. Lufta e Vlorës, 1920 mbetet trampolina jonë për të notuar, aqsa, ku ka "det", "liqen", "lumë", "përrua", a "rrëke" historiko - folklorike. Po shqyrtojmë një rast tipik, ndërfigurat e errësuara (të denigruara) nga LV, 1920, Qazim Koculin.Duke kujtuar fjalën e urtë: "Gur, gur bëhet mur", gjykojmë se përshkrimi korrekt, pa shtesa të tepërta dhe pa hequr bëmat e Koculit, për një arsye apo një tjetër ndikon mire për ta bërë sidomos historinë një shkencë serioze, të besueshme dhe pashqetësueshmërisht referencë kryesore burimore për studiuesit dhe për të interesuarit. Për të mos rënë në batakun e historiografisë komuniste, pra, për të mos përsëritur modelin e keq të paraqitjes bardhë e zi të personazheve me gjurmë në histori, puna më e vlertë që mund të bëhet është radioskopia historike, skaneri historik që historian, ashtu simjeku ndaj pacientit, në një rrafsh tjetër, ka detyrë ndaj figurave historike, aq më tepër ndaj figurave komplekse si Q. Koculi. Gjykimin e bën koha për historinë, për ngjarjen, për personazhet, për ata që bënë historinë dhe për ata që e shkruajnë historinë. Jetëshkrimi atdhetar i Koculit është me dritëhije. Ajo ngjan me dallgët e detit. Ai u lind në fshatin Kocul të Vlorës, më 22 korrik 1887. Studimet e larta i kreu në Akademinë e Marinës në Stamboll. Njihet si veprimtar politik i periudhës së Pavarësisë, si udhëheqës ushtarak, delegat i Vlorës në Kongresin e Lushnjës, senator i Dhomës së Këshillit Kombëtar të Shqipërisë, Komandant i Trupave Kombëtare në Luftën e Vlorës dhe, pas çlirimit të qytetit, u emërua prefekt i Vlorës.Atlasi atdhetaro - politik i Koculit, na tregon se ai, fitoi mandatin e deputetit në zgjedhjet parlamentare të vitit 1921 dhe, më 6 dhjetor të atij viti, Këshilli i Lartë e caktoi kryeministër. Mbahet mend si kryeministri më jetëshkurtër i Shqipërisë, sepse qeverisi vetëm një ditë, më saktë 6 orë. Dihet qëndrimi i tij fanolist dhe emigrimi me mërgatën politike. Në Fjalorin Enciklopedik shqiptar shkruhet: "Me pushtimin e vendit nga Italia fashiste më 1939, Q. K. u kthye në atdhe, bashkëpunoi me pushtuesit italianë dhe u emëruar anëtar i Këshillit të Lartë të Shtetit. Në fund të vitit 1942, u caktua nga pushtuesit italianë, komisar i jashtëzakonshëm në Vlorë. U vra në Vlorë me atentat nga pushtuesit italianë, si pasojë e pështjellimit që ngjalli në radhët e tyre disfata në luftën e Gjormit" (Fjalori enciklopedik shqiptar, II, 1195).

1. Figurat me dritë hije në histori dhe folklori për ta. Rasti i Qazim Koculit

Për realizimin e këtij punimi kemi gërshetuar studimin e botimeve të nivelit akademit, të historisë së Shqipërisë dhe ato lokale, botimet e folkloristike, ku mund të shënonim përmendjen e Q. Koculit, gërmimet në arkiva e biblioteka, si dhe ekspeditat vetiake e kolektive në terren, në ato hapësira ku ka lenë emër dhe ndihen gjurmët në të dy pamjet që na shfaqet "heroi dhe antiheroi". Dëshirojmë të sjellim një rast të freskët, nga Lufta e Gjormit (30. 12. 1942 - 02.01. 1943), për të bërë një krahasim kontekstual. Gjatë muajit

qershor 2013, realizojmë një ekspeditë vetiake në Labërinë e Brendshme të Lumit të Vlorës. Në Gjorm regjistrojmë moshatarin 84 vjeçar, Hyso Askushaj, i cili, ndër të tjera, na kujton se në ato luftime, nga më të mëdhatë në rrethin e Vlorës, armiku u thye keq. Atyre brinjave mbeti dhe komandanti i tyre, konsulli Franko Klementis. Të mbeturit gjallë, kur u kthyen në Vlorë, për humbjen që pësuan në luftën e Gjormit, pushkatuan edhe guvernatorin Qazim Koculi, edhe prefektin Lele Koçi. Kjo ngjarje ka ndodhur më 2 janar1943. (*Regjistrim* gjatë ekspeditës vetiake, në Gjorm, Vlorë).

Nuk mund të mbetej jashtë vëmendjes së kujtesës popullore kjo ngjarje, se populli në këngën: "Lufta e Gjormit", që mbahet mend deri sot e praktikohet në komunitetin e Gjormit, Vlorë, ndër të tjera merret vesh se… *"Armiqtë e mblodhë veten/ S' lanë plaçk' e bagëti,/ Për hakmarrje morën pleqtë/ Dhe i mbyllë në qeli./ Kur në Vlorë vanë:/ Qazim, na jep llogari!"/ Armiqtë vranë shoshojnë,/ Vranë Kocul e Koçì…"*. Kur thotë kënga se vranë shoshojnë, ka parasysh faktin se: si ata që erdhën si pushtues edhe ata që nuk luftuan për çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj e u pajtuan me të, ishin njësoj, për vendasit që u ngritën me armë në dorë, si gjithnjë, kundër zaptuesit të tokave e pronave që trashëgonin nga të parët, që kur s'mbahet mend. Kënga i vë në një kandar, i vlerëson ashtu siç e mendon: armiq, u vë notën në moment, nuk i dallon nga njeri - tjetri, ndaj shprehet që ata vranë shoqi - shoqin, njeri - tjetrin.

Më 1920 - n Qazim Koculi ishte hero, një nga udhëheqësit më të shquar, më të zotë, më veprimtarë ndaj çështjes së Atdheut, shembulli i patriotit të vërtetë. Për atë luftë i këndohet kënga, bashkë më Osman Haxhiun me nur kombëtar: "*Lule, Osmën Efendi/ Edhe Qazim Koculì/ Të kishin dy, tre si ti/ do të bënej Shqipëri!…"*, apo "*Burrat që morën vendimë/ Osmëni me dy Qazimë/ mblodhë gjithë Parësinë,/ të hidh' në det Italinë*" etj. Gjatë LDB, apo gjatë LANÇ, siç është quajtur më ngushtë, e fëlliqi, siç thotë populli. Kjo është e vërteta.Kjo është historia. Nga sa kemi njohuri, gjykojmë se jo vetëm historia e Shqipërisë, e Ballkanit, e Europës, por edhe historia botërore dhe qytetërërimi, nuk njeh ndonjë personazh "kimikisht të pastër"(Frashëri, 49). Edhe personazhet historikë, njerëz janë, dhe, si të tillë s'mund të jenë të pagabueshëm. Si duket, ne vuajmë akoma nga kompleksiteti i të qenit o vetëm i mirë, o vetëm i keq. Mendojmë se ende nuk qenkemi pastruar nga vesi i të dukurit, i vetëmburrjes (pa e ngatërrruar me ndjenjën e krenarisë, si veti, si virtyt). Mbase nuk mjaftojnë disa bulëzime studimore, në të cilat jepen ngjarja apo personazhi ashtu siç duhet: siç është paraqitur në realitet, siç është njohur në komunitet, siç ka qenë në të vërtetë, me të mirat dhe të këqijat e tij si profil, që ka zenë një vend të caktuar në histori dhe kënga e ka marrë në gjirin e saj, e mban apo e flak dhe pse? Ujëvara studimore, ku jepen ngjarjet e personazhet me të gjitha "ngjyrat e ylberit" dhe jo vetëm o bardhë, o zi, mendojmë se e bën të patundshme ndërtesën e historisë, me themele të forta, me mure rezistente; vetëm kështu mund të shëndoshet pema historike që hijeshon kështjellën e veçantë dhe

interesante të “Vendit të Shqipeve”; vetëm kështu rrënjët e pemës nuk i shkul dot asnjë furtunë, nga do që të vijë. Dhe trungu forcohet, dhe degët lulëzojnë në rrjedhat e kohës. Ndërkohë, ndjejmë se Kujdesi Studimor ndaj Infeksioneve të Ekspansionit së Shfrenuar Amatoreks të Parasë së Egos Primitive, ia vlen të jetë i vëmendshëm, serioz dhe i vijueshëm. Atje ku historia ka nevojë, e ndihmon kënga, e plotëson atë, e saktëson, me gjithë rezervat, se folkori hiperbolizon, apo litotizon, sipas botës së tij mentale, që nuk duhen shpërfillur nga historishkruesit. Historianët, historishkruesit, sigurisht, duke respektuar parimet shkencore, metodat e kërkuara, parë nga pozitat e duhura, ata dhe vetëm ata e kanë shkruar po e shkruajnë dhe do ta shkruajnë Historinë e Popullit Shqiptar, duke i vështruar e vlerësuar në zhvillimin e tyre historik të pandërprerë e tërësor historibërësit, ngjarjet, dukuritë, personazhet, sendet etj., dhe në lidhje të ngushtë me kushtet konkrete historike. Fjala vjen, një figurë e njohur, me kontribute të dalluara për LV, por e diskutueshme si Qazim Koculi, nuk ka mbetur i shpërfillur nga historia. Konkretisht është përmendur në HSH, 1965 (487), i është hequr emri në botimet e mëvoshme, ndërsa i ripërmendet emri i pacunguar në HPSH/ 3, 2007 (157). Pse ka ndodhur ky fenomen? Telegrafisht mund të bëjmë këtë interpretim. Q. Koculi ka vlera të padiskutueshme për LV, 1920. Ai, duke qenë edhe ushtarak me akademi, oficer marine, me gradën kapiten, jo vetëm që radhitej në krye të Parisë së krahinës së Vlorës, qe drejtues ushtarak i LV, (pas A. Lepenicës në Kotë), që hodhi në det Italinë kolonizatore, me bekimin e zotit, në të drejtën shqiptare, sipas urtësisë kombëtare të KMK dhe në ballë të gjithë Shqiptarëve të organizuar e të armatosur për liri. Gjatë LDB (LANÇ) Koculi bashëpunoi me pushtuesit, me “Italinë e dytë”, siç thotë populli. Por, ata nuk mund t’ia harronin Njëzetën Koculit, se u doli vetë në shteg.

2. Dy qëndrime kundërshtuese me njëra - tjetrën për kontributin e Q. Koculit

Edhe në komunitetin e Vlorës, për Qazim Koculin ka dymendime kontradiktore me njëra - tjetrën. Njëra palë thotë se ka bashkëpunuar me pushtuesin; nga pala tjetër, nga të pasmit e tij thuhet se ka qenë atdhetar. Mbi këto gjykime, duke interpretuar mendësisë e banorëve të Vlorës si krahinë, si rreth, ne me përgjegjësi vërtetësore, evidentojmë se, ai qe anëtar i KMK dhe në ballë të LV, më 1920, por më 1943, i vuri shqelmin lavdisë që bëri ndaj Italisë së Parë, me turpin që nxiu faqen me Italinë e Dytë. Banorët - për Njëzetën e quajnë patriot, për Dyzetetreshin tradhëtar (*jezit*). Gjithsesi, ai është një figurë komplekse, me dritëhije, me të mira e të liga, që ndoshta ka rëndësi të njihet nga historia, sepse folkori shumë pak vend i ka kushtuar dhe ndoshta vetëm në Kocul, në vendlindjen e tij dhe jo gjetkë. Ndoshta ka patur, por ato këngë pa përhapje, kanë rrjedhur gjatë rrugës, janë tharë e nuk kanë qarkulluar edhe për shkak, se në regjimin e Hoxhës ka patur direktiva për figura të tilla dhe krijuesit e rinj të folklorit të pasluftës e kanë parë të

arsyshme të mos e përfillin, ose janë tutur të këndojnë për luftën e tij të parë, apo, si duket ngaqë nuk i kanë pëlqyer fundin e palavdishëm e kanë anashkaluar apo përbuzur. Kemi parasysh një pasazh të Sali Muratit, (të cilin të gjithë luftëtarët e flisnin Kapedan; e konfirmon dhe shkrimtari P. Marko te romani etnologjik "Ultimatum" me rete dhe gurët [Marko, 92 - 111]), debatin me Q. Kokoshin, një tjetër figurë me dritëhije, anëtar i KMK të LV, sikurse dhe Koculi *("Unë të bëra Kokosh, unë t'i çkul pëndët!")*, personalitete të LV. Kemi shkelje të dinjititetit njerëzor tek ky rast nga komandanti i çetës së Rrëzës ndaj anëtarit të KMK? Mendojmë se jo, po ta gjykojmë në kohën e ndodhur dhe në situatën reale, sepse ata ishin të njohur me njëri - tjerin, ishin edhe miq, por qëndrimi ndaj çështjes kombëtare ishte pasaporta e Nderit. Ndaj thotë populli, që e mira do një jetë të tërë të mbahet e të ruhet si vlerë; e keqja për një minutë bëhet dhe shëmbet monumenti i mëparshëm i lavdisë, bëhet hi e përfundon në koshin e Historisë.

3. Epika Historike për Qazim Koculin

Për popullin, i cili flet me këngë, të mburr apo të shan, apo dhe s' të përmend fare, se s'i intereson, se s'ka ndërmend të të rregjistrojë në kujtesën sociale, as të të qarkullojë me krahët magjikë të këngës së komunitetit të tij, Q. Koculi (i paraqitur me dy pamje), vërtet në Luftën e Vlorës, më Njëzetën është Hero, është në gjirin dehës e të merituar të Lavdisë, por në LDB (LANÇ), për segmentin kohor trevjeçar 1939 - 1943, cilësohet tradhëtar i vendit, se u bë me armikun. Këtë dëshmon në Shqipëri logjika e Lirisë, se liria e Atdheut nuk mund të jetë trampoline e lavdisë vetiake, e mosngacmimit të interesave personale dhe kështu "baloset" kushdoqoftë, si Ballabani. Ky është folkori. Një fytyrë ka ai, s'pranon dy fytyra…S'ke ç'i bën, se dhe të duash, s'e ndryshon dot, pasi ai ka përhapjen gojore dhe lidhjen e së bukurës me të dobishmen "ligjësi". E ka në natyrën e tij dhe kontrastin e prerë (o i mirë deri në fund, o i lig që në fillim - pikë dalluese kjo, ku trajtimi folklorik bëhet jo siç është fakti historik.Na ka intriguar kompleksiteti i kësaj figure interesante, për të mos u tërhequr nga hulumtimet në terren, sidomos të kërkojmë gjurmët folklorike në vendlindjen e tij. Një bartës me kujtesë të fortë e të verifikueshme, si Fahri Shaskën, e gjejmë ulur hark me shtatë a tetë moshatarë në odën e miqve, në shtëpinë e tij, në lagjen Peçkat të Koculit. Ishte e diela e 21 korrikut të vitit 2013). Ishin mbledhur në nderim të 126 vjetorit të lindjes së Qazim Koculit dhe në respekt të trimit tjetër bujar, nga Koculi dhe ai, Avdurrahman Shaska; edhe ai anëtar i Komitetit Mbrojtja Kombëtare, apo një nga të *dymbëdhjetë komisjonë*, si i quan populli. Më ftuan të ulesha. I gjeta në këngë. Ia merrte, me atë zërin e shtruar karakteristik vetë zotëri Fahriu e kënga bënte të dridheshin xhamat e dritares së dhomës së burrave. Atë njësi folklorike, të padëgjuar më parë, e regjistrova si vijon: "*Kal ' i verdhë hingëllin,/ Durro Shaska sokëllin:/ - O djem - ,o për këtë ditë!/ Na nxuarr' Arditët sytë./ Mbahu, o Hate Qamili,/ Mbahu burrë, sojë trimi!/ - Do të mbahem, o aga,/*

Kam përpara një kala/ Do më hajë, a do ta ha!/ Nga vate Qazo Koculi?/ Ku është Qazo Desturi?/ Qazimi në pelë të bardhë/ U vërvit përmbi Qishbardhë”. Informacioni i kësaj njësie folklorike dallon që është i pasur, i ngjeshur historik, folklorik dhe etnografik e, kësisoj, këngë të tilla burimore shënohen si vlera të mirëfillta folklorike dhe pasurojnë fondin e Epikës Historike të Luftës së Vlorës.

Konkluzione

Një historian dhe diplomat i huaj shkruan se luftërat shkaktoheshin nga nacionalizmi, militarizmi, rrjetet e aleancave, faktorët ekonomikë etj., dhe më tej se, vetë njerëzit përshpejtonin luftërat (Stoessinger, XV). Lufta e Vlorës, me historinë e saj të shkruar na dha heroin historik. LV, me ciklin e këngëve të EHLV, me folkorin e saj të kënduar, na dha heroin kulturor. Mendojmë, se ndoshta po nuk u respektuan kriteret shkencore të historizmit nuk prodhohet histori, por hiçtori; ashtu sikurse po nuk u respektuan veçoritë specifike të folklorit, nuk rrjedh folklor i kulluar nga burimi, por “turbofolk”, ku turbullohet burimi folklorik, me një, dy, tre a katër zëra të bërë tok në mënyrë artificiale, të shtërnguar, duke shtërzuar, pa një bërthamë harmonike, ku elementët të rezonojnë me njëri - tjetrin kumbueshëm. Ndërkohë, nga shkruesit e historisë, deri këtë mesviti (2014), nuk ka një monografi të plotë kushtuar figurës së Q. Koculit, kur ka vërshime të papara për figura më periferike sesa ky shqiptar i shkolluar, me kontribute dhe me karakter kompleks. Kjo mangësi vihet re edhe për botimet folkoristike, kushtuar këtij personazhi historik. Nga studimet e deritanishme të historisë lokale dhe asaj kombëtare, rezulton se figura e Qazim Koculit, me gjithë kontrastet e dritëhijeve të jetëshkrimit historik, raviijëzohet si kontribues për paqen, parë në kontekst, me planin e aktorëve shqiparë, me faktorët rajonalë e ndërkombëtarë, në atë det me lule e furtunë të faktorit të brendshëm, paparashikueshmërisht të ndryshueshëm. Ndërsa epika historike, folklori i asaj hapësire ku ka lindur, ku ka jetuar dhe ku ka vepruar jo pak kohë personazhi historik që trajtojmë, siç është Koculi, një fshat i vjetër kufitar midis krahinës etnografike të Labërisë së Brendshme dhe asaj të Myzeqesë së Vogël, në krahinëzën e Fëngut apo Treblovës, po thuaj është bjerrafat, sepse ka humbur. Ai pak, shumë pak që ka ngelur e kemi mundur të mbledhim, nuk ka nivel aristik dhe nuk bëhet dot përfaqësues i folklorit të asaj treve të pasur me gurrë popullore, edhe me burimin e vjetër, por të kulluar të epikës historike të Luftës së Vlorës.Vetëm kënga që s’bëhet me urdhëra. Dhe në se ngrihet me paterica, nuk ka jetëgjatësi. Folklori është qibar, fodull, sqimatar, kryelartë, shumë i kujdesshëm intuitivisht e kërkues në “Kushtetutën” e tij, që nuk afrohet me këdo, por me ata që plotësojnë kushtet e tij specifike. Vrojtimi me pjesëmarrje në terren, sipas kritereve të duhura për punë kërkimore - shkencore, mendojmë se do të japë fryte të prekshme, duke i grumbulluar në gurrën e këngës për t’i përgatitur e për t’i botuar, sepse deri më sot është e cunguar dhe e paplotë epika historike e

luftës së Vlorës, 1920; gjithmonë duke patur parasysh verifikimin për "aktin krijues e qarkullues të folklorit" (Xhagolli, 135).

Literatura

AKADEMIA e Shkencave e Shqipërisë (2008), *Fjalor enciklopedik shqiptar, II*, zëri përgatitur nga Bardhosh Gaçe, Tiranë.
AKADEMIA e Shkencave e Shqipërisë (2007), *Historia e popullit shqiptar, III*, Toena, Tiranë.
FRASHËRI, Kristo, (2006), *Identiteti Kombëtar Shqiptar dhe Çështje të Tjera*, Edisud Spa, Tiranë.
MARKO, Petro, (1972), *Ultimatum*, Naim Frashëri, Tiranë.
REGJISTRIM gjatë ekspeditës vetiake, e mërkurë, 19. 06. 2013, në Gjorm, Vlorë, bartës Hyso Askushaj, 84 vjeç, me arsim të mesëm.
REGJISTRIM gjatë ekspeditës vetiake,e dielë , 21.07. 2013 në Kocul, Vlorë, me bartësin Fahri Shaska, 75 vjeç, me arsim të mesëm.
STOESSINGER, John G., (2009), *Përse kombet shkojnë në luftë*, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë.
UNIVERSITETI Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhei Gjuhësisë, (1965), *Historia e Shqipërisë, II*, Tiranë.
XHAGOLLI, Agron, (2007), *Etonologjia dhe folklori shqiptar*, Triptik, Vlorë.

**) Master Shkencor për Etnologji dhe Folklor,*
Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë.

Drejtor i Bibliotekës Qendrore "Nermin Vlora Falaschi",
Universiteti i "Ismail Qemali", Vlorë, Albania.

SHAREHOLDERS ACTIVISM: EVIDENCE FROM ALBANIAN JOINT STOCK COMPANIES

Amali Çipi[1], **Shyqyri Llaci**[2] , **Albert Qarri**[3]

[1]*Department of Business Administration,*
Faculty of Economics, University of Vlora "Ismail Qemali",
Sheshi Pavarësia, 9401 Vlorë, Albania
Email: amalia.cipi@univlora.edu.al

[2]*Department of Management,*
Faculty of Economics, University of Tirana,
Rruga Elbasanit, 1016 Tiranë, Albania
Email: shyqyri.llaci@fakultetiekonomise.edu.al

[3]*Department of Economics,*
Faculty of Economics, University of Vlora "Ismail Qemali",
Sheshi Pavarësia, 9401 Vlorë, Albania
Email: albert.qarri@univlora.edu.al

Abstract. The challenge of Corporate Governance – CG - in transition economies such as Albania is to generate a favorable business environment in which shareholders and managers are encouraged to target long-term performance, influencing the decision-making portfolio of foreign investors and devising effective governance frameworks to boost sustainable economic growth. Within this scenario, is plausible to assume that Albanian companies face an urgent need to assess CG standards and promote CG reforms especially related to shareholders rights protection and activism as a good CG practice. In this paper, we aim to analyze the evolutionary patterns of shareholders' rights level of implementation, in Albanian Joint Stock Companies - JSCs- and based on an application of the Delphi technique, provide development prospects considering the perceptions of a panel of corporate directors. Despite the relatively low level of shareholders' rights (especially minority shareholders) implementation, our essay demonstrates that the corporate directors express overall satisfaction in relation to the company's shareholders participation in the decision-making process and their rights protection. Additionally, a real need for a concentration of the ownership is strongly associated with the degree of Albanian financial market development.From this premise we believe that the direct involvement of shareholders in many important decisions and daily monitoring of the company is not going to change for a long period.

Keywords: Shareholders' Rights, Delphi, Corporate Governance, Corporate Directors, Joint Stock Companies.

1. Introduction

CG in general has claimed numerous positive consequences for shareholders,

corporation and society. Generally, effective CG promotes efficient use of resources both within the firm and the economy, and it assists firms and economies to attract low-cost investment capital by increasing both domestic and international investor confidence. On the other hand, a good CG framework should protect shareholders' rights; ensure the equitable treatment of all shareholders, including minority and foreign shareholders; recognize the rights of all stakeholders as established by law, and encourage active cooperation between corporations and stakeholders in creating wealth, jobs, and the sustainability of financially sound enterprises; ensure that timely and accurate disclosure is made on all material matters regarding the corporation, including its financial situation, performance, ownership and governance; and ensure the strategic guidance of the company, the effective monitoring of management by the board, and the board's accountability to the company and the shareholders (*cf.* OECD, 2004). Following this, one may assume that CG is important not only in developed market but also in transition economies as Albania. Firms in transitional economies as Albania, on which the post privatization process, political and cultural features contributed in establishing a distinct concentrated CG system and relationships between the governance and management functions, have urgent need in assessing CG standards. Good CG in big companies will be a guiding force for mid and small companies to devise effective governance frameworks that will result in further strengthening of the governance environment. Following this, not only the stakeholders of the companies but the societies at large will be the biggest beneficiaries of CG outcomes. Nevertheless, despite these general benefits and implications on implementing CG mechanisms, especially shareholders protection, the research related with CG has not been in the desirable levels. To the best of our knowledge, there is a lack of knowledge and appreciation on the role that shareholders, as an important CG mechanism, have on the firm performance. Based on this initial background, the present paper aims to understand the current state of maturity of corporate shareholders activism in Albanian JSCs based on the perceptions of a panel of Albanian CEOs. Methodologically, considering that the Delphi technique has proven over the years to be effective in forecasting trends (*cf.* Ferreira and Monteiro Barata, 2011; Ferreira *et al.*, 2013), we believe that there is considerable scope to explore its applicability in the particular context of this study. For that purpose, our experiment involves a panel of several Albanian CEOs from the most representative city in Albania. We know of no prior work using the Delphi technique to analyze the evolutionary patterns for shareholders activism in this particular context. In this sense, the study contributes to current research by offering empirical results related to the application of the Delphi technique and will help us to understand the peculiar transformations that managers are facing in this dynamic and complex environment.

The reminder of this is paper is structured as follows: Section 2 presents the

literature review highlighting the role of different shareholders; Section 3 presents a brief methodological background of the Delphi approach and justifies its application in the context of the present study; Section 4 presents the results of our experiment; and Section 5 concludes the paper.

2. Literature Review on Shareholders' Rights

CG has emerged as a way to manage modern joint stock corporations but it is equally significant in state-owned enterprises, cooperatives and family businesses. Shleifer and Vishny (1997: 737) point out that CG deals with the ways in which suppliers of finance to corporations assure themselves of getting a return on their investment. In this sense, shareholders, as an extremely important economic agent, provide capital to the company, and expect sustainable return on their investment in terms of periodic dividends and stock price appreciations (Rezaee, 2009). The owners of a company can be the State, individual investors, institutional investors, banks, pension funds and holding companies, among others. Shareholders' interest in a company has a wide dimension, which can be financial and/or strategic. Based on power disputed among shareholders, designing CG mechanisms and safeguards is paramount to protect minority shareholders' interests from expropriation by majority shareholders (Rajagopalan and Zhang, 2008). Therefore, "good" CG practices can provide incentives to investors, facilitate effective monitoring, and defend shareholders' interests (*e.g.* greater security on investments, assets sale, proper and updated information, fair treatment of all stakeholders) (*cf.* CIPE, 2002; OECD, 2004). It is well known that well-functioning CG mechanisms are of crucial importance for both local firms and foreign investors that are interested in pursuing the tremendous opportunities for investment and growth that, for example, emerging economies provide. In fact, CG practices are a mean whereby society can be sure that large corporations are well-run institutions to which investors and lenders can confidently commit their funds. Following this, and according to Rajagopalan and Zhang (2008), improvements in CG can enhance investor confidence in firms in emerging economies and increase these firms' access to capital. Good CG is, therefore, important to attract new investment, particularly for developing countries where good CG is seen as a mean of attracting Foreign Direct Investment – FDI – at more favorable rates (*cf.* Mallin, 2007). Following this, one may assume that one of the major goals of CG is to maximize the value of a shareholder while taking into account the value of the others. For this reason, independently of the country's jurisdiction, CG plays an important role in the firm well being. Shareholder is a person who owns at least one share on a company and cannot lose more than the capital stock invested. From this premise, shareholders have the right to influence management decisions and the way in which the company should be governed, through voting at annual general meetings. In this sense, they can influence the composition of the board of di-

[16] Shih Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 30 datë 17.06.2010, pg. 45

[17] Vendim Unfikues nr. 1 dt 20.01.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, fq. 8. Gjykata ka arsyetuar se: "*Ndonëse nga njëra anë paraqitja e rekursit nga i pandehuri, pas rivendosjes së tij në afat, është një e drejtë kushtetuese, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, i pandehuri e ka ezauruar këtë të drejtë ankimi (rekursi) në momentin e gjykimit të çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, gjykim në të cilin i pandehuri është konsideruar i përfaqësuar rregullisht sipas neneve 48/3 e 410/2 te K.Pr.P. nga avokati i caktuar nga familjarët e tij me prokurë të posaçme. Për më tepër, mospranimi i rekursit prej Kolegjit Penal nuk kufizohet vetëm në shqyrtimin e elementeve formalë të rekursit dhe që lidhen me afatin ligjor, tregimin e saktë të shkaqeve të paligjshmërisë së vendimit dhe nënshkrimin nga mbrojtësi (neni 435 i K.Pr.P.), por edhe në kontrollin e ekzistencës ose jo të shkaqeve të rekursit dhe që lidhen me "a) mosrespektimin ose për zbatimin e gabuar të ligjit penal; b) shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të këtij Kodi; c) shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit" (neni 433 i K.Pr.P.)...**Vetëm në rastet kur gjykata më e lartë ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës më të ulët për shkak të kalimit të afatit (rastet e parashikuara nga neni 420/1), i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të kërkojnë rivendosjen në afat të të drejtës për të ushtruar ankim ndaj të njëjtit vendim".***

vendimit. I njëjti qëndrim mbahet edhe në rastin e kërkesës për rivendosje në afat të të drejtës për të bërë apel pasi çështja është shqyrtuar në gjykatën e apelit... Rishqyrtimi i rekursit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në kushtet kur ai është shprehur njëherë në lidhje me mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala, jo për shkak të paraqitjes së tij tej afatit ligjor, bie ndesh me parimin e res judicata (gjëja e gjykuar), pasi i njëjti Kolegj nuk mund të shqyrtojë dhe shprehet dy herë në lidhje me rekursin e paraqitur nga e njëjta palë kundër të njëjtit vendim të gjykatës së apelit".

3.1.3. Në lidhje me të drejtën e bashkë të pandehurve të gjykuar në mungesë për t'u rivendosur në afat, pasi çështja është shqyrtuar mbi bazën e ankimit të njërit prej tyre, Gjykata e Lartë është shprehur se: "*Në çështjet penale me disa të pandehur, gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkë të pandehuri*.

Pavarësisht sa më sipër, në çështjet penale me disa të pandehur, gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur ankimi i bashkë të pandehurit nuk është pranuar për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të nenit 420 të K.Pr.Penale, si dhe kur gjykata është shprehur në vendim vetëm për ankimin e të pandehurit që ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe jo për gjithë të pandehurit[18]".

3.1.4. Së fundi, një çështje mjaft e diskutuar në praktikë, lidhet me legjitimimin e prokurorit për të kërkuar rivendosjen në afat. A mund të justifikohet pamundësia e organit të prokurorisë për të ushtruar të drejtën e ankimit për shkak të padijenisë, si rezultat i mosnjoftimit brenda organit të prokurorisë? Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen ***Xheraj v Republikës së Shqipërisë***, është shprehur se:

"*Gjykata shpreh keqardhjen e saj për faktin se gjykata e brendshme nuk përmbushi kërkesat e njoftimit të parashikuara në nenin 147 § 1 të KPrP-së…Gjykata nuk e pranon argumentin e Qeverisë se prokurori që mori pjesë në gjykimin në të cilin u vendos pafajësia, nuk kishte njoftuar eprorët e tij, duke çuar kështu në mosdepozitimin e një ankese brenda afateve kohore të parashikuara me ligj. Ajo gjykon se gabimet e autoriteteve shtetërore duhet t'i shërbejnë të pandehurit… Gjykata, gjithashtu vlerëson se argumentet e përdorura nga prokurori për të justifikuar kërkesën për rivendosje në afat ishin të pamjaftueshme për të justifikuar vënien në pikëpyetje të një vendimi përfundimtar dhe për të përdorur këtë mjet të jashtëzakonshëm. Gjykata është e mendimit se lejimi i kërkesës së prokurorit nuk vendos një baraspeshë ndërmjet interesit të ankuesit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale. Duke marrë parasysh këto konsiderata, Gjykata është e mendimit se duke i dhënë leje prokurorit për rivendosje në afat, Gjykata e Lartë cenoi parimin e sigurisë ligjore të parashikuar në nenin 6§1 të Konventës*[19]".

[18] *Idem*, fq. 11.

[19] Shih Xheraj v Shqiperisë, aplikimi nr.37959/02, 29 korrik 2008, pg. 57-61.

4. ORGANI KOMPETENT

Në lidhje me përcaktimin e gjykatës kompetente, neni 147 duket i paqartë, pasi ai përcakton se për kërkesën vendos organi që procedon në kohën e paraqitjes së saj. Ka mendime se gjykata kompetente do të jetë në çdo rast Gjykata e Shkallës së Parë që ka dhënë vendimin. Një tjetër mendim argumenton se, kompetente për të shqyrtuar kërkesën për rivendosjen e afatit të ankimit, kundër një vendimi gjyqësor është ajo gjykatë që ka dhënë vendimin që kërkohet të ankimohet. Po kështu, e diskutueshme është edhe çështja në lidhje me gjykatën kompetente për shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit të dhënë nga gjykata për rivendosjen në afat.

Përgjigja për problemet e sipërpërmendura ka ndryshuar në vazhdimësi. Kështu, në fillim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet qëndrimit unifikues argumentonin se: *"Pavarësisht nëse çështja është shqyrtuar në themel apo jo edhe nga gjykata e Apelit, kompetente për të shqyrtuar kërkesën për rivendosjen e afatit të ankimit është gjykata e shkallës së parë. Gjykata e apelit dhe, pas saj, Gjykata e Lartë, shqyrtojnë vetëm ankimet kundër vendimeve respektive*[20]*"***.**

Gjithsesi, ky qëndrim unifikues i Gjykatës së Lartë, u ndryshua nga Gjykata Kushtetuese e cila argumentoi se:

Së pari, në lidhje me gjykatën kompetente për të shqyrtuar kërkesën për rivendosje në afat:"… *Shprehja "organi që procedon" i referohet organit që ka dhënë vendimin, ndaj të cilit kërkon të ankohet i gjykuari. Pra, nëse i gjykuari kërkon të ushtrojë ankim ndaj vendimit të apelit, kërkesën për rivendosje në afat duhet ta shqyrtojë gjykata e apelit dhe jo gjykata e shkallës së parë. Në këtë këndvështrim, Gjykata arrin në përfundimin se organi që merr kërkesën për shqyrtim është organi që procedon në kuptim të nenit 147/4 të KPP*[21]*…* **"**

Së dyti, në lidhje me të drejtën e ankimit ndaj vendimit të pranimit ose jo të kërkesës për rivendosje në afat**: "…***Gjykata konstaton se e drejta e ankimit ndaj vendimit të pranimit ose jo të kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit është e parashikuar shprehimisht në nenin 147 të KPP. Duke analizuar përmbajtjen e nenit 147, rezulton se kemi të bëjmë me dy aspekte të ankimit: a) ankimi ndaj vendimit të pranimit të kërkesës për rivendosje në afat, i cili bëhet*

---

[20] Vendim unifikues nr 2 datë 14.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, fq. 4, pika 1. Në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, KB shprehen se: "*Gjersa gjykimi i çështjes për akuzën në fjalë në të dy gjykatat e faktit është bërë me trupa gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, atëherë nuk mund të pranohet që kërkesa per rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimeve të dhëna të shqyrtohet nga një gjyqtar i vetëm. Gjykimi nga një gjyqtar i vetëm do te ishte i pranueshëm në qoftë se Kodi i Procedurës Penale do ta parashikonte shprehimisht. Për rrjedhojë, kjo ide nuk gjen mbështetje*".

[21] Shih Vendim nr. 31 datë 17.05.2012 i Gjykatës Kushtetuese, fq. 10-11. Në vazhdim, Gjykata arsyeton: "*Gjykata çmon se një rol në keqinterpretimin e shprehjes "organi që procedon" luan edhe pika 6 e nenit 147 të KPP. Sipas pikës 6, "ankimi kundër vendimit të refuzimit të kërkesës mund të bëhet në gjykatën e apelit". Shprehja "në gjykatën e apelit" të çon në përfundimin se mospranimi është vendosur nga gjykata e shkallës së parë. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se kuptimi/zbatimi jo i drejtë i dispozitës së nenit 147/4 rrjedh pikërisht nga togfjalëshi "në gjykatën e apelit" i parashikuar në nenin 147/6 të KPP. Nëse pjesë e këtij togfjalëshi nuk do të ishte "e apelit", atëherë ankimi do të bëhej në gjykatën më të lartë respektive ndaj vendimit të dhënë nga një gjykatë më e ulët, kompetenca e së cilës do të përcaktohej sipas rastit. Në këtë mënyrë, do të garantohej edhe parimi i gjykatës së caktuar me ligj, parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata çmon se togfjalëshi "në gjykatën e apelit" bie ndesh me nenin 42/2 dhe 135 të Kushtetutës"*.

bashkë me vendimin përfundimtar; b) ankimi ndaj vendimit të refuzimit të kërkesës për rivendosje në afat, i cili mund të bëhet në gjykatën e apelit…Në rastin e parë, Gjykata çmon se Kolegji Penal në të njëjtën kohë duhet të shqyrtojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e kërkesës për rivendosje në afat si dhe bazueshmërinë e ligjshmërinë e themelit të çështjes, gjë e cila nuk përputhet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë[22]*…"*

Në mbeshtetje të vendimit të mësipërm të Gjykatës Kushtetuese, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë riunifikuar qëndrimin e tyre duke u shprehur se:

Së pari, në lidhje me gjykatën kompetente për të shqyrtuar kërkesën për rivendosje në afat: "*Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat është gjykata që ka dhënë vendimin ndaj të cilit ushtrohet ankimi. E thënë ndryshe, nëse kërkohet rivendosje në afat për të bërë ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kompetente për gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat do të jetë gjykata e shkallës së parë. Respektivisht, nëse kërkohet rivendosja në afat për të bërë ankim (rekurs) kundër vendimit të gjykatës së apelit, kompetente për gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat është gjykata e apelit*[23]*".*

Se dyti, në lidhje me të drejtën e ankimit ndaj vendimit të pranimit ose jo të kërkesës për rivendosje në afat**:** "*Pala (pjesëmarrëse në gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat), e cila nuk është dakord me vendimin për rivendosjen në afat, nuk mund të bëjë ankim në çdo kohë kundër këtij vendimi. Ajo (pala) mund të ankohet kundër vendimit të rivendosjes në afat, vetëm nëse ankohet për vendimin përfundimtar të gjykatës, që do të thotë kundër vendimit që ka zgjidhur çështjen në themel dhe vetëm bashkë me këtë vendim… Në rastin kur kërkesa për rivendosje në afat është refuzuar nga gjykata e rrethit gjyqësor, kundër këtij vendimi, pala kërkuese (prokurori, i pandehuri, palët private apo mbrojtësit) mund të bëjë ankim në gjykatën e apelit. Gjithashtu edhe në rastin kur kërkesa refuzohet nga gjykata e apelit, pala kërkuese mund të bëjë ankimin (rekursin) në Gjykatën e Lartë*[24]*".*

---

[22] *Idem,* fq.11-12. Në vazhdim, Gjykata arsyeton*: "…Mirëpo në një rast të tillë, zhvillimi i rigjykimit në themel të çështjes, kur më pas Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mund ta konsiderojë atë të paligjshëm për shkak se kërkesa mbi bazën e të cilit është rihapur gjykimi ka qenë e pabazuar në ligj, do të ishte e pakuptimtë dhe e padobishme për palët në proces. Gjykata çmon se në këtë rast kemi të bëjmë me një të drejtë ankimi jo efektive në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ, sepse palët, pas rigjykimit në themel, mund të përballen me një rezultat të ndryshëm pa patur mundësi të ankohen paraprakisht lidhur me bazueshmërinë në ligj dhe prova të kërkesës për rivendosjen ose jo në afat të së drejtës së ankimit... I takon ligjvënësit të parashikojë një mjet ankimi efektiv lidhur me këtë fazë për të garantuar efektivisht të drejtën kushtetuese të ankimit të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës dhe neni 13 i KEDNJ. Sa i takon ankimit ndaj vendimit të mospranimit të kërkesës që duhet bërë në gjykatën e apelit, Gjykata çmon se gjen vend arsyetimi i dhënë më sipër se në nenin 147/6 të KPP duhet të parashikohet e drejta e ankimit jo në gjykatën e apelit por në gjykatën më të lartë, sipas rastit, pa qenë nevoja e specifikimit të shkallës konkrete, pasi "organi që procedon" në raste të ndryshme mund të jetë i ndryshëm. Gjykata rithekson se sipas formulimit aktual të pikës 6 të nenit 147 të KPP, ku e drejta e ankimit kufizohet tek gjykata e apelit, le të nënkuptohet se kompetencën për të shqyrtuar ankimin e ka vetëm gjykata e rrethit gjyqësor, pavarësisht mjetit të ankimit që ushtron i gjykuari…"*

[23] Vendim Unifikues nr.1 datë 19.06.2013 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pg. 44.

[24] *Idem,* pg. 58-68. Në vijim, KB arsyetojnë se: "*Pra nëse kërkesën për rivendosje në afat e ka shqyrtuar gjykata e rrethit gjyqësor (dhe ka vendosur pranimin e saj), pala që nuk është dakord me këtë vendim mund të bëjë ankim ndaj tij vetëm nëse ankohet kundër vendimit të gjykatës së apelit që ka zgjidhur çështjen në themel në këtë rast (mbi bazën e ankimit të paraqitur bashkë me vendimin për rivendosje në afat), sepse ai është vendimi përfundimtar për të cilin shprehet ligjvënësi në pikën 5 të nenit 147 të K.Pr.Penal.*

5. EFEKTET E RIVENDOSJES NË AFAT

Efektet pasuese të pranimit të kërkesës për t'u rivendosur në afat, thelbësohen, në rivendosjen në të njëjtin pozicion kohor procedurial, me atë të cilin pala më parë e ka humbur[25]. Pra nëpërmjet rivendosjes në afat pala ka të drejtë që të përmbushë llojin e aktit të cilin nuk e kishte përmbushur[26]. Nga ana tjetër, duke patur parasysh se pala si rezultat i humbjes së afatit, nuk ka marrë pjesë në veprime proceduriale, ajo ka të drejtë që të kërkojë përsëritjen e tyre. Ky përbën edhe efektin e tërthortë të rivendosjes në afat.

Gjithsesi, vlen të theksohet se, që të urdhërohet përsëritja e veprimeve në të cilat pala kishte të drejtë të merrte pjesë, duhet patjetër që të plotësohen dy kushte:

1. Të ketë një kërkesë nga pala që ka kërkuar rivendosjen në afat.
2. Të jetë objektivisht e mundur një përsëritje e këtyre veprimeve.

Ligji disiplinon në një mënyrë të tillë duke lënë të kuptohet se, kërkesa e pranuar e rivendosjes në afat, nuk mund të bëhet shkak i "kthimit prapa të gjykimit"[27]. Është pikërisht gjykata e shkallës së parë që ka pranuar rivendosjen, ajo që përsërit veprimet, pra pa ndryshuar apo pa dërguar shqyrtimin gjyqësor në fazën e mëparshme të hetimeve paraprake[28]. I njëjti arsyetim vlen edhe nëse rivendosja në afat është vendosur nga gjykata e apelit. Ndërsa, në rastin e Gjykatës së Lartë, përsëritja e këtyre veprimeve bëhet nga gjykata që është kompetente për shqyrtimin në themel[29]. Arsyeja qëndron në faktin se ajo është një gjykatë ligji dhe jo fakti, dhe si e tillë nuk mund të realizojë përsëritjen e veprimeve ku duhet të merrte pjesë pala që ka kërkuar rivendosjen në afat.

Në analizë sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se qëndrimi i mbajtur nga ligjvënësi në këtë rast është plotësisht i drejtë, pasi nëse pala e cila nuk ka qenë dakord me vendimin për rivendosjen në afat, por është dakord dhe nuk ka ankim kundër vendimit përfundimtar që ka zgjidhur çështjen në themel, nuk do të bënte sens që kjo palë të ankohej vetëm kundër vendimit për rivendosjen në afat. Në këtë rast mjeti i ankimit do të ishte jo efektiv në kuptim të nenit 13 të KEDNJ…Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se situata duket e pazgjidhur plotësisht për rastin tjetër, kur kërkesën për rivendosje në afat e ka gjykuar gjykata e apelit. Në këtë rast vendimi përfundimtar, për të cilin bën fjalë ligjvënësi në pikën 5 të nenit 147 të K.Pr.Penale, është vendimi i Gjykatës së Lartë dhe palët nuk mund të ankohen kundër këtij vendimi… Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u nisur nga qëllimi përfundimtar i gjykimit, që është dhënia e drejtësisë dhe zgjidhja në themel e çështjes, çmojnë se, pavarësisht se pala nuk mund të ushtroje të drejtën e ankimit kundër vendimit të rivendosjen në afat e vendosur nga gjykata e apelit, kjo nuk përbën një shkelje të së drejtës për një mjet efektiv ankimi, pasi ky vendim mund të shihet si vendim i ndërmjetëm, si një vendim që jepet gjatë gjykimit për të siguruar zhvillimin e gjykimit në mënyrë të rregullt në pajtim me kërkesat e dispozitave procedurale".

[25] Lara, Dhimitër, "Koment mbi Kodin e Procedurës Penale" pjesa e parë, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja Morava, Tiranë 2010, faqe 495.

[26] *Idem*

[27] A.Galati, E.Zappala, "Diritto Processuale Penale" nuova ediz.2004, Giuffre editore, Vol.primo, la restituzione nel termine.

[28] Lara, Dhimitër, "Koment mbi Kodin e Procedurës Penale" pjesa e parë, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja Morava, Tiranë 2010, faqe 496.

[29] Neni 148 i KPrP, **Efektet e rivendosjes në afat:**

"1. Gjykata që ka vendosur rivendosjen në afat, me kërkesën e palës dhe për aq sa është e mundur, urdhëron përsëritjen e veprimeve në të cilat pala kishte të drejtë të merrte pjesë.

2. Kur rivendosja në afat bëhet nga Gjykata e Lartë, përsëritja e veprimeve vendoset nga gjykata që është kompetente për shqyrtimin në themel".

Në praktikë është evidentuar si problem rasti, kur i dënuari me vendim të formës së prerë, pasi është kapur dhe vendosur në institucionet e vuajtjes së dënimit, bën kërkesë për rivendosje në afat, e cila pranohet. Sipas këndvështrimit tim, do të duhej që ai të rikthehej në gjëndje të lirë, duke qënë se rimerr statusin e të pandehurit, përveç rastit kur ka një masë sigurie ndaj tij. Kjo është rrjedhojë logjike e faktit se ai duhet të vendoset në të njëjtat kushte sikurse në momentin e dhënies së vendimit të dënimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, kur i lind e drejta e ankimit, pasi vendimi nuk mund të ekzekutohet pa marrë formë të prerë[30].

6. KONKLUZIONE

Në përfundim , nga sa u trajtua më sipër, mund të konkludojmë se:

1. Rivendosja në afat përbën një përjashtim, në raport me detyrueshmërinë e palëve për të respektuar afatet e përcaktuara në KPrP. Ky përjashtim lidhet me pamundësinë e respektimit të afateve proceduriale për shkak të rastit fator ose forcës madhore, ose padijeninë e të pandehurit të gjykuar në mungesë.
2. Ajo ka si qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, konkretisht garantimin e ushtrimit të së drejtës për të kundërshtuar një vendim në një gjykatë më të lartë, nga palët në proces, në rastet e përcaktuara në mënyrë taksative nga ligjvënësi.
3. Subjektet e legjitmuar janë: a) për rastin fator ose forcën madhore, prokurori, i pandehuri, palët private dhe mbrojtësi b) I pandehuri, për rastin kur vendimi është dhënë në mungesë dhe provon se nuk ka marrë dijeni për të (këtë të drejtë ai mund t`ia delegoje me vullnetin e tij të lirë një mbrojtësi të caktuar prej tij nëpërmjet një akti përfaqësimi të lëshuar e të vërtetuar në formën e parashikuar në ligj).
4. Afati për ushtrimin e së drejtës për rivendosje në afat është 10 ditë nga dita kur është zhdukur fakti që përbënte rast fator ose forcë madhore, apo kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për aktin.
5. Pasi çështja është shqyrtuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, në mungesë të të pandehurit, ky i fundit ose mbrojtësi i tij nuk mund të kërkojë rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar rekurs ndaj të njëjtit vendim për të cilin Kolegji është shprehur njëherë mbi bazën e rekursit të mbrojtësit, me pretendimin se i pandehuri nuk është vënë në dijeni të vendimit (pasi do të vinte në kundërshtim me parimin *res judicata*). I njëjti qëndrim mbahet edhe në rastin e kërkesës për rivendosje në afat të të drejtës për të bërë apel pasi çështja është shqyrtuar në gjykatën e apelit.
6. Në çështjet penale me disa të pandehur, gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkë të pandehuri. Përjashtim bën rasti kur ankimi i bashkë të pandehurit nuk është pranuar për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të nenit 420 të K.Pr.Penale, si dhe

[30] Neni 462 i KPrP, **Vendimet e ekzekutueshme:**
"1. Vendimi penal i gjykatës vihet në ekzekutim menjëherë pasi të ketë marrë formë të prerë".

kur gjykata është shprehur në vendim vetëm për ankimin e të pandehurit që ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe jo për gjithë të pandehurit.

7. Pamundësia e organit të prokurorisë për të ushtruar të drejtën e ankimit për shkak të padijenisë, si rezultat i mosnjoftimit brenda këtij organi, nuk justifikon rivendosjen ne afat. E kundërta, do të cënonte procesin e rregullt ligjor.

8. Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat është Gjykata që ka dhënë vendimin ndaj të cilit kërkohet të ushtrohet e drejta e ankimit.

9. Kundër vendimit që refuzon rivendosjen në afat mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën më të lartë, sipas rastit.

10. Efekt i tërthortë i rivendosjes në afat: Gjykata që ka vendosur rivendosjen në afat, me kërkesë të palës dhe kur ekzistojnë mundësitë objektive, urdhëron përsëritjen e veprimeve në të cilat pala kishte të drejtë të merrte pjesë.

BIBLIOGRAFIA

1. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.
2. Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, "Procedura Penale", Botimet Morava, Tiranë 2010.
3. Dhimitër Lara "Koment mbi Kodin e Procedurës Penale" pjesa e parë, Shtëpia botuese dhe shtypshkronja Morava, Tiranë 2010
4. Gentian Trenova, "INTERPRETIME GJYQËSORE TË K.PR.PENALE" (Ripunim), Botimet "Dita 2000", Tiranë 2009.
5. F.del Giudice (2008), Dizionario Giuridico, Enciclopedia di base del diritto, VII ediz.Simone editore, Forza maggiore.
6. A.Galati, E.Zappala, "Diritto Processuale Penale" nuova ediz.2004, Giuffre editore, Vol.primo, la restituzione nel termine.
7. Paolo Tonini, "MANUALE DI PROCEDURA PENALE". Undicesima edizione. Giuffre editore, Milano 2010.
8. Vendim Unifikues nr 2 datë 14.10.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.
9. Vendim Unfikues nr. 1 dt 20.01.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Larte.
10. Vendim Unfikues nr. 1 dt 19.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Larte
11. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 30 datë 17.06.2010
12. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.31 datë 17.05.2012.
13. Xheraj v Shqiperisë, aplikimi nr.37959/02, 29 korrik 2008, vendim i GjEDNj-së.

NJOHJA E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE NË BE.

Belinda HALILAJ

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Vlorë/Shqipëri
Departamenti I Drejtesise
belindahalilaj@yahoo.it

Abstrakt

Çdo shtetas i një shteti anëtar të Bashkimit Europian ka të drejtën të lëvizi në mënyrë të lirë dhe të vendoset në një shtet tjetër anëtar. Qëndrimi në një shtet tjetër mund të jetë i përkohshëm ose i përherëshëm. Ky shtetas ka të drejtën të punësohet, në shtetin në territorin e të cilin vendoset, ose të vetëpunësohet. Hyrja në marrëdhënien punëdhënës-punëmarrës mund të jetë në bazë të profesionit që ky individ është kualifikuar ose pajisur me një titull të caktuar, ose jashtë profesionit te tij. Jo gjithmonë një individ mund të punësohet ose të ushtroj një aktivitet në mënyrë të pavarur në territorin e një shteti tjetër anëtar të BE-së në bazë të kualifikimit profesional që zotëron. Mos punësimi në profesionin në cilën personi është kualifikuar shpeshë është trajtuar dhe si burim konfliktesh, rritje e nivelit te papunësisë etj...

Fjalët kyçe: Njohje profesioni, vendosje, Korniza Europiane e Kualifikimeve etj…

Hyrje

Në shtator të 2005, pas periudhës së tranzicionit të lirisë së ofrimit të shërbimeve, Parlamenti dhe Këshilli adoptuan një direktivë të re mbi njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale, direktivën 2005/36 e cila hyri në fuqi me 20 tetor të vitit 2007.

Direktiva 2005/36 thjeshton sistemin e njohjes së kualifikimeve profesionale duke vendosur një instrument të vetëm ligjor të modernizuar, që zevëndëson 15 direktivat e adoptuara gjatë viteve të fundit, e me konkretisht zëvendëson direktivat mbi një sistem të përgjithshëm për njohjen e arsimit dhe trajnimit profesional Direktivën 89/48/KEE, Direktivën 92/51/KEE dhe Direktivën 99/42/KE si dhe 12 direktivat sektoriale që kanë lidhje me doktorët, infermierët, dentistët, kirurgët veterinerë, mamitë, farmacistët dhe arkitektët.

Direktiva 2005/36 mbulon njohjen e kualifikimeve të avokatëve, por Direktiva 98/5/KE, që ka të bëjë me të drejtën e vendosjes së avokatëve dhe Direktiva 77/249/KEE që ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve të avokatëve nuk preken nga ajo, për faktin se ato kanë të bëjnë me lejen apo autorizimin për praktikimin e profesionit të avokatit dhe jo njohjen e kualifikimeve të tij.

Duke qënë se liria e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve u kërkon shtetasve komunitare që të kenë kualifikime profesionale për të ushtruar aktivitetet e tyre Direktiva ka si qëllim tu shërbejë atyre që kanë fituar një kualifikim profesional në një shtet anëtar dhe dëshirojnë ta ushtrojnë atë në një shtet tjetër anëtar të BE-së.

1. E drejta e vendosjes

Me të drejtë për vendosje do të kuptojmë gëzimin dhe garantimin e lirisë së shtetasve komunitare për t'u vendosur në një shtet tjetër anëtar, i ndryshëm nga ai i orgjinës për arsye vetëpunësimi. Këta shtetas gezojnë në mënyrë të lirë të drejtën për të ndërmarrë dhe për të zhvilluar veprimtari dhe aktivitete, qofshin këto edhe në profesion të lirë, nga personat fizikë ose juridikë në mënyrë të qëndrueshme. Kjo veprimtari parashikohet dhe rregullohet dhe nga neni 48 i TBE në të cilën parashikohet se: Parlamenti Europian dhe Këshilli, duke vepruar sipas një procedure së zakonshme legjislative, miratojnë masa në fushën e sigurimeve shoqërore që janë të nevojshme për të siguruar lirinë e lëvizjes për punonjësit[1]. Për këtë qëllim ata marrin masat për të siguruar si punonjësit migrues:

a. të punësuar,
b. të vetëpunësuar,
c. si dhe personat që i kanë këta në varësi.

Ndalohet zbatimi i kufizimeve mbi lirinë e vedosjes së shtetasve të një Shteti Anëtar në territorin e një Shteti Anëtar tjetër. Në nenin 49 të TFBE ky ndalim zbatohet edhe për kufizimet mbi ngritjen e agjencive, degëve ose filialeve nga shtetasit e çdo Shteti Anëtar të vendosur në territorin e një shteti anëtar tjeter[2]. Kjo liri konsiston në: ushtrimin e aktiviteteve private nga personat fizik dhe juridik, kur trajtojmë aktivitete private duhet të kemi parasysh profesionet e lira, shoqeritë tregtare etj…Kushtet që do të aplikohen do të jenë të njejta me ato kushte që vendi i qëndrimit parashikon kundrejt qytetarëve të tij.

Duhet bërë dallimi midis lirisë për vendosje dhe lirisë për ofrimin e shërbimeve:

- liria për vendosje përfshin të drejtën për të nisur dhe vazhduar një aktivitet të qëndrueshëm në një shtet tjetër i ndryshëm nga shteti i orgjinës;
- liria për ofrimin e sherbimeve përbën mundësinë për të dhënë shërbimet e veta në një shtet tjetër të Komunitetit,sipas bashkëautorëve kjo duhet që të jetë" në të njëjtat kushte me profesionistët vendas, por pa qëndrim të përhershëm"[3].

Parimi i lirisë së vendosjes mundëson (nëse një person apo një kompani) për të kryer një veprimtari ekonomike në një mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme në një ose më shumë Shteteve Anëtare, duke respektuar parimin e lirisë për të ofruar shërbime. Këto dispozita kanë efekt të drejtpërdrejtë. Kjo do të thotë, në praktikë, se shtetet anëtare duhet të modifikojë ligjet kombëtare që kufizojnë lirinë e krijimit, apo me lirinë për të ofruar shërbime, dhe për këtë arsye janë të papajtueshme me këto parime. Shtetet Anëtare mund të mbajë vetëm kufizime të tilla në rrethana të veçanta ku këto janë të justifikuara nga shkaqe thelbësore me interes të përgjithshëm, për shembull për shkak të politikës publike, sigurisë publike ose shëndetit publik, dhe ku ata janë proporcionale. Sipas traktateve Komisioni është përgjegjës për të siguruar se ligji Komunitar, duke përfshirë nenet 49 dhe 56, është aplikuar siç duhet.

---

[1] "Traktati i Bashkimit Europian", *Versioni i konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Europian dhe Karta e të drejtave themelore e Bashkimit Europian*, Ministria e Integrimit, ISBN 978-99956-51-22-0, Tiranë 2011, Neni 48, faqe 67.

[2] Po aty, faqe 68.

[3] Canaj.E; Bana.S: " E drejta e Bashkimit Europian", SHB "Arbëria 07", Tiranë 2011, faqe 221.

2. Ushtrimi i profesionit në një shtet tjetër anëtar të BE-së

Natyrshem shtrohet pyetja a mundet një shtetas komunitar të ushtrojë profesionin e tij në një shtet tjetër anëtar të BE-së? Kur trajtuam të drejtën e vendosjes shpjeguam së këta shtetas gezojnë në mënyrë të lirë të drejtën për të ndërmarrë dhe për të zhvilluar veprimtari dhe aktivitete, qofshin këto edhe në profesion të lirë, nga personat fizikë ose juridikë në mënyrë të qëndrueshme. Këta shtetas në mënyrë të lirë gëzojnë të drejtën e vetëpunesimit në shtetin në të cilin këta persona vendosen, shtet ky i ndryshëm nga ai i orgjinës. Që këta shtetas komunitarë të vetëpunesohen në profesionin e tyre, në atë shtet në të cilin ata shkojnë duhet fillimisht t'iu njihet diploma apo kualifikimet e ndryshme që ata mund të kënë kryer. Të gjitha trajtimet diskriminuese[4] mbi bazën e kombësisë në lidhje me krijimin dhe ofrimin e shërbimeve janë të ndaluara.

Parlamenti Europian dhe Këshilli në vazhdimësi kanë nxjerrë një sërë direktivash për njohjen e ndersjelltë të diplomave, certifikatave dhe dëshmive të tjera të kualifikimeve formale, më qëllim për të lehtësuar ushtrimin e një aktiviteti si të vetëpunësuar. Në rastin e profesioneve mjekësore dhe farmaceutike në nenin 53 të TFBE thuhet se ndalimi progresiv i kufizimeve varte nga bashkërendimi i kushteve për ushtrimin e tyre ne shtete e ndryshme anëtare.

Traktati i Lisbonës sipas bashkëautorëve "trajton dy traktate me të njëjtën vlerë"[5]: Traktatin e Bashkimit Europian dhe Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Europian.Traktati i Lisbonës ka sjellë risi në lidhje me të drejtën e vendosjes duke parashikuar në nenin 51 të TFBE se e drejta e vendosjes mund të ushtrohet edhe për aktivitete që në shtetin pritës marrin pjesë ose ushtrojnë një veprimtari në mënyrë të rastësishtme, në ushtrimin e nje pushteti publik. Ushtrimi i profesionit të avokatit ka qënë objekt mosmarrëveshje në mënyrë të vazhdueshme, sepse ky profesion konsiderohej me karakter publik.

2.1 Njohja e kualifikimet profesionale në BE.

Qarkullimi i lirë i punëtorëve është shoqëruar me pengesa të shumta, këto pengesa kanë ardhur si rrjedhojë e kufizimeve kombëtare. Me të drejtën e vendosjes, një shtetas komunitar ka të drejtën të vetëpunësohet. Ky shtetas gëzon të drejtën për të qënë i lirë në territorin e shtetit tjetër anëtar në të cilën ky është vendosur, me venbanim të përkohshëm ose të përhereshëm. Një problematik me të cilën do te perballet cdo shtetas ne territorin e nje shteti tjeter eshte punesimi.Problematiken e punesimit duhet ta trajtojme ne dy plane:
së pari: kur ky shtetas do te punesohet ne nje institucion shteteror ose ne nje veprimtari prvate;
së dyti: kur ky shtetas do te vetepunesohet.

Në të drejtën e brëndshme të një shteti sipas autorit Arben Puto: "shtëtësia është një gjendje juridike e cila e lidhë një person me të drejta dhe detyrime"[6] , me atë shtet në territorin e të cilit ky shtetas jeton , dhe që gëzon shtetësin e atij shteti. Në të drejtën komunitare parashikohet që një shtetas komunitar gëzon të njëjtat të drejta dhe detyrime me atë shtetas të atij shteti në territoin e të cilit ky i fundit do të vendoset. Çdo person i cili mban shtetësinë e një vendi të BE-së është automatikisht edhe një shtetas i BE-së, shtetësia është shtesë për të dhe nuk zëvendësonë shtetësinë kombëtare. Kjo është për çdo vend të BE-së për të hedhur poshtë kushtet për fitimin dhe humbjen e shtetësisë së atij vendi.

Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Europian përfshin të drejtën për:

- të lëvizur dhe banuar lirisht brenda BE-së;

---

[4] http://ec. europa. eu/ Direktiva 1999/42 KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 7 qershor 1999
[5] Chalmers.D; Davides.G; Monti.G: " Europian Union Law", Cambrige: University Press, 2010, fq. 40
[6] Puto.A: "E drejta ndërkombëtare publike", SHB "albin", Tiranë 2002, fq.240

- votojnë për dhe të qëndrojë si kandidat në Parlamentin Europian dhe zgjedhjet komunale;
- të jetë i mbrojtur nga autoritetet diplomatike dhe konsullore të çdo vendi tjetër të BE-së;

I gjithë sistemi komunitar për njohjen në mënyrë reciproke të kualifikimeve profesionale ka qenë objekt i riorganizimit me direktivën 2005/36 KE të datës 7 shtator 2005. Kjo direktivë përcakton tri sisteme për njohjen e kualifikimeve:[7]

1. njohje automatike për profesione për të cilat kushtet minimale të trajnimit kanë qenë të harmonizuara (profesionistët e shëndetit, arkitektë, kirurgët, veterinarë);
2. sistemi i përgjithshëm për profesione të tjera të rregulluara;
3. njohja në bazë të përvojës profesionale për aktivitete të caktuara profesionale.

Në rastin e ushtrimit të profesioneve në mënyrë të vazhdueshme e përhershme duke u vendosur në një shtet anëtar të ndryshëm nga ai i origjinës, direktiva 2006/36 parashikon 3 sisteme njohjeje sipas llojit të aktiviteteve:

1. njohje automatike për profesionet sektoriale;
2. njohje mbi bazën e sistemit të përgjithshëm;
3. njohja automatike e kualifikimeve mbi bazën e eksperiencës profesionale.

Natyrëshëm shtrohet pyetja se çfarë do të kuptojmë me kualifikim profesional? Me kualifikim profesional do të kuptojme marrjen e njohurive në një fushë të caktuar, si dhe pajisjen me dëshmi, diploma apo me çertifikatën përkatëse. Vetë fjala kualifikimi do të thotë një rezultat zyrtar të një procesi vlerësimi dhe vlerash që është marrë kur autoriteti kompetent përcakton se rezultatet e të mësuarit të një personi të korrespondojnë me standardet e caktuara.

Ajo që duhet të shpjegojmë është se jo të gjitha profesionet janë njohur apo njihen në mënyrë të lirë në BE. Një ndërë profesionet e lira që ka hasur pengesa në njohje dhe në realizimin e kësaj të drejte për t'u punësuar në një nga shtete anëtare të komunitetit është profesioni i avokatisë. Vlerësimi i kualifikimeve kryhet nga instrumenta të posaçëm, e tillë është "Korniza Kombëtare e Kualifikimeve" që do të thotë një instrument klasifikimi i kualifikimeve sipas kritereve të vendosur në bazë të niveleve të arritjes së mësuarit specifikë. Ai synon për të integruar dhe realizuar koordinimin e nënsistemeve kombëtare të kualifikimeve.

2.2 Rruga për realizimin e njohjes së profesioneve në BE.

Dy të tretat e të rinjve kalojnë në njerën prej rrugëve të formimit profesional. Formimi i alternuar «i dyfishtë» (shkollë/ndërmarrje) përbën mënyrën kryesore të marrjes së njohurive profesionale. Në vendet e BE-së profesionet më të njohura janë: ai i mjekut, arkitektit,veterinerit, inxhinieria etj…Nje trajtim te vecante duhet te kete profesioni i avokatit, një pozicion unik në mesin e profesioneve në Evropë, pasi: së pari, avokatët kanë një funksion të rëndësishëm në administrimin e drejtësisë dhe në ruajtjen e sundimit të ligjit; së dyti, avokatët luajnë një rol jetik në ekonomitë e Shteteve Anëtare dhe funksionimin e tregut të brendshëm të Bashkimit Evropian; së treti, profesioni i avokatit është vënë në shënjestër në mënyrë specifike pasi ai është i bazuar në sistemet ligjore kombëtare në të cilën avokatët e ardhshëm kualifikohen dhe ushtrojnë praktikat profesionale. Në përgjithësi, kjo do të thotë se avokatët janë të trajnuar dhe, prandaj, janë ekspertë në sistemet e tyre respektive ligjore, por kjo nuk dmth që domosdoshmërisht të kenë edhe njohuri të sistemeve të tjera ligjore. Kriteret e kualifikimit dhe shtrirjes (ose madje edhe ekzistencës) së aktiviteteve që mund të kryhen vetëm

[7] http://ec. europa. eu/ Direktiva 2005/36/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 7 shtator 2005

nga juristët (monopolet) ndryshojnë në masë të madhe në mes të Shteteve Anëtare, e kjo përbën një ndërlikim në realizimin e lëvizjes së lirë të avokatëve në Bashkimin Evropian[8].

Profesioni ligjor i avokatit në BE rregullohet nga kuadri ligjor i mëposhtëm:

• Direktiva 77/249 mbi lehtësimin e ushtrimit nga avokatët të lëvizjes së lirë të shërbimeve

• Direktiva 98/5 mbi vendosjen e avokatëve

• Direktiva 2005/36 mbi njohjen e kualifikimeve profesionale

Njohja e kualifikimeve profesionale të përftuara në vendin e origjinës është shpesh, një parakusht për të gjetur punë në një vend anëtar, në Gjermani: në rast se përfundon studimet apo një kurs formimi jashtë dhe dëshironi të punoni serisht në Gjermani në profesionin për të cilin keni studiuar, është e rëndësishme të përcaktohet nëse kualifikimi që keni marrë jashtë njihet si i barasvlershëm me një kualifikim gjerman apo nëse njihet profesionalisht. Si vlerësohen kualifikimet? Para së gjithash, është e nevojshme të përcaktohet nëse diploma universitare jep nje mundësi per t'u bërë pjesë e një profesioni të rregulluar në Gjermani. Proçedura zyrtare e njohjes është e nevojshme (dhe e mundur) vetëm për profesionet e rregulluara.

Në Gjermani ka rreth 60 profesione të rregulluara (p.sh., i mjekut, mësuesit, profesione mjekësore dhe ligjore). Pjesa më e madhe e profesioneve në Gjermani nuk janë të rregulluara (p.sh., profesioni i fizikanit, profesionet tregtare etj…). Kjo nënkupton se nuk ka kushte të detyrueshme për kryerjen e këtyre profesioneve dhe për rrjedhojë, as proçedure njohjeje.
Në të vërtetë, është punëdhënësi që bën njohjen. Rrjedhimisht, rekomandohet aplikimi për një certifikatë njohjeje, pasi nuk mund të garantohet në mënyrë absolute se punëdhënësi gjerman do të jetë në gjendje të vlerësojë çdo kualifikim të një kursi studimi apo kompetence profesionale.

Komisioni ka vendosur që të sjellë para Gjykatës së Drejtësisë nje rast kundër shtatë shteteve anëtare (Gjermania, Spanja, Irlanda, Italia, Holanda, Austria dhe Britania e Madhe) për dështim për të njoftuar atë per zbatimin e Direktivës 1999 / 42/EC, ne legjislacionin e tyre për njohjen e kualifikimit profesional për profesione të caktuara, industriale tregtare dhe artizanale, të tilla si: elektricistë, shtruesit e pllakave dhe rrobaqepës. Kjo Direktivë përfshin dispozitat e direktivave të shfuqizuara, në lidhje me njohjen e kualifikimeve, kjo njohje automatike vendoset nga përvoja profesionale e aplikantit. Ajo gjithashtu i lejon ata të cilët nuk kanë përvojën e nevojshme profesionale për të aplikuar për njohje, në kushte të caktuara, të diplomave, çertifikatave të tyre apo kualifikimeve të tjera arsimore.

Zhvillimi dhe njohja e diturisë, aftësitë dhe kompetencat e qytetarëve janë themelore për zhvillimin e individëve, konkurrenca, punësimi dhe kohezioni social. Ato duhet të nxisin lëvizjen punëtore dhe nxënësit duhen ndihmuar per të përmbushur nevojat e ofertës dhe kërkesës në tregun Europian të punës. Për realizimin e këtij qëllim, ajo është e përshtatshme për të promovuar dhe për të përmirësuar në nivel kombëtar dhe në nivel Komunitar, qasjen dhe pjesëmarrjen në mësimin gjatë gjithë jetës për të gjithë, duke përfshirë edhe grupet e pafavorizuara, dhe përdorimin e kualifikimeve, sipas specialitetit përkatës. Në konkluzionet e Këshillit Evropian të Lisbonës ne vitin 2000 u arrit në përfundimin se transparenca në rritje për kualifikimet profesionale duhet të jetë një nga komponentët kryesorë e më të nevojshëm për të përshtatur sistemet e arsimit dhe të trajnimit në nevojat e shoqërisë së dijes. Përveç kësaj,Këshilli Europian i Barcelonës në vitin 2002 bëri thirrje për bashkëpunim më të ngushtë në arsimin e lartë dhe transparenca e përmirësuar dhe metodat per realizimin e njohjes në fushën e arsimit dhe trajnimit

[8] Reçi.S, " **L**ëvizja e lirë e shërbimeve në tregun unik evropian dhe perspektiva në kuadër të zgjerimit të Bashkimit Evropian", Tiranë, 2013, fq 136.

profesional. Rezoluta e Këshillit të 27 qershor 2002 “Për të mësuarit gjatë gjithë jetës” ka ftuar Komision në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin dhe Shtetet Anëtare për të zhvilluar një kornizë për njohjen e kualifikimeve për edukimi dhe trajnimi në bazë të rezultateve te proçesit të Bolonjës dhe iniciativave që promovojnë në fushën e formimit profesional.

Cili është funksioni i Kornizës Europiane të Kualifikimeve?

Në prill 2008, pas një pune të gjatë përgatitore dhe pas një proçesi të gjerë konsultimi që ka parë përfshirjen e aktorëve relevantë në të gjitha vendet pjesëmarrëse në "Arsimin dhe Formimin 2010", Parlamenti Europian dhe Këshilli miratuan Rekomandimin në lidhje me krijimin e një Kornize Europiane të Kualifikimeve për mësimin gjatë gjithë jetës (KEK) . Rekomandimi sjell në fund një karrierë politike që ishte nisur nga Këshilli Europian në Lisbonë në vitin 2000 dhe, për sa i përket konkretisht segmentit të arsimit dhe trajnimit profesional (AFP), e cila u formalizua e plotë me Deklaratën e Kopenhagenit në 2002[9], me një angazhim të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian për të forcuar bashkëpunimin në fushën nëpërmjet krijimit të një sërë mjetesh të zakonshme në nivel europian (të ashtu-quajtur "Toolbox" Community: korniza e vetme për transparencën).
KEK është një kornizë e përbashkët Europiane të referencës që lidhë sistemet e kualifikimit të vendeve të ndryshme, duke vepruar si një lloj pajisje për të bërë kualifikimet më të lexueshëm dhe më të kuptueshëm në të gjithë vendet dhe sistemet e ndryshme europiane.
Ajo ka dy objektiva kryesorë:
së pari: për të promovuar lëvizjen ndër-kufitar te qytetarëve dhe

së dyti: për të lehtësuar të mësuarit gjatë gjithë jetës .

Tetë janë nivelet e saj, duke marrë parasysh një gamë të plotë të kualifikimeve, nga një nivel bazë (niveli 1, për shembull nga arsimi fillor) deri në një nivel më të përparuara (Niveli 8, për doktoraturë). Si një mjet për promovimi e të mësuarit gjatë gjithë jetës, KEK përfshin të gjitha nivelet e kualifikimeve të fituara në arsimin e përgjithshëm, profesional dhe akademik dhe trajnim profesional, si dhe kualifikimeve të fituara në arsim dhe trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm. KEK pranon se sistemet e arsimit dhe trajnimit në Europë ndryshojnë dhe në kete pikë është e nevojshme për të zhvendosur fokusin në rezultatet sepse të mësuarit duhet të bëhen krahasime dhe për të krijuar bashkëpunimin ndërmjet vendeve dhe institucioneve të ndryshme.

Shtetet anëtare për realizimin e objektivave mbështeten në këto pika kombëtare koordinuese duke kryer funksionet e mëposhtme:
a) nivelet e kualifikimeve, referenca brenda sistemeve kombëtare me ato të Kornizës Europiane, kualifikimet e përcaktuara në Shtojcën II;

b) të sigurojë që metodologjia e përdorur për të lidhur kualifikimet kombëtare në nivele me Kornizën e Kualifikimeve Europiane transparente dhe për të lehtësuar krahasime midis tyre, nga njëra anë, dhe për të siguruar që vendimet që dalin prej tij të jenë botuar;

c) t’u sigurojë palëve të interesuara qasje në informata dhe udhëzime të vendosura në mes të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kualifikimet Europiane nëpër sistemet e Kualifikimeve Kombëtare;

d) të promovojë pjesëmarrjen e të gjitha palëve, duke përfshirë, në përputhje me legjislacioni dhe praktika, institucionet e arsimit të lartë, institucionet arsimore dhe trajnim profesional, partnerët socialë, sektorët dhe ekspertët në krahasim dhe Kualifikimet në nivelin Europian. Objektivi i

[9] Nënshkruar nga ministrat përgjegjës për arsimin dhe trajnimin në 31 shtete: 27 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, Turqia dhe vendet që i përkasin Zonës Ekonomike Evropiane (Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia).

përgjithshëm i rekomandimit KEK është për të siguruar ushqim për të menduar dhe për të nxitur reformat e arsimit dhe të trajnimit kombëtare, duke mbajtur parasysh specifikat e secilës[10].

Sot në lidhje me çeshtjen mbi njohjen e kualifikimeve ende problematike ngelet profesioni i avokatit.

Traktati I Lisbones ka sjellë nje risi në lidhje me të drejtën e vendosjes duke përcaktuar në nenin 51 TFBE se e drejta e vendosjes mund të ushtrohet edhe për aktivitete që në shtetin prites marrin pjesë në mënyrë rastësore, në ushtrimin e funksioneve publike. Me anë të kësaj dispozite duhet treguar kujdes edhe vetë gjykata është shprehur se ky përjashtim i referohet rasteve të ralla dhe nuk duhet të kapërcejë kufirin për të cilin është lejuar. Një situatë e tillë u krijua për shkak të mosmarrëveshjes për profesionin e avokatisë, pasi pretenduesit e konsideronin këtë profesion me karakter publik. Gjykata vendosi se nenin 45 TBE (sot neni 51 TFBE) duhet të perfshinte dhe aksesin në ato aktivitete që konsiderohen si një pjesëmarrje e drejtëpërdrejtë dhe specifike në ushtrimin e aktiviteteve publike, praktikë kjo që u unifikua më pas nga rasti i ceshtjes "Reyners"[11].

Në ndryshim nga sektorët e tjerë ekonomik, ku pengesat në qarrkullimin e lirë të punëtorëve kishin të bënin më shumë me kufizimet kombëtare, në rastin e njohjes së profesioneve të lira e veçanërisht të avokatit, pengesa për ofrimin e shërbimeve është e lidhur me mosekuivalentimin e titujve të studimit dhe kualifikimeve profesionale të kryera në shtete të ndryshme anëtare. Për këtë arsye për të patur një harmonizim të sektorit të institucioneve komunitare është dashur të nxirren direktiva të ndryshme, me anë të së cilave specifikohen kushtet e përgjithshme për njohjen në mënyrë reciproke të titujve të studimit. Pavarësisht nxjerrjes së disa direktivave, për ushtrimin e disa profesioneve këto masa kanë rezultuar të pamjaftushme për të garantuar lirinë e qarkullimit për profesionistët. Ato kategori të caktuara subjektesh të cilat nuk kanë arritur të mos punësohen në një shtet tjetër anëtar në profesionin e tyre u është dhënë mundësia për t'u punësuar në sektorë të tjerë, politikë kjo e cila ka sjellë uljen e papunësisë.

---

[10] http:// www.nrpitalia.it

[11] http://ec. europa. eu/ Në rastin e Reyners *versus*. Belgjikë, vendimi i datës 21 qershor 1974.

Konkluzione

Në ditët e sotme në Bashkimin Europian, edhe pse në mënyrë të vazhdueshme janë nxjerrë një numër i madh direktivash, vazhdon të ketë një mungesë përsa i përketë njohjes së disa kualifikimeve profesionale dhe titujve të caktuar të diplomave. Sot në BE disa prej kualifikimeve profesonale nuk njihen sepse disa prej shteteve anëtare nuk njohin dhe konvertojnë disa tituj dhe diploma të fituara në një shtet tjetër anëtar. Kjo mosnjohje e kualifikimeve profesionale dhe titujve të diplomave vjen si rezultat se disa shtete të BE-së nuk ndjekin të njëjtën proçedurë për njëhsimin e tyre. Duke mos ndjekur të njëjtën proçedure njohje do të krijohet një vakum ligjor, gjë që do të shoqërohet më pas me pasoja të tjera siç është dhe mospunësimi në profesionin e marrë si dhe rritja e punëtorëve të punës fizike, e shpeshë herë dhe me rritje papunësie.

Bibliografia

[1] Canaj.E, Bana.S, *E drejta e Bashkimit Europian*, SHB "Arbëria 07", Tiranë 2011
[2] Chalmers.D, Davides.G, Monti.G, *Europian Union Law*, Cambrige: University Press, 2010
[3] Puto.A, *E drejta ndërkombëtare publike*, SHB "albin", Tiranë 2002
[4] "Traktati i Bashkimit Europian", *Versioni i konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Europian dhe Karta e të drejtave themelore e Bashkimit Europian*, Ministria e Integrimit, ISBN 978-99956-51-22-0, Tiranë 2011
[5] "Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Europian", *Versioni i konsoliduar i Traktateve të Bashkimit Europian dhe Karta e të drejtave themelore e Bashkimit Europian*, Ministria e Integrimit, ISBN 978-99956-51-22-0, Tiranë 2011
[6] http:// www.nrpitalia.it
[7]http://ec.europa.eu/internal_market/qualifications/directive_in_practice/automatic_recognition/index_fr.htm
[8] Reçi.S, " **L**ëvizja e lirë e shërbimeve në tregun unik evropian dhe perspektiva në kuadër të zgjerimit të Bashkimit Evropian", Tiranë, 2013

PËRDORIMI I RAPORTEVE FINANCIARË NË IDENTIFIKIMIN E RISQEVE TË BRENDSHËM FINANCIARË

RAST STUDIMI: NJË SUBJEKT JURIDIK NË QYTETIN E VLORËS.

MSc.Blerina Dervishaj

Departamenti i Financës, Universiteti i Vlorës"Ismail Qemali"

Sheshi "Pavarësia", Vlorë,Shqipëri

Email:blerina.dervishaj@univlora.edu.al

Abstrakt: Manaxhimi i riskut është një sfidë për shumicën e shoqërive. Shumë prej tyre nuk mund të kryejnë një analizë të mjaftueshme për të identifikuar risqet, për shkak të mangësive që mund të kenë në bazën e të dhënave apo në njohuri të specializuara. Nisur nga fakti që literatura ekzistuese mbi manaxhimin e riskut për shoqëritë tregtare është paksa sipërfaqësore,synimi i punimit është të propozojë mënyra për të identifikuar dhe analizuar risqet financiarë të brendshëm të këtyre kompanive, si faza të para, por shumë të rëndësishme në proçesin e manaxhimit të riskut. Duke u fokusuar tek risqet e brendshëm financiarë, kjo temë përpiqet të shndërrojë teorinë e Manaxhimit të Riskut Financiar në Praktikë. Pra, të arrihet një mjet i mundshëm, i aplikueshëm nga shoqëritë, në funksion të manaxhimit të risqeve të brendshëm financiarë të tyre. Një mënyrë për të identifikuar risqet financiare është nëpërrmjet analizës së raporteve kryesorë financiarë. Kjo analizë duhet të jetë e besueshme si dhe e lehtë për t'u aplikuar kur vlerësohet risku i paaftësisë paguese ose i falimentimit të një shoqërie.

Metodologjia: Metodologjia e këtij punimi konsiston në shfrytëzimin e literaturës ekzistuese në lidhje me studimin; kryerjen e një studimi empirik i cili konsiston në studimin e pasqyrave financiare të një grupi biznesesh të mëdha të cilët operojnë suksesshëm në qytetin e Vlorës; ndërthurjen e përfundimeve të studimeve të mëparshme me elementë të studimit empirik për të bërë të mundur krahasime të mëtejshme në marrjen e një Biznesi të Madh si Rast Studimi dhe vlerësimin e pozicionit financiar të saj.

Fjalë kyç: identifikimi i riskut, risk i brendshëm financiar, analizë financiare, raporte financiare.

1. Hyrje

Motivuar nga fakti që literatura ekzistuese mbi manaxhimin e riskut është paksa sipërfaqësore, synimi i artikullit është të propozojë mënyra për të manaxhuar risqet e brendshëm financiarë të shoqërive. Të gjitha shoqëritë ndeshen me risqet e biznesit, të cilat në rastin më të keq mund të çojnë drejt falimentimit.

Synimi është të arrihet një mjet i mundshëm për identifikimin, analizën, monitorimin e riskut, i aplikueshëm nga shoqëritë për të manaxhuar risqet e tyre të brendshëm financiarë. Për këtë qëllim është zgjedhur analiza financiare, e cila është përdorur në kërkim për të identifikuar treguesit e falimentimit të shoqërive. Identifikimi, analiza, monitorimi bazohet në një grup raportesh financiarë, të cilat kanë qenë eficentë për identifikimin e riskut në kërkime të ndryshme.

Kemi marrë në studim një shoqëri të cilës do të përpiqemi t'i manaxhojmë riskun duke analizuar raportet financiarë të saj. Si fillim duhet të klasifikojmë situatën financiare të shoqërisë si riskoze ose jo. Për të bërë të mundur klasifikimin e situatës riskoze të shoqërisë, të dhënat e shoqërisë krahasohen më të dhënat e dy grupeve. Nga njëra anë janë të dhënat e shoqërive të falimentuara që përbëjnë zonën kritike(të dhënat e të cilave i kemi marrë nga rezultatet e studiuesve të ndryshëm) dhe nga ana tjetër, janë të dhënat e shoqërive të suksesshme (të dhënat e të cilave i kemi llogaritur nga raportet vjetore të 17 Subjekteve Juridikë për pesë vitet e fundit). Duke u krahasuar me këto 2 grupe, situata aktuale e riskut të një shoqërie mund të analizohet dhe mund të identifikohen aspekte kritike të financimit,likuiditetit apo aftësisë paguese.Duhen identifikuar mënyra dhe struktura të standardizuara që shoqëria të analizojë edhe më thellë burimet e risqeve të identifikuar si dhe t'i manaxhojë ata. Për këtë si dhe për të gjithë procesin duhen marrë në konsideratë karakteristikat e shoqërisë.

Pra, qasja e propozuar është një mjet i parë dhe gjithëpërfshirës për analizimin dhe monitorimin e situatës së riskut financiar të shoqërisë. Ajo synon të plotësojë nevojat e shoqërisë ndërsa merr parasysh karakteristikat e saj dhe mund të shërbejë si bazë për kërkime të mëtejshme në fushën e manaxhimit të riskut.

2. Rishikimi i literaturës

Studiues të ndryshëm kanë përdorur në periudha të ndryshme analizën financiare si metodë për identifikimin e riskut të brendshëm financiar. Nga gama e të gjitha studimeve veçojmë punimet e Altman(1968), Porporato & Sandin(1997) dhe Ohlson (1980), pasi studimet e tyre përmbajnë vlera mesatare për 5 vitet e fundit,çka na bëjnë të kuptojmë ecurinë e raporteve me kalimin e kohës, e cila mund të përdoret si tregues për një paralajmërim të hershëm në menaxhimin e riskut të shoqërisë. Rezultatet e studimeve të

zgjedhura janë të rëndësishme për t'iu referuar sepse vlerat e tyre janë të bazuara në kampione të mëdha raportesh vjetore; përdorin vlera mesatare(të cilat janë më të rëndësishme se ato të veçanta); vlerësojnë riskun e një shoqërie duke krahasuar raporte të ndryshme financiare me një databazë shumë të madhe raportesh të shoqërive me aftësi apo paaftësi paguese; si dhe arrijnë në një përfundim të përbashkët: *Risqet kryesore financiare të brendshme në një shoqëri duhet të mbulohen nga Struktura financiare, Likuiditeti ,Raportet e përfitueshmërisë* .

Struktura financiare



Figura 1: Ecuria e raportit Detyrime Totale /Asete Totale

Nga raportet që mbulojnë strukturën financiare të një shoqërie, më i përshtatshmi për qëllime të menaxhimit të riskut është raporti ***Borxh total /Asete Totale.*** Sa më shumë një shoqëri i afrohet falimentimit,aq më shumë rritet ky raport, aq më e madhe diferenca e tij me atë të shoqërive financiarisht të shëndosha. Sa më e lartë shuma e borxhit të një firme,(edhe detyrimet e saj për të paguar interes), aq më i lartë risku i financimit e si pasojë edhe risku i falimentimit**.**

Likuiditeti



Figura 2: Ecuria e raportit Kapital Punues/Asete Totale

Raporti **Kapital punues/Aktive Totale** është një matës i mirë për vlerësimin e likuiditetit të firmës. Raporti dëshmon nëse firma do të jetë në gjendje të shlyejë të gjitha detyrimet e saj afatshkurtra duke përdorur asetet afatshkurtra të saj. Në rast se jo, gjë që ndodh kur detyrimet tejkalojnë asetet, kemi të bëjmë me risk të paaftësisë paguese. Aktivet Totale në emërues tregojnë diferencën në madhësinë e shoqërive dhe e bën raportin të krahasueshëm. Vlera të larta të aseteve totale ulin riskun e paaftësisë paguese, pasi nëse shoqëria nuk mund të paguajë detyrimet e saj aktuale me ndihmën e aseteve qarkulluese, mund të përdorë asetet e tjera. Edhe pse një hap më i papërshtatshëm dhe i vështirë, ai gjithsesi do të shmangte falimentimin.

Përfitueshmëria



Figura 3: Ecuria e raportit EBIT / Asete Totale dhe EAN/Asetet totale .

Kthimi në asetet totale (ROA) është një tregues i fuqishëm për riskun e shoqërisë dhe jep informacion të dobishëm për menaxhimin e riskut. Rentabiliteti mbetet gati konstant me kalimin e kohës për shoqëritë e shëndetshme ndërsa raportet për shoqëritë drejt falimentimit janë shumë më të ulëta se ato të shoqërive të shëndetshme .



Figura 4: Ecuria Fitim i pashpërndarë/Aktive Totale dhe Fitim i pashpërndarë /Kapital i vet

Raporti **Fitim i pashpërndarë/Asete totale** mund të përfshihet në menaxhimin e riskut për matjen e përfitueshmërisë së akumuluar të firmës dhe nëpërmjet kësaj edhe të aftësisë së saj paguese. Ky raport mat mbrojtjen e fondeve që shoqëria ka qenë në gjendje të fitojë përgjatë kohës dhe të cilat mund të përdoren në kohë krize për të balancuar humbjet. Sa më e lartë mbrojtja, aq më i ulët është risku i paaftësisë paguese meqë mbrojtja mund të përdoret përpara se kapitali të konsumohet nga humbjet. Altman përdor si emërues asetet totale, ndërsa Porporato & Sandin përdorin kapitalin e vet. Kur përdoren asetet totale raporti është i pavarur nga përzierja financuese e zgjedhur e shoqërisë dhe si pasojë është më i krahasueshëm**.** Në të dy rastet vihet re një ndryshim i rëndësishëm midis firmave me aftësi paguese dhe atyre me paaftësi paguese si dhe një rënie e shpejtë e raportit për shoqëritë e grupit të dytë.

Është e rëndësishme të theksohet se një raport i vetëm me vlera të afërta me ato të shoqërive me paaftësi paguese nuk do të thotë se vetë shoqëria është pranë falimentimit. Ai vetëm tregon një risk total më të lartë. Për një tablo të përgjithshme duhet të merren në konsideratë edhe raportet dhe kategoritë e tjera.

Të dhënat mëposhtme, përmbledhin studimet e lartpërmendura për raportet e shoqërive me paaftësi paguese si dhe të atyre financiarisht të shëndetshme. Ato paraqesin treguesit mesatarë të riskut të shoqërive të falimentuara në harkun kohor 5 vjet përpara falimentimit si dhe treguesit mesatarë të grupit të shoqërive me ecuri financiare normale.

Raporti	Borxhi/ Aktive Totale	Kapitali Punues/ Aktive Totale	EBIT/ Aktive Totale	Fitim i Pashperndarë/ Aktive Totale
Mesatarja e Jofalimentit	35%	38%	10%	36%
Mesatarja e Falimentit				
4 Vjet me pare	55%	23%	1%	-1%
3 Vjet me pare	58%	18%	-6%	-7%
2 Vjet me pare	71%	9%	-21%	-30%
1 Vit me pare	85%	-1%	-32%	-63%

Tabela 1: Treguesit mesatarë të riskut të grupit jo të falimentuar dhe grupit të falimentuar

3.Studimi empirik

Periudha e studimit ishte Nëntor 2013-Mars 2014.Me aksesin në Pasqyrat Financiare vjetore të një grupi prej 17 shoqërish me Status Subjekte Juridikë, për pesë vitet e fundit,tashmë disponoj informacion të mjaftueshëm financiar për të llogaritur mesataret e 4 kategorive kryesore të raporteve të aplikuara, për identifikimin e risqeve të brendshëm të shoqërive gjatë viteve 2008-2012. Kriteret që plotësojnë këto shoqëri: janë Biznese të Mëdha,sipas Klasifikimit Fiskal, operojnë në Sektorin Industrial, kryejnë aktivitet në qytetin e Vlorës, janë cilësuar si 'shoqëri të suksesshme' (tregues financiarë të balancuar të kënaqshëm, me trend rritës, përgjatë kohës).

Vitet	**Detyrime totale/Aktive totale**	**Kapital punues/Aktive Totale**	**ROA=EBT/ Aktive totale**	**Fitim i pashperndare/ Aktive Totale**
2008	0.67	-0.75	0.095	0.23
2009	0.59	0.38	0.05	0.04
2010	0.61	0.43	0.06	0.07
2011	0.53	0.55	0.14	0.12
2012	0.4	0.44	0.13	0.14
Mesatarja per 5 vite	**0.56**	**0.21**	**0.095**	**0.12**

Tabela 2: Treguesit mesatarë në grupin kategoria më e mire

Krahasimi i të dhënave

Mund të ekzistojnë mospërputhje të të dhënave nga artikujt me të dhënat nga studimi empirik për këto arsye:1.Të dhënat e kategorisë *shoqëri të suksesshme* janë nga sektori industrial ndërsa të dhënat nga shoqëritë në artikuj përfshijnë sektorë të ndryshëm.2.Vendet e ndryshme të origjinës së shoqërive dhe si pasojë edhe standardet e ndryshme të kontabilitetit ndikojnë bilancin dhe vlerat e raporteve.3.Të dhënat e artikujve janë më të vjetra në kohë,të dhënat e punimit tonë janë aktuale.
Megjithatë, meqenëse trendi i raporteve është shumë i ngjashëm në të gjitha studimet e ndryshme, ato mund të përdoren për analizën e riskut.

Rast Studimi

Shoqëria e marrë në studim është Subjekti Juridik *Beton Vlora SH.P.K*, një Biznes i Madh sipas Klasifikimit Fiskal në Sektorin Industrial, e cila operon në qytetin e Vlorës dhe për të cilën disponoj informacion të mjaftueshëm financiar.Duam të analizojmë situatën financiare të saj në lidhje me riskun, duke përcaktuar fillimisht pozicionin financiar të saj me anë të krahasimit me grupet e shoqërive të falimentuara dhe ato të suksesshme (studimet e mëparshme dhe ai aktual).Në mënyrë që të përdoren vlera të krahasueshme, qëllimi është të krahasohet shoqëria e marrë në studim me shoqëri nga i njëjti sektor. Në rastin e vlerave krahasuese nga artikujt kjo nuk është e mundur pasi ato nuk janë specifikuar më tej në lidhje me sektorin. Sektori i zgjedhur në kërkim si për shoqërinë e marrë si rast studimi,ashtu edhe për kategorinë "shoqëri të suksesshme", është sektori industrial, duke qenë se në këtë sektor risku i financimit dhe likuiditetit mund të konsiderohet si urgjent, pasi duhet të financohen sasi më të mëdha pajisjesh sesa në sektorë të tjerë dhe nganjëherë projektet zgjasin shumë dhe përfshijnë parapagesa, çka kërkon likuiditet të mjaftueshëm.

Përcaktimi i vlerave kufi për ndërtimin e zonave kritike dhe pozitive

Situata e riskut financiar të shoqërisë së marrë në studim do të vlerësohet duke krahasuar vlerat mesatare të raporteve të saj ndër vite, me limitet kritike dhe pozitive, të cilat i përcaktojmë duke analizuar të dhënat e studimeve të mëparshme dhe ato aktuale.

i. Vlerat mesatare të raporteve të grupit të falimentuar *Borxh/Asetet totale* dhe *Kapital Punues/Totali i aseteve* dy vite para falimentimit

e në vazhdim, mund të përdoren për të shënuar zonat kritike (përkatësisht 71% dhe 9%).

ii. Për të shënuar zonën kritike për përfitueshmërinë mund të përdoret vlera mesatare e katër viteve përpara falimentimit të shoqërive të grupit të falimentuar(për ROA-në vlera 4% dhe për Fitimin e pashpërndarë vlera -1%). Për këto raporte ecuria negative është tashmë e dukshme qysh katër vjet para falimentimit.

iii. Si kufi për zonat pozitive, do të përdoren vlerat mesatare të shoqërive aktualisht të suksesshme.

iv. Pra, në një paraqitje grafike fushat kritike dhe pozitive do të shënohen nga vlerat e grupit të falimentuar dhe vlerat e grupit të shoqërive të suksesshme. Brenda këtyre kufijve do të paraqiten raportet e shoqërisë së marrë në studim. Bazuar në pozicionimin në grafik, mund të analizohet gjendja e riskut të kësaj shoqërie.

Analiza Empirike



Figura 5: Analiza e raportit të Borxhit Total

Në vitin 2008, raporti i borxhit të shoqërisë së marrë si rast studimi është 49% dhe nënkupton një të dytën e financimit me kapitalin e vet, pra stabilitet financiar më të lartë se mesatarja e shoqerive te suksesshme.Madje, raporti do të përmirësohet, dhe në vitin 2009, ai bie në vlerën 40% .Shoqëria ka të njëjtin trend përgjatë kohës,duke qëndruar tërësisht në zonën pozitive dhe duke patur tregues edhe më të mirë së vetë mesatarja prej 56 % e grupit të shoqërive të cilësuar si të suksesshme. Ky

zhvillim tregon një avantazh dhe një gjendje shumë pozitive dhe të qëndrueshme, e cila ul riskun e përgjithshëm të falimentimit.



Figura 6: Analiza e raportit AAGJ/(DAGJ+Kap.vet)

Raporti tregon nëse aktivet afatgjata janë blerë me kapital afatgjatë ekonomik apo për financimin e tyre janë përdorur edhe detyrime afatshkurtra. Ky raport duhet të jetë pothuajse gjithmonë më i vogël se 1. Raporti për vitin 2008 është 1.45 që do të thotë se aktivet afatgjata për këtë vit janë financuar edhe me detyrime afatshkurtra. Për vitet në vazhdim raporti është i ulët (25%) gjatë gjithë horizontit kohor, pra të gjitha asetet afatgjata financohen me afat të gjatë dhe nuk ka risk me financimin e ardhshëm. Por, kjo tregon edhe se rreth 3/4 e financimit afat-gjatë është përdorur për asetet afatshkurtra. Pra, shoqëria e marrë në studim mund të paguajë relativisht norma shumë të larta interesi, pasi ajo mund të jetë e mbërthyer në kontrata afatgjata. Pra përveç vitit 2008,shoqëria tregon një gjendje të qëndrueshme të financimit dhe risk të ulët të falimentimit.



Figura 7: Analiza e raportit Kapital punues/Aktive Totale

Raporti tregon një gjendje të fortë të shoqërisë në lidhje me likuiditetin. Me vlerat e saj shoqëria B.V SH.P.K ka më shumë likuiditet se grupi i falimentuar dhe gjithashtu më shumë se mesatarja e grupit të përbërë nga 17 shoqëritë. Nga viti 2008 likuiditeti fillon të bjerë dhe në vitin 2009 fillon të rritet dhe vazhdon kështu deri në 2012. Vlera shumë e lartë e likuiditeteve në vitin 2008 nga njëra anë nënkupton situatë likuiditeti të konsoliduar,por përsëri një situatë e tillë nuk është e preferuar. Kjo për arsye se një vlerë e tillë na sinjalizon për një tepricë investimesh në aktive afatshkurtra,të cilat nuk shfrytëzohen për të sjellë përfitueshmëri,pra mospërdorim efiçent të fondeve në dispozicion. Më pas kemi një qëndrueshmëri në likuiditet me vlerë gati sa 1/2 e vlerës së 2008. Ajo qëndron gjatë gjithë kohës në zonën pozitive,çka do të thotë mungesë e riskut të likuiditetit dhe gjithashtu e riskut të falimentimit.



Figura 8: Analiza e EBIT / AseteTotale të shoqërisë

Katër vitet e para ROA është në zonën pozitive dhe më e lartë sesa mesatarja e raportit për grupin e17 shoqërive të marra si prag pozitiv. Këtu EBIT tejkalon dukshëm minimumin e kërkuar dhe pagesat e interesit. Megjithëse ai qëndron në pozicion goxha të mirë gjatë 4 viteve të para në zonën pozitive,ai ka një tendencë të lehtë rënieje nga viti në vit. Megjithatë, gjendja ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2012. Në këtë vit (ROA=1%), shoqëria tashmë është në zonën kritike, që do të thotë se shoqëria ka vështirësi të mëdha në mbulimin e shpenzimeve të interesit dhe rrezikon të dalë me humbje. Megjithatë, për shkak të niveleve të ulëta të borxhit,humbja është gjithashtu e ulët. Pra, raporti *EBIT / aktive totale* tregon një situatë pozitive për 4 vitet e para,por një përkeqësim të gjendjes

së biznesit dhe riskut të shoqërisë në vitin e fundit.



Figura 9: Analiza e Fitimit të Pashpërndarë/ Totalit të Aseteve të shoqërisë

Në tre vitet e para vlerat e raportit janë shumë të mira dhe situata e shoqërisë shumë pozitive. Rënia që ka filluar gjatë 2010-2011tregon për fillimin e pranisë së riskut. por nuk tregon për një risk të lartë falimentimi. Ndryshimi është në vitin 2012, ku ROA është shumë e ulët dhe shoqëria rrezikon të dalë me humbje,çka mund të çojë në konsum të fitimit të - pashpërndarë të shoqërisë. Në total, ky raport, edhe pse fillon në nivele shumë pozitive, tregon nga viti 2010 një rritje të paaftësisë paguese dhe riskut të falimentimit.

4. Përfundime dhe Rekomandime

Qëllimi i studimit është gjetja e një mjeti të mundshëm për identifikimin, analizën dhe monitorimin e riskut, i cili mund të zbatohet nga shoqëritë për të menaxhuar risqet e tyre të brendshme financiare. Për këtë është zgjedhur analiza financiare, e cila është përdorur në kërkim për identifikimin e treguesve të falimentimit të firmës. Në përgjithësi studimet përqëndrohen në tri kategori të riskut, përkatësisht *likuiditeti*, *rentabilitetit* dhe *aftësia paguese*. Së bashku me të dhënat krahasuese të shoqërive të falimentuara nga literatura ekzistuese, si dhe të një grupi shoqërish të suksesshme që operojnë në qytetin e Vlorës, këto raporte formojnë një tablo në funksion të menaxhimit të riskut të brendshëm financiar. Me ndihmën e kësaj tabloje, mund të vlerësohet gjendja e riskut të shoqërisë. Për këtë vlerësim, në mënyrë që të përmirësohej krahasueshmëria do të ishte ideale të përdoreshin të dhëna nga shoqëritë e falimentuara që e kanë origjinën nga i njëjti vend dhe sektor. Një përmirësim i mundshëm në kërkime të mëtejshme mund të jetë mbledhja e të dhënave të reja, të cilat përputhen me karakteristikat e shoqërisë që i nënshtrohet vlerësimit të riskut. Kjo ka të ngjarë që ta

përmirësojë më tej vlerësimin. E megjithatë të dhënat dhe metoda mund të përdoren si pjesë e proçesit të administrimit të riskut të shoqërisë. Kjo tablo e përgjithshme është një mjet për identifikimin e riskut, një mënyrë për analizën e tij dhe monitorimin grafik në të njëjtën kohë. Me ndihmën e kësaj tabloje të përgjithshme një shoqëri mund të kontrollojë lehtë nëse një nga kategoritë kryesore të riskut është urgjente dhe duhet të menaxhohet. Pasi një risk është identifikuar,të dhëna të tjera të brendshme mund të analizohen për të kuptuar se cili është burimi i riskut. Së fundi mund të merren masa të përshtatshme në përputhje me nevojat specifike të shoqërisë. Këto hapa të fundit nuk janë specifikuar dhe mund të jenë subjekt hulumtimi i mëtejshëm. Për një vlerësim të detajuar të riskut dhe hapa të drejtpërdrejtë për menaxhimin e tij, të dhënat e disponueshme duhet të analizohen në detaje. Në varësi të shoqërisë, e cila përdor këtë tablo, përveç raporteve të zgjedhur mund të përfshihet edhe informacion shtesë rreth sektorit apo aspekteve kritike të shoqërisë. Nga ana tjetër nuk duhet të injorohet fakti se përdorimi i kësaj metode për identifikimin e riskut nuk do të thotë se risqet janë menaxhuar ose risku është ulur. Kjo duhet të realizohet më tej në hapa të veçantë. Si një mjet i përgjithshëm dhe gjithëpërfshirës, tabloja jep kontributin e saj në menaxhimin e riskut të brendshëm financiar në shoqëri. Avanatazh përbën fakti se për zbatimin e saj nuk janë të nevojshme as programe të veçantë, as njohuri të kualifikuara apo burime të mëdha. Ky vështrim i përgjithshëm bazohet te të dhënat që disponon vetë shoqëria, raportet kanë kuptim të drejtpërdrejtë, janë të qartë dhe lidhen ngushtë me kategoritë e riskut. Prandaj metoda mund të aplikohet lehtë brenda shoqërisë. Për këtë arsye ajo shërben si mjeti fillestar, të cilin shoqëria mund ta përdorë për të identifikuar, analizuar dhe monitoruar riskun e saj.

Referenca

[1]Nazarova, I.G., 2003. Risk management within the entrepreneurial activity. Uhta, Russia: USTU.

[2]Baldoni, R. J. 1998, “A Best Practices Approach to Risk Management”, TMA Journal,Jan/Feb, pp. 30-34.

[3]Financial Ratios As Predictors of Failure,William H. Beaver,Journal of Accounting Research,Vol. 4, Empirical Research in Accounting: Selected Studies 1966

[4]Discriminant Analysis Models. Journal of Financial Management & Analysis, 15, 1, 1.

[5]Holmen, J. (1988). Using Financial Ratios to Predict Bankruptcy: an Evaluation of Classic Models Using Recent Evidence. Akron Business and Economic Review, 19, 1, 52-63.

[6]Beaver, William H., and Mark A. Wolfson, 1995, “Risk Measurement.”, in “Risk Management - Problems and Solutions” by Beaver, William H. and George Parker, New York

[7]Altman, Edward I. (1984). A Further Empirical Investigation of the Bankruptcy Cost Question“Journal of Finance, Vol. 39, No. 4, 1067-1089

[8]Analiza e Pasqyrave Financiare - Ingrid Shuli,Rezarta Peri

[9]Drejtim Financiar – Beshir Ciceri,Halit Xhafa

[10]Fitzpatrick, P. J. A Comparison of ratios of successful industrial enterprises with those of failed firms. Certified Public Accountant, 1932. October, November, December, pp. 598-605, pp. 656-662, pp. 727-731.

[11]Ohlson, J. Financial ratios and the probabilistic prediction of bankruptcy. Journal of Accounting Research. 1980, XVIII. Nr. 1, pp. 109-131.

[12]Deakin, E., "A Discriminant Analysis of Predictors of Business Failure," Journal of Accounting Research, Spring, 1972, 167-179.

[13]The use of Financial Ratios for Research: Problems Associated with and Recommendations for Using Large Databases by Boris Nenide ,Robert W. Pricer, Graham Wisconsin Distinguished Professor ,S. Michael Camp

[14]Deakin, E., "A Discriminant Analysis of Predictors of Business Failure," Journal of Accounting Research, Spring, 1972, 167-179.

INSTITUTI I SHPALLJES SË PERSONIT TË ZHDUKUR APO TË VDEKUR SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR DHE LEGJISLACIONIT RUS

Author: Valbona Alikaj

Pedagogue "Ismail Qemali" University of Vlora

Departamenti i Drejtësisë

e- mail: bonaaliko@gmail.com

Abstrakt

Instituti i shpalljes së personit te zhdukur është një ndër institutet më të vjetër. Një institut që për herë të parë është ndeshur në Romën e lashtë, dhe që vazhdon të ekzistoje deri në ditët e sotme.

Ky institut është i një rëndësie të vecantë, pasi për fat të keq dhe në ditët e sotme numri i personave të shpallur të zhdukur apo të vdekur është mjaft i madh për shkaqe te ndryshme si rrëmbimi, trafikimi i personave, mbajtja e tyre me dhunë dhe përdorimi i tyre si skllevër.

Qëllimi i studimit të këtij instituti është analiza krahasimore që do ti bëhet legjislacionit Shqiptar dhe legjislacionint Rus.

Për të realizuar qëllimin e punimit do të trajtohet me mënyrë të detajuar procedura e shpalljes së personit të zhdukur apo të vdekur, afatet, kërkesëpadia, procedura e shqyrtimit të cështjes.

Rëndësia e këtij instituti është ruajtja e të drejtave personale dhe pasurore të personit të shpallur të zhdukur apo te vdekur, si dhe mbrojtja e interesave dhe të drejtave të personave të cilët janë në marrëdhënie juridike me personin e shpallur të zhdukur apo të vdekur.

Fjalë Kyçe: shpallja e personit të humbur, shpallja e personit të vdekur, afate kohore, legjislacioni Shqiptar, legjislacioni Rus

HYRJE

Instituti i shpalljes së personit të zhdukur është një ndër institutet më të vjetër. Për herë të parë është rregulluar në Romën e lashtë, i cili është njohur si Post Liminium- e drejta ndërkombëtare e përcakton si e drejta përmes të cilës personat dhe pasuria e mbetur ne luftë rikthehen në statusin e tyre të mëparshme. (dictionaryreference.com)

Për të shmangur situatën e pasigurtë, me qëllim mbrojtjen e pasurisë së personit të larguar nga vendbanimi i tij, në romën e lashtë gjykatës i është liria e plotë në vlerësimin e asaj, nëse personi është i gjallë ose jo (Efrimova V.V 1894). Romakët nuk kishin ndonjë rregull të përgjithshëm, megjithatë, interpretuesit pasues të të drejtës Romake krijuan dy sisteme rregulluese lidhur me vdekjen: sistemi i përcaktimit të kohëzgjatjes mbi moshën dhe sistemi i afateve. (Hvostov V. M, 1909)

Sistemi i afateve, përcakton kohëzgjatjen e jetës së personit, sipas së cilës personi i shpallur i humbur mund të supozohet i vdekur. Kjo kohezgjatje është 70 vjet. Sistemi i shpalljes realizohej; ns mungess të gjatë të personit bëhet kërkesa në gjykatë, dhe në rast se nga momenti i bërjes së kërkesës kalojnë 10 vjet, do të lindin të njëjtat pasoja juridike sikur vdekja e të zhdukurit. (Omelchinko O. A, 2005)

Shpallja e personit të zhdukur- është e bazuar në tërësinë e fakteve, të mbledhura dhe të shqyrtuara nga gjykata, të cilat mundësojne krijimin e bazave të mjaftueshme për shpalljen e personit të zhdukur.

Në rast se personi do të mungjojë për një kohë të gjatë nga vendbanimi dhe vendeqëndrimi, dhe nuk do të ketë lajme passjell lindjen e pasojave juridike, të cilat mund të sjellin cënimin e të drejtave të personave të cilët janë në marrëdhënie juridike me personin.

Studimi i këtij instituti është i një rëndësie të veçantë. Në rastet e shpalljes së personit të zhdukur duhet të merren masa për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tij, mbrojtja e të drejtave personale dhe pasurore si të personit të shpallur të zhdukur apo të vdekur edhe të personave të cilët janë në marrëdhënie me të. Personat që prezumohen të jenë trashgimtarë të tij, ose çdo i interesuar tjetër, apo prokurori mund t'i kerkojë gjykatës së vendqëndrimit apo të vendbanimit të tij të fundit caktimin e një kujdestari.

Në mënyre që të shmangen situatat e pasigurta, gjykata nuk e eskludon prezumimin e jetës së personit apo vdekjen e tij, por bën vetëm konstatimin e faktit të personit të zhdukur, ndërsa personat e interesuar mund t' iu drejtohen organeve shtetërore për të shmangur pasigurinë e marrëdhenies juridike, palë e të cilave është personi i zhdukur.

Pas kalimit të afatit nga momenti i shpalljes së personit të zhdukur, me vendim gjykate shpallet personi i vdekur. Sipas legjislacionit përcaktohet data e çeljes së trashëgimisë.

Qëllimi i studimit të këtij instituti është analiza krahasimore që do të bëhet midis dy legjislacioneve në të gjitha etapat që duhet të respektohen në këtë gjykim.

SHPALLJA E PERSONIT TË ZHDUKUR

Sipas legjislacionit Shqiptar në nenin 15 te Kodit Civil parashikohet se "Personi që mungon nga vendi i banimit ose i vendqëndrimit të fundit të tij dhe për të cilin nuk ka lajme për më shumë se dy vjet, me kërkesën e çdo të interesuari mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës".

Në interpretim të nenit 15 të K.C ku parashikohet instituti i shpalljes së zhdukur të personit kërkohet si element i domosdoshëm i kësaj proçedure kalimi i afateve kohore të cilat janë të domsdoshme për ta bindur gjykatën se nuk ka asnjë lajm në lidhje me personin për të cilin i është drejtuar kërkesa. Afatet kohore për shpalljen të zhdukur dhe të vdekur tentojnë të jenë relativisht të gjata për ti dhënë siguri juridike të drejtave subjektive të tij dhe për të mos e privuar në mënyre arbitrare nga ushtrimi të këtyre të drejtave.

Në dallim nga legjislacioni shqiptar, legjislatori rus afatin ë shpalljës së zhdukur e ka reduktuar në një vit, përkatësisht në nenin 42 të Kodit Civil të Federatës Ruse parashikohet "Personi me kërkesë të personave të interesuar mund të shpallet i zhdukur nga gjykata, në vendbanimin e tij nuk ka informacion për vendqëndrimin e tij te fundit gjatë një viti".

Ekzitojnë tre teori për konceptin e prezumimit të personit të zhdukur. Disa autorë e konsiderojnë prezumimin e zhdukjes si prezumimi i vdekjes së personit; (Eroshenko A, 1981), e cila është e vështire për tu pranur, sepse është e vështirë te përcaktohen kufijtë që ekzistojnë midis shpalljes së zhdukur dhe shpalljes së vdekur, po ashtu është e vështirë të përcaktohen pasojat juridike që sjell njëra dhe pasojat juridike që sjell tjetra.

Autorë të tjerë mëndojnë se prezumimi i personit të zhdukur është prezumimi gjallë i personit, duke qënë se nuk ka mjaftueshmërisht të dhëna, për të vërtetuar se personi ka vdekur. (Popova J.A, 1985)

Më e arsyeshme është pozita e këtij autori, i cili beson se prezumimi i personit të zhdukur nuk përmban asnjërën prej këtyre teorive, por konstaton pamundësinë e zgjidhjes së çështjes së jetës apo të vdekjes së personit. (Kuleshova A, 2007)

Afati i shpalljes së personit të zhdukur sipas legjislacionit të Federatës Ruse është më i shkurtër se ai i parashikuar në legjislacionin Shqiptar. Legjislatori Rus i akordon shpalljes së zhdukur një afat më të shkurtër me qëllim “ruajtjen e marrëdhënive juridike në të cilat ai ka marrë pjesë”. Pasuria, e cila i takon personit duhet të administrohet, duhet të ndërpriten detyrimet të cilat janë të

lidhura ngushtë me personin si dhe bashkëshorti mund të kërkojë zgjidhjen e martesës. Problemeve juridike të lindura nga shpallja e personit të zhdukur do tu jepet zgjidhje në një kohë me të shkurtër.

Në të dyja rastet shpallja e personit të zhdukur duhet të realizohet me vendim gjykate. Gjykata pas marrjes në shqyrtim të kërkesës së bërë nga personi i interesuar duhet të mbledh informacionin e mjaftueshme për të vërtetuar faktin e zhdukjes së personit. Gjykata duhet të përdori të gjitha mjetet e ligjshme për të vërtetuar zhdukjen e personit, duhet të marri në pyetje të gjithë të afërmit, miqtë, personat me të cilët ka qënë në marrëdhënie pune apo në marrëdhënie të tjera. Këto verifikime duhet të bëhen pasi, personi në mënyrë të vetdijshme mund të fshihet nga vendbanimi i tij i fundit për të evituar pagesën e alimenteve, pagesën e taksave apo për të shmagur përgjegjësinë apo detyrime të tjerë.

Në Kodin Civil Shqiptar dhe në atë te Federatës Ruse parashikohet vetëm përllogaritja e afatit të fillimit të shpalljes së personit të zhdukur. Por shpesh herë është e vështirë të bëhet përcaktimi i saktë i datës ndaj legjislatori vendos "Kur dita e lajmeve të fundit nuk mund të caktohet, afati i mësipërm fillon nga dita e parë e muajit pasardhës në të cilin janë marrë lajmet e fundit. Kur muaji nuk mund të caktohet, afati fillon nga dita 1 janar e vitit të mëpasëm".

Sipas legjislacionit Shqiptar pas kalimit të dy vjetëve nga data e lajmit të fundit, gjykaka mund të bëj deklarimin e zhdukjes së personit dhe të përcaktoje një kujdestar për administrimin e pasurisë së tij. (Kodi Civil, 1994) Sipas nenit 43 të Kodit Civil të Federatës Ruse "Pasuria e personit të shpallur të zhdukur, me vendim gjykate për administrimin e vazhdueshmëm i jepet personit, i cili percaktohet nga organet e kujdestarisë dhe tutorisë dhe vepron në përmbajtje të kontratës së mirëbesimit, e lidhur me këtë organ. Nga kjo pasuri një pjesë e lejuar duhet tu paguhet personave, të cilëve personi i shpallur i zhdukur, është i detyruar ti mbaj, dhe të paguhen borxhet e tjera të personit të shpallur të zhdukur".

Të dy legjislacionet parashikojnë përcaktimin e një kujdestari për administrimin e pasurisë së tij, me qëllim ruajtjen e interesave të personit të shpallur të zhdukur

Por, në dallim nga legjislacioni Shqiptar, legjislacioni Rus parashikon se pas dhënies së vendimit për shpalljen e personit të zhdukur apo edhe në rastin e dhënies së vendimit për shpalljen e personit të vdekur janë organe të posaçme të cilat gëzojne të drejtën e përcaktimit të kujdestarit për administrimin e pasurisë "Organet e Kujdestarisë dhe Tutorisë". (Ligji "Kujdestaria dhe tutoria", 2008)

Organet e Kujdestarisë dhe Tutorisë janë një institut kompleks i të drejtës civile dhe familjare, të cilët përmbajnë norma dhe të sektorëve publike (e drejta administrative), duke siguruar të gjitha mënyrat e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të personave të cilët kanë nevojë për të mbrojtur të drejtat e tyre personale dhe pasurore. (Polishuk- Mollodezhenya T. R, 2007)

Parimet e këtij organi janë: parimi i mirëbesimit, domethenë "liria e pranimit të kujdestarit (tutorit) dhe liria e heqjes dorë nga përgjegjësia e kujdestarit (tutorit) (Sadikova O. N, 2007); mban nënkontroll veprimtarinë e kujdestarit (tutorit), organet e kujdestarisë dhe tutorisë përmes mbikqyrjes; sigurojnë mbrojtjen maksimale të drejtave dhe interesave të personave.

Përveç organeve, e veçantë e ketij neni shprehet kontrata e miërbesimit për administrimin e pasurisë, e cila është e lidhur me organin. Kontratë kjo e cila e angazhon administruesin të veprojë me mirëbesim dhe përkujdesje në të gjitha veprimet juridike që kanë për objekt të drejta të personit të shpallur të zhdukur.

Ne këtë nen nuk shpjegohet, se në cilat raste është e nevojshme administrimi i vazhdueshëm i pronës dhe cilat mund të jenë kriteret që e përcaktojnë administrimin e pasurisë si të nevojshme.

Një kriter të tillë e hasim në nenin 38/1 te Kodit Civil, i cili shpreh "Në rast të administrimit të vazhdueshëm të pasurisë së paluajtshme dhe sendeve me vlerë të luajtshme, organet e kujdestarisë dhe tutorisë duhet të lidhin me administruesin kontratën e mirëbesimit" Kjo dispozitë lidh nevojën për kontroll të vazhdueshëm të llojeve të pronës .

Instituti i shpalljes së zhdukur nuk ka si qëllim përfundimin e të gjitha marredhënieve, përkundrazi luan një rol mbrojtës, sepse mbron të drejtat dhe detyrimet të personit të shpallur të zhdukur, njëkohësisht edhe të drejtat dhe detyrimet e personave të cilët janë në marrëdhënie juridike me të.

SHAPLLJA E PERSONIT TË VDEKUR

Deklarimi i personit të vdekur nuk nënkputon vetëm mos patjen e lajmeve mbi personin e zhdukur, por edhe situata të tjera të cilat të bëjnë të kuptosh se personi nuk është më gjallë (fatkeqësi natyrore, veprimet luftarake e tjera).

Nevoja për deklarimin e personit të vdekur, si dhe shpallja i tij i zhdukur lind në ato raste, kur për një periudhë të gjatë kohore nuk dihet vendndodhja e njërit prej subjekteve të marrëdhënieve juridike, e cila përbën pengesë për realizimin e të drejtave subjektive të palës tjetër, si dhe përmbushjen e detyrimeve.

Rastet e shpalljes së personit të zhdukur dhe deklarimi i vdekjes së personit kanë të perbashkëta nga përbërja faktike, edhe pse pasojat që lindin nga deklarimi i personit të vdekur janë më të vështira. (Abovoi T.E. & Kabalkina A.J, 2006)

Në nenin 17 të Kodit Civil të Shqipëris parashikohet "Personi që është shpallur i zhdukur, me kërkesën e çdo të interesuari, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme katër vjet nga dita që është shpallur i zhdukur".

Në nenin 45 të Kodit Civil Rus parashikohet "Personi mund të shpallet i vdekur, në qoftë se në vendbanimin nuk ka lajme mbi vendqëndrimin e tij prej 5 vjet".

Afatet e shaplljes së personit të vdekur ndryshojne jo vetëm në kohë zgjatjen e tyre por edhe në përllogaritje. Pasi, legjislacioni Rus e përllogarit që nga momenti i mos marrjes së informacioneve për vendqëndrimin e tij; ndërsa legjislacioni Shqiptar e përllogarit nga momenti i shpalljes së zhdukur. Pra, afati për shpalljen e personit të vdekur sipas legjislacionit Rus është 4 vjet, ndërsa sipas atij Shqiptar është 6 po ta përllogarisim nga moment i marrjes së lajmeve të fundit.

Të dy legjislacionet civil jepet lidhja që ekziston midis shpalljes së personit të zhdukur dhe deklarimit të vdekjes.

Kjo lidhje e veçantë shfaqet midis shpallje së personit të zhdukur dhe deklarimit të tij të vdekur, gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatë, pasi gjykata për të dyja rastet duhet të vendosi datën (ditën, muajin, vitin), kur janë marrë lajmet e fundit nga personi. (Kodi Civil i Shqipërisë, 1994)

Personat e interesuar për paraqitjen e kërkesës për shpalljen e personit të vdekur në gjykatë janë po të njëjtat subjekte të legjitimuara për paraqitjen e kërkesën për shpalljen e personit të zhdukur.

Në qoftë se i referohemi nenit 375 të Kodit të procedurës civile shohim se rrethi i personave të legjitimuar është me i gjerë se sa ai i përcaktuar në Kodin Civil ne nenin 17, "Kërkesa për shpalljen e një personi të zhdukur ose të vdekur mund të paraqitet nga çdo person i interesuar dhe nga prokurori në gjykatën ku ka pasur vendbanimin e fundit personi për të cilin kërkohet shpallja si i tillë".

Ndërkohë që në legjislacionin Rus thuhet se janë personat e interesuar të cilët bëjnë kërkesën për shpalljen e personit të vdekur, por nuk përcaktohet se cilët janë personat që bëjnë pjesë në këtë kategori. Pavarësisht faktit që në legjislacion nuk janë përmenedur personat e legjitimuar për shpalljen e personit të vdekur, këtë të drejtë e gëzojne familjarët, personat që janë marrëdhenie juridike me të, organet e qeverisjes vendore si dhe prokurori në qoftë se ligjërisht gëzojnë të drejtëen për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave të tretë. (Kohonova E.A, 2007)

Për hartimin e kërkesës sipas dy legjislacioneve është nevojshme të jepen rrethanat nëpërmjet të ciles bëhet e besueshme shpallja e personit të vdekur. Por në dallim nga njëra tjetra shohim se, legislacioni Shqiptar parashikon në përmbajtjen e kërkeses përcaktimin e kujdestarit ose përfaqësuesit ligjor të tij, për rastet kur ka të tille, si dhe të tregohen edhe personat që janë ose mund të jenë trashëgimtarë të tij, si dhe gjithë personat e tjerë për të cilët është e ditur që nga ky fakt fitojnë ose humbin të drejta. (Kodi i Proçedurës Civile, 1996)

Ndërsa, legjislacioni Rus me shumë vëmendje i kushton qëllimit përse personi i interesuar kërkon shpalljen e personit të humbur apo të vdekur, gjithashtu duhet të përcaktohen rrethanat, të cilat vërtetojnë zhdukjen e personit" (Kodi i Proçedurës Civile Së Federatës Ruse, 2002)

Cila është proçedura e gjykimit pas marrjes së kërkesëpadisë?

Një e veçantë që haset vetëm në legjislacionin shqiptar është publikimi i kërkesëpadisë. (Kodi i Proçedurës Civile, 1996)

Në legjislacionin Rus parashikohet vetem bërja e kërkesës, dhe marrja në shqyrtim nga gjykata në mënyrë të menjëherëshme.

Me vendim të gjykatës personi i cili ka bërë kërkesën duhet që për llogari të tij të bëj publikimin e çështjes në gazetën lokale. Ky njoftim duhet të përmbajë: emrin e gjykatës; emrin dhe mbiemrin e personit që bën kërkesën dhe vendbanimin e tij; emrin dhe mbiemrin, vendlindjen dhe vendin e fundit të punës ku ka punuar personi i kërkuar; u kërkojne personave, që kanë lajme mbi vendqëndrimin e personit, të lajmerojnë për këtë gjykatën brenda 3 muajve nga momenti i publikimit. (Kuleshova A, 2007)

Në përputhje me nenin 378, "Gjykata merr në shqyrtimi kërkesen për shpalljen të vdekur të një personi, pyet njerëz të afërt të tij, merr të dhëna për këtë person nga bashkia ose komuna, ku ai ka pasur vendbanimin e tij të fundit, si dhe nga çdo burim tjetër që mund të japë lajme për këtë person". Po njësoj parashikohet edhe në dispozitat e kodit procedurial civil të Federates Ruse "Gjykata gjatë përgatitjes paraprake të çështjes për shqyrtim, duhet të gjej persona të cilët mund të kenë lajme mbi personin e shpallur të zhdukur, gjithashtu pyet organizatat përkatëse mbi vendbanimin e tij të fundit dhe vendin e fundit të punës të personit të zhdukur, organet e punëve të brendshme, njësitë ushtarake për informacionin që disponononin për të". (Kodi i Proçedurës Civile Së Federatës Ruse, 2002)

Gjithashtu në kodin procedurial civil në paragrafin e po të njëjtit nen parashikohet " Çështaja e shpalljes së personit të zhdukur apo të vdekur do të shqyrtohet në prani të prokurorit".

Kur të jenë realizuar të gjitha verifikimet e duhura nga gjykata, dhe nëse gjykata konstaton nga hetimet se personi nuk është me i gjallë, atëhere gjykata me vendim shpall vdekjen e personit të zhdukur. Kur shpallet vdekja e një personi të zhdukur, caktohet dita se kur ka ngjarë ajo. Kur kjo ditë nuk është e mundur të vërtetohet me saktësi, gjykata e cakton atë sipas rregullave të parashikuara në nenet e këtij Kodi. Me kërkesën e çdo të interesuari, gjykata që ka dhënë vendimin, mund të ndryshojë datën e vdekjes, kur vërtetohet se personi ka vdekur në një ditë tjetër. (Kodi Civil i Shqipërisë, 1994)

Dita e vdekjes së personit të shpallur të vdekur do të llogaritet dita e hyrjes në fuqi e vendimi i gjykatës për shpalljen e personit të vdekur. (Kodi i Proçedurës Civile Së Federatës Ruse, 2002)

Data e vdekjes së personit, të shpallur të vdekur, quhet dita e hyrjes në fuqi të vendimit të gjykatës (pas 15 ditësh, në qofte se nuk ka patur ankimime ose nuk është kundërshtuar nga prokurori). (Portyankina S.P 2008)

Shqyrtimi i çështjes për shpalljen e personit të zhdukur apo të vdekur përfundon me dhënien e vendimit. Në vendim gjykata tregon: mbiemër, emër, atësinë e personit, vitin dhe vendlindjen e tij; lajmet e fundit të vendqëndrimit; fillimin e shpalljes së zhdukur ose datën e vdekjes të personit, nëse është e njohur.(Yarkova V.V 2004)

Vendimi i gjykatës me të cilin një person është shpallur i vdekur, botohet në Fletoren Zyrtare dhe dërgohet për regjistrim zyrës përkatëse të gjendjes civile si dhe të paktën në një gazetë lokale të caktuar prej saj

KONKLUZIONE

Institutit të shpalljes së personit të zhdukur apo të vdekur është një institut i veçantë, i cili ka karakteristika të cilat e dallojnë nga institutet e tjera.

Gjatë punimit u trajtua proçedura e shpallje së personit të vdekur sipas legjislacionit shqiptar dhe atij Rus. Pavarësisht se janë pjesë e sistemit juridik civil, parashikimi i këtyre instituteve nga të dy legjislacionet paraqiten ndryshime esenciale.

1. Afati i shpalljes së personit të zhdukur është dy vjeçare për Shqiperin, ndërsa për Rusinë një vit. Mendoj se përcaktimi i afatit një vjeçar për shpalljen e personit të zhdukur është më e përshtatshëm, kjo do të lejonte rregullimin e marrëdhënieve juridike në nje kohë më të shkurtër. Pra, do te mbronte të drejtat dhe interesat jo vetëm të personit të shpallur të zhdukur por edhe të personave të cilët janë palë e marrëdhënie juridike me të.

2. Për shpalljen e personit të vdekur gjithashtu afatet janë të ndryshme. Ato ndryshojnë jo vetëm në afate kohore por edhe në mënyrën e përllogaritjes. Legjislacioni Rus e përcakton 4 vjet nga momenti i marrjes së lajmeve të fundit. Ndërsa legjislacioni Shqiptar e përllogarite 4 vjet nga momenti i shpalljes së personit të zhdukur. Afatet e përcaktimit kohor që na ofron legjislacioni Shqiptar janë më optimale, pasi sa më e gjatë të jetë periudha për shpalljen e vdekur të personit aq më gjatë do të ekzistojë prezumimi i jetës për personin. Por nga ana tjetër, ofrimi i një afati më të shkurtër për shpalljen e personit të vdekur do të sillte rregullimin e marrëdhenieve juridike të personave të tjerë (do të sillte çeljen e trashegimisë).

3. Sipas legjislacionit Shqiptar gjykata me dhënien e vendimit për shpalljen e personit të zhdukur përcakton edhe administratorin e pasurisë së personit, ndërkohe që legjislacioni Rus parashikon se pas dhënies se vendimit të gjykatë, i drejtohet organeve të kujdesatisë dhe tutorisë për të përcaktuar

administratorin e pasurisë të personit të shpallur të zhdukur apo të vdekur. Ku ky i fundit lidh një kontratë mirëbesimi me administratorin.

Nje organ i tillë do të ishte i domosdoshëm edhe për Shqipërinë, pasi roli i këtij organi nuk është vetëm përcaktimi i administratorit por njëkohësisht edhe kontrolli i vazhdueshëm që ushtron kujdestari dhe tutori mbi administratorin. Qëllimi i këtij organi është mbrojtja e të drejtave dhe interesave të personit të shpallur të zhdukur.

Instituti i shpalljes së personit të zhdukur apo të vdekur është i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personit të shpallur të zhdukur apo të vdekur si dhe të personave të cilët janë palë e marrëdhënieve juridike, dhe sjellja e dallimeve midis legjislacioneve të ndryshme ndihmon në adoptimin e gjetjeve dhe parashikimeve më të mira për të dyja këto legjislacione.

LITERATURA

1. Efrimova V.V. Dogma of Roman Law, General Part, Saint Petersburg 1894, pg. 69
2. Hvostov V. M. The system of Roman Law, Moscow 1909, pg. 96.
3. Omelchinko O. A. Roman Law, M:. 2005, pg. 230.
4. Eroshenko A. Missing person and the legal effects// Socialist legality . - M.: 1981. - № 10. – pg. 27.
5. Popova Ju.A. Recognizing a person missing. .– M.: Juridical Lecture. - 1985. – pg. 40.
6. Kuleshova A. The juridical nature of the cases of recognizing the person missing and declaring him dead. // Vestik The State University of Tver. – 2007. - № 4. – pg. 18.
7. Polishuk- Mollodezhenya T. R. Some issues of guardianship ang trusteeship Notarius. - 2007- № 1
8. Commentary of Civil Code of Russian Federation, part one/ redaction. O. N. Sadikova. – M.: 2007. – pg. 1061
9. Commentary of Civil Code of Russian Federation: 3 volume. T.E. Abovoi, A.Ju. Kabalkina.- 2006
10. Civil law. Book 1, E.A. Kohonova 2007, pg. 199
11. Portyankina S.P Recognizing the person missing or declaring dead // Advocate. – 2008. – № 2. – pg. 33.
12. Yarkova V.V The Civil Process: «Volter Kluver», - 2004.
13. Федеральный закон от 24 апреля 2008 года № 48-ФЗ "Об опеке и попечительстве" Art. 4
14. Kodi i Proçedurës Civile Republikës së Shqipërisë 1996, neni 376, 377
15. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë 1994, neni 15, 16, 21
16. The civil procedural Code of Russian Federation 2002, Art. 277, 278
17. The Civil Code of Russian Federation 1994, Art. 38, 42, 45/3
18. http://dictionary.reference.com/browse/postliminium

Tema: Kontributi i Uilliam Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike

Autori Bukuroshe Isufaj
Fakulteti i Shkencave Humane
Departamenti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Vlorës
Lagja "Pavarësia" Rr. "Kosova"
Cel 0694029361
Email: bukuroshe_isufaj@yahoo.it

Abstrakt

Uilliam Martin Liku ,gjatë shek.XIX,shërben në disa vende ballkanike që ishin nën sundimin e perandorisë otomane.Edhe pse ai ishte diplomat ,me një kulturë të gjerë e erudicion të thellë ,në botimet e tij "Kërkime në Greqi","Udhëtime në Greqinë e Veriut","Udhëtime në More"etj,veprat e tij përfshijnë mjaft material me interes për historinë ,kulturën ,gjuhën,dhe marrdhëniet ekonomike e shoqërore të shqiptarëve.

Në faqet e kësaj teme do të ndalemi veçanërisht edhe në një nga punimet e tij mbi gramatikën e shqipes dhe Fjalorin greqisht-anglisht –shqip.Nëpërmjet mjaft botimeve të tij Liku bën përpjekje të nxjerrë në dritë edhe mjaft vende arkeologjike,shënime topografike,dhe jetën shoqërore të shqiptarëve në Pashallëkun e Janinës që drejtohej nga Ali Pashë Tepelena.

Duke patur parasysh rëndësinë dhe vlerat e veprës së M.Likut,veprimtarinë e tij kërkimore e shkencore ,si dhe ndikimin e tij të vecantë në qarqet kulturore e shkencore të Europës së asaj kohe,në këtë temë analizohen e përgjithësohen mjaft të dhëna e mendime që kanë të bëjnë me prejardhjen e shqiptarëve dhe të shqipes,gjendjen e tyre kulturore e shoqërore,si dhe tiparet e marrdhëniet e tyre me popujt e tjerë të Ballkanit.

Fjalët çelës: U.M.Liku,veprat,botime,analizë,kontribut,studime

KONTRIBUTI I UILLIAM MARTIN LIKUT NË FUSHËN E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Bukuroshe Isufaj

Universiteti "Ismail Qemali"Vlorë

Studimi ishqiptarëve dhe gjuhës shqipe ka shfaqur nje interes të madh qysh herët te shumë udhëtarë, dijetarë , e studiues të huaj si:Bajroni,J.Hobhauzi,Margaret Hasluck, Aubrey Herbert, J.Pukvil,Th.S. Hjuzi, J.Besti,U.M.Liku,Eduard Lir etj.

Studimet e tyre dhe veprat që ata kanë lënë edhe pse hera-herës mund të shoqërohen nga ndonjë dozë subjektivizmi pa dyshim, janë një pasuri e madhe për shkencat etnografike, arkeologjike, kulturore ,gjeografike ,gjuhësore , dhe ato albanologjike në veçanti,megjithëse me keqardhje duhet thënë,se një pjesë e këtyre veprave edhe pse mbartin vlera të padiskutueshme janë studiuar pak ose nuk kanë arritur akoma të studiohen thellësisht .

Po nuk do të thuhej kjo për U. M.Lik pasi interesi për të nuk ka qenë i paktë as nga të huajt anlezë ,grekë apo francezë po as nga shqiptarët si Dh.Shuteriqi,J,Kastrati,L.Skëndo,I.M.Qafëzezi,Q.Haxhihasani,Shpresa Hoxha,Xhevat Lloshi etj.

Uilliam Martin Liku ,gjatë shek.XIX,shërbeu në disa vende ballkanike që ishin nën sundimin e perandorisë otomane.Edhe pse ai ishte diplomat ,me një kulturë të gjerë e erudicion të thellë ,në botimet e tij "Kërkime në Greqi","Udhëtime në Greqinë e Veriut","Udhëtime në More"etj, përfshihet mjaft material me interes për historinë ,kulturën ,gjuhën,dhe marrdhëniet ekonomike e shoqërore të shqiptarëve .

I një rëndësie të veçantëështë studimi dhe vlerësimi që ka bërë Lik në veprën e vet për origjinën e shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe ,për historinë , kulturën ,zakonet ,veshjet e mbi të gjitha për fustanellën ,këtë veshje tipike e origjinale shqiptare .Pra Lik ishte një njohës i mirë i shqiptarëve ndaj i trajton edhe me mjaft korrektësi duke analizuar gjeografinë dhe të dhënat në fushën e topografisë .Kështu Çamëria shkruhet *Camuria* apo Himara –*Khimara* etj ,duke toleruar faktin që nuk janë shkruar në gjuhën shqipe po vetëm në atë greke.Nuk ka më pak vlerë edhe skica gramatikore e Likut për gjuhësinë shqipe e në veçanti për dialektologjinë, pasiajo daton ndër gramatikat e para për gjuhën shqipe.

Liku në vëzhgimet e tij historike në librin e vet Kërkime në Greqi i kushton një rëndësi të veçantë popullatës shqiptare në pjesën jugore të Shqipërisë dhe pjesën veriore të Greqisë e duke bërë një ndarje në panoramën gjeografike e etnografike të poleve të Shqipërisë jugore e asaj veriore. Këtë të fundit edhe pse e prek pak, por sigurisht duke e njohur e përshkruan si ;"rajon me toka pjellore, me shqiptarëtejet luftarakë"e duke shtuar "*një racë që përmban krenarinë tipike të tyre dhe vrazhdësinë tipike me bullgarët"*[1]

Lik nuk përshkruan zhvendosjet e shqiptarëve nga Janina apo Thesalia drejt vendeve të tjera si Athina apo Moreja por, na jep një panoramë gjeografike të shqiptarëve në atë kohë,duke e shoqëruar me strukturën etnike të tyre ,ku psh për krahinën e Çamërisë shkruan se banohej kryesisht nga shqiptarë të besimit mysliman.[2]E kur ai flet për kulturën e lashtë greke apo bizantine nuk lë pa përmendur shqiptarët e Greqisë si një element mjaft të rëndësishëm historik.

Me sa duket, në atë kohë Likut i kishte tërhequr vëmendjen zhvillimi i shqiptarëve, duke i krahasuar me popujt e tjerë ballkanikë sidomos zona e Janinës, Myzeqe, Çamëri,fusha e Dropullit në Gjirokastër apo lugina e lumit Osum, Saranda apo Tepelena, për sa i takon zhvillimit bujqësor,blektoral apo edhe tregëtisë në përgjithësi, pa harruar zejtarinë si një tregues i mirë zhvillimi. Madje sipas tij shqiptarët dinin të përpunonin edhe drurin ,duhanin për këtë të fundit ai shkruan punishtet më të mira ishin në Korçë dhe Gjirokastër[3].Nuk ka lënë pa përmendur Vlorën që nëpërmjet portit të vet ishte një qëndër e rëndësishme tregtare e ekonomike , që sipas tij,mbante lidhje të ngushta me Beratin ,si"*qytet i rëndësishëm ndërlidhjeje me Shqipërinë e Mesme"*[4],apo Durrësin si një qendër strategjike dhe politike etj.

Liku erdhi në Shqipëri më 1804-1805vite kur veziri shqiptar e kishte shndërruar Janinën e shqiptarët nënjë element shumë tërheqës në Ballkan e Europë ,për tu vizituar e studiuar nga studiues ,diplomat,misionar apo udhëtarë për atëçka kish realizuar në ekonomi,politikë e kulturë.Nuk kish sitë mos shfaqte interes në studimin e vet për Ali Pashë Tepelenën, njeriun ambicioz i cili kishte bërë që në pashallëkun e tij jo vetëm të lulëzonte ekonomia po edhe qetësia aq sa kur ishkruan nënës së vet nga Preveza, Liku i thotë ;"*Njeriu është mësigurt në rrugët e Ali Pash Tepelenës se në rrugët e Londrës*"[5].Mbi të gjitha fama e Janinës kishte mbërritur gjithandej për zhvillimin e vet ekonomik ,politik, arsimor,kulturor dhe shoqëror . Duhet theksuar se zhvillimi në këto përmasa në shek e XIX i popujve të pashallëkut të Janinës u bë me interes për mjaft të huaj si francezë apo anglezëndër ta Bajron e Lik ,Hobhaus për studimin e origjinës,të gjuhës, historisë ,kulturës,veshjeve ,zakoneve etj deri aty sa ndonjë prej tyre studimin e

---

[1]W.M.Leake ,Researches in Greece,London 1814,f 251
[2]W.M.Leake,Travels in Norther n GreeceIV,London 1835,f 72
[3]W.M.Leake,Travels in Norther n GreeceI,,London 1835,f 337
[4]W.M.Leake,Travels in Norther n GreeceIV,,London 1835,549
[5] T.M.Moore, The life,letters and journals of Lord Byron,London 1830,f 95-98

vendeve të vizituara e konsideronte si synim prioritar[6].E në këtë këndvështrimLik ka theksuar se gjuha shqipe ishte një burim i mirë për tu pasuruar me informacione.

Në veprën e vet "Kërkime në Greqi "Liku bën një analizë në planin leksikografik të gjuhëve që përdoreshin në këtë vend veç shqipes e greqishtes edhe të vllahishtes e bullgarishtes, pra duke kuptuar kështu një vend me një popullsi jo fort homogjene edhe pse këta të fundit jetonin jo në qendër po në rrethina .Madje ai bën me dije se vllehët e vërtetë kanë huazuar alfabetin ilir të cilin ata e përdorin[7]. Në vazhdën e studimeve të veta me vlera historike për shqiptarët ,vllehët e bullgarët, ai përmend fjalorin katër gjuhësh duke e quajtur në greqisht "Lexicon Tetraglosson" e si pohon vetëështë shtypur pesëdhjetë vite më parë në Voskopojë.[8]Ai nuk lë pa përmëndur në studimin e vet megjithëse shkurt, popullatën sllave përvec atyre tëOhrit ,Prespës ,apo Manastirit e vendeve të tjera që i quan me emrin bullgarë, duke mos dashur të për sllavo-maqedonasit ,por për bullgarët që jetojnë pranë shqiptarëve rreth fushës së Dropullit apoLiqenit të Prespës, megjithëse në numër të vogël krahasuar edhe me vllehët që jetonin me ta.

Shqiptarët si në Camëri,Janinë apo Prevezë apo kudo ku jetonin i kanë mahnitur dhe entuziasmuar të gjithë miqtë ,vizitorët apo studiuesit me mikëpritjen e traditat e tyre të shkëlqyera dhe ndaj këta të fundit nuk nguronin ti shkruanin këto përshtypje si J.C.Hobhouse në veprën e vet" Një udhëtim nëpër Shqipëri dhe province të tjera të Turqisë në Evropë dhe në Azi deri në Stamboll gjatë viteve 1809-18010"shkruan për këto zakone,doke,traditë e histori me vërtetësinë që ai vet sheh,prek e jeton mes shqiptarëve në atë epokë.E ndërsa Lord Bajron si një udhëtarë i përhershëm e romantik i vërtetë i mahnitur nga ajo që pa në viset shqiptare nuk do të linte pa përmendur vec të tjerave edhe trimërinë,besnikërinë, fizikun ,bukurinë dhe vitalitetin e shqiptarëve .

Siç e përmënda dhe më lart shqiptarët kanë jetuar disa periudha të lavdishme historike ndaj padyshim interesi i shfaqur për studim nga të huajt nuk ka qen i paktë ,veç Likut dëshmi tëçmuara shkencore na kanë lënë gjithashtu H.Holland në veprën e vet *"Udhëtime në ishujt jonianë,Shqipëri ,Tesali,Maqedoni etj .Gjatë viteve 1812-1813,nga Henri Holland* "apo shëtitësi tjetër anglez Thomas Smart Hughes(Hjuz) me veprën "*Udhëtime në Sicili,Greqi dhe në Shqipëri*" dëshmohet edhe një herë për atë rëndësi të madhe ekonomike ,politike me kulturorë e civilizim me një elitë dijetarësh nga Shqipëria,Greqia po dhe Europa të atij pashallëku që kishte tërhequr vëmendjen çdo ditë e më shumë.Në këtë aspekt nuk ngelen pas as historiani gjerman L.S.Bertholdy(Bertoldi) , komandanti osman me origjinë franceze Ibrahim Manzur Efendi e as historiani dhe diplomati francez F.Pouqueville(F.Pukëvil) . Por dy janë ato që e bëjnë më të njohur megjithëse hera –herës me gabime e subjektivizma "*Udhëtime*

---

[6] Shpëtim Mema,Mendime për Gjuhën shqipe tek autorë anglezë të gjysmës së parë të shekullit XIX ,"StudimeFilologjike"4,Tiranë 1985,31

[7]W.M.Leake ,Researches in Greece,London 1814,f 382

[8]W.M.Leake ,Researches in Greece,London 1814,f 382

në More,në Stamboll,në Shqipëri dhe në shumë vende të tjera të perandorisë Osmane gjatë viteve 1798-1799,1800-1801",dhe "*Udhëtime në Greqi*" në pesë vëllime.Sigurisht, pika më e debatuar për tëështë kur fletpër origjinën e shqipes (thotë Kaukazi)apo kur thotë se shqipja nuk shkruhet me njëalfabet të vetin po me alfabetin grek apo atë turk ,ndërkohë që përpjekjet për të shkruar në shqip siç dihet nga dëshmitë nuk kishin reshtur që nga Buzuku ,Matrënga,Bardhi,Bogdani,Budi e Kavalioti e tentative për të bërë një skicë gramatikore ishte bërë edhe nga Dhaskal Todri apo Evstrat Vithkuqari etj.

Pra Janina për nga përmasat e marra nën sundimin e Ali pashë Tepelenës edhe pse një vend me popullsi heterogjene shqiptarë,grek,turq e pakicat e tjera, falë këtyre studiuesve dëshmon për një kulturë të lartë ,civilizim, qendër e rëndësishme politike ,shkencore tashmë me influencë në hapsirat ballkanike e më gjerë.

Lik i tërhequr nga këto kualitete gjatë udhëtimeve të tij nëpër viset shqiptare jo vetëm që shfaq interes për to, po dhe i dëshmon ato nëpërmjet veprave që na ka lënë me ngjyra të gjalla që nga vendbanimet ,orenditë,gastronominë gjë për të cilën shquhet sidomos zona e Çamërisëpo edhe si mjaft kursimtarë ,luftarakë dhe të zotë.Ai duke parë jetën e fshatit po dhe ndërtesat diferente nga ato të qytetit,i përshkruan me hollësi si një dëshmi të rëndësishme etnografike,dhe i vlerëson "ndër më të mirat që mund të gjendeshin në Turqinë Europiane [9].E sipas Lik jo vetëm konakët shqiptarë ishin me nam po edhe veshja, sidomos fustanella e famshme e Shqipërisë jugore dhe e Greqisë Veriore (zona e Çamerisë),ishte aq e bukur sa ishte huazuar edhe nga grekët.Një tjetër detaj që na pasqyron Lik është mënyra e të jetuarit ndërmjet familjeve apo fiseve në përputhje me ligjet e së drejtës zakonore[10] gjë që për mendimin tim vazhdon edhe sot në zonat e thella malore shqiptare.

Dijetarit anglez nuk kishte si të mos i tërhiqte vëmendjen krenaria e himarjotëve për lirinë e tyre të përjashtuar nga trysnia turke nëpërmjet formimit të tyre ushtarak e shërbimit që kishin realizuar në vende të huaja si mbretërinë e Napolit,apo të regjimeve franceze e angleze.

Dhe pa dyshim nuk do të mbetej jashtë rrezes së interesave të Lik edhe mënyra e organizimit të jetës shoqërore brenda familjes shqiptare në aspektin e zakoneve,dokeve,e mbi të gjitha, raportin burrë-grua . Një dëshmi e tij me mjaft interes është toleranca fetare midis muslimanëve e ortodoksëve gjë që vazhdon edhe sot si në asnjë vend tjetër të botës.E duke studjuar familjen shqiptare dijetari Lik ,megjithëse nuk na jep hollësi për dasmat ,festat apo ceremonitë e tjera familjare ,përsëri e vlerëson kulturën shqiptare si mjaft të lashtë ,të pasur ,të pastër e mjaft të vyer.

Në mënyrë të padiskutueshme dëshmitë që na ka lënë studiuesi Lik me të dhëna gjeografike dhe topografike të kohës së vet janë një meritë me një rëndësi të veçantë shkencore për shkencat albanologjike.Ai na ka sjellë emrat e vendeve që ka shkelur ,

---

[9]W.M.Leake,T.N.G,Vol IV,f 140
[10]W.M.Leake,T.N.G,Vol IV,f 87

vizituar apo ka pasur interes studimi gjatë udhëtimeve të tij për toponime të tjera pa dyshim ka shfrytëzuar informacionet apo burimet e autorëve antikë dhe atyre të mesjetës.Kështu psh,në librin e vet"*Kërkime në Greqinë Veriore*"na jep emra dhe tablonë e disa qyteteve si : Vlorë,Tepelenë,Sarandë , Gjirokastra,Artë, Prevezë,Sul,Nivicëetj. Vlora *(Valona*-italisht e *Avlona* –greqisht) edhe në atë kohë na dëshmohet nga Lik si një prej qyteteve dhe qendrave më të rëndësishmëve me rëndësi strategjike duke filluar nga prania e Sazanit ,nga popullsia me besim të përzier etj.Duke vazhduar me kalanë antike të Kaninës e njohur në historinë bizantine e këtë konstatim e bën në bazë të kronistes së Bizantit ,Ana Komnenës,[11]ndërsa për Vlorën pohon se mbështetet në autorin grek Straboni.Apo për Tepelenën na shkruan emirii saj lidhet me një grua(*Helenë* apo turqisht *Tepeddellene* e shqip *Tepelenë*)shtrihet pranë lumit Vjosë me një popullsi të përzier ,aty gjenden edhe rrënojat e qyteteve antike Limeni ,Eskala dhe emrat e dy kishave Shën Nikolla e Shën Vasili.Sarandën na e përcjell vetëm nëpërmjet greqishtes "*Agio Saranda* "emër i krijuar sipas gërmave të një kishe me sa duket e tipit bizantin "*Shën e Dyzeta"*.Po edhe dëshmia e tij mbi Prevezën duke e cilësuar si një prej qendrave më të bukura të kulturës greke[12]. Nuk kishte si të linte studiuesi ,pa përshkruar edhe një vend me nam për kohën siç shte Suli e suliotët me trimërinë dhe historinë e tyre , për kundërshtimin e Ali Pashës. Po jo vetëm kjo ,atai kishte bërë të famshëm edhe vallja e vdekjes e gjashtë burrave e njëzet e dy grave në majën e malit Zalongji për të mos rënë në dorë tëAli Pashës.Po në këtë libër "*Kërkime në Greqinë Veriore*" Lik na sjell edhe emra të tjerë të vendeve të Shqipërisësi:Lessio (*Lezha*),Oricus*(Orikum*),Liaberi*(Labëria*),Kalama(lum
në(Ç*amëri),*Tzamuria*(Çamëria*),Apolonia(Apollonia-Pojani
sot),Liuarati,Margariti,Aghia*(Agjia)* apo vende të pjesës veriore të greqisë si:Parga, Suli,Paramithia, Nivica,Progonati,Dodona,etj., dhe të tjerë emra në librin "*Udhëtime në More* "si:Liopesi (*Lopësi)*Ydhra (*Hidra),*Spata*(Shpata*) Tripolitza*(Tripolica)* e kështu lista mund të vazhdoj gjatë.

E nuk ka lënë pas dore në kuadër të shënimeve të veta mbi hartën e Shqipërisë edhe një ndarje topografike e etnografike duke vlerësuar se Labët, Çamët ,Gegët e Toskët janë farët që bënin popullsinë shqiptare dhe sigurisht të shoqëruar me hapësirat në të cilat shtriheshin duke na dhënë kështu një panoramë të rëndësishme gjeografiko-topografiko-etnik, që edhe pse studim i tij megjithëse me mangësi është një pasuri e madhe . Në bazë të përshkrimeve tëvendeve që na bën Lik në mënyrë të pa diskutueshmeështë një prej dëshmitarëve më të mëdhenj të asaj kohe të civilizimit të lashtë që kishin viset shqiptare në krahasim me fqinjët e tyre .

Siç e kemi përmendur edhe më lart, Shqipëria dhe shqiptarët për nga vjetërsia e ekzistencës së tyre ,për nga gjuha,zakonet,traditat , veshjet ,kultura dhe mjaftë elemente të tjera, ka tërhequr vëmendjen e dijetarëve ,gjuhëtarëve ,shkencëtarëve ,historianëve,etj dhe në këtë këndvështrim padyshim Lik shfaqet figura më e spikatur pasi përfundimet e tij u referohen jo vetëm udhëtarët anglezë e evropianë bashkëkohës,po studiues të

---

[11]W.M.Leake,T.N.G,Vol I,f 2
[12]W.M.Leake,T.N.G,Vol IV ,f 178

njohur ,albanologë të mëvonshëm[13]. Kështu duhet radhitur krah emrave me kontribute të vyera shkencore ,historike e gjuhësore siJ.Tunman,G.Lajbnic etj,që në kushtet e mungesës së materialeve dhe dokumentave në gjuhën shqipepërbëjnë një fond të rëndësishëm për të kuptuar mbi shqipen e shqiptarët.

Lik ,duke studiuar autorë të periudhave më të hershme si ;Skylaksit(Scylax), apoStrabonitnë atëçka shkruhej për Shqipërinë e shqiptarët para tij dhe mbështetur në studimin e vet shprehet prerazi se" Shqiptarët kanë prejardhje ilire" dhe "shqipja buron prej ilirishtes"dhe popujt e veriperëndimit grek i quan ilir dhe epirotik[14] duke shpjeguar edhe huazimet e shqipes nga gjuhët e tjera për hir të pozicionit gjeografik ,ngjarjeve historike apo dhe shkëmbimeve tregëtare. Unë ndaj të njëjtin mendim me Dr.Shpresa Hoxha kur pohon se "konstatimet e Lik për prejardhjen e shqipes nga gjuha ilire si dhe huazimet e elementeve të gjuhëve të huaja në shqipen janë plotësisht të drejta dhe shkencore[15] e duke u pajtuar me tezat e shkencave të sotme albanologjike[16].Ushtaraku,diplomati, studiuesi i historisë së Ballkanit, me një formim të plotë shkencor na dëshmon për etapat e kalimit të emrit ilir në arbër ,emër me të cilin do të njihen shqiptarët tash e tutje si nga bashkëkufitarët e tyre dhe nga letrarët e mesjetës, ashtu si dhe kalimi nga antikiteti në fillimet e mesjetës deri në shek e XI nëpërmjet një vakumi në informacion.Veprës së Lik nuk do ti mungonin as emërtimet pellazgë apo trakë, të cilët në antikitet jetonin në fqinjësi me helenët po që nuk flisnin greqisht, informacion të marrë në bazë të studimeve të veprave të autorëvë të lashtë Herodoti ,Straboni,Skylaksi apo Tukididi etj.

Edhe pse nuk flet për pjesën e madhe të shqiptarëve në historinë e Epirit sidomos në fundshekullin XII,apo për ekzistencën e një principate të Arbërisë me qendër në Krujëështë meritë e veçantë shkencore e tij kur pohon se falë edhe relievit malor, shqiptarët ilir dhe epirot i kanë mbijetuar asimilimit falë shpirtit të gjallë e luftarak.Një tjetër fakt që nxjerr në dritë studimi i Lik është shtegëtimi ishqiptarëve që prej 1391 drejt Moresë,Kalabrisë,Sicilisë etj. Eshtë po aq e vërtetë kur thotë, se shqiptarët në zonat e Durrësit ,Beratit,Kosturit,Janinës, Artës,Akarnanisë,Thesalisë e Maqedonisë deri në fillimshekullin XV nuk kishin , mundur ti mbanin nën qeverisjen e vet këto rajone sikundër viset malore gjatë sundimtarëve e pushtuesve të huaj ndërmjet të tjerëve Car

---

[13] Shpëtim Mema,Shqipëria dhe shqiptarët në veprat e udhëtarëve anglezë,Tiranë,1988 f.59

[14]W.M.Leake,R,G, f 241

[15] Shpresa Hoxha,Kontributi i Uilljëm Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike,prishtinë ,2007 f.71

[16] Shpëtim Mema,Shqipëria dhe shqiptarët në veprat e udhëtarëve anglezë,Tiranë,1988 f.60

Dushani[17]despotët bizantë apo feudalët frëngj, aq sa Epiri e Akarnania rreth vitit 1400 vihen nën sundimin e feudalit frëng Karlo Tokos[18].

Si ushtarak e diplomat Lik ishte një njohës i mirëi rrethanave politike nga historia mesjetare e shqiptarëve kundër trupave armike të Sulltan Muratit .Duke iu referuar veprës së Marin Barletit e duke u thelluar në studimet e veta me autorë të ndryshëm që kishin shkruar më herët për Shqipërnë e shqiptarët,aika bërë një përshkrim tejet vlerësues për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti[19].

Vepra e Martin Lik "Kërkime në Greqi " për nga vlerat e rralla që mbart dhe si një dëshmi e vyer për Shqipërinë e shqiptarët e epokës së vet po dhe më herët e me një studim të thellë e të plotëbazuar në korifejtë historik botëror , mund të quhet një kryevepër e tij, edhe pse për pjesën më lindore të Shqipërisë përdoret gabimisht termi Greqia e Veriut .[20]E për gjuhën shqipe një gjuhë me interes për të Lik do të shkruante edhe pse nuk i kishte parë personalisht këto shkrime , më herët kishin lënë dëshmi në gjuhën shqipe Teodor Kavalioti,Pjetër Budi ,Frank Bardhi apo Francesco Maria da Lecce etj.Gjuha shqipe nuk mund të shkruhet nëpërmjet greqishtes për faktin se kjo e fundit nuk i ka të gjitha shkronjat për të shprehur tingujt e shqipes .Megjithëse Lik shqipen e shkruan me gërma latine duke kombinuar shkronjat latine për disa tinguj të shqipes si me *kh = h apo edhe j ,tz =c apo dz=xh*etj dhe ngashembujt e dhënë në fjalorin e vet e në gramatikë , k e përdor me vlerën e k në shqip apo të q (kendis=qëndis apo ky,,këjo,kam,ke etj) ,g =g po edhe gj(giri =gjiri ,zongu =zogu ,etj) apo gi =gj (giuan=gjuanj) dhe l=l dhe ll(giale =gjallë) ,etj.

Po ta mendosh këto studime leksiko- gjuhësore Lik na i ka dhuruar që para dy shekujsh dhe nuk shohim ndonjë ndryshim të madh në shqipen e sotme ,shtatë zanore e hera herës *y* e konvertuar në*i* ,tipike kjo për të folmen e dialektit jugor Gjirokastër, në bregdetin e Shqipërisë Jugore(Saranda) e sidomos nëÇamëri [21].Është për tu theksuar se mënyra e paraqitjes së gjuhës shqipe me diftongje nga Lik janë mjaft pranë me gjuhën e sotme letrare me përjashtim të ndonjë rasti të rrallë*(ye* në *ie*).Tabloja e tij gjuhësore me një studim të hollësishëm gjuhësor e pa dyshim nga të gjitha gjasat në skicën gramatikore të gjuhës shqipe, del të jetë konsultuar edhe me Evrast Vithkuqarin ,apofjalorin e Dhanil Adam Haxhi Voskopojarit botuar më 1802 në Venedik e ribotuar më 1814 në Londër. Nga Lik ,na vjen një grafik i gjuhës shqipe me të gjitha veçoritë e veta e trasformimet fonetike që edhe me ndonjë mangësi në rasat apo në gjininë

---

[17] G.Schiro,cronacadei Tocco di Cefalonia,AnonimoProlegomen testo critica e traduzione,Roma 1975,p 42-49;Historia e popullit shqiptar I, f 192-193

[18]W.M.Leake ,R.G.f 248 Koco Bozhari,Kronika e Tokave si burim për historinë e formacioneve shtetërorë shqiptare të jugut në fund të shek XIV dhe në cerekun e parë të shekullit XV"Studime Historike"3,Tiranë,1976 f 177-182

[19]W.M.Leake ,R.G.f 248

[20] Shpresa Hoxha, Kontributi I Uilljëm Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike ,prishtinë ,2007 f.83

[21] Qemal Haxhihasani,Vështrim I përgjithshëm mbi të folmen e banorëve të Camërisë "Dialektologjia shqiptare"I,tiranë 1971,f142

asnjanëse apo mungesa e përemrave të pacaktuar apo vetvetor apo mungesa e disa kategorive gramatikore të foljeve(koha,mënyra,diateza)kanë një rëndësi të madhe për gjuhësinë shqipe e për dialektologjinë historike të saj, po të kihet parasysh edhe fakti që më parë nuk është botuar ndonjë gramatikë tjetër për gjuhën tonë,duke nxjerrë në pah karakteristika morfologjike,leksikore e fonetike , si një kontribut i vlefshëm për studimet gjuhësore.

I një vlere tëvaçantë në veprën e U.M.Lik është fjalori greqisht-anglisht-shqip me fjalë të mbledhura nga viset e trevat shqiptare në hapsira të ndryshme kohore ,në bazë të hartës gjeografike e mbi të gjitha historike që, siç pohon edhe profesori dhe studiuesi i madh i gjuhës shqipe prof.E.Cabej ”kanë lënë gjurmët e tyre si tek populli shqiptar ashtu edhe në gjuhën shqipe”[22] apo edhe nëpërmjet shkëmbimeve politike,ekonomike,tregëtare,kulturore,fetare etj, duke vënë në dukje huazimet nga të tjerat gjuhë, sidomos nga greqishtja e vjetër dhe ajo e re apo turqizmat që janë adaptuar nëpërmjet fjalëve turke,arabe e persiane,latine ,sllave, italiane ,frënge,etj. Si ipari studimi këtij lloji ,shprehjet frazeologjike të tij veçse pasuri janë edhe të bukura pasi janë mbledhur me kujdes nga burimi i pashtershëm popull (psh,vë më hu =e rrah fort).

Së fundi do të thosha se mbi autorësinë e Gramatikës shqipe dhe të fjalorit tri gjuhësh të Lik ka pasur dilema e debate se është vepër e tij apo i konsultuar me njohësin e madh të gjuhës shqipe Evstrat Vithkuqari apo është vepër vetëm e këtij të fundit . Mendime të ndryshme japin Dhimitër Shuteriqi, Ilo Mitkë Qafëzezi ,JupKastrati etj,por për të dhënë një mendim definitiv unë mendoj se duhen bërë studime të thelluara shkencore dhe dalja në dritë e autorit të vërtetë do të mbart vlera po aq sa edhe vetë ky studim gjuhësor ,që megjithë ndonjë gabim nga dimensioni i figurës së Lik si diplomat,ushtarak,e studiues i apasionuar nuk izbehen aspak vlerat e mëdha gjuhësore ,shkencore e kulturore si për dialektologjinë ashtu edhe për historinë e gjuhës shqipe.

Bibliografia

- Çabej Eqerem,Studime gjuhësore,III,Prishtinë 1978
- Haxhihasani Qemal,Vështrim i përgjithshëm mbi të folmen e banorëve tëÇamërisë, ”Dialektologjia shqiptare”I,Tiranë 1971
- Hoxha Shpresa,Kontributi i Uilljëm Martin Likut në fushën e studimeve albanologjike,Prishtinë 2007
- Leake Martin William,Researches in Greece,London 1914
- Leake Martin William ,Travels in Northen Greece,London 1835
- Leake Martin William,Travels in the Morea ,London 1930

[22] E.Cabej,Studime GjuhësoreIII,Prishtinë 1987,f.47

- Mema Shpëtim,Mendime për Gjuhën shqipe tek autorë anglezë të gjysmës së parë të shekullit XIX ,"StudimeFilologjike"4,Tiranë 1985
- Moore, T.M. The life,letters and journals of Lord Byron,London 1830
- Schiro G,Cronaca dei Tocco di Cefalonia,AnonimoProlegomen testo critica e traduzione,Roma 1975

Vlorë, 5 maj 2014

EVIDENTIMI I PERDORIMIT TE MASAVE TE BIOSIGURISE NGA PERSONELI INFERMIEROR NE SPITALIN RAJONAL VLORE

MND. Denada Selfo[1], Skender Skenderi[2], Brunilda Subashi[1], Juliana Xhindoli[1], Rozeta Luci[1], Yllka Bilushi[1]
Fakulteti i Shendetit Publik Vlore[1],QSUT "Nene Tereza"
e-mail : denadaselfo@yahoo.com

Abstrakt

Hyrje: Rreziku biologjik është ai që haset më shpesh në mjediset spitalore dhe sidomos në shërbimin e kirurgjisë, duke u përqëndruar në aksidentet nga shpimet me age dhe kontaktin me gjakun. Pasojat apo dëmtimet nga ekspozimi ndaj agjentëve biologjikë janë sëmundjet infektive që mund të jenë okulare, infeksionet kutane, sëmundjet parazitare. **Qellimi:** Identifikimi i lidhjes që ekziston midis aplikimit të masave të biosigurisë nga personeli infermieror dhe aksidenteve në punë me rrezik biologjik. **Metodologjia:**.Studimi shtrihet në një periudhë kohore nëntor- shkurt 2013 ne Spitalit Rajonal Vlorë. Për grumbullimin e të dhënave u përdor si instrument një pyetësor i vetëadministruar me rreth 16 pyetje te ndryshme qe u shperndane te 24 infermier te sherbimit te kirurgjise. **Rezultatet:** Personeli infermieror i shërbimit të kirurgjisë ka përjetuar një larmishmëri dëmtimesh të shëndetit të prejardhura nga puna, si incidente në 8% të rasteve, aksidente (shpime me age) në 38% të rasteve, sëmundje profesionale në 7% të rasteve, stres në 21% të rasteve, lodhje në 19% të rasteve, pakënaqësi në 9% të rasteve. Ky sherbim përdor në masë më të madhe kapuçin 22%, dorezat 17% dhe maskën faciale dhe uniformën sterile 15 %, në krahasim me masat e tjera të biosigurisë si syzet 3%, biankeria sterile 4%, instrumentet njëpërdorimshe 4% dhe shapkat e mbyllura 17%. Gjithashtu bie në sy një kontigjent i vogël infermierësh 3%, të cilët nuk përdorin asnjë prej masave standarte të mbrojtjes personale. 87% e personelit infermieror janë shpuar me age , ku 58% kane pësuar shpime me age mbi 4 herë gjatë vitit të fundit, 21% dy here, 13% nje here dhe 8% asnjehere. 50% e shpimeve kane ndodhur duke mbyllur agen. **Fjale kyc:** rrezik biologjik, shpime me age, masat e biosigurisë, infeksione spitalore.

Hyrjen : Sektori i kujdesit shëndetësor është kompleks dhe mbulon një shumëllojshmëri profesionesh dhe vendesh pune, përballet me rreziqe të ndryshme profesionale shëndetësore si dhe me problemet shëndetësore që i shoqërojnë ato. [7]. Rreziku për infeksione nga agjentet biologjike, njihet si një nga më të rëndësishmit në personat që japin kujdes në fushën e shëndetit, e në veçanti në ata që punojnë në zonat kirurgjikale mbi të gjithë profesionistët e infermierisë. [17], [18].Brenda shërbimit të kirurgjisë, personeli infermieror është i ekspozuar vazhdimisht ndaj rrezikut biologjik, për këtë është e nevojshme që të posedojë informacionin se si të aplikohen masat e biosigurisë për të parandaluar sëmundjet okupacionale.[21]Personeli infermieror që është i ekspozuar për një kohë të gjatë ndaj një agjenti biologjik, çon në rritjen e rrezikut për sëmundje infektive të shkaktuar nga ky lloj agjenti, e cila është e lidhur me mosaplikimin e masave të mbrojtjes universale. Midis sëmundjeve infektive të shkaktuara nga agjentët biologjikë ndaj të cilëve janë të ekspozuar profesionistët e shëndetit, qëndrojnë ato me etiologji virale si hepatiti B, hepatiti C, hepatiti Delta dhe SIDA, pa harruar viruset e tjera dhe sëmundjet e shkaktuara nga mikrorganizmat e tjerë.[21]

Qellimi: Evidentimi i masave të biosigurisë që aplikon personeli infermieror dhe i aksidenteve në punë në shërbimin e kirurgjisë prane Spitalit Rajonal Vlorë. Nxjerrja në pah e rëndësisë së planifikimit të masave parandaluese që do të synojnë eleminimin e faktorëve të rrezikut,

Objektiva te pergjithshem:

- Identifikimi i lidhjes që ekziston midis aplikimit të masave të biosigurisë nga personeli infemieror gjatë manipulimeve invazive dhe aksidenteve në punë me rrezik biologjik si shpimet me age.
- Evidentimi i dëmtimeve të prejardhura nga puna dhe vendi që zënë aksidentet me rrezik biologjik- shpimet me age.
- Evidentimi i profilit të personelit infermieror që nuk është shpuar asnjëherë me age gjatë vitit të fundit.
- Evidentimi i profilit të personelit infermieror që është shpuar mbi 4 herë me age gjatë vitit të fundit.

Materiali dhe metodat: Studimi u realizua në shërbimin e kirurgjisë, pranë Spitalit Rajonal Vlorë.

Studimi shtrihet në një periudhë kohore nëntor- shkurt 2013. Popullata e marrë në studim përbëhet nga gjithë infermierët që punojnë në shërbimin e kirurgjisë së Spitalit, pra 19 infermierë dhe 5 infermierë vullnetar te licensuar të UISH qe plotësuan pyetësorin e këtij studimi, pra 24 infermierë. Për grumbullimin e të dhënave për realizimin e këtij studimi u përdor si instrument i mbledhjes së të dhënave një pyetësor vetëadministruar me 16 pyetje, 7 prej të cilat i referoheshin të dhënave personale të personelit infermieror që mori pjesë në studim dhe 9 pyetjet e tjera u formuluan në mënyrë të tillë që të përmbushnin objektivat dhe qëllimin e këtij studimi.

Rezultatet :Nga përpunimi i të dhënave të marra nga pyetësori kemi këto rezultate:

4. Evidentimi i dëmtimeve të prejardhura nga puna dhe vendi që zënë aksidentet me rrezik biologjik- shpimet me age

Dëmtimet që ju keni përjetuar për shkak të punës janë:	Nr i infermierëve
Incidente në punë	5
Aksidente në punë (shpime)	24
Sëmundje profesionale	5
Stres	14

5. Evidentimi i masave të biosigurisë që përdor personeli infermieror

Masat mbrojtëse që ju përdorni gjatë ushtrimit të profesionit janë:	Nr i infermierëve
Kapuçi	16
Dorezat	12
Maska faciale	11
Uniforma sterile	11

Personeli infermieror I shërbimit të kirurgjisë ka përjetuar një larmishmëri dëmtimesh të shëndetit të prejardhura nga puna si incidente në 8% të rasteve, aksidente (shpime me age) në 38% të rasteve, sëmundje profesionale në 7% të rasteve, stres në 21% të rasteve, lodhje në 19% të rasteve, pakënaqësi në

9% të rasteve. Bien ne sy përqindja e ,lartë që zënë aksidentet me rrezik biologjik (shpime me age) në totalin e dëmtimeve të prejardhura nga puna, pra 38% të rasteve.

Grafiku1. Paraqet të dhënat mbi masat mbrojtëse që përdorin infermierët gjatë procedurave infermierore.

Grafiku 2.Paraqet te dhenat mbi demtimet qe kane perjetuar infermieret per shkak te punes









Grafiku 3,4: Paraqesin te dhënat e nr.te shpimeve me age dhe si ndodhi shpimi





Personeli infermieror i shërbimit të kirurgjisë ka përjetuar një larmishmëri dëmtimesh të shëndetit të prejardhura nga puna si incidente në 8% të rasteve, aksidente (shpime me age) në 38% të rasteve, sëmundje profesionale në 7% të rasteve, stres në 21% të rasteve, lodhje në 19% të rasteve, pakënaqësi në 9% të rasteve. Ky sherbim përdor në masë më të madhe kapuçin 22%, dorezat 17% dhe maskën faciale dhe uniformën sterile 15 %, në krahasim me masat e tjera të biosigurisë si syzet 3%, biankeria sterile 4%, instrumentet njëpërdorimshe 4% dhe shapkat e mbyllura 17%. Gjithashtu bie në sy një kontigjent i vogël infermierësh 3%, të cilët nuk përdorin asnjë prej masave standarte të mbrojtjes personale. 87% e personelit infermieror janë shpuar me age , ku 58% kane pësuar shpime me age mbi 4 herë gjatë vitit të fundit, 21% dy here,13% nje here dhe8% asnjehere. 50% e shpimeve kane ndodhur duke mbyllur agen.

Literatura:

1. Safety and health at work, http://www.ilo.org/global/topics/safety-and-health-at-work/lang--en/index.htm

2. Workplace, safety + health profile, ministry of manpower, singapore, http://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---asia/---ro-bangkok/---sro-bangkok/documents/policy/wcms_208348.pdf

3. Vanessa Ortiz, personal de enfermería debe capacitarse en prevención de accidentes laborales, http://bitacora.ivic.gob.ve/?p=2132, 8 julio 2011 at 12:27

4. Occupational risk factors. Marisol Concha-Barrientos, Deborah Imel Nelson, Timothy Driscoll, n. Kyle steenland, laura punnett, marilyn a. Fingerhut, annette prüss-üstün, james leigh, sangwoo tak and carlos corvalan, http://www.who.int/publications/cra/chapters/volume2/1651-1802.pdf

5. Hernández, Fernando Gil (2011-12-02). Tratado de medicina del trabajo (spanish edition) (kindle locations 44050-44138). Elsevier masson. Kindle edition.

6. Vlerësimi i riskut tek kujdesi shëndetësor, agjensia europiane për sigurinë dhe shëndetin në punë - http://osha.europa.eu, http://www.sli.gov.al/images/stories/focal_point/efact18.pdf

7. Dita botërore e sigurisë dhe shëndetit në punë, ishp, ministria e shendetesise, http://www.ishp.gov.al/dita-boterore-e-sigurise-dhe-shendetit-ne-pune/]

8. Historiku, http://spitalirajonalvlore.com/?page_id=28

9. Kirurgjia, http://spitalirajonalvlore.com/?page_id=192

10. Ortopedia, http://spitalirajonalvlore.com/?page_id=196

11. Reanimacioni, http://spitalirajonalvlore.com/?page_id=196

12. Shëndeti publik, Gentiana Qirjako, Genc Burazeri, Enver Roshi, Vitori Hasani, ISBN 978-99956-48-46-6, Tiranë 2010

13. Prevención de riesgos laborales, 2012, Fernando Luna Rosauro, ISBN: 978-84-9931-514-0.

14. Medidas de bioseguridad que aplica el profesional de enfermeria y la accidentabilidad laboral en la unidad quirúrgica, hospital "dr. José maría vargas" en el segundo semestre de 2007, téllez, julia, tovar maritza, caracas, enero de 2008.

15. Arellano, m. Y mark, a. (2002) factores de riesgo biológico a los que esta expuesto el profesional de enfermería del área quirúrgica

16. Carolina gisel rodriguez bravo, exposicion a peligros ocupacionales de los profesionales de enfermieria de urgencias, unidad de cuidados intensivos y salas de cirugia del hospital universitario san ignacio en la ciudad de bogota, durante el periodo comprendido mayo-junio de 2009.

17. Principet bazë të infermierisë së përgjithëshme, E. Kiçaj, A. Ramaj, 2012, ISBN: 978-99956-91-43-1.

18. Medidas de bioseguridad que aplica el professional de enfermeria y la accidentabilidad laboral en la unidad quirúrgica, hospital "dr. José maría vargas" en el segundo semestre de 2007, caracas, enero de 2008, t.s.u. Téllez, Julia, t.s.u. Tovar Maritza, lic. Maribel Osorio

18.Prevención vigilancia y control de riesgos profesionales, http:/www.risaralda.gov.co/sitio/salud/index.php/riesgos-profesionales

19. Accidentes de trabajo ¿porqué se producen? , http://www.dt.gob.cl/1601/ë3-article-63152.html

NDIKIMI I STANDARDIT DHE MARRËDHËNIET GJUHË E NJËSUAR / NËNDIALEKT / IDIOLEKT

Msc. Doriana Klosi

Universiteti "Ismail Qemali"

Vlorë, Shqipëri

dorianaklosi@gmail.com

Abstrakt

Gjuha është dukuri që gjithmonë është në ndryshim e zhvillim. Burimi kryesor për këto lëvizje në gjuhën letrare do të jenë përherë dialektet. Gjuha standarde kombëtare është por duhet të jetë më e hapur ndaj dialekteve, të pranojë prej tyre çdo gjë që nuk bie ndesh me sistemin e saj, çdo gjë që integrohet në mënyrë të natyrshme dhe e pasuron atë. Gjatë këtij proçesi gjuha letrare dhe dialektet do të jenë në marrëdhënie të dyanshme gjersa të jetojnë dialektet[1]. Përdorimi i variantit letrar të dialektit nuk e rrezikon gjuhën letrare kombëtare të njëhsuar. Asnjëri nga dialektet nuk i ka shterurar mundësitë e tij shprehëse, nuk ka vënë në qarkullim të gjithë pasurinë leksiore, frazeologjike dhe ndërtimet sintaksore, përdorimi i dialekteve në sfera dhe funksione të caktuara do ta pasuronte gjuhën standarde në drejtim të leksikut dhe sintaksës[2].

Fjalët kyçe: normë gjuhësore, dialekt, idiolekt, marrëdhënie të ndërsjellta.

Hyrja

Gjuha letrare ka në bazë tipare të dialektit jugor në sistemin leksikor, në sistemin morfologjik e në sistemin fonetik. Ndërsa, nga dialekti verior ka marrë disa elemente të veçanta me qëllim plotësimin e disa funksione të caktuara dhe që nuk shkaktojnë përzierje brenda tij[3].

"*Gjuha letrare kombëtare ngrihet dhe formohet mbi bazën e dialekteve e merr lëndët gjuhësore prej tyre dhe formon një sistem mbidialektor me*

---

[1] Gjinari, J., *Marrëdhëniet e sotme të dialektikave me gjuhën letrare.* Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011,f.456.

[2] Mansaku, S. , *Nga gjuha letrare kombëtare te gjuha standard-dallime terminologjike dhe përmbajtësore,* Botimet albanologjike, Tiranë, 2011, f. 60-61

[3] Çerkezi, E., dhe Billa. E., *Norma letrare e shqiptimit dhe tipare dalluese dialektore që hyjnë në gjuhën letrare.* Studime sociolinguistike. KOTTI, Korçë, 2013, f. 312.

normë të njëjtë për të gjithë. Zakonisht mbi bazën e saj qëndron një dialekt. Nga pikëpamja gjuhësore çdo dialekt ka mundësi dhe është i aftë ër t'u ngritur në nivelin e një gjuhe letrare e cila ka në bazën e vet një dialekt, por nuk përputhet krejtësisht me të"[4].

Materiali dhe metodat

Për këtë studim është shfrytëzuar literatura e albanologëve më të shquar shqipëtar, si Prof. Gj. Shkurtaj, Prof. J. Gjinari, Prof. A. Marashi, Prof. E. Çabej, studiues I. Mustafa, A. Omari etj. Materiali i përzgjedhur është gërshetuar me mendimet e gjuhëtarëve të huaj të Gjuhësisë moderne. Të tillë janë: R. Hudson, R. M. Morau, E., Briscoe, O. Ducrot, C. Porter, K. Rabbitt, L. Waugh, B. Bloch, V. M., Rentel.

Materiali teorik është analizuar dhe tipizuar nëpërmjet vëzhgimeve dhe anketimeve të realizuara në mjediset e Universitetit "Ismail Qemali". Reazilimi i plotë dhe i saktë i normës standarde është paraqitur me shembuj konktret. Marrëdhëniet e ndërsjellta që ekzistojnë midis normës gjuhësore dhe dialektit dhe shmangiet nga norma gjuhësore paraqiten të plota dhe shoqërohen nga materiali spjegues. Ndikimi i gjuhës së individit në grupin shoqëror e më gjerë është vëzhguar në marrëdhëniet socio-gjuhësore të bashkësisë shoqërore të grupit të ngushtë dhe të bashkësisë së gjerë studentore.

Rezultatet

Ndikimi i standardit dhe marrëdhëniet gjuhë e njësuar / nëndialekt / idiolekt

Norma letrare, krijoi shtresat e saj nëpërmjet lidhjeve me strukturat e ndryshme gjuhësore të të dy dialekteve. Gjatë proçesit të huazimit dhe përzgjedhjeve gjuhësore, norma standarde ka mënjanuar shumë elementë të rrafshit tingullor e leksikor me karakter mbeturinor. Për ilustrim mund të përmendim se në toskërisht sot bashkëjetojnë format me rotacizëm dhe format parotacizëm p.sh., (*vera-vena*), por (*hëna-hana*), etj. Rotanizmi i *n*-së ndërzanore në strukturën e gjuhës letrare mund të konsiderohet një tipar i shqiptimit jugor *(khs: vera-vera, hini-hiri, bani-bëri*)[5].

---

[4] Gjinari J, *Rotacizmi në dialekte dhe në gjuhën letrare në "Gjuha jonë"*, 2, Tiranë, 1978 fq 46-47. Cituar në: Çerkezi, E., dhe Billa. E., *Norma letrare e shqiptimit dhe tipare dalluese dialektore që hyjnë në gjuhën letrare.* Studime sociolinguistike. KOTTI, Korçë, 2013, f. 311.

[5] (*Fjalori i sotëm i gjuhës shqipe*) (1980).

Gjuha letrare ka huazuar edhe mjaft elementë të leksikut nga dialekti geg. Gjatë këtij proçesi huazimi janë përftuar edhe forma pa rotacizëm (formime të tilla në shqiptimin jugor duhet të kishin rotacizëm). Si rezultat, në gjuhën letrare gjenden fjalë që kanë burimin nga gegërishtja dhe që s'kanë rotacizëm, si: *zana, rini,* të cilat janë integruar plotësisht në strukturën e gjuhës letrare.

Në këto kushte, mund të shprehemi se norma letrare është në marrdhënie të vazhdueshme e të pandërprera me të dyja dialektet. Por, shembujt e mësipërm, nxjerrin përfundimin se gjuha standarde bazohet më tepër në dialektin tosk, duke pasqyruar tipare dhe elementë gjuhësor më afër veçorive të shqiptimit jugor.

Gjuha si dukuri shoqërore e veçantë, ka një ndërthurje e ndërtim mjaft kompleks. Duke e parë gjuhën si dukuri shoqërore që ndryshon pandërprerë në rrjedhë të kohës në lëmin e shqipes, vërehen ndryshime gjuhësore të rrafshit leksikor, fonetik, morfologjik, sintaksor.[6] Kjo gjuhë e normuar me rregullat e standardit i shërben një komuniteti të caktuar, jo thjesht për komunikim, por edhe si arritje e përparim të zhvillimit të përgjithshëm kulturor gjuhësor të çdo individi të shoqërisë.

Gjithashtu, gjuha e folur ka një sistem më të ndërlikuar, me shumë nënsisteme e mjete gjuhësore të stileve të ndryshme, që funksionojnë në sferën shkencore-teknike, në sferën shtetërore-administrative, letrare-artistike, politike-shoqërore, etj., kurse gjuha e stileve ka një sistem më të thjeshtë për shkak të numrit të kufizuar të stileve të saj[7].

Dallimi i tyre vjen edhe ngaqë në kodifikimin e normës së gjuhës së shkruar, në parimin fonetik[8] që është parimi themelor i gjuhës sonë letrare, ndërthuren edhe parimi gramatikor i cili kërkon të ruhen në shkrim njësia tingullore e fjalëve e të morfemave dhe parimi historik me parimin tradicional që e largojnë normën e gjuhës së shkruar nga norma e shqiptimit të sotëm.

Sipas Profesor A. Marashi (2011:11) shqipja i ka mjaft të gjalla dhe tepër aktive dialektet e saj. Prurjet dialektore dhe e folura bisedore janë rryma të natyrshme që mund ta ushqejnë e ta vitalizonë normën letrare. [9]

Prej studimeve të deritanishme mund të thuhet se nga të dy format e gjuhës standarde më e zbuluar dhe më e ndjeshme ndaj trysnive së

---

[6]Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territorial që ndikojnë në variantet e shqipes standard si dukuri sociolinguistike.* Studime sociolinguistike. KOTTI, Korçë, 2013, f. 380.

[7] Çerkezi, E., dhe Billa. E., *Norma letrare e shqiptimit dhe tipare dalluese dialektore që hyjnë në gjuhën letrare.* Studime sociolinguistike. KOTTI, Korçë, 2013, f. 313.

[8] Gjinari J, "*Përqasja e gjuhës letrare me dialektet në sistemin fonetik*",“Gjuha jonë”, 2, 1984

[9] Marashi A, "*Shqipja në etapën e sotme: sfidat e gjuhës dhe të gjuhëtarëve*", Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011. F. 12

dialekteve është forma e folur, sidomos ligjërimi bisedor. Ndryshe nga sferat e fonetikës dhe të morfologjisë që kanë inventar dhe sistem të përcaktuar e të fiksuar, sferat e leksikut e të sintakës mbeten gjithmonë më të hapura ndaj veprimit të dialekteve edhe në normën e shkruar sepse këto dy sfera kanë më shumë shtresëzime stilistikore, që kanë nevojë për variante funksionale, dhe ka ndërtime dhe fjalë sinonime që duhen pasuruar kohë pas kohe.[10]

Gjithësesi, situata e sotme gjuhësore sillet mjaft problematike në lidhje me fushën e zbatimit të kulturës gjuhësore. Jo në çdo aspekt të përdorimit të vet gjuha njeh saktësinë dhe normativitetin standard. Kështu, shumëllojshmëria e mjeteve të shprehjes, e gjuhëve të shumta të lëvruara brenda një komuniteti, e përdoruesve të tyre kanë rënë në një shkujdesje dhe deformin të standardit.

Në fazën e tanishme të zhvillimit të gjuhës sonë letrare sferat e leksikut e të sintaksës janë më tepër në lëvizje dhe pësojnë më shumë ndryshime se sistemi fonetik dhe morfologjik. Në këto dy sfera sot ndihet më shumë veprimi i dialekteve mbi gjuhën tonë standarde. [11]

Aspekti i parë që do të trajtojmë është përfshirja në gjuhën letrare fjalë dialektore të cilat shërbejnë për pasurimin, pastrimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të saj. Gjuha letrare funksionon në formën e shkruar dhe në formën e folur, midis këtyre dy varianteve ka edhe dallime.

Prurjet e shumta të popullatave në qendrat urbane kanë sjellë edhe një përthyerje të ndjeshme të normës letrare, sikurse në qendrat rurale duket një përforcim i dialekteve.[12]

Kështu, në gjuhën letrare nuk do të hynin nga dialektet pa funksione të veçanta si[13]: *katërdhetë, nadje, edh, tlynë, rënkoj* "ngushëlloj", *cini* "kanë uji", etj. Ajo ka pranuar variante dialektore me funksione stilistike ose si sinonime: *gocë-vashë* krahas *vajzë, lirishtë* krahas *rage, epem* krahas *përkulem.*

Ndodhë që studentë të ardhur nga qytetet veriore të përdorin me shoqërinë e tyre leksik, ndërtime fjalësh apo shqiptime krahinore. Kjo ndodh më tepër kur ata janë me vajza e djem nga mjedisi i tyre administrativ; ndërsa janë më të pakta rastet e shprehjeve gjuhësore krahinore kur ndodhen në shoqëri heterogjene.

Dijetarë si Bali, Guberina, etj., kanë vënë re se njeriu gjendet në të folur, jo në gjuhë. Ata kanë ndjekur edhe intonacionin nga aspekti i

---

[10] Hudson R. *Sociolinguistika,* Dituria, Tiranë. 2002, 25

[11] Çabej E. *Studime gjuhësore,* Prishtinë, Vëllimi V, 1975,f. 213

[12] Mustafa I. *Raporti gjuhë standard-dialekt në opinionet e studentëvetë UEJL-it dhe USHT-së.* Në Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë. USHT: Tetovë-Ohër, 2007,f. 274

[13]*Fjalori i sotëm i gjuhës shqipe,* 1980.

veprimtarisë gjuhësore, të cilin e konsiderorin si tërësi vlerash të gjuhës së folur, të realizimit folës.[14] Folësit dallohen nga pikëpamja stilistike, gjithashtu edhe nga ana fonetike.

Ndër gabimet më të shpeshta në fushën e fonetikës e të fonologjisë në ligjërimin e shqipes janë: përdorimi i varianteve territoriale të fonemave zanore e bashkëtingëllore, përngjashmime e rënie tingujsh të papranueshme për shqiptimin letrar; zhbuzorëzimi i /y/-së në /i/, humbja e opozicionit fonologjik ndërmjet bashkëtingëllores shumëdridhëse /rr/ dhe njëdridhëse /r/, mospërdorimi i glotales [h], shqiptimi më i përparmë e ndonjëherë edhe afrikatizimi i mesgjuhorëve /q, gj/ në /ç, xh/; këmbimi i /h/-së me /f/-në, ndërrimi i /nj/-së në /j/, monoftongimi i grupeve të zanoreve /ie/ dhe /ue/ në zanore të rëndomta të gjata, etj.[15]

Gjuha e folur është edhe nën ndikimin e dialekteve dhe gjysmëdialekteve. Parimi fonetik mbetet parimi themelor i cili luan një rol të rëndësishëm në shprehitë gjuhësore të folësit.[16] Norma e gjuhës së folur shqipe pasqyrohet në shprehitë gjuhësore të folësit dhe tregues i zbatimit të saj të drejtë është fakti se si reagon ky folës ndaj varianteve të ndryshme të shqiptimit. P.sh.: shqiptimet, *qën, e ënjte, shtrënjt*,ngjallin reagim te dëgjuesit dhe vlerësohen si tipare të qarta dialektorë të jugut[17].

Po kështu edhe lidhur me përdorimin e (ë) së theksuar përpara bashkëtingëlloreve hundore, norma e gjuhës së folur e shkruar është njësuar mbi bazën e formave me (e).[18] Lëkundje të normës dhe format me (ë) dëgjohen jo vetëm nga njerëzit e thjeshtë, apo situata joformale, por edhe njerëzit me kulturë gjuhësore, si folësit në TV, etj. Vihet re përdorimi i ***e-ë***: *vënd, mënd, brënda, trëmb, më dhëmb, etj*[19].

Shmangie nga norma kemi dhe në përdorimin e *r-rr: pavarrësisht, orre, zotërri.*

---

[14] Mujaj, H., *Edukimi gjuhësor dhe indeksikaliteti në gjuhën standarde.* Studime Sociolinguistike, Korçë, KOTTI, 2013, f. 46.

[15] Beci. B., *Gjuha letrare shqipe dhe bazat e saj dialektore*, "Albania", 3 Nëntor 1995, Tiranë.

[16] Shkurtaj Gj. *Kahe dhe dukuri të kulturës dhe gjuhës shqipe,* Tiranë, KRISTALINA-KH, 2003f.104

[17] Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territorial që ndikojnë në variantet e shqipes standard si dukuri sociolinguistike.* Studime sociolinguistike. KOTTI, Korçë, 2013, f. 382.

[18] Shkurtaj. Gj., *Kahe dhe dukuri të kulturës dhe gjuhës shqipe,* Tiranë, KRISTALINA-KH, 2003f.124.

[19] Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territorial që ndikojnë në variantet e shqipes standard si dukuri sociolinguistike.* Studime sociolinguistike. KOTTI, Korçë, 2013, f. 380.

Përdorimet e tipit *çertifikat* për çertifikatë, *uversitet* për universitet, *fugon* për furgon, *vin* për vjen, *filëm* për film, *pastaja* për pastaj, *naturisht* për natyrisht, *e bëjëm* për e bëmë, etj., janë jashtë normës.

Trysnia e dialekteve në raste shumë të pakta shihet edhe në tiparet që lidhen në inventarin e strukturave dhe të formave morfologjike e sintaksore, d.m.th. edhe në raste kur dallimet e dialekteve janë të karakterit strukturor, pra shumë të rëndësishme.[20]

Krahas tipareve të lartpërmendura, shkelje të normës gramatikore janë edhe tipare të tilla si: gabime në përdorimin e nyjës; përdorimi i formës së shumësit pa /ë/ fundore, në vend të përemrave vetorë; mosdallimi i gjinisë së përemrave vetorë *ata* dhe *ato;* përdorimi i kohës së ardhme pa pjesëzën *të;* përshtatja e gabuar e fjalëve përcaktuese me emra mashkullorë që e formojnë shumësin me *–e* dhe *–ra*; dëgjohen shpesh pjesoret e foljeve pa mbaresa: (kam) *lexu, shku, shkru:;* e pakryera veprore e foljeve ndonjëherë dëgohet e shkruhet në formën (punojsha) në vend të formës (punoja); *ne, ju* përdoren trajtat e tyre të dhanores *neve, juve*; *etj.*

Të shpeshta janë edhe gabimet në përdorimin e formës standarde të lidhores, sepse në vend të /ë/-së ose përdoret /e/-ja ose pjesëza të + forma e mënyrës dëftore e kohës së tashme e vetës së tretë njëjës, si p.sh.: (thuhet) *të shkojë* ose *të shkon, të punoje* ose *të punon, të mësoje* ose *të mëson (< duhet të shkojë, të punojë,të mësojë)* etj[21].

Duke qënë se gjuha jonë letrare tashmë është e formuar dhe është e ngulitur, në vështrim e parë do të dukej sikur këtu ka një kontradiktë. Por, në të vërtetë nuk ka kontradiktë sepse, së pari në tërësinë e gjuhës letrare të formuar sistemi dhe norma leksikore janë më të hapura. Së dyti, sidomos në sferën e leksikut janë shumë të pakta dallimet e mirëfillta dialektore[22]. Fjalët që do të hynin nga dialektet nuk do t'i binin ndesh normës letrare. Përgjithësisht, këto fjalë të këtilla janë pasuri e gjuhës shqipe. Për ilustrim po japim disa nga këto fjalë: *boranë, batak, gjithnajë, kopanis, tejtu etj*[23].

Sociologët dhe gjuhëtarët shprehen se shumë pak dihet për strategjitë e të folurit dhe të komunikimit, me të cilat të rinjtë duan të afirmohen në grupin e tyre shoqëror, të krijojnë realitete alternative (subkultura) ose të garojnë për prestigj. Mirëpo, në komunikimet e ndërmjetme për të rinjtë është me rëndësi ta shprehin Veten. Të jesh anëtar i një grupi kërkon një nivel të caktuar të ndërveprimit shoqëror. Nëpërmjet shoqërisë, të rinjtë

---

[20] Omari. A., *Vështrim mbi disa prirje të gjuhës së sotme letrare*, Botimet Albanologjike, Tiranë, 2011,n f.175

[21] Durmishi, G., *Kultura gjuhësore dhe shtresimet territorial që ndikojnë në variantet e shqipes standard si dukuri sociolinguistike.* Studime sociolinguistike. KOTTI, Korçë, 2013, f. 383.

[22] Gjinari. J., "Përqasja e gjuhës letrare me dialetet në sistemin fonetik","Gjuha jonë", 2, 1984

[23] *Fjalori i sotëm i gjuhës shqipe,* 1980.

mësohen ta përcaktojnë identitetin e tyre. Brenda shoqërisë, rrallë, krijohet një lloj identiteti i përkohshëm personal, siç e quan Broën (1990). Komunikimet brenda grupeve të tilla ofrojnë rast për t'i zbatuar aftësitë shoqërore dhe zhvillojnë strategji efektive për komunikim me shokët dhe me të tjerët. Në këtë situatë sociale, gjuha luan një rol të rëndësishëm gjatë përcaktimit të identitetit shoqëror të të riut. Si rezultat, krijimi dhe loja me gjuhën nuk është e pazakonshme në shoqëritë e tilla.

Secili prej nesh i përket grupeve të ndryshme sociale, dhe gjithësecili përdor shumëllojshmëri stilesh gjuhësore, me elementë që janë paksa të ndryshëm nga stilet gjuhësore të përdoruesve të tjerë të gjuhës.

Po ashtu, studimet sociolinguistike kanë parashtruar mendime për *identitetin statutor të folësit*, të ashtuquajtur ndryshe idiolekt[24]. Në këto studime shtrohet edhe teza se "gjatë ndërkëmbimeve individuale forma e mesazhit reflekton identitetin e adresës dhe referentin përkatës"[25]. Duke kundruar gjetjet gjuhësore të studentëve, tashmë jo në tërësi por si individë të veçantë, vërejmë se si ato pasqyrojnë identitetin individual e social: mosha, seksi, krahina, karakteristikat fizike të zërit, pozicioni, dhe prezantimi i parë i tyre paraqitet nëpërmjet emërtimeve nga të tjetër e për të tjerët. Kështu, përdorimi i zbunimeve*: Lushka, Niti, Genushe* etj; shfaqja e antroponimeve konotative *Altin Tralalaja, Genta Sherrxhesha* dhe i emrave të përgjithshëm: *shoku, shoqe*, të cilat shërbejnë si forma të adresimit për të shfaqur orientimin e tyre psikosocial në raport me adresën[26], si edhe ndjenjën për të vendosur raportet e distancës ose të afrimitetit me të tjerët.

Në lëmin e studimeve gjuhësore mbi idiolektin, shumë debate e etiketojnë gjuhën si më tepër vetjake sesa sociale, duke krijuar edhe "*konfliktin*": Idiolekt kundrejt Sociolekt. Gjuha e përdorur nga individi është përkufizuar si dialekt individual—mënyra origjinale e përdorimi të gjuhës gjatë aktit ilokucionar.[27]

Gjatë përdorimit individual të gjuhës, folësi ndikohet nga një sërë faktorë, si p.sh.:

Tabela 1. 1 Faktorët që ndikojnë në ligjërimin individual

Kultura dhe media—tv, filmat, muzika, librat, revistat

[24] Sipas gjuhëtarit Bernard Bloch, termi idiolect rrjedh nga Greqishtja idio (personale, private) +(dia)lekt.
http://grammar.about.com/od/il/g/idiolecterm.htm

[25] Morau, M. "*Sociolinguistique*", Paris, 1997, f. 163

[26] Morau, M. "*Sociolinguistique*", Paris, 1997, f. 164

[27] *Investigating the relation between idiolect and sociolect.* www.teachit.co.uk 2008, f. 6. 25/09/2012 17:58.



Ndryshimet më të shumta në nivel individual, janë hasur nëfjalorin e përdorur sipas interesave dhe aktiviteteve dhe shpiptimin e fjalëve e shprehjeve të ndryshme i cili ndikohej nga mjedisi administrativ që i përket secili student, si dhe nga situata sociale. Në rast të ndryshimit të situatave, folësi ndryshon regjistrin gjuhësor duke e përshtatur ligjërimin në varësi të situatës. Dukuria e ndryshimit të rregjistrit (në sociolinguistikë njihet si register sëitching) ndikon në fonologji, sintaks, leksik dhe elementët paragjuhësor të individit[28]. Elementët e lartëpërmendur ndryshonin dhe përshtateshin sipas interlokutorit me të cilin zhvillohej biseda.

Tipar tjetër i dallueshëm i idiolektit është tipari fonetikor, i cili fiton përdorim edhe në bashkësinë socio-gjuhësore në të cilën folësi individual është anëtar.[29] Nëse tipari fonetikor fiton popullaritet, ai gjen përdorim edhe më të gjerë në kulturat e tjera gjuhësore. Janë jo të pakta rastet kur dëgjohen rëndom të përdoren variante të tilla të fjalëve: *shtëpia-shpia; shpërlaj-shplaj; rrugë-rug; mundësi-munci; internet-net; një çikë-çikë; duhen-duen; hajde-hajt; çfarë-ça; rrihet-riet;vijnë-vin; rëndësishme-rëndsishme; përdorues-përdorus; kraharor-kraror.*

Përfundime

Duhet pasur parasysh se gjuha e folur e çdo njeriu, vartësisht nga vendlindja, vendbanimi, arsimi, profesioni, etj., pasqyron gjurmët e përvojës dhe të përjetimeve të tij.[30]

Një klasë e organizuar dhe e strukturuar mirë do të ndihmonte në mbajtjen e nxënësve në punë.Mjedisi i strukturuar dhe funksional i motivon nxënësit që të përgatiten për rubrika të ndryshme të orës mësimore dhe t'i ushtrojmë ato në harmoni me të.Mjedisi pozitiv i shtyn nxënësit dhe mësuesin që e udhëheq procesin drejt një të nxëni cilësor.

3.Krijimi i një ambjenti të sigurt

Nxënësit do të motivohen nëse ata ndihen të sigurt dhe të mbrojtur në klasë.Ata vijnë nga lloje të ndryshme personalitetesh dhe nevoja të ndryshme të të nxënit,kështu që mësuesi duhet t'i adresojë në mësimdhënie të gjitha këto diferenca midis tyre.Në klasë ka nxënës të ndryshëm,nxënës me shenja individualiste të forta,dhe nxënës që vijnë për herë të parë në një mjedis të ri,i cili për ta është i pasigurt.Ata arrijnë rezultate pozitive nëse mbahen nën vëmendjen dhe komentet pozitive të mësuesit.

4 . Stilet e të nxënit janë të ndryshme.Nxënësi duhet mbajtur në tension të vazhdueshëm për t'u bërë i përgjegjshëm për pritshmëritë ndaj tij,(pritshmëri në një kohë të shkurtër)por nxënësi nuk duhet të ndjehet i frikësuar.

5. Vendosja e ndërthurur e nxënësve në klasë

Në klasat ku ka nxënës që kanë ardhur nga shkollat e tjera jashtë vendit,vihet re një prirje për t'i dalluar nxënësit e ardhur duke i vendosur në bankat e para afër tryezës së mësuesit.Ne mendojmë se mësuesi nuk duhet të gabojë duke i vendosur në radhën e parë të veçuar,por duhet t'i integrojë mes grupimeve,veçanërisht duke i vendosur me nxënës me përparim më të mirë për t'i ndihmuar në ecurinë e tyre të mëtejshme.

6. Ndryshimi i vazhdueshëm i orës mësimore

Në klasat me nevoja të veçanta(me nxënës të ardhur)një format i orës mësimore nuk mund të funfsionojë për secilin nxënës.Mësuesi duhet të ndryshojë herë pas here formatin e tij të zhvillimit të orës mësimore,duke përfshirë punë në grupe,punë në çifte,detyra individuale,apo duke aplikuar teknika të larmishme mësimdhënieje që do të tërhiqnin një numër gjithnjë e më të madh nxënësish drejt objektivave të të nxënit.Mësuesi duhet të organizojë mirë rubrikat pyetëse për kategorinë e nxënësve të integruar.

7. Lavdërimi dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve.

Për çdo arritje sado e vogël dhe e parëndësishme qoftë ajo ,mësuesi duhet të shprehë konsideratën e tij dhe të çmojë punën e bërë nga ata,në rast të kundërt motivimi i tyre nuk do të jetë aspak nxitës dhe mobilizues për të përvetësuar njohuri,koncepte apo aftësi dhe shprehi të të nxënit.Mësuesi duhet të përdorë strategji në të cilat vetë nxënësit shikojnë përmirësimin e tyre,nuk ka rëndësi se sa i vogël është ai.Duhet gjetur diçka pozitive në punën e nxënësve edhe nëse nuk është ajo e kërkuara.

8. Lëvdatat nuk i bëjnë keq asnjëherë nxënësit.

Në qoftë se nxënësit që duan të integrohen,të arrijnë rezultate pozitive në përvetësimin e gjuhës shqipe dhe njohuri në të gjitha lëndët,vënë re se në mënyrë konstante po dështojnë dhe nuk po arrijnë asnjë rezultat,atëherë ata do të fokusohen mbi diçka tjetër,që do të thotë sjellje jo e përshtatshme dhe prishje e disiplinës pozitive të punës në klasë.

9. Kalimi i përgjegjësive të nxënësit.

Për të rritur nivelin e motivimit të kësaj kategorie nxënësish mund t'i vendosim ata në role lideri brenda grupit.Këtë rol mund t'ua japim veçanërisht në veprimtari argëtuese,sportive pasi këta nxënës shfaqin aftësi të mira argëtuese kjo dhe për rëndësinë që i kushtohet lëndëve të edukimit muzikor,figurativ e fizik në shtetet nga kanë ardhur.Në këto veprimtari,nxënësit e rinj shfaqin vërtetë vlera për t'u admiruar.

10. Mosvënia në siklet e nxënësve.

Asnjëherë e për asnjë arsye nuk duhet që mësuesi të vërë në siklet,të shigjetojë apo të turpërojë nxënësin në prani të shokëve të tij të klasës. Nxënësit në rast shigjetimi reagojnë keq,ata shkëpusin lidhjen me mësimin,demotivohen,mund të braktisin orët mësimore.

11. Përpikmëria në zbatimin e orarit mësimor.

Nëse mësuesi nuk është i përpiktë me orarin mësimor,nëse ai paraqitet në klasë pesë minuta apo edhe më vonë pasi ka filluar ora mësimore,atëherë nxënësit kanë shansin të sjellin problem në klasë.Dhe nëse parregullsitë përsëriten nga mësuesi,është e sigurtë që do të imitohen edhe nga nxënësit.

12. Zemërgjerësia dhe mbështetja.

Për një nxënës të ri,ardhja në një realitet arsimor, social,kultura ndryshe përbën një stres më vete,mungesë sigurie e dyshim për rezultat.Një nxënës që mbart frikë në vetvete mund të arrijë performancë të ulët gjatë gjithë vitit.Mësuesi duke punuar me këmbëngulje dhe durim që nxënësit të nxjerrin jashtë vetvetes së tyre frikën. Nga sa thamë më lartë,vihet re se kjo listë me udhëzime për mësuesin ka në themel të vet motivimin,i cili përbën një faktor kyç që përcakton nivelin e arritjeve në mësimdhënie.

Përfundime dhe rekomandime

Kjo punë me rëndësinë e problemit që trajton synon të hapë një dritare të re per dukurinë reale të integrimit të nxënësve.

Nëpërmjet çështjeve të trajtuara arritëm në përfundimin se roli i mësuesit është vendimtar në integrim,por edhe nxitës për ruajtjen e identitetit kombëtar.

Mendojmë se një vend të rëndësishëm Ministria e Arsimit duhet t'i lë hartimit të programeve të veçanta të studimit për këtë kategori nxënësish dhe jo të mjaftohet me programet e hartuara prej tyre duke e lënë në ndërgjegjen e secilit mësues. Disa prej sugjerimeve tona do të ishin:

1.Përfshirja në kurrikulat shkollore e një plani të veçantë për integrim

2.Sigurimi i librave falas për diasporën

3.Krijimi i klubit të dygjuhësisë në mjediset shkollore.

4.Punësimi i mësuesve plotësues për orët shtesë me këtë kategori fëmijësh

5.Formimi në mjediset e DAR-ve të rretheve i grupit të mësuesve në dispozicion për këtë kategori nxënësish. Mendojmë se ky grup mund të jetë edhe i përbëre nga studentë që kanë mbaruar sistemin 3-vjeçar dhe vazhdojne studimet master .Ata mund të ndjekin praktika pedagogjike pranë

shkollave ku ka nxënës të ardhur nga jashtë shtetit dhe mund të ndihmojnë edhe mësuesin e lëndësës me ndihmën qe mund t'i japin për këtë kategori nxënësish.

6.Mbështetja që bordet e shkollave duhet t'i bëjnë këtij grupimi nxënësish është shumë e rëndësishme.Bordi si organ që miraton buxhetin e shkollës duhet të planifikojë një fond shtesë për nxënësit emigrant në mënyrë që ai të përdoret në çdo kohë kur të ketë nxënës të tillë.

8. Ne mendojmë se edhe mësuesit që punojnë me këta nxënës duhet të vlerësohen finianciarisht pasi ata zhvillojnë një punë të dytë dhe pavarësisht misionit fisnik qe mësuesit kanë edhe ata kanë nevojë për motivim i cili duhet të vijë natyrshëm e si vlerësim i punës se secilit.

9. Si përfundim ,procesi i integrimit të nxënësve të ardhur nga jasjtë shtetit është një proces i vështirë që kërkon një vullnet të përbashkët të të gjithë aktorëve:shkollë ,familje,komunitet.

Bibliografi

Cummins J.(1984),Bilingualism and special education :Issues in assessment and pedagogy,Clevedon (England),Multilingual Matters .

Favaro G.(2007),l'imigrazione cambia la scuola ,Milano ,Franco Angeli .

Vuji .Mark,(2012),Vetëvlerësimi mësimor ,Kultura e të nxënit seria 3 Geer Tiranë.

Demiraj,Prof.Shaban:''Gjuha shqipe dhe historia e saj''Tiranë 1988

Kraja.Musa:(1997), Idetë Pestalociane në hapësirën shqiptare ,Tiranë .

Meholi,Muhamet: (2010), Forcimi I karakterit të shkëlqyer te fëmijët ,Shkup.

Musai. Bardhyl:(1996) ,Mjeshtëritë e mësimdhënies ,Tiranë .

Kraja ,Musa(2008) ,Sa merresh me fëmijën tënd''Geer ,Tiranë .

Balboni P. (1994),Didattica dell'italiano a sranieri ,Roma ,Bonacci

Balboni P.(1998),Tecniche didatiche per l'educazione linguistic,torino ,Utet

Balboni P.(2008) Imparare le lingue straniere ,Venezia ,Marsilio

Bettoni C.(2001) Imparare un altra lingua ,Roma –Bari ,Laterza.

Bettoni C.(2006) Usare un altra lingua ,Roma –Bari ,Laterza.

Corder P.(1983),Itroduzione alla linguistica applicata,Bologna,Il Mulino.

Ellis R.(1997),Second language acquisition ,Oxford ,Oxford University Press.

Krashen S.(1981),Second Language Acquisition and Second Language Learning ,Oxford ,Pergamon Press.

Pallotti G.(1998),La seconda lingua ,Milano ,Bompiani.
Selinker L.(1972)Iterlanguage ,<<IRAL>> n 10.

RËNDËSIA E GABIMEVE NË MËSIMNXËNIEN E GJUHËVE TË HUAJA.QËNDRIMI MËSUESIT NDAJ TYRE .

Eglantina Gerveni

Universiteti Ismail Qemali

Vlorë \Shqipëri

egla_gerveni@yahoo.com

Abstrakt

Bota në të cilën jetojmë ka si kryefjalë të saj komunikimin. Gjuha është mjeti i vetëm i cili realizon komunikimin, për këtë arsye mësimi i gjuhëve të huaja është bërë jetësor .Ky sdudim ka si synim të tregojë rëndësin e gabimeve në mësimin e gjuhës së huaj .Vendi që duhet të zë trajtimi i tyre në organizimin e mësimdhënies e në vendosjen e objektivave nga ana e mësuesit

Nëpërmjet këtij punimi do jepen përgjigje mbi pyetjet : çfarë mund të konsiderohet si një " gabim "? Të gjithë gabimet janë të së njëjtës rëndësi? Cili duhet të jetë qëndrimi i mësuesit ndaj gabimit? Cilët janë katër kriteret te të cilët duhet të mbështetet mësuesi per të identifikuar e klasifikuar gabimin? Cilat janë efektet që shkakton te nxënësi korrigjimi ose moskorrigjimii i gabimit ? Këto e shumë cështje të tjera do të jenë në fokus të këij studimi.

Fjalë kyçe - gabim, gjuhë e dytë, mësues,nxënë, mësimnxënie

Studimet mbi analizën e gabimeve

Studimet mbi analizën e gabimeve karakterizohen nga ndryshim rrënjësor i teorive të interferencës dhe të konceptimit të gabimeve. Kriteret e klasifikimit janë të shumëllojshme dhe tipologjia e tyre (gabime absolute / relative, gabim fonetik, leksikor, morfosintaksor, sitematik, josistematik, ndërgjuhësor, të heqjes apo shtimit, të zhvendosjes, etj. Chomsky ka një ndikim thelbësor. Gjatë konferencës së 1966-ës, drejtuar profesorëve amerikanë të gjuhës, ai ngre çështjen dhe vë në diskutim paraqitjen e gjuhës si sistem zakonesh. Bihevjorizmi veçohet duke u mbështetur në konceptin ku gjuha paraqitet si një proces krijues, që mbështetet në disa rregulla abstrakte. Ndikimi i Chomsky-t ndjehet, gjithashtu, në një dallim të rëndësishëm, që del nga konceptet e kompetencës dhe performancës, të cilat bëjnë të mundur

të ndajnë dy përkufizimet, përkatësisht bazë të *gabimeve*: *të kompetencës* dhe *të prodhim-performancës.* Pit Corder e karakterizon këtë dallim duke llogaritur si *gabim të kompetencës atë që është rezultat i rastësisë së rrethanave*, dhe *të prodhimit, gabimin që reflekton në një çast të dhënë njohurinë gjuhësore, ose si mund ta quajmë dhe kompetencë kalimtare*. Gabimet e performancës janë josistematike dhe gabimet e kompetencës janë sistematike.

Pit Corder ka dhënë një ndihmë të madhe në dhënien e statusit pozitiv *gabimeve të kompetencës,* për të cilat ai ndan dy lloj qëndrimesh:

1. i konsideron rezultat të një mësimdhënieje të papërshtatshme. Nëse mësimdhënia do qe e përkryer nuk do të kishte gabime.

2. Fataliste, shpjegohet me thenien 'errare humannum est'. Pra gabimi është një shprehje e natyrshme e mësimnxënies. Ai nxjerr në pah dimensionin e tyre sistematik.

Shkaqet e gabimeve

Pit Corder pretendon se tre janë shkaqet kryesore të gabimeve, të cilat i etiketon" *gabime transferimi" "gabime analogjike* " "*gabime të shkaktuara gjatë mësimit*". Të njejtat mendime ndajnë edhe studiues të tjerë., Jack C Richards e me rradhë.

Devijimi nga norma në përdorimin e gjuhës së huaj shkaktohet nga shumë arsye. Kështu pra kemi: 1- *interferencën "e jashtme"*, dmth atë që ushtrohet nga gjuha amë apo nga një gjuhë tjetër e huaj që është mësuar më parë. Një shkak tjetër i gabimeve është 2- *interferenca "e brendëshme"*, e shkaktuar nga mungesa e përvetësimit të rregullave të Gj2 apo nga analogjia e gabuar që nxënësi përpiqet të vendosë në brendësi të saj.

Gabimet që lidhen me *llojin e parë* të interferencës kanë karakter *fonologik dhe sintaksor*, ndërsa ato të shkaktuara nga interferenca e *brendëshme* janë kryesisht të *karakterit morfologik* (dAssi për dEssi), folja 'dare' në formën e saj në kohën e kryer të thjeshtë. 3- Më në fund disa gabime hasen në të ashtuquajturën "*transitional phase*", atëherë kur nxënësi pushon së marri për model sistemin gjuhësor të gjuhës amë pa arritur ende të zotërojë sa duhet sistemin e Gjuhës së huaj.

Interferencat e gjuhës amëtare apo transferimi i gjuhës amëtare në gjuhën e huaj.

Megjithëse fëmijët e vegjël duken të aftë të mësojnë shumë shpejt një gjuhë të huaj dhe të riprodhojnë saktësisht tingujt e rinj , nxënësit më të rritur hasin vështirësi të konsiderueshme . Sistemi fonetikor i gjuhës mëmë i imponohet gjuhës së re dhe çon në një shqiptim të huaj , në modele gramatikore të gabuara dhe , në disa raste , në zgjedhje të gabuara të fjalorit . Fjalitë në gjuhën që ata duan të mësojnë ndikohen nga fjalitë e gjuhës amëtare. Sic thotë dhe Pit Corder, gjuha amëtare na jëp një gjuhë specifike e mjaft të pasur me hipoteza që mund të përdoren nga nxënësi që mëson gjuhë

të huaj. Shumë nga ato mund të konfirmohen ngaqë gjuhët kanë shumë gjëra të përbashkëta. Nxënësi që mëson gjuhë të huaj ndonjëherë ndjen se dy gjuhët janë mjaft të ndryshme kurse në fakt ka shumë mënyra në të cilat njohuritë e gjuhës amë mund të transferohen drejtpërdrejtë në përvetësimin e gjuhës së huaj. Kjo do të thotë se nxënësi nuk do zbulojë cdo gjë nga zero. Për shembull kur nxënësi shqiptar mëson gjuhën italiane, kemi rregula themelore të renditjes së fjalëve në fjali dhe të kategorive gramatikore gati të njëjta.

Ja disa shembuj:

‘E‘ una persona culturata...’. Në vend që të thonë : ‘colta’.

‘Ho imparato tutto il giorno ’. Në vend të : ‘ho studiato...’.

‘Siete gia‘ qui, Signore?...’ Në vend të ‘ E‘ gia‘ qui, Signore’.

‘La monte....’. Në vend të :‘Il monte...’.

‘Periodo [peri‘odo]’. Në vend të: ‘Periodo [pe‘riodo]’.

‘camariere...’ Në vend të: ‘Cameriere ’.

Mbipërgjithësimi

Teoria mentaliste pretendon se gabimet janë të pashmangshëm sepse reflektojnë një sërë stadesh në zhvillimin gjuhësor të nxënësit . Kjo teori pretendon që nxënësi përpunon të dhenat e gjuhës së huaj dhe krijon disa rregulla bazuar në disa të dhëna. Aty ku të dhënat janë të papërshtatshme , ose të pjesëshme , ndodh që:

A) Rregulli nuk zbatohet për një dukuri të veçantë, një folje, një shprehje foljore etj., edhe pse i përket kategorisë së duhur. Për këtë duhet të mësojmë një përjashtim për rregullin e përgjithshëm.

B) Dukuria që trajtohet i përket një kategorie ndryshe për të cilën ka një rregull që përdorim ne. Për këtë duhet të përdoret me një kategori të ndryshme apo të ndërtojmë një kategori të re dhe një rregull të ri.

Në të dy rastet, gabimi është shkaktuar nga mbipërgjithësimi apo e thënë ndryshe nga tejpërgjithësimi i një rregulli që na shkaktoi një parashikim të gabuar.

Për shembull në gjuhësi: një nxënës që mëson gjuhën italiane ka përvetësuar se emrat e shquar në italisht marrin një nyje shquese përkatesisht për gjininë mashkullore njëjës dhe shumës ‘Il’, ‘I’, dhe për ata femërore përkatësisht ‘La’, dhe ‘Le’. Nga sa thashë më lart nxënësi ka formuar rregullin nyje shquese mashkullore apo femërore, njëjës apo shumës plus emri përkatës. Mirëpo kur nxënësi thotë: ‘Il mio fratello., la mia sorella’., ai ka mbipërgjithësuar rregullin duke e shtrirë edhe me ata emra të cilët nuk kërkojnë në njëjës nyje shquese pse emra që tregojnë lidhje gjaku kur

shoqërohen nga një përemër pronor nuk marin nyje shquese. Ka vend për të aresyetuar edhe për interferencë nga gjuha shqipe. Një rast tjetër: përdorimi i nyjes shquese njëjës mashkullore përpara emrave që fillojnë me 'ps', 'gn', 's+bashkëtingëllore', 'y' , 'z', 'x' ,si për shembull : ' lo psicoterapista , lo stadio', lo xenofobo , lo zaino , etj., gabimi shumë më i përsëritur është përdorimi thjesh i formës mashkullore të shquar njëjës 'Il' që rezulton e gabuar për këto raste : ' Il psicoterapista, ' il stadio', 'il xenofobo', 'il zaino'...etj. Ky është rasti i tejpërgjithësimit dhe për emrat që kërkojnë nyjen 'Lo' dhe jo formën tjetër 'I'.

Po ashtu dhe për foljet ndihmëse në përdorimin e tyre në formimin e kohëve të përbëra. Folja 'avere' dhe ' essere' plus pjesore e shkuar e foljes kryesore. Kështu kemi: ' Ho camminato', 'Ho mangiato'. Me foljet jokalimtare nxënësi priret të zbatojë këtë rregull me foljen 'avere' në formimin e kohëve të përbëra të foljeve. Ai kështu shtrin një rregull përdorimi dhe në një kategori tjetër, pra tejpërgjihëson këtë mënyrë të përdorimi të foljes ndihmëse në italisht.

Këtu kemi disa shembuj të gabimeve ekuivalente:

Eco njejes femerore dhe *gli echi* ne shumes mashkullore

Il tema dhe jo la tema apo il temo.

Gabimet janë pasojë e të mësuarit. Prej tyre nxjerrim përfundimin e proçesit gabimet janë gabime "përgjithësimi" dhe është e zakonshme të përdoret e njëjta formë për të cituar strategjitë e mësimit që na tregojnë për të nxjerrë si përfundim. Kjo është vetëm vlera e dijes së mëtejshme që nxënësi mund të arrijë të kuptojë që është shembull përgjithësimi.

Ndërrimi

Ndërrimi dhe përgjithësimi nuk janë proçese të njëjta. Por në të vërtetë ato përfaqësojnë aspekte të një strategjie të kuptueshme të mësuarit të njëjtë. Të dyja arrijnë përfundimin nga e dhëna se nxënësi përdor atë që ai di rreth gjuhës për t'i dhënë kuptimin një përvoje të re. Në rastin e përgjithësimit është dija që ata kanë për gjuhën e dytë të cilën e përdor nxënësi. Në rastin e ndërrimit nxënësi përdor përvojën e gjuhës së nënës për të organizuar të dhënat në gjuhën e dytë. Është domethënëse se si Barry Taylor zbuloi gabime të ndërrimit që haseshin më shumë tek fillestarët se sa tek studentët e nivelit mesatar. Fillestrarët kanë më pak njohuri të gjuhës së dytë për të krijuar hipoteza mbi rregullat, dhe ndoshta pritet të venë në përdorim më shumë njohuritë për gjuhën e parë. Për nxënësit e gjuhës së dytë është më me rendiment dhe ekonomike të ndërrojë njohuritë e mëparshme të gjuhës (duke përfshirë gjuhën e parë) me gjuhën që mësohet. Kjo nënkupton se ata nuk duhet ta zbulojnë gjithshka nga fillimi. Gjuha e parë na vërteton "më shumë hipoteza të gjalla dhe të hollësishme" të cilat

mund t'i përdorin nxënësit. Sipas disa aspekteve të gjuhës së dytë, hipotezat konfirmohen për shkak të ngjashmërive që kanë gjuhët. Nxënësi i gjuhës së dytë kupton se ajo që mëson ndryshon nga gjuha që flet, megjithëse ka raste kur njohuritë rreth gjuhës së nënës mund të ndërrohen drejtpërsëdrejti. Për shembull: ja si shprehet një nxënës shqiptar kur atë e pyesim për moshën në gjuhën italiane.

-'Quanti anni hai? – *Io sono dicianove anni*'në vend të shprehet '*Io ho dicianove anni'*. Apo kur flet për mëngjesin. –'Io mangio colazione ogni giorno'në vend të shprehet 'Io faccio colazione ogni giorno '.

Gabime me kuptim të dyfishtë

Kur nuk mund të vendosim nëse kemi të bëjmë me përgjithësime apo ndërrime ekzistojnë disa shembuj që i takojnë një gabimi të veçantë. Madje edhe disa shembuj të përgjithësimit mund të interpretohen si shembuj ndërrimi. Ky ndikim i dyfishtë ka të ngjarë veçanërisht në formën e ngjashmërive kryesore midis përgjithësimit dhe ndërrimit.

Për shembull, në fjalinë –'*Non ha molta gente nella piazza della mia citta*'.' Folja '*avere'* është përdorur në vend të foljes '*esserci'*. Më tej: -' telefonare mio fratello', në vend të –'telefonare a mio fratello'. Kur shumë i përdorur është rasti me foljen tjetër: 'chiamare'.

Gabime ne praktikën me gojë

Kur një nxënës bën një gabim gjatë praktikës me gojë zakonisht ka përpara publikun, që është klasa apo shoqëria. Një pjesë e tyre, nuk do të jenë në gjendje të dallojnë gabimin, por disa të tjerë do ta venë re dhe do të interesohen për kundërveprimin e mësuesit.

Ja se cfarë ndodh në një situatë të komunikimit kur zhvillohet ajo që quhet faza e dramatizimit të një pjese në klasë: folja 'legger ['*leggere*]., shqiptohet gjatë komunikimit me një spostim të theksit nga 'e' e parë në atë të dytën. Në italisht kemi një fjalë më një kuptim krejt tjetër(me theks te e -ja parë kemi foljen *lexoj* dhe me theks te e –ja e dyte kemi mbiemrin e lehtë). Kemi një mbiemër megjithëse nxënësi vazhdon në komunikimin e tij. Ka probleme sidomos kur është fjala për të përdorur fjalë të cilat kanë një parashtesë dhe ka një prirje për të zhvendosur dhe theksin e fjalës, si për shembull: *'fare'., 'rifare'* ku përkatësisht theksat janë [*`fare] dhe [ri`fare]*. Po ashtu dhe me vetën e tretë shumës të disa foljeve: '*imparare' – imparano – [im`parano],* e zhvendosin shpesh në rrokjen e parafundit dhe shqiptojnë [impa`rano].

'*Cui'* dhe '*Qui'*, problemet shfaqen jo vec në shqiptimin e pasaktë të 'cui', por dhe në shkrim.

Folja '*aiutare'* në nxënësit tanë është normalisht e shoqëruar nga parafjala '*per'*, kur në përdorimin e folësve natyrorë kërkon parafjalën *'a'*, si për shembull: aiutare qualcuno a fare qualcosa….

‘*Completazione’ për ‘completamento’*., që haset dhe në shumë fjalë të tjera të cilat në formimin e tyre kanë prapashtesa me kuptime të përafërta. Kur këto prapashtesa nuk përvetësohen sic duhet lënë shkas gabimesh në të folur por dhe në të shkruar.

Gabime në praktikën e shkruar

Përgjithësisht, në këto raste, i vetmi që shqyrton është mësuesi. Teorikisht, mësuesi duhet të kontrollojë detyrën me shkrim me personin që e ka shkruar, por kjo bëhet gjithnjë e më e vështirë sa më tepër përparohet në përvetësimin e gjuhës italiane. Këto ndreqje nuk janë shumë efikase, përvec rasteve kur nxënësi është mjaft i motivuar. Sigurisht ka disa mënyra për të ndrequr detyrat me shkrim.

Praktikë e lirë

Nuk është e tepërt të thuhet se pjesa më e madhe e gjuhës së riprodhuar nga nxënësit në klasë, shfaqet në kushte artificiale. Ndoshta problemi më i madh i mësuesit është të mbushë hapësirat mes këtij përdorimi artificial dhe përdorimit të natyrshëm jashtë klasës. Ky është problem ngaqë përdorimi jashtë klasës është i kushtëzuar në mos i pamundur për vetë rrethanat ku mësohet gjuha e huaj italiane.

Shumë mësues pohojnë se në qoftë se nxënësit e tyre kanë arritur një kompetencë gjuhësore të mjaftueshme për të kuptuar dhe riprodhuar saktësisht një formë të caktuar, do të thotë se ata ua kanë mësuar këte formë. Por, në fakt, kjo është vetëm gjysma e procesit të mësimdhënies; pjesa tjetër, dhe më e vështira, është t’u sigurojë nxënësve mundësinë për ta përdorur gjuhën e re të fituar.

Një sasi e caktuar e punës me gojë në klasë do të jetë nën kontroll. Kjo do të jetë e nevojshme në stadet e mëvonshme për një sërë arsyesh. Mësuesi duhet të kontrollojë nëse nxënësit arrijnë të kuptojnë saktë një model të caktuar si dhe shqiptimin e tij. Ai duhet të ndreqë gabimet që shfaqen. Ai duhet të drejtojë dhe kontrollojë klasën gjatë praktikimit, dhe nëse është një klasë e madhe, mësuesi duhet të ushtrojë një kontroll më të gjërë, që të sigurohet se të gjithë po marrin pjesë dhe po mësojnë. Kontrolli I mësuesit mund të analizohet si vijon:

Mësuesi nis dhe drejton veprimtarinë. Ai i bën të ditur nxënësve se cfarë kanë për detyrë dhe i siguron ata se po e bëjne atë sic duhet.

Mësuesi ndreq gabimet. Kjo nuk do të thotë se ai duhet të ofrojë gjithmonë formën e saktë. Ai mund te nxisë nxënësit të ndreqin njëri-tjetrin ose vetveten, thjesht duke vënë në dukje gabimin dhe mundësisht duke treguar llojin ose pozicionin e gabimit.

Mësuesi flet gjysmën e kohës. Nxënësit gjysmën tjetër. Ne mund të krahasojmë raportin e kohës që flet mësuesi (KFM) me kohën që flasin nxënësit (KFN).

Mësuesi kontrollon subjektin e bisedës duke sugjeruar fjalët që duhen përdorur, ose duke i shkruar në tabelë, ose duke zgjedhur një bllok materialesh për mësimin e gjuhës si tekste shkollore, figura etj.

Në parashtrimin e analizës së gabime ka dhe një dukuri e cila po të mbahet mirë parasysh, ndihmon drejtpërdrejtë në diagnostikimin e gabimeve të verifikuara dhe të përcaktimit të zgjidhjeve për to. Kjo dukuri quhet f*osilizim* . Ai është proces që të shpie në kristalizimin e një gabimi gjuhësor. Ai ndodh, në një fazë të caktuar të përvetësimit apo të mësuarit të një gjuhe, folësi nuk e ndjen më nevojën për të përmirësuar produktin e tij gjuhësor dhe nuk merr as së jashtmi (psh nga mësuesit apo nga konteksti shoqëror) inpute të vlefshme apo të pasura gjuhësore e komunikuese që ta shyjnë në këtë drejtim. Kur rregulli në vijim të fosilizimit ngec pavarësisht se koha kalon dhe se pjesë të tjera të sistemit kanë bërë përpara, flitet për kristalizim të rregullit, rregulli ka ngecur tërësisht.

Analiza e gabimeve gjuhësore.

Gabimet gjuhësore dhe të mësuarit gjuhësor

Postulati në të cilin bazohen të gjitha diskutimet në lidhje me këtë argument është se vështirësia e të mësuarit del në pah nga shpeshtësia e gabimeve gjatë përdorimit. "*Për shumë arësye hartuesit e programeve po ndryshojnë qëndrimin e tyre në lidhje me gabimin. Gabimet, që më parë kanë qenë shkak i rishikimeve të gjera, kanë marrë një vend të rëndësishëm në programet. Veç nëse studenti ka rastin të bëjë një gabim, programuesi nxjerr informacionin për atë çka ka nevojë studenti të mësojë*".[1] "Psikologu i edukimit e quan prodhimin e gabimeve nga ana e studentëve një proces normal, në të njëjtën mënyrë që mjeku shikon tek pacieni ethet një dukuri pozitive që i jep mundësinë që të bëjë diagnozen".

"*Fusha e analizës së gabimit për shumë arësye është thelbi i mësimdhënies së gjuhëve të huaja*".[2] Do patur parasysh se në çdo kohë studiuesit e didaktikës janë marrë me dukurinë e gabimeve. *Didaktika moderne* përpiqet të parandalojë gabimet nëpërmjet programimit të materialit të llojit linear që e kufizon mundësinë e nxënësit për të zgjedhur. *Didaktika* e llojit *tradicional* nuk e kufizon lirinë e nxënësit dhe me një qëndrim mospëlqyes ndaj gabimit të bërë (i cili ka të bëjë me atë se sheh në bërjen e gabimeve veç një mungesë kujdesi), e shpie nxënësin deri në tepri për të qenë i matur në dëm të natyrshmërisë së të shprehurit. Duhet parapëlqyer një nxënës që bën disa gabime tek përdor gjuhën në nivelin e komunikimt sesa një i frikësuar që di gjithçka për gabimet e nuk flet se ka frikë se mos gabon.

Në kuadër të metodologjisë moderne (metoda audio-orale) komportamentistët kanë ngulur këmbë ndoshta ca si shumë në bindjen që të

shmanget kryerja e gabimeve duke i shtrënguar nxënësit, me anë të "*patern practice*"(praktika sipas një modeli të dhënë), që të japin veç shprehje të sakta, të programuara e të drejtuara me mjeshtëri. "Nëse ajo që nxënësit thonë është e sakë, do jetë e saktë dhe ajo që mësojnë". Një pohim i tillë sidoqoftë nuk është vërtetuar nga të dhënat jashtë rrethanave të laboratorit, në përdorimin e lirë të gjuhës. "*Ciladoqoftë metoda e përdorur, mund të thuhet me siguri se një nxënës me të vërtetë ka përvetësuar një rregull veç atëherë kur di ta zbatojë në përdorimin e lirë të gjuhës. Zgjedhja e formave është një fazë thelbësore e të mësuarit e nuk mund të bëhet në rrethanat kur bëhet kontrolli"*[3]. Tani që ka kaluar entuziazmi për studimet përqasëse, nuk përpiqet kush të shpjegojë të gjitha problemet e të mësuarit me transferin nga Gjuha amtare. Studime të tilla janë ende të vlefshme në atë masë sa ndihmojnë nxënës e mësues për të përcaktuar shtypjen deformuese të ushtruar nga Gjuha amtare mbi Gjuhën me huaj dhe nga shprehi të fituara drejtpërdrejtë në Gjuhën e huaj. Ndërsa për shmangiet nga norma të llojit të parë kemi sot të dhëna të mjaftueshme teorike e praktike, për llojin e dytë jemi ende në pritje që të shohim konkretizimin në teori shkencore të mirëfillta të intuimeve pak a shumë gjeniale të studiuesve të veçantë.

Analiza kontrastive mbetet pra e vlefshme sepse jep të dhëna paraprake për vështirësitë e të mësuarit si edhe për gabimet e bëra në fakt. *Gati është e pamundur të duash të përmirësosh nivelin e nxënësve nëse më parë nuk janë shqyrtuar shkaqet dhe origjina e gabimeve.* Për këtë *Nickel* dhe Ëagner pohojnë: " *Për sa mund të zbulohet pas vëzhgimeve të gjata se cilat gabime mund të hasen në të mësuar, një analizë e llojit përqasës e kapërcen renditjen e thjeshtë, meqë mund të japë një shpjegim se përse bëhen gabime të tilla, të çfarë shkalle vështirësie janë ato dhe çfarë duhet bërë për t`i shmangur*".[4]

Ndreqja dhe parandalimi i gabimeve

Rezultatet e analizës përqasëse e mbi të gjitha të analizës së gabimeve dëshmojnë sa pa baza është bindja, që u formua që në fillim të zhvillimit të kësaj disipline, se gabimet shkaktoheshin veç nga disimetritë dhe jo simetritë midis dy sistemeve gjuhësore. Do ishte mjaft sempliciste të pretendojmë të jemi në gjendje të parashikojmë çdo herë sjelljen e nxënësit përpara faktorëve kaq të larmishëm.

Të merremi me disa vlerësime për metodat e ndjekura nga autorët e studimeve në këtë fushë.

Një pjesë e tyre ndalet veç me analizën e gabimeve, me "diagnostikimin" (G.Nickel), pa propozuar skema për ndreqjen dhe parandalimin e gabimeve të tilla. Të tjerë japin edhe të dhëna mjaft me

interes rreth mënyrës së ndreqjes së gabimeve, por pak syresh merren me problemin e parandalimit.

Shpesh si *ndreqje* kuptohet veç një shpjegim i thjeshtë, e dhënë sipas skemave të ndryshme të përshkrimit gjuhësor (tradicional, strukturor, gjenerativ – transformues) apo bëhet përkthimi në Gj1 dhe krahasimi përkatës me Gjuhën e huaj.

Do nënvizuar se meqë është fjala për gabime të outputit dhe jo të kompetencës, shpjegimi nuk ka vlerë dhe problemi mbetet i hapur. *Nga studimi i gabimeve, në fakt, nuk pritet veç të zbulojmë çfarë ende nuk dinë nxënësit për t`ua mësuar atyre sa më parë (për këtë do mjaftonte të kontrollonim programin e zhvilluar), por sidomos për të përcaktuar atë çka ata ende nuk kanë përvetësuar mjaftueshëm, që të mund ta rregullojmë duke bërë ndreqjen e duhur apo një rishikim të programit didaktik.*

Meqë bëhet fjalë për gabime të prodhimit dhe jo të kompetencës, nevojitet t'i shkojmë më tej "kritikës" dhe "autokritikës" (vetëndreqjes), që mbart një ndërgjegjësim për gabimin e bërë (një etapë e domosdoshme), për të arritur të eleminohen shprehi gjuhësorë tash të konsoliduara e për t`i zëvendësuar ato me të tjera të sakta e për t`i përforcuar. *Për të arritur në një rezultat të tillë është e nevojshme të ushtrohen në mënyrë të përsëritur strukturat ku haset gabimi deri sa të përforcohen dhe automatizohen shprehitë e reja.*

Të ndreqim gabimet?

Në vitet e fundit është diskutuar shumë nëse, sa dhe kur mësuesit duhet të ndreqin gabimet e nxënësve. Diskutimi i konceptit të intergjuhës na e sqaron se si shumë prej atyre që mund të quhen *gabime*, devijime apo mungesa, nga pikëpamja e nxënësit janë shfaqje të rregullave të një sistemi ndërghuhësor kalimtar, që ka një llogjikë, koherencë dhe funksion të caktuar. Se ky sistem zhvillohet sipas sekuencave natyrore që janë pjesërisht të padryshueshëm, kështu që të gabosh, sidomos në të folurin spontan, në disa nivele është e pashmangshme. Në këtë mënyrë zakonisht dallojmë gabimet dhe lapsuset (sipas Corder-it). Në të dyja rastet kemi një shkelje të rregullit të gjuhës që nxënësit po mësojnë, ndërsa një gabim pasqyron një rregull sistematik të gjuhës së nxënësit (psh të mos zgjedhojë foljet, apo të përdorë 'jo' si pjesëz mohuese e të ndryshueshme). Një lapsus i detyrohet një aksidenti në ligjerimin e çastit nga ana e një nxënësi i cili thjesht ndjek rregullin e cënuar. Studimet mbi llojet e ndryshme te ndërgjuhëve tregojnë sesi një kategori kalon tek tjetra, ngaqë rindërtimi i sistemit ndërgjuhësor ecën gjithmonë në mënyrë të shkallëzuar dhe shpesh dy forma alternative bashkëjetojnë edhe për një kohë mjaft të gjatë. Jo gjithmonë është e mundur të thuhet kur një formë jo e rregullt është shkaktuar nga një rregull sistemi apo nga një rënie e vëmendjes në atë çast. Më në fund duhet të kuptojmë se nocioni i gabimit është në të vërtetë më i gjërë. Flasim për gabime vetëm në prani të mungesës së përshtatjes leksikore, gramatikore, fonetike, por ka edhe probleme semantike dhe gramatike, të cilat i mbajmë parasysh.

Edhe nocioni i ndreqjes së gabimeve analizohet më mirë kur dimë se ka mënyra të ndryshme që nxënësit të marrin vesh për atë çfarë kanë si prodhim apo performancë gjuhësore; mund të tregohet se cili është problem, mund të sinjalizohet per problemin dhe në të njëjtën kohë të zgjidhë, mund të thuhet se nuk ka asnjë problem e kështu me radhë. Ky problem mund të jetë një vështirësi në kuptim, por ndodh kryesisht në bashkëbisedime spontane, apo një nënvleftësim formal, që del në pah në klasat e gjuhës së huaj.

Pasi sqarohen këto çështje, mund të kalojmë në diskutimin e mirëfilltë mbi mundësitë dhe mënyrat e ndreqjes së gabimeve. Ai që i kundërvihet ndreqjes së gabimeve zakonisht i referohet dy lloj arësyetimesh. *Para së gjithash* dihet se ndreqja mund të shkaktojë ankth, frustracion, humbjen e vetëvlerësimit, dhe të gjitha këto janë faktorë afektivë që ndikojnë negativisht në procesin e të nxënit. Në radhë *të dytë*, ndreqja e gabimeve e cila zhvillohet në klasa tradicionale është një veprimtari e përqëndruar në formën gjuhësore, që i largon nxënësit nga përdorimi komunikues i gjuhës për tu përqëndruar në një përdorim të saj si qëllim në vetëvehte. Kjo shkakton vec rënies së interesit dhe të motivimit, edhe një rrjedhshmëri të ulët në gjuhën e dytë, një spontaneitet e paket, largim nga objektivat komunikues në favor të atyre që janë thjesht formalë.

Por kush mbështet se gabimet duhet të ndreqen mund t'i referohet teorive të ndryshme të të nxënit gjuhësor. Teoritë e vjetra komortamentiste konceptonin gabimet si zakone negative dhe duhet të shkulen që në lindje; ata propozonin ushtrime të strukuruara rreptësisht që të pengonin lindjen e gabimeve, që ndreqeshin menjëherë sa herë që ato shfaqeshin. Sidoqoftë edhe teoritë më moderne të psikologjisë konjitive mund të justifikojnë ndreqjen e gabimeve. Po qese nxënësi konceptohet si një subjekt aktiv i cili ndërton hipoteza dhe i vë në provë, krahasimi konjitiv midis këtyre teorive dhe strukturave të sakta të gjuhës së huaj mund të jetë një pjesë e rëndësishme e procesit të të nxënit. Të ndreqësh gabimet do të ishte një mënyrë për t`i dhënë nxënësit informacion të rëndësishëm për të rregulluar hipotezat e tij, një ndihmë për të bërë dallimin midis sistemit të vet ndërgjuhësor dhe gjuhës që don të përvetësojë.(Carroll dhe Sëain 1993, Johnson 1988). Nga ana tjetër duhet të kujtojmë se janë vetë nxënësit, vecanërisht adoleshentët dhe të rriturit që dëshirojnë të ndreqen dhe që shfaqin ndjenjë ankthi sa herë që nuk komenton kurrë performancën e tyre.(Leki 1991, Young 1990).

Ka të ngjare të këtë të vërteta në dy qëndrimet dhe pyetja që bëhet nuk është në duhet të ndreqim apo jo, por të ndreqim, si dhe kur? Për fat të keq, nuk ka ende shumë studime empirike që të na ndihmojnë për t'iu përgjigjur pyetjes më lart. Kërkimet e bëra deri më tani, janë përqendruar në qëndrimin e skajshëm, atë se ndreqja e gabimeve do ishte gjithmonë e sidoqoftë jo e leverdisshme. Për këtë Krashen 1994, një nga mbështetësit kryesorë kundër ndreqjes, sjell në mbështetje të tezës së tij rezultatet e katër studimeve (Cohen dhe Robbins 1976, Robb dhe Shortreed 1986, Ross 1992, Semke

1984) në të cilët nxënësit që i kishin ndrequr nuk ishin më të mirë se të tjerët. Nuk duket se ka ndonjë studim eksperimental që të provojë se ndreqjet sjellin rezultate sitematikisht më të keqija.

Në anën e kundërt që mbështet dobinë e ndreqjes, rezultatet janë shumë më të bollshme. Në nivelin eksperimental, punimet e Carroll dhe Sëain kanë provuar se mundësia për të patur feedback të ndonjë lloji mbi gabimet e veta (nevoja për sqarim, riformulime, ndreqje të hollësishme me shpjegime), përmirëson dukshëm arritjet e nxënësve. Për sa u takon eksperimenteve në klasat e gjuhës së huaj, disa studiues kanë gjetur se nëse mësuesi u kërkon sistematikisht nxënësve të riformulojnë prodhimin e tyre gjuhësor që të përmbajnë një lloj të caktuar gabimesh, këta arrijnë rezultate më të mira nga ata të cilëve nuk u është kërkuar kjo gjë. Të tjerë kërkues kanë parë të tilla përfitime nga ndreqja edhe për sa i takon prodhimit gjuhësor të shkruar të nxënësve. Ata kanë provuar se të shtysh nxënësit qëllimisht të bëjnë gabime dhe pastaj t'i ndreqin ato të shpie në rezultate më të mira sesa t'i vesh në gadishmëri që më parë duke u shpjeguar rregullin dhe gabimet më të zakonshme. Edhe Lightboën1992 ka vërejtur se ndreqja e gabimeve jep rezultate më të mira sesa mosndreqja. Megjithatë ajo është veçanerisht efikase kur jepet nga konteksi i veprimtarisë komunikuese ndërsa ka një dobi më të kufizuar nëse zbatohet në ushtrimet strukturore përsëritëse. Studime të tjera në fokus nuk kanë parë veç ndreqjen e gabimeve, por kanë rëndësi për diskutimin tonë. (Spada dhe Lightboën 1993, Trahey dhe Ëhite 1993, Ëhite 1991, Ëhite, Spada, Lightboën dhe Ranta 1991. Studime të bëra në shkollat e mesme me metoda të mësimit intensiv komunikues, ku hasej një përdorim i vazhdueshëm dhe real i gjuhës së dytë, vëmendje për përmbajtjen e jo për formën, aresyetime të rralla për gramatikën, dhe ndreqje gabimesh. Trajtimi kishte të bënte me futjen në këto klasa me mësim kryesisht komunikues, shtatë orë mësimdhënie të ndara në dy jave. Në këto orë u jepej studentëve veprimtari të ndryshme të fokusuara në formë, mbi një strukturë gramatikore të veçantë të Gjuhës së huaj, si zhvillimi i ushtrimeve strukturore apo ndreqja sitematike e gabimeve. Ne tërësi këto punë provojnë se klasat në të cilat jepeshin ndreqje dhe fokus në formë, bënin përparime shumë më të mëdha sesa klasat e kontrollit edhe pse shpesh këto përparime nuk mbaheshin për një kohë të gjatë.

Bilanci duket pra i qartë. Mosndreqja është një rrethanë më e keqe, nuk jep rezultate më të mira. Të kemi parasysh se këto kërkime tregojnë dhe kufijtë e mungesës së plotë të ndreqjes, ato nuk kanë paraqitur të dhëna përfundimtare për sa e si është me vend të ndreqim, as edhe mund të provojnë se zgjidhja më e mirë qëndron në të ndrequrin gjithmonë dhe të gjithçkaje. Gabimi më i madh nga ana e mësuesve mund të jetë ai i të besuarit se ajo që në ndërveprimin në klasë shfaqet si ndreqje do të shpjerë automatikisht në përvetësim nga nxënësi. Po ashtu tani për tani nuk ka një përgjigje për pyetjen se ç'lloj ndreqje të gabimeve është më efikas dhe një të tillë s'do ta kemi kurrë. *Kjo ngaqë është nxënësi e jo mësuesi që përcakton nëse forma e saktë do të përvetësohet*. Nuk janë gjithësesi rezultate të papërfillshme, në

bazë të tyre mund të quhet e mbyllur çështja e të ndreqësh apo të mos ndreqësh, mungesa e plotë e ndreqjes nën dritën e kërkimeve, një opsion që vështirë se mund të paraqitet i padiskutueshëm. Në bazë të tyre mund të priremi se ndreqja do të jetë më efikase kur prek zona në të cilat nxënësi është i gatshëm të dallojë ndryshimin midis rregullave të veta dhe të gjuhës që po mëson, ne të cilën gabimet sistematike mund të bëhen lapsuse nga mungesa e vëmendjes. Po këto punime tregojnë edhe se ndreqja në disa anë të gjuhës mund të jetë e kotë në mos e dëmshme nëse bëhet në castin e gabuar.

Përsa u takon rrethanave në të cilat ndreqja quhet e dobishme, studimet tregojnë se ndreqja dhe fokusimi në formë, janë më të dobishëm kur bëhen në kontekstin e veprimtarisë komunikuese, me kuptim; me fjalë të tjera nuk vihet në diskutim dobia e të mësuarit të gjuhës duke filluar nga komunikimi, por implikimi që disa kanë nxjerrë nga kjo premisë, dmth se veprimtaria e vetme për të zhvilluar në klasë duhet të jetë komunikimi i pastër. Shumë kërkues sot bien dakord se një farë vëmendje në format gjuhësore të komunikimit është e dobishme, në mos e nevojshme, për një përvetësim efikas; feedback ndreqjeje është një mënyrë për të ngjallur një vëmendje të tillë.

Qëndrimi i mësuesit ndaj gabimit

Qëndrimi i mësuesit ndaj gabimit ka një rëndësi të madhe . Asgjë nuk mund të shkatërrojë besimin e një nxënësi aq shumë sa një sërë komentesh përçmuese mbi shfaqjen e tij të gjuhës . Ndreqja pa takt gjatë bashkëbisedimit, mund të jetë i dëmshëm ngaqë nxit nxënësin të tërhiqet ; komentet me shkrim nuk janë të këndshme në librat e ushtrimeve dhe dekurajojnë rishikimin . Megjithatë , mësuesi duhet të ketë një qëndrim pozitiv ndaj gabimit dhe duhet të jetë i përgatitur për të bërë diçka për këtë.

Po të kujtojmë bihejvioristët, ata e shohin gabimin si simptomë të një mësimdhënieje jo frytdhënëse apo si dëshmi e dështimit. Ata gjithashtu e shohin atë pikërisht si fillimin e një interference në shkallë shumë të madhe të gjuhës amtare – interferencë të cilën mësuesi (i cili përfaqëson atë që drejton kursin) ka dështuar ne parashikimin e tij dhe e ka pranuar si të tillë . Kur gabimet ngjajnë midis tyre, duhen rregulluar me një sulm formash të sakta. Ky sulm arrihet duke përdorur ushtrime intensive apo duke dhënë shumë mësim .

Mendojnë ndryshe mentalistët. Kur një pjesë e madhe e gabimeve vjen si rezultat i mbipërgjithësimit, mendohet se nxënesi përpunon të dhënat e reja në mendjen e tij dhe vjen me një sërë rregullash që prodhojnë shembuj të rinj në gjuhen që synon të mësojë . Meqë nxënësi është vazhdimisht në përpjekje për zgjidhjen e problemeve dhe për t'i dhënë kuptim realitetit gjuhësor përreth tij . Kështu gabimi është i pashmangshëm, ai është pjesë përbërëse e

proçesit te mesimit dhe zhvillimit te aftesise gjuhësore. Nxënësit mund të bëjnë gabime sepse hipotezat e tyre mbi gjuhën e re janë të gabuara apo jo të plota . Gjithmonë sipas mentalistëve, gabimet nuk duhet të konsiderohen si shenjë dështimi por si dështmi se nxënësi po punon në drejtim të rregullave të sakta . Gabimet nuk janë të dëmshme për proçesin e të mësuarit. Përkundrazi , nxënësit mësojnë nga gabimet dhe nga ndreqja e tyre.

Duke arësyetuar në këtë mënyrë, largojmë shumë ankthin e shkaktuar nga këmbëngulja e bihavioristëve për t'i eliminuar njëkohësisht në të gjithë klasën gabimet . Në të njëjtën kohë , i lejon mësuesit të përshtasë nivelin e vështirësisë me përparimin e nxënësve, motivimin e kështu me rradhë . Një kurs i lehtë do të shkaktonte mërzitje : duhet të përfshihet edhe një ndjenjë sfide , si në çdo detyrë , por nëse detyra do të kthehet në sfidë , do të kemi gabime e keqkuptime.

Mësuesi interesohet rreth asaj që ndodh në mendjen e nxënësit dhe duhet të jetë i përgatitur për të diskutuar problemet e gjuhës . Ai të jetë i përgatitur për të ndihmuar nxënësit e tij për t'i zgjidhur gjërat vetë , dhe nuk duhet të tregohet i nxituar në përjashtimin e një sasie të kontrolluar të terminologjisë gramatikore dhe në shpjegimin e gjuhës amtare. Vetëm shpjegimi gramatikor , sidoqoftë, është më pak i efektshëm, përdoret më mirë si plan dytësor apo si një strategji shtesë në fazën e rishikimit .

Rëndësia e gabimeve.

Është interesante mënyra sesi mësuesit përballen me gabimet e nxënësve dhe ndreqjen e tyre. Ato janë pjesë e procesit të mësimit. Është padyshim e vërtetë se zbatimi i teorive gjuhësore dhe psikologjike në studimin e një gjuhe shtoi nje dimension të ri në diskutimin mbi gabimet. Ndihmesa më e madhe e gjuhëtarëve në lidhje me mësimdhënien është një studim krahasues i sistemit të gjuhës amtare me sistemin e gjuhës se dytë. Kështu u bë e mundur të hartohet një listë me vështirësitë me të cilat do të ndeshej një nxënës. Në këtë mënyre kjo listë do të drejtojë vëmendjen e mësuesit në zona që kanë nevojë për më shumë kujdes, në mënyrë që të mënjanohen këto gabime të pritshme. Mësuesit janë përqëndruar në mënyrën se si të përballen me vështirësitë dhe nuk i kanë kushtuar rëndësi identifikimit të tyre.

Përfundime dhe rekomandime

1. Shumë mësues e sidomos më të vjetërit janë më të informuar në lidhje me kërkimet për gabimet. Po qese është e vërtetë se një mësues më njëfarë praktike dhe një përvojë të gjatë mbi supe di boll për gabimet, është po aq e vërtetë se mësuesit më të rinj dinë fare pak dhe nga kërkime të tilla pritet të sigurohen të dhëna për punën e tyre.
2. Është me vend që analiza e gabimeve të shkojë me të njëjtin hap me analizën përqasëse dhe të shfrytëzojë kontributin e psikologjisë së sjelljes së nxënësve. Asnjë nga të treja veçmas, nuk mund të na japë një përgjigje të plotë në fushën e nxënies së gjuhës së huaj.

3. Është më me vend të nxirren përfundime nga të dhëna reale sesa të bëhen parashikime mbi të dhëna hipotetike. Në dallim nga analiza përqasëse, analiza e gabimeve hedh poshtë mendimin e përhapur se është më e lehtë të arrihet kompetenca aktive e një gjuhe e ngjashme me atë amë. Rezultatet e analizës së gabimeve tregojnë në fakt se herë herë gabimet bëhen edhe në rast simetrish dhe në rast ngjashmërie midis Gj1 dhe Gj2 pasi është më i madh tundimi nga nxënësit për të nxjerrë forma gramatikore dhe elementë leksikorë nga gjuha e tyre.
4. Analiza e gabimeve duhet të mbajë mirë paraqsysh rrethanat që i kanë mbështetur ato (mosha e nxënësve, teksti i përdorur, orari, etj.)
5. Jo të gjithë gabimet tipike janë njëlloj të rëndësishme dhe të rënda. Gabimet tipike më të shpeshta janë ato që duhet të shqetësojnë mësuesin. Siç tregojnë studimet tre a katër gabimet e para më të shpeshta për secilin grup gjuhësor i kapërcejnë dukshëm nga numri njëzet a tridhjetë që bëhen njëri pas tjetrit të marrë së bashku.
6. Ashtu si kundër të kuptosh si funksionon mekanizmi gramatikor nuk nënkupton përvetësimin në mënyrë automatike të aftësive gjuhësore, edhe t`i shpjegosh nxënësit shkakun e gabimit dhe t`i shpjegosh sërish argumentin gramatikor nuk e zgjidh problemin. Gabimet më problem nuk janë aq ato të kompetencës sesa më tepër ato të outputit, për të cilët është i tepërt një shpjegim plotësues. Të tilla gabime mund të eleminohen duke bërë ushtrime që përsëriten deri në overlerning.
7. Kyçi i problemit qëndron në ushtrimet ndreqëse, a më mirë në ato parandaluese, që synojnë të eleminojnë rrezikun për të gabuar.
8. Pasi sigurohet cilët janë gabimet më tipike e më të shpeshta, mësuesi u tërheq vëmendjen nxënësve të rritur për rrezikun se mund të gabojnë, duke shmangur gjithësesi të bjerë në formalizmin e metodës gramatikore përkthyese tradicionale. Kur nxënësit nuk janë të rritur, mësuesit duhet të ruhet mos bëjë të qartë referimet për rrezikun e gabimeve dhe do përdorë të dhënat e marra nga analiza e gabimeve vetëm për përpunimin e materialit didaktik që do parandalojë gabimet më të shpeshta.
9. Asnjë studim për gabime nuk duhet të quhet përfundimtar. Nëse është e vërtetë që problemet e nxënësve të sotëm mendohet të jenë problemet e nxënësve të së nesërmes është po aq e vërtetë se problemet mund të ndryshojnë nga klasa në klasë, sipas elementit njerëzor dhe rrethanave ku kryhet mësimi.
10. Do uronim që çdo mësues të bënte studime të tilla, me klasën që ka. Në këtë rast është e qartë se rezultate e mbledhura do qenë shumë më të vlefshme për punën e tij.

Bibliografi

Markle,S . (1963) Faulty Branching Frame: A model for maximing feedback to the Programer, f.4

Nickel.G (1970) Beitragen der Somerkursen

Wilkins. A (1973) Linguistica e insegnameto delle lingue(Gjuhësia dhe mësimi I GjH). f.175.

Nickel G .wagner. K.H. (1968) Contrastive linguistics and language teaching. f.6.

Balboni P. (1994),Didattica dell'italiano a sranieri ,Roma ,Bonacci

Balboni P.(1998),Tecniche didatiche per l'educazione linguistic,torino ,Utet

Balboni P.(2008) Imparare le lingue straniere ,Venezia ,Marsilio

Bettoni C.(2001) Imparare un altra lingua ,Roma –Bari ,Laterza.

Bettoni C.(2006) Usare un altra lingua ,Roma –Bari ,Laterza.

Corder P.(1983),Itroduzione alla linguistica applicata,Bologna,Il Mulino.

Ellis R.(1990),Incructed second language acquisition ,Oxford,Blackëell.

Ellis R.(1997),Second language acquisition ,Oxford ,Oxford University Press.

Krashen S.(1981),Second Language Acquisition and Second Language Learning ,Oxford ,Pergamon Press.

Numan D.(1992),Collaborative language learning e teaching ,Cambridge,Cambridge University Press.

Pallotti G.(1998),La seconda lingua ,Milano ,Bompiani.

Selinker L.(1972)Iterlanguage ,<<IRAL>> n 10.

Vedovell M.(1999),Il parlato nella L2:le ragioni di naturalezza e dell'apprendimento,Milano,Franco Angeli.

HIV AIDS DHE SJELLJET RISKANTE TE ADOLESHENTEVE

[1]Emirjona Kiçaj, [1]Rudina Çerçizaj, [1] Ela Peto, [2] Emiljana Coraj,
emirjona.kicaj@univlora.edu.al

[1]Fakulteti i Shëndetit Publik, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
[2]Drejtoria e Shëndetit Publik, Vlorë,

Abstract

Hyrje: Përdorimi i alkoolit, drogës shihen si faktorë shumë të rëndësishëm në përhapjen e HIV AIDS, sepse është vërtetuar se ekziston një lidhje e fortë midis përdorimit të tyre dhe sjelljeve sexuale riskante tek adoleshentët.

Qëllimi i studimit: Të përcaktohet prevalenca e sjelljeve riskante tek nxënësit e shkollave të mesme në qytetin e Vlorës.

Objektivat specifike: Të përcaktohet prevalenca e përdorimit të alkoolit, llojeve të ndryshme të drograve si dhe aktiviteti sexual i të rinjve.

Materiali dhe metoda: Ky është një studim cross – sectional, i realizuar në 5 gjimnaze të qytetit të Vlorës gjatë periudhës, Janar – Mars 2013. Në këtë studim morën pjesë 407 nxënës të shkollave të mesme.Për realizimin e këtij studimi u përdor një pyetësor i mbështetur në YRBS questionare.

Rezultatet: Mosha mesatare e pjesmarësve ishte 16.6 ±0.5. 45.7% ishin meshkuj dhe 54.3% ishin femra. 24.1% e pjesmarrësve ishin sexualisht aktiv. 9.1% e tyre raportuan se kishin përdorur të paktën një herë mariuanën. 89.6% e përdoruesve raportuan se kishin përdorur mariuanën në shoqërinë e miqve të tyre. 63.9% e pjesmarësve raportuan kishin përdorur një pije alkoolike gjatë muajit të fundit dhe 53.1% e tyre e kanë përdorur në shoqërinë e miqve. 35.6% e pjesmarësve mendojnë se përdorimi i prezervativit është mënyra më e mirë për parandalimin e AIDS. Përsa i përket rrugëve të transmetimit 13.4% e pyetjeve u plotësuan gabim dhe 50.8% e tyre ishin të sakta. 63.9% e femrave dhe 67.9% e meshkujve sexualisht aktiv nuk kanë përdorur asnjëherë prezervativin gjatë marrëdhënieve seksuale.

Konkluzion: Vihet re se kemi një prevalencë të lartë të përdorimit të substancave abuzuese prej të rinjve. Kanë kryer marrëdhënie seksuale nën efektin e drogës 2.6% e përdoruesve të një substance abuzuese (drogë) dhe nën efektin e alkoolit 3.4% e nxënësve përdorues të alkoolit.

Fjalët kyçe: HIV AIDS, përdorim i alkoolit, përdorimi i drogës, sjelljet seksuale, nxënësit e shkollave të mesme.

Hyrje: Parandalimi i sjelljeve riskante tek të rinjtëështë shumëi rëndësishëm për shumëarsye(Currie C 2009 – 2010). Një arsye është se një sjellje riskante e drejton adoleshentin drejt sjelljeve të tjera riskante (Robert C 2008). Një arsye tjetër është se ndjekja e këtyre sjelljeve prej të rinjve do të ndikonte negativisht në procesin edukues. (Rober C 2008) (Madhavika B 2010), (Leigh B 2008) P.sh pirja e pijeve alkoolike nëadoleshencë mund të shoqërohet askoolizimin e këtyre të rinjve në moshën e adultit si dhe ndjekja e sjelljeve sexual negative prej tyre (Leigh B 2008), (Devieux 2002), (Adefuye A. 2009). Përdorimi I drogës nga të rinjtë do të ndikonte

nëvështirësitë e rinjve për tu përshtatur si dhe ndaj sjelljeve sexual riskante. Sjelljet riskante sexual nga ana tjetër do ti vendosnin të rinjtë përballë rrezikut të marrjes së infeksioneve sexualisht të transmetueshme apo dhe përballë një shtatzanie të padëshiruar (Arliss R. 2008).

Edhe pse këto sjellje janë të ndryshme nga njëra tjetra mund të themi se kanë disa karakteristika të përbashkëta si:

- Janë bashkëshoqëruese të moshës së Adoleshencës. (Calderia 2009)
- Zakonisht vihet re ulje e prevalencës së tyre me rritjen e moshës por mund të kemi dhe një stabilizim të këtyre sjelljeve tek këta të rinj dhe me kalimin në moshën e adultit (George W 2009).
- Kanë si tendencë që të prezantohen së bashku tek një idivid si një "stil jetese"(Hutton H 2008)
- Përdoren nga adoleshëntët për një arsye apo për një funksion: i lejojnë ata për të arritur objektiva specifike si: të fitojnë autonomi, zhvillojnë identitetin e tyre, për të krijuar relacione të reja (lewis M 2010), (Turchick J 2009), (Wechsler H 2010).

Qëllimi i studimit: Të përcaktohet prevalenca e sjelljeve riskante tek nxënësit e shkollave të mesme në qytetin e Vlorës.

Objektivat specifike: Të përcaktohet prevalenca e përdorimit të alkoolit, prevalenca e përdorimit të llojeve të ndryshme të drograve si dhe aktiviteti sexual i të rinjve.

Materiali dhe metodat: Të dhënat e këtij studimi u morën nëpërmjet një pyetësori të vet-administruar i bazuar në YRBS questionare që iu shpërnda nxënësve të 5 shkollave të mesme të qytetit të Vlorës.Këtij studimi iu përgjigjën 407 nxënës të shkollave të mesme.Pyetësori i vet-administruar përmbante pyetje mbi:

- **Të dhënat sociodemografike:** mosha, gjinia, vendbanimi,
- ***Përdorimin e pijeve alkoolike*** mosha e perdorimit per here të parë, momentet e përdorimit
- ***Përdorimin e drogës.*** mosha e përdorimit për herë të parë, llojin e drogës së përdorur, momentet e përdorimit
- ***Njohuritë në drejtim të rrugëve të transmetimit të HIV Aids*** rrugët e transmetimit, metodës së parandalimit të HIV AIDS.
- **Marrëdhëniet sexuale** mosha e fillimit të marrëdhënieve sexuale, numri i partnerëve, përdorimit të prezevativit

Rezultatet: Ky studim kros-seksional u realizua në periudhën Janar - Mars 2013 me nxënësit e 5 shkollave të mesme në qytetin e Vlorës. Në këtë studim u përfshinë 407 nxënës të shkollave të mesme.

- Mosha mesatare e pjesmarësve 16.6±0.5 vjeç,
- 45.7% ishin meshkuj 54.35 femra.
- 79.1% jetonin në qytet dhe 20.9% në fshatrat përreth Vlorës.

- 24.1%(98 të rinj)e pjesmarësve referuan se ishin seksualisht aktiv.

Përdorimi idrogës Përdorimi i drogës shihet si një realitet tek të rinjtë në qytetin e Vlorës, në fakt 18.9% e tyre referuan se kanë përdorur të paktën një herë një nga llojet e ndryshme të drogave.

Përdorimi i drogës shihet se është një sjellje karakteristike e meshkujve potë krahasohen me femrat dhe konkretisht 93.5% e të rinjve që referuan përdorimin e drogës të paktën një herë ishin meshkuj.Me rritjen e moshës vihet re se kemi dhe rritjen e përdorimit të drogës.

Grafiku 1. ***Shpërndarja e pjesmarësve sipas përdorimittë drogës, gjinisë dhe moshës***.



Kontakti për herë të parë me drogën vihet re në një moshë tepër të vogël.

Grafiku 2. Shpërndarja e pjesmarësve sipas moshës dhe perdorimit për herë të pare te drogës.



Mosha mesatare e përdorimit për herë të parë të saj 15vjeç .Substanca më tepër e përdorur tek të rinjtë e përfshirë në studim ishte Mariuana (hashashi).

Grafiku ***3. Shpërndarja e pjesmarësve sipas momentit te perdorimit te drogës.***



Studimi kishte si qëllim që të përcaktonte se në cilat momente të rinjtë kanë përdorur më sëshumti një prej drograve.

- 89.6% e popullatës që ka përdorur drogë ka deklaruar se e ka bërë atë në shoqërinë e miqve të tyre me një mesatare 2.3 herë në muaj.
- 16.9% e tyre deklaruan se e kanë kryer përdorimin e drogës kur kanë qënë vetëm me një mesatare rreth 1.5 herë në muaj.
- 39% e tyre deklaruan se kanë përdorur drogë kur kanë parë se të tjerët e kanë përdorur me një mesatare 1.7 herë / muaj.
- 54.5% e e kanë përdorur kur ia kanë ofruar tëtjerët me një mesatare 1.8 herë/ muaj.
- 26% deklaruan se ekanë përdorur kur kanë patur mundësi për ta blerë, me një mesatare 1.9 herë/muaj.
- 2.6% e tyre deklaruan se e kanë përdorur drogën përpara se të kryenin marrëdhënie seksuale 1 herë/ muaj.
- 38.9% e kanë përdorur vetëm në fundjavë me një mesatare 1.5 herë/muaj.
- 12.9% kur kanë qënë në shtëpi me një mestare 1 herë / muaj.
- 14.3% e kanë përdorur drogën në diskotekë dhe kjo ka ndodhur mesatarisht 1 herë / muaj.
- 3.9% deklaruan se e kanë përdorur atë dhe në ambjentet e shkollës dhe kjo mesatarisht 1.3 herë / muaj.

- 18.2% deklaruan se e kanë përdorur atë në ambjentet e konviktit dhe kjo ka ndodhur mesatarisht 1.5 herë në muaj.

Përdorimi i pijeve alkoolike.

Përdorimi i pijeve alkoolike dhe abuzimi me këto pije alkoolike është mjaft kompleks. Përdorimi ialkoolit bën pjesë në kulturën e popullit shqiptar. Këto pije alkoolike shpesh herë vihet re se përdoren që në moshë të hershme.Të rinjtë përdorin pijet alkoolikesë bashku me familjarët e tyre apo me miqtë.

Vetëm 36% e nxënësve referuan se nuk kishin përdorur pije alkoolike gjatë muajit të fundit dhe me rritjen e moshës vihet re se kemi rritjen e numrit të individëve të cilët kishin përdorur alkool gjatë muajit të fundit.

Grafiku 4. ***Shperndarja e pjesmaresve sipas perdorimit te pijeve alkoolike gjate muajit te fundit.***



Vihet re se kemi një rritje të frekuencës së përdorimit të pijeve alkoolike si dhe rritje të sasisë së alkoolit të konsumuar me rritjen e moshës si tek meshkujt ashtu dhe tek femrat.

Grafiku 5. ***Shperndarja e pjesmaresve sipas moshes se perdorimit per here te pare te pijeve alkoolike.***



53.1% e përdoruyesve të pijeve alkoolike deklaruan se e kanë kryer atë me miqtë e tyre.

28.8% deklaruan se kanë përdorur pije alkoolike me familjarët e tyre dhe 18.10% e kanë përdorur atë kur kanë qënë vetëm.

Grafiku 6. ***Shperndarja e pjesmaresve sipas momentit te perdorimit te pijeve alkoolike.***



Sjelljet seksuale

24.1% e pjesmarësve referuan se ishin seksualisht aktiv. 10.2% e tyre referuan se kishin filluar marrëdhëniet seksuale në moshë tepër të hershme 13 – 14 vjeç, 19.4% në moshën 15 – 16 vjec dhe 70.4% në moshën 17 vjec.

Grafiku 7. Shperndarja e pjesmaresve seksualisht aktiv sipas moshes se fillimit te maredhenieve seksuale.



Përsa i përket rrugëve të transmetimit 13.4% e pyetjeve u plotësuan gabim dhe 50.8% e tyre ishin të sakta.Vetëm 3.2% e pjesmaresve dinin se HIV mund të transmetohet nga nëna tek fëmija. 47.9% e pjesmarësve thanë se HIV nuk transmetohet nga përdorimi i shiringave të përbashkëta. 35.6% e pjesmarësve u shprehën se HIV transmetohet nëpërmjet marëdhënieve seksuale të pambrojtura, kundrejt 49.9% të tyre të cilët thanë se HIV nuk transmetohet nëpërmjet marrëdhënieve seksuale të pambrojtura.

Përsa i përket pyetjes se cila nga metodat do të ishte metoda më e mirë për parandalimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme vetëm 35.6% e tyre referuan se përdorimi i prezervativit është metoda më e saktë.

Mospërdorimi i prezervativit vihet re se rritet me rritjen e moshës së pjesmarësve seksualisht aktiv, tendencë kjo e njëtë për të dyja gjinitë.

Grafiku 8. Shperndarja e pjessmarësve sipas mosperdorimit tëprezevativit , gjinisë dhe moshës.



Pyetjes drejtuar personave të cilët referuan se e kishin përdorur prezervativin gjatë marëdhënies së fundit seksuale, se pse e kishin përdorur atë 80% e tyre e kishin përdorur nga frika e një shtatëzanie dhe 36.7% e tyre referuan se e kishin përdorur për tu mbrojtur nga Infeksionet Seksualisht të transmetueshme.

Konkluzion

Vihet re se kemi një prevalencë të lartë të përdorimit të substancave abuzuese prej të rinjve.

Kanë kryer marrëdhënie seksuale nën efektin e drogës 2.6% e pjesmarësve dhe nën efektin e alkoolit 3.4% e nxënësve.

Rekomandime

Sjelljet riskante janë shumë të zakonshme gjatë moshës së adoleshencës.Këto sjellje mund të jenë afatgjata dhe në disa raste mund të sjellin dhe pasoja tepër të rënda në shëndetin e të rinjve.

- Suportimi dhe forcimi i funksionit të familjeve.
- Forcimi i lidhjes midis nxënësve dhe shkollave të gjitha niveleve.
- Promovimi i programeve mbështetësve për të rinjtë.
- Ofrimi tek fëmijët dhe të rinjtë mundësi për të rritur kompetencat sociale dhe emocionale.
- Përmirësimi i kurikulave mësimore në drejtim të sjelljeve të shëndetshme tek të rinjtë

Falenderime: Falenderojmë drejtuesit e shkollave te mesme te qytetit te Vlores si dhe gjithe pjesmaresit per bashkëpunimin në këtë studim**.**

Referencat

1. Adefuye,A.S.,Abiona,T. C., Balogun,J.A.,&Lukobo-Durrell,M.(2009).HIVsexualrisk behaviors andperceptionofriskamongcollegestudents:implicationsforplanning interventions.*BMC PublicHealth*, 9:281-292. doi:10.1186/1471-2458-9-281
2. Arliss,R.(2008). Acomparisonofthesexualriskbehaviors ofasianamerican.*AmericanJournalofHealthEducation, 39*(4),221-227.
3. BehaviorSurveyQuestionnaire.(2012) *AmericanJournalofEpidemiology,141*,575-580.
4. Currie C et al. eds Health Behaviours in school – aged children (HBSC) study protocol: background, methodology and mandatory items for the 2009 – 2010 survery. St. Andrews, Child and Adolescent Health Researche Unit, Vienna, Ludwig Boltzmann Institute of Healthe Promotion.
5. Caldeira,K.M.,Arria,A.M.,Zarate, E. M., Vincent,K.B.,Wish,E.D., &O'Grady,K.E. (2009). ProspectiveAssociations betweenAlcoholandDrugConsumptionandRiskySex amongFemaleCollege Students.*JournalofAlcohol&Drug Education,53*(2),71-92. RetrievedfromEBSCOhost.
6. Devieux J et al 2002 Impulsivity and HIV risk among alcohol and athers drugs abusing adolescent. Aids education and prevention suppl B 24 – 35.
7. George, W.,Davis,K.,Norris,J.,Heiman,J.,Stoner,S., Schacht,R., Hendershot,C.,&Kajumulo,K.,(2009). Indirecteffectsofacutealcoholintoxicationonsexualrisk-taking: theroles ofsubjectiveandphysiological sexualarousal. *Archives ofSexualBehavior,38*(4), 498-513.
8. Hutton,H.E.,McCaul,M.E., Santora, P. B.,&Erbelding,E. J.(2008). Therelationship betweenrecentalcoholuseandsexualbehaviors:Genderdifferences among sexuallytransmitteddiseaseclinicpatients.alcoholism:*Clinical&Experimental Research,32*(11), 2008-2015.
9. Leigh B et al 2008 Alcohol, drugs and condom use. 93 (1) 38 – 42.
10. Lewis,M.,Rees,M., Logan,D.,Kaysen,D.,&Kilmer,J.(2010). Useofdrinkingprotective behavioral strategiesinassocationtosex-relatedalcoholnegativeconsequences:The mediatingroleofalcoholconsumption.*PsychologyofAddictiveBehaviors,24* (2), 229-238.
11. Madhavika B. Nayak ety al 2010 Alcohol use, mental healthand HIV related risk behavior among adult men, AIDS and behaviours vol 14 Suplement 1

12. Roberts C et al eds The health Behaviours in school aged Children (HBSC) study: methodological development and current tensionons. International Journal of Public Health, 54 (suppl, 2) 140 – 150
13. Turchick,J,&Garske,J.(2009).Measurementofsexualrisktakingamongcollegestudents .*Archives ofSexualBehavior,38*(6), 936-948.
14. Wechsler,H., Lee,J., Kuo, M., &Lee,H.(2010). Collegebingedrinkinginthe1990s:A continuingproblemresults oftheharvardschoolofpublichealth1999collegealcohol study.*JournalofAmericanCollegeHealth,48*(5), 199-210.

LEGJISLACIONI SHQIPTAR MBI LIRINË KONTRAKTORE DHE MIRËBESIMIN

Autor: M. Sc. Ergysa IKONOMI

LEKTORE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE HUMANE

DEPARTMENTI I DREJTËSISË - E DREJTË CIVILE

Adresa: Universiteti "Ismail Qemali", Godina B, Vlorë

e - mail: ergysa83@yahoo.com

Kontraktimi është një veprim juridik që ndërmerret në mënyrë që personat të realizojnë interesat e tyre të ligjshme. Një palë në kontratë është absolutisht e interesuar për të zgjedhur me kujdes palën tjetër kontraktore dhe llojin e kontratës, si dhe për të negociuar klauzola të kontratës, të cilat janë më të favorshme për të. Kjo sjellje është e justifikuar nga prania e Lirisë Kontraktore, si një parim i rëndësishëm i të drejtës tonë kontraktore.

Terminologjia e përdorur e përcakton parimin si liri. Ky punim ka si qëllim të zbulojë nëse ka ende mundësi të merret në konsideratë si liri, duke iu referuar zhvillimit ekonomik dhe kufizimeve ligjore të siguruara nga Kodi Civil Shqiptar, si dhe ligje të tjera, në lidhje me palët kontraktuese dhe përmbajtjen e kontratës.

Nëpërmjet analizimit të këtyre kufizimeve dhe detyrimit të kërkuar që palët të veprojnë në mirëbesim gjatë negociatave dhe zbatimit të kontratës, do të sqarohet se Liria Kontraktore nuk është një liri absolute.

Fjalë kyçe: *kontratë, liri kontraktore, ligj, mirëbesim, kufizime*

1. HYRJE

Në Shqipëri, si në vendet e tjera të Evropës Lindore pas Luftës së Dytë Botërore u vendos një sistem politik i centralizuar. Sipas Kushtetutave që pasuan njëra-tjetrën, deri në ndryshimin e madh në vitin 1991, u parashikua se: "… *shteti drejton jetën dhe zhvillimin ekonomik në bazë të një plani të përgjithshëm ekonomik.*" (Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë, 1946) Me justifikimin e mbrojtjes së interesave vitale të popullit dhe për të rritur nivelin e mirëqenies së tij, shteti ushtronte një kontroll të përgjithshëm mbi sektorin privat. Tregtia e jashtme ishte nën kontrollin e shtetit. Shteti gjithashtu rregullonte dhe kontrollonte të gjithë tregtinë e brendshme në vend. (Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, 1950) Edhe prona private u ndalua gradualisht: *"Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë nuk ka klasa shfrytëzuese, janë zhdukur dhe ndalohen prona private e shfrytëzimi i njeriut prej njeriut."*

(Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1976) *"Zhdukja e pronës private"* u përforcua nga dispozitat e Kodit Civil, (Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1981) duke njohur vetëm pasurinë vetjake, (Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1981) e cila gjithashtu nuk mund të përdorej kundër interesave të socializmit. Qytetarët mund të kontraktonin për përmbushjen e nevojave të tyre materiale dhe kulturore, si dhe për nëdorësinë, gëzimin dhe disponimin e pronës së tyre vetjake. (Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, 1981)

Por, para kësaj, Shqipëria kishte një legjislacion civil të bazuar në arritjet më të mira të jurisprudencës evropiane, sidomos franceze dhe italiane. Kodi Civil Shqiptar i vitit 1929 ka qenë një progres për shoqërinë shqiptare, i cili parashikonte mundësinë e realizimit të një shumëllojshmërie kontratash bazuar në pëlqimin e palëve. Në Shqipëri ka ekzistuar një traditë e ekonomisë së tregut dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike.

Ndryshimet politike dhe sociale në Shqipëri u shoqëruan me ndryshime thelbësore në legjislacion. Kodi Civil aktual, i cili hyri në fuqi në vitin 1994, ka një dispozitë të veçantë për lirinë e palëve që kontraktojnë. Kjo është një dispozitë e rëndësishme, sepse ka të bëjë me lirinë në zgjedhjen e palës tjetër kontraktuese, llojit të kontratës, si dhe përmbajtjes së saj. Pjesa e parë e punimit do të qartësojë kuptimin e lirisë kontraktore si parim dhe rëndësinë e tij.

Nëpërmjet analizimit të dispozitave të Kodit Civil Shqiptar, pjesa e dytë e këtij punimi do të shpjegojë se pse liria kontraktore nuk mund të konsiderohet absolute. Ligji vendos kufizime në lirinë kontraktore, të cilat janë të lidhura me personat si palë kontraktore potenciale dhe në përmbajtjen e kontratës.

Pjesa e tretë e këtij punimi do të përqëndrohet në praninë e mirëbesimit, si një detyrim i kërkuar për palët, për të vepruar në mirëbesim gjatë negociatave, interpretimit dhe zbatimit të kontratës. Në pjesën e tretë të punimit dy parime të rëndësishme të ligjit kontraktor do të vihen ballë për ballë, për të treguar se nuk kufizojnë, por plotësojnë njëri-tjetrin.

2. METODOLOGJIA

Në realizimin e këtij punimi është përdorur metodat hulumtuese, si pjesë e metodës cilësore, për përzgjedhjen e materialeve për realizimin e tij. Metoda analitike është përdorur në dispozitat e Kodit Civil Shqiptar, duke u përqëndruar në lirinë kontraktore dhe në elementët thelbësore të kontratës. Përmes metodës interpretuese, është realizuar interpretimi sistematik i dispozitave të Kodit Civil në lidhje me mirëbesimin dhe lirinë kontraktore si parime të rëndësishme të së drejtës kontraktore.

3. LIRIA KONTRAKTORE

Kushtetuta e Shqipërisë përcakton lirinë e veprimtarisë ekonomike, ekonominë e tregut dhe pronën publike dhe private si elementët mbi të cilat është bazuar sistemi ynë ekonomik. (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998)

Sipas përkufizimit të ekonomisë së tregut, ajo është një sistem ekonomik në të cilin çmimet janë të bazuara në konkurrencën ndërmjet bizneseve private dhe nuk kontrollohen nga qeveria. (merriam-webster.com) "Mungesa e kontrollit nga qeveria" është e bazuar në doktrinën "*laissez faire*".

"Doktrina laissez-faire ishte politike, si dhe ekonomike. Teoria mbizotëruese e shekullit 19- të ishte se individi, duke ndjekur qëllimet e tij të dëshiruara, do të arrinte rezultatet më të mira për shoqërinë ku ai bënte pjesë. Funksioni i shtetit ishte për të ruajtur rendin dhe sigurinë dhe për të shmangur ndërhyrjen në iniciativën e individit në ndjekjen e qëllimeve të dëshiruara të tij. Por, avokatët e laissez-faire megjithatë argumentuan se qeveria kishte një rol thelbësor në zbatimin e kontratave, si dhe për të siguruar rendin civil." (britannica.com, 2013)

Aktiviteti ekonomik zhvillohet çdo ditë përmes kontratave, të cilat janë forma më e përdorur për të shprehur interesin ekonomik dhe tregtar të njerëzve në të gjithë botën. Një parim i rëndësishëm i ligjit kontraktor është liria kontraktore, e cila nuk duhet të ngatërrohet me autonominë e palëve.

Nuk është aq e thjeshtë të diskutosh mbi lirinë kontraktore. Richard Craswell deklaron se: *"Pjesa më e madhe e ligjit kontraktor përbëhet nga rregulla të paracaktuara, apo rregulla që zbatohen kur palët dështojnë për të arritur një çështje në një mënyrë apo tjetër në kontratat e tyre. Për shembull, shumica e rregullave që rregullojnë ofertën dhe pranimin, dhe garancitë që përfshihen, apo justifikime të përfshira si pazbatueshmëria apo gabimi, zbatohen vetëm nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe. Dhe sa kohë që palët janë të lira të bien dakord ndryshe, është e vështirë për të parë se si liria kontraktore ndikohet nga këto rregulla të paracaktuara."* (Craswell, R. 1994)

Liria kontraktore përbëhet nga tre aspekte: liria për të kontraktuar, liria për të mos kontraktuar dhe liria për të përcaktuar përmbajtjen e kontratës në diskrecionin e palës. (De Bondt, W. 2001) Sigurisht bëhet fjalë për lirinë në zgjedhjen e llojit të kontratës, si dhe përmbajtjen e saj. Përmbajtja përbëhet nga tërësia e klauzolave. Çdo klauzolë duhet të jetë në përputhje me normat imperative të ligjit.

"Liria kontraktore shpesh shqiptohet si "dead on arrival", si një parim organizues për shoqëritë komplekse bashkëkohore. Ky parim thuhet të jetë i

pandjeshëm për dallimet në pasuri, status, pozitë, dhe fuqi, që e bëjnë ushtrimin e zgjedhjes kontraktore një mit për të dobëtit dhe të shpronësuarit." (Epstein, R. A. 1999)

Kur palët vendosin të lidhin kontratë me njëri-tjetrin, përmbajtja apo mbi çfarë palët kanë rënë dakord duhet të jetë brenda kufijve ligjorë. *"Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët."* (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994) Njihet si *pacta sunt servanda*, që do të thotë se nënshkrimi i një kontrate ka si pasojë detyrueshmërinë e një pale në tjetrën. Është thelbësore që premtuesi, jo vetëm e kupton plotësisht kuptimin e marrëveshjes që ai është duke bërë, por edhe se ai është në gjendje të japë lirisht pëlqimin e tij, i cili është rezultati i një procesi vendosës plotësisht informues. Sipas këtij interpretimi, "liria kontraktore" konsiston jo vetëm në qëndrimin e natyrshëm të çdo individi për të mbajtur premtimet e tij, por veçanërisht në mundësinë e palëve kontraktuese për të deklaruar dhe më pas për të modifikuar përmbajtjen e kontratës, pa asnjë ndërhyrje tjetër të jashtme nga gjykatat apo persona të tretë. (Cicoria, C. 2003)

Pra, ideja e lirisë kontraktore përmban dy elemente:

- elementi negativ, i cili refuzon ndërhyrjen e shtetit në kushtet e transaksioneve të tregut;
- elementi pozitiv, i cili sheh një përmirësim të lirisë në lejen e përgjithshme për të hyrë në kontrata të detyrueshme, sepse kjo lehtësi lejon forma të reja të përpjekjeve bashkëpunuese të cilat zgjasin për një periudhë kohore. (Beale, H. G. 2008)

Elementi negativ duhet të shihet edhe në mënyrën që askush nuk mund të jetë i detyruar për të kontraktuar pa vullnetin e tij.

Pavarësisht terminologjisë së përdorur për të përcaktuar atë si liri, liria kontraktore nuk i mbijeton kufizimeve ligjore të vendosura në lidhje jo vetëm me përmbajtjen e kontratës, kushtet e saj dhe mënyrën se si do të përmbushet, por edhe rreth personave dhe aftësive të tyre për të qenë pale kontraktuese.

4. KUFIZIMET E LIRISË KONTRAKTORE

Liria kontraktore është një parim i rëndësishëm, i cili i konsideron personat si të barabartë, duke mbajtur një kapacitet abstrakt për të kontraktuar. Liria, e siguruar nga ky parim, nuk mund të jetë absolute dhe fjala "liri" nuk duhet të interpretohet si diçka që lejon abuzime të bëra nga palët. *"Kreditori dhe debitori duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit me korrektesë, paanësi dhe sipas kërkesave të arsyes."* (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994) Gjykata e Lartë shqiptare ka arritur në përfundimin që: *"…liria e kontraktimit nuk është absolute. Ajo*

gjithsesi mund "të kufizohet" nga disa faktorë ekonomike e morale… që duhet t`i ketë parasysh edhe gjykata në zgjidhjen e çdo çështjeje konkrete."

"Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga ligji." (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994) Liria e kontratës do të thotë mundësi për përcaktimin e atyre me të cilët do të kontraktohet ose jo, si dhe përmbajtjen, si dy nga koordinatat e parimit të lirisë kontraktore. (Voicheci, E. 2013) Pavarësisht nga terminologjia e përdorur për të përcaktuar parimin dhe rëndësinë e tij, as nuk mund të mendohet se liria në vetvete nuk përmban kufizime. Vetëm korniza ligjore mund të kufizojë këtë liri të rëndësishme.

"Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë, krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike." (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994) Si një veprim juridik i zakonshëm, çdo kontratë duhet të jetë e vlefshme për të sjellë pasoja juridike.

Para së gjithash kushtet thelbësore të kontratës nuk duhet të jenë në konflikt me ligjin. Kjo është e rëndësishme për vlefshmërinë e kontratës: *"Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji*."(Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994)

"Kontrata quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjellë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj." (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994) Por në qoftë se ka vese të vullnetit, të tilla si mashtrimi, kanosja, gabimi ose kontrata është lidhur në kushtet e forcës madhore, ekziston rrezik për vlefshmërinë e kontratës. *"Në një kontratë, shkaku ligjor është i paligjshëm, kur vjen në kundërshtim me ligjin, rendin public ose kur kontrata bëhet mjet për të shmangur zbatimin e një norme."* (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994) *"Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet*."(Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994) Forma e kontratës kërkohet me ligj, kur vetë ligji paracakton një formë të caktuar për një lloj kontrate dhe e kërkon atë formë *ad substantiam* ose *ad probationem.*

Shpesh ligji vendos kufizime në lirinë e kontratës, siç mund të jetë rasti i kontratave të punës, në të cilën është parashikuar paraprakisht sasia e orëve javore të punës ose të pushimeve vjetore. Një rast tjetër i referohet shitjes së trojeve shtetërore, çmimi i të cilave caktohet nga Këshilli i Ministrave. (Ligj "Për shitblerjen e trojeve", 1995)

Liria e kontratës shprehet në mundësinë e njohur për palët për të kontraktuar jo vetëm kontrata tipike, të njohura dhe rregulluara me ligj, por edhe në

kontraktimin e kontratave atipike, të cilat nuk janë të parashikuara me ligj. Këto kontrata duhet të ndjekin interesa të dobishme shoqërore.

Personat fizikë që të kontraktojnë duhet të ketë zotësi të plotë për të vepruar, ose kur ata e kanë të kufizuar zotësinë për të vepruar, ose kur i mungon zotësia për të vepruar, kontrata zakonisht duhet të lidhet nga përfaqësuesi ligjor. Kontrata, si veprim juridik, duhet të lidhet nga persona të cilët janë të vetëdijshëm për rëndësinë e veprimit të tyre. Legjislacioni parashikon kufizime në lidhje me kryerjen e disa veprimeve juridike nga persona, të cilët për shkak të profesionit të tyre apo statusit të tyre si përfaqësues apo kujdestarë, nuk mund t'i kryejnë ato. Ky është rasti i përfaqësuesit, i cili zakonisht nuk mund të kryejë veprime juridike në emër ë të përfaqësuarit as me veten e tij dhe as me persona të tjerë të përfaqësuar prej tij, (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994) ose gjyqtarit, të cilit i ndalohet të marrë pjesë në administrimin apo drejtimin e shoqërive tregtare, personalisht ose me anë përfaqësimi. (Ligj "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", 2008) Dispozitat e Kodit Civil Shqiptar përmbajnë kufizime specifike për kontratën e shitjes, në lidhje me blerjen direkt, nëpërmjet ndonjë tjetër ose në ankand për disa kategori profesionistësh. (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994)

Në lidhje me lirinë kontraktore, ka sektorë ekonomikë për të cilat shtetet mund të vendosin në interes të publikut për t'i përjashtuar nga konkurrenca e hapur. Në raste të tilla mallrat ose shërbimet në fjalë mund të kërkohen vetëm nga një furnizues në dispozicion, i cili zakonisht do të jetë një organ publik, dhe që mund ose jo të ketë për detyrë që të lidhë kontrata me këdo që bën një kërkesë, brenda kufijve të disponueshmërisë së mallrave ose shërbimeve. (lexinter.net)

5. LIRIA KONTRAKTORE DHE MIRËBESIMI

Sipas teorisë klasike të kontratës në fund të shekullit të 19-të, maksimizimi i mirëqenies individuale dhe nxitja e ndarjes më të mirë të burimeve në treg mund të arrihet nëpërmjet ushtrimit të pakufizuar të lirisë kontraktore midis palëve që posedojnë fuqi të barabartë në bisedime, aftësi të barabarta, dhe njohuri të përsosura të kushteve të përshtatshme të tregut, pa pasqyruar realitetet e tregut në atë kohë. Duke qenë se palët e barabarta nuk ekzistonin, studiuesit pohuan se liria kontraktore mund të mbijetojë vetëm në një ekonomi ku besimi dhe vullneti i mirë ekzistonin ndërmjet palëve që bënin biznes. (Edwards, C. 2009).

Duke qenë se kontrata është një marrëveshje e detyrueshme, palët duhet të përmbushin detyrimet e tyre, duke vepruar në mirëbesim, për të shmangur ndonjë dëm.

Kodi ynë Civil parashikon të shprehur të qartë detyrën e mirëbesimit gjatë negociatave: *"Palët gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës, duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëra-tjetrës."* (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994) Kjo fazë është delikate dhe e pasigurt. Në qoftë se secila palë mbështetet në faktin se "liria kontraktore" do të thotë gjithashtu se ata mund të ndryshojnë mendjen e tyre në çdo kohë, pa pasoja, kjo mund të shkaktojë dëme të mundshme. Ky quhet detyrim para-kontraktor, i cili njeh detyrimin për të shpërblyer ndonjë dëm të mundshëm. Në bazë të Kodit Civil Shqiptar, art. 675 "Në rast se një palë kontraktuese disponon njohuri profesionale dhe pala tjetër i ngjall asaj besim të plotë, e para ka detyrim t'i japë asaj me mirëbesim, informata dhe udhëzime." Në këtë rast, informacioni duhet të mbetet konfidencial, nëse dëmton palën që e ka dhënë atë. Në kontrata të veçanta si franchising, detyrimi i konfidencialitetit është shprehur në mënyrë të qartë dhe vlen edhe nëse kontrata nuk është lidhur. Shkelja e këtij detyre ndiqet nga detyrimi për të kompensuar dëmin.

Kur palët kanë mosmarrëveshje mbi kushtet e kontratës, ose kur ka paqartësi, është i nevojshëm interpretimi i kontratës, i cili ndihmon palët për të kuptuar se si ligji e konsideron kontratën e tyre. *"Kontrata duhet të interpretohet në mirëbesim nga palët."* (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994) Në këtë rast nuk duhet të konsiderohet vetëm kuptimi literal, por edhe çfarë palët në mënyrë të arsyeshme kërkojnë të arrijnë nëpërmjet të drejtave dhe detyrimeve, duke i shtuar kontratës vlera njerëzore.

Lidhja e një kontrate do të thotë patjetër përmbushje të një ose disa detyrimeve nga një ose të dy palët. *"Debitori dhe kreditori duhet të tregojnë kujdesin e duhur e të jenë të përpiktë në përmbushjen e detyrimit sipas përmbajtjes së tij."* (Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, 1994) Në këtë rast është e nevojshme që detyrimi duhet të përmbushet në përputhje me përmbajtjen e tij. Duhet të tregohet kujdesi i duhur për të përmbushur detyrimin në mënyrën, afatin dhe vendin e caktuar.

"Mirëbesimi është vlerësuar të jetë një faktor jokufizues i lirisë kontraktore, por një faktor që kushtëzon ushtrimin e këtij parimi, që e kthen atë në një element të brendshëm të saj." (Voicheci, E. 2013)

6. PËRFUNDIME

"Ideja e kontratës si subjektivizëm i plotë dhe i pastër i individit, të lirë nga çdo kusht objektiv faktik apo ligjor, është një ide abstrakte që nuk është reflektuar deri tani në jetën reale." (Roppo, V. 2001)

Liria kontraktore nxit zhvillimin e ekonomisë dhe rrit konkurrencën. Ajo është sigurisht e lidhur me rritjen ekonomike dhe cilësinë më të mirë të mallrave dhe shërbimeve të ofruara.

Liria kontraktore, si parim, është e rëndësishme, por në ditët tona, duke iu referuar zhvillimit të shpejtë të ekonomisë, është e vështirë të gjesh nëse ka ende liria kontraktore. Në përmbushjen e nevojave të përditshme, ka një numër shërbimesh të ofruara për klientët nëpërmjet kontratave të përgatitura që më parë nga ana e kompanive apo ndërmarrjeve, në pa mundësi të krijimit të kontratave. Kjo do të thotë se ka pak raste kur palët kontraktuese ulen për të negociuar klauzolat e kontratës, të cilat përbëjnë përmbajtjen e kontratës. Pra, duket se të paktën një palë "nuk përdor" lirinë kontraktore për të përcaktuar përmbajtjen e saj, pranon duke nënshkruar të gjitha parashikimet e vendosura nga pala tjetër, duke mbetur e lidhur me përmbushjen e detyrimeve. Ky mund të jetë rasti i kontratave me një bankë për depozitat, ku interesi është paracaktuar, ose në rastin e kredive, ku këstet e kredisë paguhen në mënyrën që kontrata përcakton dhe ku interesi përkatës përcaktohet vetëm nga banka, ose kontratat me kompanitë që ofrojnë shërbimet e internetit, telefonisë fikse, furnizimit me ujë dhe energji elektrike.

Por edhe në rastet, kur secila palë merret me negocimet e kontratës, ka kufizime të ligjit që nuk mund të shmangen, si dhe parashikime ligjore në lidhje me mirëbesimin dhe mënyrën se si duhet të veprojnë palët në të gjitha fazat e kontratës.

Në fakt, prania e dy parimeve mund të konsiderohet kufizuese në lidhje me sjelljen e palëve dhe kontratat e tyre, por në raport me njëri-tjetrin janë parime plotësuese.

7. LITERATURA

- Craswell, R. (1994) *Freedom of Contract* (p. 1) http://www.law.uchicago.edu/files/files/33.Craswell.FrdmCntrct_0.pdf
- De Bondt, W. (2001). Contracts. In. H. Bocken & W. De Bondt (Eds.), *Introduction to Belgian Law* (p. 223)
- Epstein, R. A. (1999) Free Bargaining and Formalism. In. F. H. Buckley (Ed.), *The Fall and Rise of Freedom of Contract.* (p. 28)
- Cicoria, C. (2003). The Protection of the Weak Contractual Party in Italy vs. United States “Doctrine of Unconscionability. *Global Jurist Advance*, 3 (3), 1537 http://www.uniformterminology.unito.it/downloads/papers/cicoriaprotection.pdf
- Beale, H. G. , Bishop, W. D. & Furmston, M. P. (2008) *Contract* (p. 70)

- Voicheci, E. (2013) Freedom of Contract and its limitations in the Romanian Civil Code. *Challenges of the Knowledge Society* http://www.oalib.com/search?kw=EUGENIA%20VOICHECI&searchFields=authors
- Edwards, C. (2009). Freedom of Contract and Fundamental Fairness for Individual Parties: The Tug of War Continues. *UMKC Law Review*, 77(3), 647-649 http://scholarship.law.marquette.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1281&context=facpub
- Roppo, V. (2001) *Il Contratto* (p. 41) Giuffrè ISBN: 8814086176
- Statuti i Republikës Popullore të Shqipërisë (1946), art. 6
- Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë (1950), art. 7, 8
- Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (1976), art. 16
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998), art. 11
- Ligj Nr. 6340, datë 26.06.1981 "Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", art. 7, 77, 142
- Ligji Nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", art. 67, 422, 455, 659, 660, 663, 674/1, 676, 677, 678, 682/2, 690, 709
- Ligj Nr. 7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", art. 8
- Ligj Nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", art. 23
- Vendim Nr. 932, datë 22.06.2000 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Shqiptare
- http://www.merriam-webster.com/dictionary/market%20economy
- http://www.britannica.com/EBchecked/topic/328028/laissez-faire
- http://www.lexinter.net/LOTWVers4/freedom_of_contract.htm

IMPAKTI I RRITJES SE NJE FEMIJE ME CRREGULLIME ZHVILLIMI NE CILESINE E JETES SE PRINDERVE: SHQYRTIM LITERATURE

Erjona Dervishaliaj
Universiteti i Vlores Ismail Qemali
Edaliaj123@gmail.com

Studimet kanë vlerësuar se rritja e një fëmijë me çrregullime zhvillimi rrit nivelet e stresit të përjetuar në familje si dhe prek shëndetin e prindërve. Në gamën e shërbimeve profesionale që i ofrohen familjes është pranuar rëndësia e konceptit të cilësisë së jetës si qëllimi përfundimtar drejt të cilit synojnë këto shërbime. Qëllimi i këtij studimi ishte hulumtimi i cilësisë së jetës së prindërve të fëmijëve me çrregullime zhvillimi, si dhe identifikimi i faktorëve më domethënës që ndikojnë në cilësinë e jetës së prindërve, të matura këto nga studime të mëparshme. Për këtë qëllim u realizua shqyrtimi i literaturës ekzistuese. Së pari u identifikuan studimet përmes kërkimit kompiuterik në databaza të ndryshme duke përdorur fjalët kyç. Më tej, artikujt që përmbushën kriteret e vendosur, u përzgjodhën për shqyrtimin e literaturës në këtë studim. Dhjetë artikuj prëmbushën kriteret, nga të cilët nëntë artikuj kanë përdorur qasje sasiore, ndërsa një artikull shqyrtimin e literaturës. Cilësia e jetës së lidhur me shëndetin (fizik dhe mendor), faktorët ekonomike dhe marrëdhëniet ndërpersonale janë trajtuar në studim. Më tej është diskutuar mbi ndikimin e mundshëm të faktorëve demografikë dhe përfshirjes së baballarëve në përkujdesjen për fëmijën me çrregullime, si faktorë mediatorë mes stresit nga përkujdesja dhe cilësisë së jetës së prindërve. Së fundi, jepen sugjerime për kërkime të mëtejshme në Shqipëri.

Fjalwt kyçe: *cilwsi e jetws sw prindwrve, çrregullime zhvillimi, familje/prindër, paaftësi intelektuale, çrregullim të spektrit të autizmit*

Hyrje

Në dy dhjetë vjeçarët e fundit, në fushën e studimeve të familjeve me fëmijë me çrregullime dhe suportit ndaj tyre, i është kushtuar gjithnjë e më tepër rëndësi konceptit të cilësisë së jetës, duke e konsideruar atë një koncept kyç (Wang & Brown, 2009). Cilësia e jetës konsiderohet një konstrukt shumë dimensional, e cila në vija të përgjithshme përfshin disa fusha; mirëqënien fizike, materiale, sociale, emocionale dhe ate produktive. Studiuesit bien dakord se, çrregullimi i fëmijës ndikon në mënyra të ndryshme mbi cilësinë e jetës së prindërve të tij. Ndonëse disa studiues sugjerojnë se impakti i çrregullimit të fëmijës mbi cilësinë e jetës së familjes mund të jetë më i ulët nga sa raportohet në studime të ndryshme, ata i mbështesin gjetjet se në një mënyrë a në një tjetër cilësia e jetës së familjes gjithsesi kompromentohet (Lin et al, 2009). Në gamën e shërbimeve profesionale që i ofrohen familjes është pranuar rëndësia e konceptit të cilësisë së jetës si qëllimi përfundimtar drejt të cilit synojnë këto shërbime. Studimi i cilësisë së jetës së familjeve siguron jo vetëm një kornizë për shërbimet të cilat kanë për qëllim suportin ndaj individëve dhe familjeve të tyre, por gjithashtu u vjen në ndihmë profesionistëve duke i orientuar drejt nevojave të individëve dhe familjeve të tyre, për t'i ndihmuar ata të përjetojnë më shumë kënaqësi e gëzim në jetët e tyre.

Ndonëse një koncept i përdorur gjerësisht (Olson 2000), për cilësinë e jetës nuk ekziston një përkufizim i vetëm. Ajo është cilësuar nga Grant dhe kolegët e tij si një deklaratë personale mbi pozitivitetin apo negativitetin e atributeve që karakterizojnë jetën e dikujt (cituar nga Olson 2000. Grant et al 1990). Nndërkohë, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë cilësia e jetës do të përkthehej si shuma e një sërë kushtesh jetësore të përjetuara nga individi, të matshme këto në mënyrë objektive, ku përfshihen shëndeti fizik e mendor, rrethanat personale, marrëdhëniet sociale, aktivitetet funksionale e qëllimet e individit, si dhe faktorë të tjerë me natyrë shoqërore e ekonomike (WHOQOL Group, 1993). Reagimi subjektiv i individit ndaj këtyre kushteve përbën kënaqësinë e tij personale nga jeta (Hsiao & Nixon, 2008).

Studimet mbi cilësinë e jetës, janë fokusuar si mbi cilësinë e jetës së individit në veçanti dhe atë të familjes në përgjithësi, duke hulumtuar disa dimensione.
WHOQOL- (World Health Organization Quality of Life Questionnaire), një shkallë e përdorur shpesh për vlerësimin e cilësisë së jetës së individit përfshin vlerësimin e katër fushave të ndryshme; aftësitë fizike (ku përfshihen lëvizshmëria, aktivitet ditore, kapacitetin funksional, energjinë, dhimbjen dhe gjumin), mirëqënien psikologjike (ku përfshihen vetë imazhi, mendimet negative, qëndrimet positive, vetë vlerësimin, mentalitetin, aftësitë për të mësuar, memorien dhe përqëndrimin, fenë dhe statusin mendor), marrëdhëniet sociae (ku përfshihen marrëdhëniet personale, suportin social, dhe jetën seksuale) dhe shëndetin në lidhje me mjedisin (ku përfshihen burimet financiare, sigurinë, shëndetin dhe shërbimet sociale, mjedisin fizik ku jeton, mundësitë për të fituar aftësi të reja dhe njohuri, rekreacionin, mjedisin e përgjithshëm dhe transportin) (Lin et al 2009).

Ndërkohë Schalock dhe kolegët (2002) në vlerësimin e cilësisë së jetës së familjes përfshinë 10 fusha të ndryshme, nga të cilat 6 prej tyre të orientuara drejt individit; advokacine, mirëqënien emocionale, shëndetin, mjedisin fizik, produktivitetin, mirëqënien soicale , dhe katër fushat të orientuara drejt familjes të cilat marrin në konsideratë ndërveprimin e anëtarëvë të familjes me njëri-tjetrin si një njësi e vetme. Këto fusha përfshijnë jetën e përditshme e familjes, ndërveprimin e familjes, prindërimin, dhe mirëqënien financiare. Veç advokaciësë që rezulton të jetë e rëndësishme vetëm për familjet që kanë një anëtar me paaftësi (Poston et al., 2003), nëntë fushat e tjera janë njësoj të rëndësishme për të gjitha tipet e familjeve.

Artikulli realizon një shqyrtim të kërkimeve të zhvilluara gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit mbi cilësinë e jetës së familjeve të fëmijëve me çrregullime. Do të prezantohet së pari një përmbledhje e konceptualizimit të cilësisë së jetës dhe matjeve të saj, e më tej do të diskutohet mbi marrëdhënien e këtij koncepti me një sërë variablash të tjerë, sesi ndikohen dimensione të ndryshme të tij gjatë rritjes së një fëmije me çrregullime zhvillimi.

Metodologjia

Kriteret e përzgjedhjes së artikujve

Artikujt u identifikuan përmes kërkimit kompiuterik në databaza të ndryshme. Studimet u përzgjodhën për t'u përfshirë në studim nëse titulli i tyre përfshinte termat *familje/prindër, fëmijë me çrregullime zhvillimi* apo *paaftësi intelektuale*, apo *çrregullim të spektrit të autizmit, cilësi e jetës* apo terma të tjerë që lidhen me cilësinë e jetës si *mirëqënie fizike, psikologjike, mendore, sociale, ekonomike.* Fokusi i shqyrtimit të literaturës ishte sesi prekej cilësia e jetës së prindërve gjatë rritjes dhe kujdesit për një fëmijë me çrregullime zhvillimi. Dhjetw artikuj plotësuan kriteret për t'u përfshirë në studim.

Karakteristikat e studimeve dhe kampionit të përfshirë në to

Artikujt e përfshirë në shqyrtimin e literaturës janë zhvilluar përgjatë viteve 2001-2012. Përmasat e kampioneve të përfshirë në këto artikuj varionin nga 46 në 597 prindër.. Të gjithë studimet e kishin përqëndruar kampionin në prindër të fëmijëve apo adoleshentëve me çrregullime zhvillimi. Në të gjitha artikujt e përzgjedhur është aplikuar përqasja sasiore. Vetëm një nga artikujt e përzgjedhur konsiston në shqyrtim të literaturës mbi cilësinë e jetës së familjeve të fëmijëve me çrregullime zhvillimi.

Rezultatet

Implikime të mirëqënies fizike dhe psikologjike

Nënat e fëmijëve me çrregullim zhvillmi janë më të rrezikuara të preken nga çrregullime të shëndetit mendor e veçanërisht depresioni (Resch et. al, 2012; Glidden, 2003; McLinden, 1990), si dhe cilësia e jetës së tyre priret të jetë më e varfër krahasuar kjo me nënat e fëmijëve me zhvillim tipik (Lin, et. al, 2009). Në një studim krahues Lin dhe kolegët (2009) gjetën se cilësia e jetës së kujdestarëve të fëmijëve dhe adoleshentëve me çrregullime zhvillimi ishtë më e varfër se ajo e pjesës tjetër të popullatës. Ndër katër fushat e jetës së individit të vlerësuara prej tyre fusha e mirëqënies psikologjike rezultoi të ishtë më e cënuara. Kjo e fundit mund të përkufizohet si përjetimi i vazhdueshëm i stresit, depresionit dhe ankthit në nivele të larta. (Uskul & Greenglass, 2005).

Nënat e fëmijëve me çrregullime raportojnë shpesh probleme të shëndetit fizik. Duket se aftësitë jo të mira motorike të fëmijëve mund të shërbejnë si parashikues të gjendjes shëndetësore të nënës. Truesdale dhe McConkey, (2001) treguan se nivelet e larta të stresit të raportuar nga nënat dhe aftësitë e varfra motorike të fëmijëve të tyre janë të lidhura me shëndetin fizik të nënave. Nënat që raportuan nivele më të larta stresi, i lidhur ky me kujdesin ndaj fëmijës me çrregullime, raportuan edhe më shumë probleme shëndetësore në pyetësorin e shëndetit të përgjithshëm të administruar nga studiuesti (General Health Questionnaire) (Truesdale & McConkey 2001). Këto gjetje mbështeten edhe nga Johnson dhe kolegët (2011) të cilët gjetën se stresi i lidhur me përkujdesjen për fëmijën shoqërohej me probleme të shëndetit fizik tek nënat, por jo të shëndetit mendor. Ndërkohë, rezultoi se, si tek nënat dhe baballarët stresi që vinte nga jeta personale dhe familjare shoqërohej me probleme të shëndetit mendor. Për baballarët, stresi nga jeta personale shoqërohej edhe me probleme të shëndetit fizik.

Karakteristikat e fëmijës me çrregullime zvhillimi, si sjelljet e vështira për t'u menaxhuar, ato sfiduese, ashpërsia e çrregullimit të fëmijës, problemet e tij me gjumin, mosha e tyre, etj., janë të lidhura me shëndetin psikologjik e fizik të prindërve, e më tej me cilësinë e jetës së tyre.

Lin dhe kolegët, (2009) gjetën se mosha e fëmijëve me paaftësi intelektuale kishte një korrelacion të moderuar me mirëqënien fizike dhe mirëqënien psikologjike të pjesëmarrësve të studimit.

Vazhdimisht, studimet kanë treguar një lidhje të fortë mes sjelljeve problematike dhe mirëqënies së përgjithshme të nënave (Kring et al 2008; Abbeduto et al., 2004). Sipas Kring dhe kolegët (2008) mirëqënia e nënave të fëmijëve me një çrregullim të spektrit të autizmit mund të kompromentohet nga pesha e kujdesit për fëmijën. Kësaj të fundit i mbivendoshet përballja me sjelljet problematike,tejet sfiduese të fëmijës (Kring et al 2008). Si sjelljet problematike te personave me çrregullime zhvillimi, edhe ashpërsia e çrregullimit shoqërohen me një nivel më të lartë sfidash në përkudjesin për fëmijët me çrregullime (Essex et al., 1999).

Ndërkohë që çrregullimet e gjumit janë të zakonshme në fëmijëri, tek fëmijët me çrregullime të zhvillimit ato zgjasin më tepër në kohë, duke u shoqëruar kështu jo veëm me gjumë të prishur tek prindërit, por edhe me probleme të tjera psikologjike (Chu & Richdale, 2009). Studimet sugjerojnë se problemet me gjumin vihen re më shpesh tek nënat sesa tek baballarët (Wiggs & Stores, 2001) Ndërkohë që Richdale et al., (2000) kanë treguar lidhje mes problemeve të gjumit të fëmijëve me çrregullime zhvillimi dhe problemeve emocionale e sjellore të tyre, studime të tjera kanë treguar se çrregullimet e gjumit te këta fëmijë, si vështirësitë për të rënë në gjumë, zgjimi i shpeshtë natën, refuzimi për të fjetur vetëm, shoqërohen me gjumë të prishur tek nënat, me simptoma ankthi, depresion, dhe nivel të lartë stresi (Chu & Richdale 2009). Sipas Chu & Richdale (2009) gjumi jo i mirë i nënave mund të prekë humorin dhe kënaqësinë e tyre nga jeta, duke rezultuar në mireqënie të varfër psikologjike, e cila ndikon në kahun tjetër në uljen e aftësive të nënës për t'u përballur pozitivisht me çrregullimet e sjelljes dhe të gjumit që shfaq fëmija. Sjelljet problematike të fëmijëve janë parashikues të fortë të nivelit të stresit të prindërve. Cilësia jo e mirë e gjumit të nënave parashikon nivele më të larta depresioni tek ato. Për nënat e fëmijëve me çrregullime zhvillimi gjumi i çrregullt i fëmijëve mund të ndikojë negativisht në aftësitë e tyre për t'u përshtatur me stresin që vjen nga kujdesi për fëmijën. Akoma më i madh është ky ndikim nëse fëmija shfaq çrregullime të ashpra të sjelljes (Chu & Richdale 2009).

Studime të tjera tregojnë se keqpërshtatja e prindërve lidhet më pak me karakteristikat e fëmijës e më shpesh me variabla si probleme në sigurimin e informacionit, të burimeve dhe suportit social (Green, 2007). Koncepti i suportit social është invokuar is një faktor domethënës në zbutjen e stresti të përjetuar nga familjes dhe rritjet e aftësive të përballimit të stresit nga familjet, duke ndikuar kështu edhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së familjeve (Truesdale & McConkey 2001). Megjithatë, shkalla e kërkimit të suportit social duket se është e ndikuar nga karakteristikat e fëmijës. Sipas Truesdale & McConkey (2001) suporti formal kërkohet më tepër nga prindërit e fëmijëve të cilëve shfaqnin më shumë sjellje keqpërshatëse dhe vështirësi në aftësitë motorike.

Suporti formal ndaj familjeve u mundëson anëtarëve të tyre të suportojnë njëri-tjetrin, u jep mbështetje atyre, dhe e ndihmon familjen të funksionojnë si një njësi e tërë . Studimet tregojnë se suporti ndaj familjes rrit cilësinë e jetës se saj, përmirëson jetën e personave me paaftësi dhe të familjeve të tyre (Turnbull et al. 2005).

Implikime të mirëqënies financiare dhe sociale

Kujdesi për fëmijët me çrregullime zhvillimi rrit barrën e shpenzimeve financiare për familjen si dhe kohën që shpenzohet duke u kujdesur për ta (Krenawi et al, 2011; Einfeld et al, 2010). Koha e shpenzuar për t'iu përgjigjur nevojave të veçanta të fëmijës e që shpesh perceptohet nga familja si kohë që i rrëmbehet përfshirjes së saj në aktivitete të tjera apo që i hiqet kujdesit e vëmendjes për fëmijët e tjerë, mund të shpjegojë qëndrimet zemërake, jo komunikuese dhe grindjet mes anëtarëve të familjes (Krenawi et al 2011). Po kështu, Lin dhe kolegët (2009) gjetën se të niveli i të ardhurave të familjes lidhet në mënyrë domethënëse me të katër fushat e cilesisë së jetës të matur nga WHOQOL.

Në një stdudim të kryer nga Murphy dhe kolegët (2007) 41% e prindërve të cilët kujdeseshin për një fëmijë me çrregullime, raportonin se shëndeti i tyre ishte përkeqësuar përgjatë vitit të fundit, dhe ia atribuonin këto përkeqësime kohës së pamjaftueshme për të bërë gjëra të tjera, limitimit të mundësive për të ndjekur interesa jashtë shtëpisë, mungesës së kontrollit dhe rënies së energjisë psikosociale.

Einfeld et al (2010) studiuan 109 familje të fëmijëve me paaftësi intelektuale, me qëllim ekzaminimin e shpenzimeve të tyre, nëse këto të fundit pësonin rritje nën ndikimin e problemeve sjellore e emocionale të fëmijëve me paaftësi intelektuale përgjatë një periudhe 6 mujore. Shpenzimet e familjeve u operacionalizuan në kosto financiare (shpenzime lodra, ushqime të caktuara, mobilje, apo objekte të tjerë të rëndësishëm për fëmijën, kosto për kujdesin ndaj fëmijës , mjekim, transport etj) dhe koston në mundësi (përfshin kohën që shpenzohet në familje për t'u kujdesur për fëmijën me çrregullime zhvillimi). Kjo e fundit u përllogarit duke kombinuar pagesën mesatare të prindërve për një orë punë, dhe orët e kaluara mesatarisht gjatë javës duke u kujdesur për fëmijën. Nga studimi rezultoi se përgjatë një periudhe 6 mujore një familje mesatare shpenzonte afërsisht 10.250 $ për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës. Shpenzimet më të larta në para shkonin për edukimin special apo punësimin e një personi ndihmues në shtëpi. Kostoja e mundësive shkonte mesatarisht në 41.332 & për një familje. Gjetjet e studimit treguan se problemet emocionale dhe sjellore të fëmijës me paaftësi intelektuale shoqërohen me ngritje të shpenzimeve financiare, me ngritje të kostove në mundësi dhe ngritje të kostos në total për familjen. Sjelljet egocentrike të fëmijëve rezultuan parashikuesit më të fortë të shpenzimeve të familjes, ndjekur këto nga problemet në komunikim, dhe çrregullimet e sjelljes. Duket se në moshat më të vogla të fëmijëve dhe në rastet me të ashpra të çrregullimeve të zhvillimit , kostot janë pak më të larta për familjen.

Përmbledhtazi do të thoshim se sjelljet sfiduese, problemet në komunikim, mosha e vogël e fëmijëve dhe ashpërsia e çrregullimit janë parashikuesit më të fortë e domethënës të rritjes së shpenzimeve për familjen.

Cilësia e jetës dhe variablat demografikë

Studimet kanë hulumtuar gjithashtu mbi lidhjet e mundshme mes variablave demografikë të prindërve (moshë, edukim, të ardhura, status civil, status punësimi) dhe cilësisë së jetës së prindërve, ku variablat demografikë janë trajtuar si variabla moderatorë. Hayden & Heller (1997) gjetën se prindërit e rinj, krahasuar me ata më të vjetër , raportonin më shumë nevoja të paplotësuara e nivele më të larta stresi, se sa prindërit më të vjetër. Por studimet janë kontradiktore në këtë pjese. Ndërsa Resch et al (2012) nuk gjetën lidhje domethënëse mes variablave demografikë të prindërve (mosha, edukimi, të ardhurat, punësimi) dhe mirëqënies psikologjike, Krenawi , Graham, & Gharaibeh, (2011) sugjerojnë se niveli i edukimit të prindërve lidhet negativisht me peshën e përkudesjes për fëmijën me çrregullime zhvillimi dhe pozitivisht me sensin e koherencës në familje. Meqënëse pesha e madhe e përkujdesjes është lidhur negativisht me cilësine e jetës së prindërve dhe sensi i koherencës në familje është lidhur pozitivisht me cilësinë e jetës, mund të sugjerohet se edukimi mund të jetë një variabël moderator në cilësinë e jetës së prindërve. Sipas Lin, et al (2009) nuk ekziston ndonjë lidhje domethënëse mes statusit martesor, moshës e besimit fetar të prindërve dhe fushave të ndryshme të cilësisë së jetës së prindërve.

Përfshirja e baballarëve

Pergjithësisht janë nënat ato që janë më të përfshira e marrin më tepër përgjegjësi në përkujdesjen për fëmijën me çrregullime (Cohen & Petrescu-Prahova, 2006; Schilling, Schinke, & Kirkham, 1985). Studimet sugjerojnë se përfshirja e baballarëve në përkujdesjen për fëmijën me çrregullime është shumë i rëndësishëm për cilësinë e jetës së familjes (McConnell, Futris, & Bartholomae, 2008). McConnell et al (2208) gjetën se nënat e lidhnin përjetimin e simptomave të tyre depresive me sjelljet problematike të fëmijës, me pakënaqësinë nga përfshirja e baballarëve në përkujdesje, dhe me konfliktet në çift. Analiza multivariate e variablave tregoi se kënaqësia e nënës nga përfshirja e bashkëshortit në kujdesin për fëmijën, shërbente si mediator mes sjelljeve keqpërshtatëse të fëmijës dhe simptomave depresive të nënës, duke e ulur këtë të fundit. Nënat tentonin t'i peceptonin problemet sjellore të fëmijëve të tyre si me më pak ndikim në stresin e tyre kur ato ishin më të kënaqura me përfshirjen dhe prindërimin e bashkëshortëve të tyre. Kënaqësia e nënës me përfshirjen e babait lidhet negativisht me përjetimin e simptomave depresive të nënave dhe pozitivisht me konfliktin mes prindërve. Akoma më tej, konflikti mes prindërve ndërhyn në marrëdhënien mes sjelljeve keqpërshtatëse të fëmijëve dhe kënaqësisë së nënave nga përfshirja e bashkëshortëve me e simptomat e tyre depressive. Nënat më pak të kënaqura me prindërimin e bashkëshortëve të tyre, raportonin konflikte më të shpeshta me ta. Kur nënat perceptojnë se fëmijët e tyre po shfaqin më shumë sjellje keqpërshatëse, tentojnë të jenë më të pakënaqura me përfshirjen e bashkëshortëve të tyre e të kenë më shume konfliktë në çift (McConnell et. al 2008).

Mënyra si funksionon familja është një faktor mjaft i rëndësishëm për kënaqësinë që përceptojnë anëtarët e saj nga jeta në familje, si dhe për cilësinë e jetës së tyre. Johnson et al (2011) gjetën se mospërputhjet mes pritshmërive për funksionimin e familjes dhe nivelit aktual të funksionimit të saj ishin më të larta tek nënat sesa tek baballarët. Kur bëhej fjalë për stresin nga jeta familjare e sociale, mospërputhjet mes pritshmërive dhe funksionimit të familjes, shërbenin si mediatorë në marrëdhënien mes stresit dhe problemeve të shëndetit mendor që prindërit shfaqnin.

Diskutim

Qëllimi i këtij studimi ishtë të hetohej sesi preket cilësia e jetës së familjes gjatë rritjes së një fëmije me çrregullime të zhvillimit, si dhe evidentimi i variablave të cilët shërbejnë si parashikuesit më domethënës të problemeve në fushën e mirëqënies fizike, psikologjike, sociale e financiare të familjes. Për këtë arsye u shqyrtuan dhjetë studime të realizuara në familjet e fëmijëve me çrregullime zhvillimi. Familja, e cila është njësia bazë e shoqërisë, mbart përgjëgjësi shumë të mëdha përkujdesjeje për anëtarët e vetë me çrregullime. Prindërit përballen me një sërë sfidash si pasojë e përgjegjësive dhe vështirësive që hasin gjatë kujdesit për fëmijën me çrregullime. Si rrjedhojë ata janë më të ekspozuar ndaj rrezikut për t'u prekur nga stresi, i cili prek jo vetëm mirëqënien e tyre por edhe të gjithë familjes si një njësi. Studimet tregojnë se familjet e fëmijëve me çrregullime zhvillimi paraqesin një gamë shumë të gjerë nevojash.

Gjetjet e studimeve sugjerojnë se mesatarja e cilësisë së jetës së prindërve të fëmijëve me çrregullime është më të ulët se ajo e prindërve të fëmijëve me zhvillim tipik, dhe kjo, mundësisht si pasojë e kombinimit të një sërë faktorësh të tillë si stresi, shëndeti, vështirësitë financiare e sociale. Gjetje të tilla duhet të merren në konsideratë gjatë ndërtimit të politikave që synojnë sigurimin e suportit dhe ndërhyrjeve për prindërit. Është e rëndësishme t'i sigurohet suport gjithë familjes, dhe jo vetëm fëmijës me çrregullime. Për këtë arsye lind nevoja e realizimit të studimeve ne kontekstin shqiptar, për identifikimin e nevoja të familjeve dhe fushave ku ndërhyrja e profesionistëve për t'i siguruar suport familjes është më emergjente.

Tabela 1.

Detaje të studimit/ autorë, qëllimi I studimit	**Grup mosha**	**Crreg ullimi**	**Inform antët**	**Gjetjet e studimit**	**Nr total I pjesëmarrë sve**
Einfeld, et al. (2010). Studimi I lidhjes mes sjelljeve të vështira dhe kostos së kujdesit për fëmijët me paaftësi intelektuale (dizenjim sasior)	Fëmijë	Paaftësi intelektu ale	Njëri nga prindërit	Mosha e vogël e fëmjëve, crregullimet emocionale dhe sjellore të fëmijës me paaftësi intelektuale u lidhën me kosto të lartë kujdesi për familjen.	109
Chu, et al (2009). Studimi I impaktit të crregullimeve të gjumit dhe sjelljes së fëmijëve me crregullime zhvillimi në cilësinë e gjumit të nënave dhe mirëqënien e tyre psikologjike (dizenjim sasior)	Fëmijë	Crregulli me zhvillimi	Nëna	Problemet e gjumit dhe të sjelljes lidhen në mënyrë sinjifikative me probleme të gjumit, depresion, ankth dhe stres me te larte tekn nënat. Shqetësimet e gjumit tek nënat shërbenin si parashikues të mirëqënies së varfër psikologjike të tyre.	46
Lin, et al (2009). Ekzaminimi I cilësisë së jetës së prindërve të fëmijëve/adoleshentë ve me paaftësi intelektuale, si dhe faktorëve kontribues në cilësine e jetes së tyre	Fëmijëve/ adoleshent ë	Paaftësi intelektu ale	Nëna /baballarë	Mesatarja e pikëve për të secilën nga fushat e cilësisë së jetës rezulton të jetë më e ulët se pjesa tjetër e popullatës. vetëperceptimi i prindërve mbi gjendjen e tyre shëndetësore, të ardhurat në familje, dhe stresi i lidhur me suportin familjar të pamjaftueshëm korrelonin me të katër fushat e vlerësuara të cilësisë së jetës.	597

Resch, et al (2012). Hulumtimi I faktorëve që lidhen me simptomat depresive tek prindërit (dizenjim sasior)	Fëmijë	Crregulli me zhvillimi	Njëri nga prindërit	Analizat regressive treguan se kognicionet negative të prindërve, shëndeti fizik jo I mirë I tyre, dhe kënaqësia e ulët në familje korrelonin në mënyrë sinjifikative me depresionin.	110
Kring, et al (2008). Hulumtimi I lidhjes mes karakteristikave të adoleshentëve dhe të të rriturve me crregullim të spektrtit të autizmit, dhe mirëqënies së nënave	Adoleshentë/ të rritur	Crregullim I spektrit të autizmit	Nëna	Ashpërsia e crregullimit lidhet me një peshë më të madhe kujdesi nga nënat, nivel më të lartë stresi dhe cilësi më të varfër marrëdhënieje prind-fëmijë	273
McConnell, et al (2008). Si ndikojnë sjelljet keqpërshtatëse të fëmijëve, përfshirja e baballarëve, dhe konfliktet në cift në mirëqënien psikologjike të nënave	Fëmijë	Paaftësi fizike	Nëna	Nënat I peceptojnë problemet sjellore të fëmijëve të tyre si me më pak ndikim në stresin e tyre kur ishin më të kënaqura me përfshirjen dhe prindërimin e bashkëshortëve të tyre	60
Truesdale, M. & McConkey, R. (2001). Si ndikojnë problemet sjellore të fëmijëve në shëndetin fizik e psikologjik të prindërve, si dhe roli i suportit të shërbimeve profesioniste në mirëqënien e prindërve. (dizenjim sasior)	Fëmijë & adoleshentë	Crregulli me të shmëfishta	Njëri nga prindërit	Stresi i prindërve lidhet me shëndetin fizik jo të mirë, i cilin në anën tjetër u lidh me vështirësitë në sjelljet motorike të fëmiëve, me sjelljet problematike. Familjet më të stresuara dhe me shëndet jo të mirë, ishin ato që kërkonin më shumë suport informal.	68
Krenawi , et al (2011). Roli i paaftësisë intelektuale të fëmijës në stresin, funksionimin e familjes, cilësinë e martesës dhe sensin e koherencës në familje. (dizenjim sasior)	Fëmijë	Paaftësi intelektuale	nëna ose baballarë	Nga familjet e femijeve me paaftësi intelektuale u raportua me teper funksionim problematik i familjes, më pak kënaqësi nga martesa, më tepër stres dhe sens më i ulët koherence në familje, krahasuar me familjet e fëmijëve me zhvilllim tipik. diferenca kishte në varësi të moshës së prindërve, statusit martesor, dhe numrit të fëmijëve me paaftësi.	300 prinder të fëmijëve me crregullime zhvillmi dhe 100 prindër të fëmijëve me zhvillim tipik

Johnson, N., Frenn, M., Feetham, S., Simpson, P. (2011), eksplorimi I marrëdhënies mes stresit të prindërve e funksionimit të familjes dhe cilësisë së jetës të lidhur me shëndetin mendor e fizik. (dizenjim sasior)	Fëmijë dhe adoleshentë	Crregullim i spektrit të autizmit	Nëna dhe baballarë në cift	Stresi i lartë tek nënat sesa tek baballaret, I cili u lidh me probleme me shëndetin fizik. Rezultoi mospërputhje mes pritshmërive të nënave &baballërëve dhe funksionimit aktual të familjes, dhe të gjitha këto parashikuan vështirësi të shëndetit mendor.	64
Wang & Brown, (2013), konceptualizimi I cilësisë së jetës së familjeve dhe krijimi I një strukture konceptuale bazuar në kërkimet në familjet e fëmijëve me crregullime zhvillimi (shqyrtim literature)	__	Crregullime zhvillimi	___	Rendesia e trajtimit te konceptit ne literature ka ardhur ne rritje. Suporti profesional ndaj familjes rrit cilësinë e jetës se familjeve, përmirëson jetën e personave me paaftësi dhe të familjeve të tyre.	__

Referenca

Abbeduto, L., Seltzer, M. M., Shattuck, P., Krauss, M. W., Osmond, G., & Murphy, M. M. (2004). Psychological well-being and coping in mothers of youths with autism, Down syndrome, or fragile X syndrome. *American Journal on Mental Retardation*, *109*, 237–254.

Chu, J. & Richdale, A. L. (2009). Sleep quality and psychological wellbeing in mothers of children with developmental disabilities. *Research in Developmental Disabilities,* 30, 1512–1522 doi:10.1016/j.ridd.2009.07.007.

Cohen, P. N. and Petrescu-Prahova, M. (2006), Gendered Living Arrangements Among Children With Disabilities. Journal of Marriage and Family, 68: 630–638. doi: 10.1111/j.1741-3737.2006.00279.x

Einfeld, S. L., Ellis, L. A. , Doran, C. .M. , Emerson, E., Horstead, S. K., Madden, R. H., & Tonge, B. J. (2010). Behavior Problems Increase Costs of Care of Children With Intellectual Disabilities. *Journal of Mental Health Research in Intellectual Disabilities*, 3(4) 202-209. DOI:10.1080/19315864.2010.524973

Essex, E. L., Seltzer, M. M., & Krauss, M. W. (1999). Differences in coping effectiveness and well-being among aging mothers and fathers of adults with retardation. *American Journal of Mental Retardation*, 104(6), 545–563.

Glidden, L. M. & Schoolcraft, S. A. (2003). Depression: Its trajectory and correlates in mothers rearing children with intellectual disability. *Journal of Intellectual Disability Research*, 47(4), 250_263.

Green, S. E. (2007). "We're tired, not sad": Benefits and burdens of mothering a child with a disability. *Social Science and Medicine,* Vol 64(1), Jan 2007, 150-163. doi:10.1016/j.socscimed.2006.08.025

Hayden, M. F., & Heller, T. (1997). Support, problem-solving=coping ability, and personal burden of younger and older caregivers of adults with mental retardation. *Mental Retardation*, 35, 364–372.

Hsiao, K. H., & Nixon, G. M. (2008). The effect of treatment of obstructive sleep apnea on quality of life in children with cerebral palsy. *Research in Development Disabilities*, 29, 133–140.

Johnson, N., Frenn, M., Feetham, S., Simpson, P. (2011), Autism Spectrum Disorder:

Parenting Stress, Family Functioning and Health-Related Quality of Life. *Families, Systems, & Health* 29; 3, 232–252, DOI: 10.1037/a0025341

Krenawi , A. A., Graham, J. R., & Gharaibeh, F. A. (2011). The impact of intellectual disability, caregiver burden, family functioning, marital quality, and sense of coherence. *Disability & Society*, 26:2, 139-150, DOI: 10.1080/09687599.2011.543861.

Kring, S. R., Greenberg, J. S., & Seltzer, M. M., (2008). Adolescents and Adults with Autism with and without Co-morbid Psychiatric Disorders: Differences in Maternal Well-Being, Journal of Mental Health Research in Intellectual Disabilities, 1:2, 53-74, DOI: 10.1080/19315860801988228.

Lin, J. D., Hua, J., Yen, C. F., Hsu, S. W., Lin, L. P., Loh, C. H., Chen, M. H., Wuf, S. R., Chu, C. M., Wue, J. L. (2009). Quality of life in caregivers of children and adolescents with intellectual disabilities: Use of WHOQOL-BREF survey. *Research in Devconelopmental Disabilities* 30, 1448–1458, doi:10.1016/j.ridd.2009.07.005

McConnell, A. D., Futris, T. G., & Bartholomae, S. (2008) Mothers of Children With Physical Disabilities: Influence of Family Processes on Mothers' Depressive Symptomatology. *Marriage & Family Review*, 45:1, 68-83, DOI: 10.1080/01494920802537522.

McLinden, S. E. (1990). Mothers' and fathers' reports of the effects of a young child with special needs on the family. *Journal of Early Intervention*, 14(3), 249_259.

Murphy, N.A., B. Christian, D.A. Caplin, and P.C. Young. 2007. The health of caregivers for children with disabilities: Caregiver perspectives. *Child: Care, Health & Development* 33(2), 180–7.

Poston, D., Turnbull, A., Park, J., Mannan, H., Marquis, J., & Wang, M. (2003). Family quality of life: A qualitative inquiry. *Mental Retardation*, 41(5), 313–328.

Resch, J. A., Elliott, T. R., & Benz, M. R. (2012). Depression Among Parents of Children With Disabilities. *Families, Systems, & Health. Advance online publication*. 30(4), 291–301, doi: 10.1037/a0030366.

Richdale, A., Francis, A., Gavidia-Payne, S., & Cotton, S. (2000). Stress, behaviour, and sleep problems in children with an intellectual disability. *Journal of Intellectual & Developmental Disability*, 25, 147–161.

Schalock, R. L., Brown, I., Brown, R. I., Cummins, R. A., Felce, D., Matikka, L., et al. (2002). Conceptualization, measurement, and application of quality of life for persons with intellectual disabilities: Report of an international panel of experts. *Mental Retardation*, 40, 457–470.

Schilling, R. F., Schinke, S. P., & Kirkham, M. A. (1985). Coping with a handicapped child: Differences between mothers and fathers. *Social Sciences Medical*, 21(8),857_863. DOI:10.1016/0277-9536(85)90141-8

Truesdale, M. & McConkey, R. (2001) Parental health and stress in families with a child who has multiple disabilities, *Child Care in Practice*, 7:2, 141-152, DOI: 10.1080/13575270108415317

Turnbull, A., Turnbull, H. R., Agosta, J., Erwin, E., Fujiura, G., Singer, G., & Soodak, L. (2005). Support of families and family life across the lifespan. In C. Lakin & A. P. Turnbull (Eds.), National goals and research for persons with intellectual and developmental disabilities (pp. 217–256). Washington, DC: AAMR.

Uskul, A. K., & Greenglass, E. (2005). Psychological wellbeing in a Turkish–Canadian sample. *Anxiety, Stress and Coping*, 18, 269–278.

Wang, M. & Brown, R. (2009) Family Quality of Life: A Framework for Policy and Social Service Provisions to Support Families of Children With Disabilities, Journal of Family Social Work, 12:2, 144-167, DOI: 10.1080/10522150902874842.

Wiggs, L. and Stores, G. (2001), Behavioural treatment for sleep problems in children with severe intellectual disabilities and daytime challenging behaviour: Effect on mothers and fathers. *British Journal of Health Psychology*, 6: 257–269. doi: 10.1348/135910701169197

DISIPLINA E BASHKIMIT FAMILJAR PËR SHTETASIT E VENDEVE TË TRETA NË LEGJISLACIONIN E BASHKIMIT EUROPIAN

Author: Ervis Moçka; Sokol Bana

ervis.mocka@univlora.edu.al

Universiteti "Ismail Qemali"
Adresa: L. Pavarësia,
9400 Vlorë, Shqipëri

Nëpërmjet institutit të bashkimit familjar i lejohet një personi të caktuar ti bashkohen anëtarët e familjes së vet në territorin e një Shteti tjetër të ndryshëm nga ai nënshtetësisë. Nëpërmjet këtij mekanizmi krijohet një lloj mobiliteti i personave nga një Shtet në një tjetër i cili ka nevojë për një rregullim normativ specifik dhe të detajuar. Në Bashkimin Europian disiplina nuk rregullohet vetëm në një nivel normativ dhe ndryshon në varësi të kategorisë së subjekteve të interesuar. Më konkretisht ndryshon nëse personat e interesuar për tu bashkuar me familjarë në territorin e një Shteti tjetër nga ai i nënshtetësisë janë shtetas të një vendi anëtar të BE apo shtetas të një vendi të tretë jo anëtar i BE. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë disiplinimin e institutit të bashkimit familjar të parashikuar nga legjislacioni i Bashkimit Europian për shtetasit e vendeve të treta jo anëtare të BE.

1. Disiplina e bashkimit familjar në BE

Parimi i lëvizjes së lirë të personave u aplikohej në fillim jo të gjithë personave por vetëm shtetasve të një vendi anëtar që ishin në marrëdhënie pune në një vend tjetër anëtar të BE. Instituti i bashkimit familjar duke i dhënë mundësinë personit të punësuar në një vend anëtar të ndryshëm nga ai i origjinës që ti bashkohen familjarët, krijon një fenomen mobiliteti të personave nga një Shtet në një tjetër duke qenë kështu pjesë e kuadrit komunitar të qarkullimit të lirë të personave. Neni 39 Traktatit të Komunitetit europian (TKE) i cili përcaktonte lirinë e qarkullimit të punëtorëve nuk përcaktonte shprehimisht një të drejtë për bashkim familjar. Kjo e drejtë do të njihej nga burimet e prejardhura, konkretisht nga Rregullorja 1612/68[1] relative me lëvizjen e lirë të punëtorëve brenda territorit komunitar, e cila u njohu punëtorëve shtetas të një Shteti anëtar, të punësuar në një Shtet tjetër anëtar mundësin që tu bashkoheshin një kategori

[1] REGULATION (EEC) No 1612/68 OF THE COUNCIL of 15 October 1968 on freedom of movement for workers within the Community in *Official Journal L 257 , 19/10/1968 P. 0002 – 0012.*

familjarësh, pavarësisht nga shtetësia që kishin këta të fundit[2]. Siç vihet re e drejta e bashkimit familjar nuk u njihej të gjithë qytetarëve të Shteteve anëtare, por ka një natyrë funksionale në lidhje me qarkullimin e lirë të punëtorëve. Kjo e drejtë e strukturuar në këtë lloj mënyre u njihej vetëm qytetarëve të një vendi anëtar të cilët kishin ushtruar të drejtën e lëvizjes së lirë duke shkuar në një vend tjetër anëtar për tu punësuar. Nuk përfitonin nga normativa komunitare mbi të drejtën e bashkimit familjar qytetarët e një vendi anëtar të cilët nuk ishin larguar nga vendi origjinës, pasi siç është shprehur dhe Gjykata e Drejtësisë në disa vendime të saja[3], gjenden në një situatë e cila disiplinohet plotësisht nga juridiksioni i brendshëm i vendeve anëtare, pra në këtë rast është legjislacioni kombëtar mbi bashkimin familjar që do të aplikohet. Liria e qarkullimit do tu njihej familjarëve të punëtorëve edhe nga Direktiva nr. 72/194/KEE[4], liri kjo e cila me Direktivat e 90/365[5], 93/96[6], 90/364[7] do tu njihej në përgjithësi të gjithë qytetarëve të Shteteve anëtare.

---

[2] Neni 10 i Rregullores 1612/68 përcakton: "*1. The following shall, irrespective of their nationality, have the right to install themselves with a worker who is a national of one Member State and who is employed in the territory of another Member State: (a) his spouse and their descendants who are under the age of 21 years or are dependants; (b) dependent relatives in the ascending line of the worker and his spouse. 2. Member States shall facilitate the admission of any member of the family not coming within the provisions of paragraph 1 if dependent on the worker referred to above or living under his roof in the country whence he comes. 3. For the purposes of paragraphs 1 and 2, the worker must have available for his family housing considered as normal for national workers in the region where he is employed ; this provision, however must not give rise to discrimination between national workers and workers from the other Member States*".

[3] Shih Vendimet: *Moser* i 28 qershorit 1984, çwshtja 180/83 nw *European Court reports* 1984, fq. 2539; *Iorio,* çwshtja 298/84, nw *European Court reports* 1986, fq. 247; *Morais*, çwshtja C-60/91, nw *European Court reports* 1992, fq. 285; *Morson* dhe *Jhanjan*, çwshtjet e bashkuara 35/82 dhe 36/82, nw *European Court reports* 1982, fq. 3723.

[4] COUNCIL DIRECTIVE of 18 May 1972 extending to workers exercising the right to remain in the territory of a Member State after having been employed in that State the scope of the Directive of 25 February 1964 on coordination of special measures concerning the movement and residence of foreign nationals which are justified on grounds of public policy, public security or public health (72/194/EEC), in *Official Journal n. L 121 del 26/05/1972 pag. 0032 – 0032.*

[5] Council Directive 90/365/EEC of 28 June 1990 on the right of residence for employees and self-employed persons who have ceased their occupational activity, in *Official Journal L 180, 13/07/1990, p. 28–29.*

[6] Council Directive 93/96/EEC of 29 October 1993 on the right of residence for students, në *Official Journal L 317, 18.02.1993*.

[7] Council Directive 90/364/EEC of 28 June 1990 on the right of residence**,** në *Official Journal L 180, 13/07/1990, p. 26–27.*

1.1 Qytetaria europiane dhe lëvizja e lirë.

Në 1992 me Traktatin e Maastricht themelohet Bashkimi europian, i cili shënonte "*a new stage in the process of creating an ever closer union among the peoples of Europe...*"[8]. Si shprehje e këtij bashkimi më të madh Traktati ndërton "qytetarin europiane" (neni 17 TKE), e cila i përket çdo personi i cili është shtetas i një vendi anëtar të BE; kështu që kjo qytetari është komplementare e shtetësisë kombëtare dhe nuk e zëvendëson atë. Statusi i qytetarisë europiane sjell dhe një sërë të drejtash të njohura drejtpërsëdrejti nga Traktati (nenet 17-22 TKE pas Lisbonës 9-11 TBE dhe 20-25 TFBE), ndër të cilat të drejtën për të lëvizur dhe qëndruar lirisht në territorin e vendeve anëtare për çdo person që posedon shtetësinë europiane (neni 20 TFBE). Qytetaria e Bashkimit europian nëse nga njëra anë u njeh te drejtën për të lëvizur lirisht dhe qëndruar në territorin e çdo vendi anëtar, nga ana tjetër nuk zgjidhte problemin e bashkimit familjar për shtetasit e një vendi anëtar të cilët nuk kishin përfituar nga e drejta e lëvizjes së lirë dhe e qëndrimit, familjarët e të cilëve ishin shtetas të një vendi jo anëtar të BE. Këta nuk përfitonin nga normativa komunitare por kjo situatë vazhdonte të disiplinohej nga normativa e brendshme e çdo Shteti anëtar. Kjo do të konfirmohet dhe në vendimin *Uecker and Jacquet*[9] e Gjykatës së Drejtësisë e cila do të shprehej se "*qytetaria europiane nuk ka si qëllim të zgjerojë sferën e aplikimit ratione materia të Traktatit edhe për situatat kombëtare të cilat nuk kanë asnjë lidhje me të drejtën komunitare...*". Gjykata gjithashtu theksoi se në rastin kur bashkëshorti është shtetas i një vendi jo anëtar i BE mund të përfitojë nga e drejta e bashkimit familjar të njohur nga neni 11 i Rregullores 1612/68 vetëm nëse shtetasi i një vendi anëtar është punëtor në territorin e një vendi të ndryshëm nga ai i origjinës. Pra siç vihet re dallojmë tre kategori të ndryshme të cilët u aplikohen normativa të ndryshme mbi bashkimin familjar: në kategorinë e parë bëjnë pjesë shtetasit e vendeve anëtare të BE të cilët punojnë në një vend të ndryshëm nga ai i origjinës, familjarët e të cilëve përfitojnë në këtë mënyrë nga normativa komunitare mbi bashkimin familjar. Në kategorinë e dytë bëjnë pjesë shtetasit e vendeve anëtare por të cilët nuk kanë ushtruar të drejtën e lëvizjes apo qëndrimit në një vend tjetër të ndryshëm nga ai i origjinës, ndaj këtyre do të aplikohet normativa kombëtare mbi bashkimin familjar. Në kategorinë e tretë bëjnë pjesë shtetasit e vendeve të treta jo anëtare të BE, dhe këtyre do tu aplikohet legjislacioni i Shtetit anëtare në të cilët qëndrojnë pasi nuk përfitojnë nga normativa komunitare sepse politikat e imigracionit do të fillojnë të bëhen pjesë e rregullimit komunitar vetëm pas Traktatit të Amsterdamit i cili do të fusë Titullin IV "Vizat, azili, imigracioni dhe politika të tjera në lidhje me lëvizjen e lirë" si dhe do të integrojë në të drejtën komunitare të gjithë *acquis*

---

[8] Teksti plotë i Traktatit në: http://www.eurotreaties.com/maastrichteu.pdf

[9] Judgment of the Court of 5 June 1997 in joined cases C-64/96 and C-65/96 - Land Nordrhein-Westfalen v Kari Uecker and Vera Jacquet v Land Nordrhein-Westfalen in *European Court reports 1997 Page I-03171.*

Schengen. Siç dhe vihet re ka një lloj diskriminimi në kah të kundërt midis shtetasve të një vendi anëtar të BE, kjo pasi një shtetas i një vendi anëtar i cili ushtron të drejtën e lëvizjes së lirë dhe punësohet dhe qëndron në një vend tjetër anëtar të ndryshëm nga ai i origjinës, përfiton nga normativa komunitare e bashkimit familjar e cila i njeh të drejtën ti bashkohen familjarët pavarësisht shtetësisë që kanë domethënë dhe nëse kanë shtetësinë e një vendi jo anëtar të BE. Siç është shprehur Gjykata e drejtësisë në një vendim të saj[10] përfiton nga normativa komunitare dhe një shtetas i një vendi anëtar i cili është punësuar në një vend anëtar të ndryshëm nga ai i origjinës dhe më pas është kthyer në vendin e origjinës, ndërkohë që një shtetas i po të njëjtit vend anëtar i cili nuk ka ushtruar asnjëherë të drejtën e lëvizjes së lirë apo qëndrimit në një vend tjetër anëtar nuk do të përfitoj nga normativa komunitare por ndaj tij do të aplikohet normativa kombëtare.

1.2 Harmonizimi i disiplinës.

Disiplina mbi qarkullimin e lirë të personave përfshi këtu dhe tematikën e bashkimit familjar do të ndryshojë, duke kaluar nga një kuadër normativ sektorial dhe i fragmentarizuar në një legjislacion të qartë, nëpërmjet Direktivës 2004/38/KE[11] mbi të drejtën e qytetarëve të BE dhe të familjarëve të tyre për të qarkulluar lirisht në territorin e Shteteve anëtare dhe Direktivës 2003/86/KE[12] mbi të drejtën e bashkimit familjar. Qëllimi i Direktivës nr. 2004/38 është trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve komunitarë duke përafruar statusin e tyre juridik në vendet anëtare, pavarësisht faktit nëse ushtrojnë një aktivitet ekonomik apo jo. Direktiva në fjalë modifikon dhe zëvendëson gjithë aktet komunitare të sipërpërmendur që disiplinonin në mënyrë të fragmentarizuar të drejtën e qarkullimit dhe qëndrimit duke përmbledhur në një akt të vetëm kategoritë e ndryshme të përfituesve të këtyre të drejtave. Duke përgjithësuar të drejtën e qarkullimit dhe qëndrimit për të gjithë qytetarët e Unionit në këtë mënyrë përcakton dhe një shtrirje të së drejtës për tu bashkuar me familjarët në territorin e një vendi anëtar të ndryshëm nga ai i origjinës për të gjithë qytetarët e Unionit. Direktiva nr. 2003/86 disiplinon bashkimin familjar për personat që nuk janë qytetarë të Bashkimit europian. Qëllimi kësaj direktive është të ofrojë një trajtim të

---

[10] Judgment of the Court of 7 July 1992 The Queen v Immigration Appeal Tribunal and Surinder Singh, ex parte Secretary of State for Home Department, Case C-370/90, in *European Court reports 1992 Page I-04265.*

[11] Council Directive 2004/38/EC of the European Parliament and of the Council of 29 April 2004 on the right of citizens of the Union and their family members to move and reside freely within the territory of the Member States amending Regulation (EEC) No 1612/68 and repealing Directives 64/221/EEC, 68/360/EEC, 72/194/EEC, 73/148/EEC, 75/34/EEC, 75/35/EEC, 90/364/EEC, 90/365/EEC and 93/96/EEC in *Official Journal of European Union L 158/77.*

[12] Council Directive 2003/86/EC of 22 September 2003 on the right to family reunification in *Official Journal of European Union L 251/12, 03/10/2003.*

drejtë (equo) për shtetasit e vendeve të treta jo anëtare të BE të cilët janë rezident të ligjshëm në territorin e vendeve anëtare, duke ditur se "një politikë më energjike në fushën e integrimit do tu ofrojë të drejta dhe detyrime të krahasueshme me ato të qytetarëve të Be. Për këtë qëllim "bashkimi familjar është një mjet i nevojshëm për të lejuar një jetën familjare". Disiplina e bashkimit familjar lidhet drejtpërdrejtë me sektorin e imigracionit të rregulluar nga Titulli V i Traktatit mbi funksionimin e Bashkimit europian (TFBE) dhe veçanërisht nga Kreun 2 (nenet 77-80 TFUE) titulluar: Politikat në lidhje me kontrollin e kufijve, azilit dhe imigracionit. Masat e parashikuara nga Kreu 2 janë të nevojshme për objektivin specifik të përcaktuar nga Traktati mbi Bashkimin europian (TBE) në nenin 3 siç është ai i realizimit të një "*...area of freedom, security and justice without internal frontiers, in which the free movement of persons is ensured in conjunction with appropriate measures with respect to external border controls, asylum, immigration and the prevention and combating of crime*". Siç dhe kemi theksuar me lartë disiplina e imigracionit do të pësonte një revolucion me Traktatin e Amsterdamit i cili do të njihte kompetencën komunitare në këtë disiplinë dhe do të përcaktonte objektiva të qartë për Komunitetin si dhe do ti caktonte këtij të fundit fuqitë e nevojshme për arritjen e këtyre objektivave. Për realizimin e objektivit të vendosur në përfundimet e Samitit të Tamperes së 15-16 tetorit 1999 në të cilin palët angazhoheshin se: "*The European Union must ensure fair treatment of third country nationals ëho reside legally on the territory of its Member States. A more vigorous integration policy should aim at granting them rights and obligations comparable to those of EU citizens. It should also enhance non-discrimination..*"[13], Komisioni në propozimin e parë të Direktivës[14] mbi bashkimin familjar në 1 dhejtor 1999 mendonte si të nevojshëm njohjen e të drejtës së bashkimit familjar për shtetasit e vendeve jo komunitare që ishin rezident të ligjshëm në një nga vendet anëtare. Me anë të kësaj Direktive, Komisioni nëpërmjet harmonizimit të legjislacioneve kombëtare në disiplinën e imigracionit kërkonte që nga njëra anë të garantonte që shtetasit e vendeve të treta të gëzonin kushte të njëjta për sa i përket bashkimit familjar, pavarësisht vendit anëtar në të cilin ishin pranuar të qëndronin dhe nga ana tjetër të zvogëlonte mundësinë që zgjedhja e vendit anëtar se ku do të qëndronte nga ana e shtetasit të vendit të tretë të bazohej nga prezenca më e mirë e kushteve të bashkimit familjar[15]. Ky propozim hasi vështirësi në miratim nga ana e Këshillit. Tema e bashkimit familjar do të rikthehej në qendër të diskutimeve në Samitin e Laken në përfundimet e të cilit theksohet se bashkimi familjar është një element i rëndësishëm i politikës së

---

[13] PRESIDENCY Conclusions, Tampere european council 15 and 16 october 1999, në http://www.europarl.europa.eu/summits/tam_en.htm

[14] COM (99) 368, në *Official Journal C 116* e 26 prillit 2000.

[15] GUILD E., *Implementing Amsterdam: Immigration and Asylum rights in EC law*, Oxford, Portland, Oregon, 2001, fq. 241 vazhdim.

përbashkët mbi imigracionin[16]. Në linjë me këto përfundime Komisioni adopton në 2 maj 2002 një propozim tjetër Direktive mbi bashkimin familjar të shtetasve të vendeve të treta të cilët janë rezident të ligjshëm në një prej vendeve anëtare të BE. Direktiva 2003/86 është miratuar më 22 shtator 2003. Direktiva tenton të harmonizojë legjislacionet kombëtare duke garantuar të drejtën në fjalë. Ajo realizon një tutelë të unitetit të familjes jo vetëm si një e drejtë themelore por, edhe si faktor promotor i qëndrueshmërisë socio-kulturore të emigrantëve dhe të integrimit të tyre në shtresat sociale të shtetit pritës[17]. Direktiva njeh ekzistencën e një të drejte të bashkimit familjar. Direktiva parashikon, në veçanti, që një shtetas i një shteti të tretë i cili jeton ligjërisht në Bashkimin evropian disponon, në parim, të drejtën që shteti anëtar pritës ti lejojë fëmijëve të tij të bashkohen me të në shtetin pritës në kuadrin e bashkimit familjar. Por, direktiva i lejon shteteve anëtare të zbatojnë, në prani të disa rrethanave, një normativë kombëtare që kufizon rregullat e parimit. Në këtë kuptim, kur një fëmijë me moshë më të madhe se 12 vjeç mbërrin në shtetin pritës pavarësisht nga pjesa tjetër e familjes së tij, shteti anëtar, para se të autorizojë hyrjen dhe qëndrimin, mund të shqyrtojë nëse i mituri i përgjigjet kritereve të integrimit të parashikuara nga normativa kombëtare. Shtetet anëtare mund të kërkojnë që kërkesat në lidhje me bashkimin familjar të fëmijëve të mitur të paraqiten para se këta të arrijnë moshën 15 vjeç, në përputhje me dispozitat e normativës së tyre në fuqi në datën e zbatimit të direktivës (2006). Direktiva parashikon, gjithashtu, që shtetet anëtare mund të kërkojnë që personi me qëndrim të rregullt, para se të bashkohet me familjarët e tij të ketë qëndruar ligjërisht në territorin e tyre për një periudhë të caktuar, sidoqoftë jo më të lartë se dy vjet. Së fundmi, një shtet anëtar mund të vendosë një periudhë pritje jo më të gjatë se tre vjet nga momenti i depozitimit të kërkesës për bashkim familjar dhe dhënien e lejes së qëndrimit për familjarët në fjalë, nëse normativa në këtë fushë përdor si kriter aftësinë pritëse të vetë shtetit. Parlamenti evropian, duke i gjykuar këto dispozita në kundërshtim me të drejtat themelore, në veçanti, me të drejtën e

---

[16] PRESIDENCY ConclusionS, Laeken european Council 14-15 dhjetor 2001, ne http://ec.europa.eu/smartregulation/impact/background/docs/laeken_concl_en.pdf

[17] Shih konsiderimin e tretë të direktivës në të cilën pohon se: "*Këshilli evropian i Tampere-s ka njohur se [….] Bashkimi Evropian duhet të garantojë një trajtim të barabartë për shtetasit e shteteve të treta që jetojnë ligjërisht në territorin e shteteve anëtare dhe se një politikë më energjike në fushën e integrimit duhet të propozojë ofrimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre të krahasueshme me ato të shtetasve të Bashkimit evropian* …" dhe konsiderimi i katërt në të cilin specifikohet se: "*Bashkimi familjar është një instrument i nevojshëm për të lejuar jetën familjare. Ai kontribuon në krijimin e një stabiliteti socio-kulturor që lehtëson integrimin e shtetasve të shteteve të treta në shtetet anëtare, duke i lejuar nga ana tjetër të promovojë kohezionin ekonomike dhe sociale, objektiv themelor i Komunitetit, i deklaruar nga traktati*". R. Cholewinsky, *Family reunification and conditions placed on family members: Dismalting a foundamental right*, faqe 278 e vijuese.

respektimit të jetës familjare dhe të drejtës së mos diskriminimit, ka propozuar apelin për anulim në Gjykatën e drejtësisë, e cila e refuzoi atë. Gjykata ka deklaruar përputhshmërinë si me parimin e respektimit të jetës familjare të sanksionuar me nenin 8 CEDU dhe me traktate të tjera Direktiva 2003/68, pra në disiplinën e bashkimit familjar për shtetasit e një shteti të tretë i cili jeton ligjërisht në BE.

2. Disiplina e bashkimit familjar për shtetasit e vendeve të treta

Është jashtë interesit të punimit tonë analiza në detaje e direktivës 2004/38 e cila disiplinon bashkimin familjar për qytetarët e BE, ndaj do të përqëndrohemi vetëm te disiplina e bashkimit familjar e rregulluar nga Direktiva 2003/68.

2.1 Sfera e aplikimit *ratione personae*. E drejta e bashkimit familjar sipas Direktivës 2003/68 u rezervohet shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë ligjërisht në një shtet anëtar të BE dhe posedojnë një leje qëndrimi jo më të ulët se një vjeçare, pavarësisht nga arsyeja e qëndrimit[18]. Për sa i përket bashkimit familjar të personave të cilët posedojnë një leje qëndrimi me afat më të vogël se një vit, kjo e drejtë mbetet në diskrecion të shteteve anëtare[19]. Direktiva u aplikohet gjithashtu refugjatëve, të njohur nga shtetet anëtare sipas parashikimeve të Konventës së Gjenevës , mbi statusin e refugjatit, por nuk u aplikohet azilkërkuesve dhe përfituesve të mbrojtjes së përkohshme. Në bazë të nenit 2.a me termin "shtetas i një vendi të tretë" përcaktohet cilido i cili nuk është qytetar i BE sipas përkufizimit që parashikon neni 17 i Traktatit[20]. Në bazë të nenit 16 paragrafi 5 Direktiva u aplikohet dhe të gjithë shtetasve të vendeve të treta të cilët kanë përfituar statusin e rezidentit afatgjatë në bazë të Direktivës 2003/109, në rast se vendosin të transferohen në një shtet tjetër anëtar në rastin kur familja ishte bashkuar në shtetin e parë[21].

2.2 Subjektet përfitues të së drejtës së bashkimit familjar. Neni 3 i Direktivës përcakton se familjarët e pranuar për bashkim familjar duhet të jenë dhe ata shtetas të vendeve të treta pavarësisht statusit juridik të tyre. Neni 4 përcakton se subjekte pasive, pra përfitues janë anëtarët e familjes bërthamë, pra bashkëshorti dhe fëmijët minoren qofshin këta dhe të adoptuar nga vetëm njëri nga bashkëshortët. Ndërkohë që bashkimi i familjarëve të tjerë si paraardhësit dhe fëmijët në moshë madhore lihet në diskrecion të

---

[18] E.Bergamini, *Libera circolazione delle persone, diritto di soggiorno e ricongiungimento familiare,* in *Codice della famiglia*, M.Sesta (a cura di) fq. 4085;

[19] A.Liguori *L'integrazione comunitaria e il diritto all'unità familiare dei cittadini dei Paesi terzi, in Rassegna di diritto pubblico europeo, 1-2/2002* fq. 149.

[20] N.Colacino, *Il diritto al ricongiungimento familiare e la disciplina introdotta dalla Direttiva 2003/86/CE*, fq. 144.

[21] Mbi Direktivën 2003/109 të 23 nëntorit 2003 shih A.Di Pascale-M.Pastore, *Il recepimento delle direttive sul ricongiungimento familiare e sui soggiornanti di lungo periodo*, në *Diritto, Immigrazione e Cittadinanza*, 1/2007 fq. 18 ss;

shteteve anëtare. Për sa i përket bashkëshortit/es direktiva autorizon shtetet të vendosin një limit moshe për përfitimin e bashkimit familjar të fiksuar në një maksimum 21 vjeç, kjo me qëllim eliminimin e martesave të lidhura midis minorëve pa konsensusin e tyre (neni 4 paragrafi 5). Për sa i përket fëmijëve Direktiva detyron shtetet anëtare të autorizojnë së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët minoren jo të martuar qofshin këta dhe adoptuar nga njëri vetëm prej bashkëshortëve. Për sa i përket moshës madhore të fëmijëve, merret si moshë madhore ajo e parashikuar nga legjislacioni shteteve anëtare dhe jo ajo e përcaktuar nga legjislacioni komunitar i cili parashikon moshën 21 vjeçare për të përfituar nga bashkimi familjar. Pra për të përfituar nga bashkimi familjar fëmijët e imigrantëve jo komunitar duhet të jenë nën 18 vjeç ndërsa fëmijët e qytetarëve komunitarë 21 vjeç. Bashkimi familjar për kategorinë e familjarëve të tjerë si: paraardhësit e gradës së parë të rezidentit apo bashkëshortit të cilët janë në ngarkim të këtij të fundit dhe nuk kanë mjete të tjera mbështetëse në vendin e origjinës dhe fëmijët madhorë jo të martuar të cilët nuk mund të sigurojnë nevojat e tyre për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore, lihet në diskrecion të shteteve anëtare. Në momentin që shtetet vendosin lejimin e tyre atëherë aplikohen rregullat e parashikuara nga Direktiva.

2.3 Kushtet për bashkimin familjar. Kushtet kryesore të cilët duhet të plotësohen për bashkimin familjar përcaktohen nga neni 7 i Direktivës. Shteti anëtar është i lirë të përcaktojë nëse kërkuesi aktiv për bashkimin familjar posedon:

i) një strehim të përshtatshëm, domethënë një banesë normale për një familje të njëjtë që jeton në të njëjtën rajon të shtetit anëtar.

ii) një sigurim shëndetësor që mbulon të gjitha rreziqet në shtetin anëtar në fjalë për veten e tij dhe anëtarët e familjes së tij;

iii) burime të qëndrueshme dhe të mjaftueshme, më të larta se ose të barabarta me nivelin e burimeve poshtë të cilave mund të jepet asistenca sociale në shtetin anëtar në fjalë.

Praktika parashikon që rezidenti duhet ti plotësojë këto kushte para se familjari të lejohet të hyjë dhe që në momentin e dorëzimit të kërkesës. Ndërsa për burimet ekonomike neni 7 dhe 16 paragrafi 1 gërma *b)* parashikojnë që ky kusht duhet të plotësohet jo vetëm në momentin e prezantimit të kërkesës por edhe më pas, praktikisht në çdo moment të prezantimit të kërkesës për rinovim të leje qëndrimit të rezidentit apo të familjarëve të pranuar nga bashkimi familjar. Shtetet anëtare mund të mohojnë kërkesën për hyrje dhe qëndrim me qëllim bashkimin familjar apo sipas rastit të tërheqin apo refuzojnë rinovimin e leje qëndrimit nëse kushtet e parashikuara nga Direktiva nuk janë ose nuk plotësohen më.

Konluzione

Tutela e familjes në Bashkimin Europian vjen si rezultat i politikave dhe lirive komunitare në realitetin socio-ekonomik dhe juridik të familjeve europiane. Edhe për sa i përket shtetasve të vendeve të treta evidentohet një tendencë për ti dhënë gjithmonë e më shumë forcë jetës familjare. Megjithëse diskutimet për aprovimin e Direktivës 2003/68 ishin mjaft komplekse dhe të vështira, adoptimi i saj shënoj një etapë të re në harmonizimin e legjislacioneve kombëtare në temën e bashkimit familjar për shtetasit e vendeve të treta. Instrumenti i zgjedhur nga Komisioni në këtë fazë të parë është ai i fleksibilitetit. Direktiva në fakt i lë në dorë legjislatorit kombëtar mundësinë që të përfitojë nga një lloj lirie veprimi në aspektet më kritike dhe të diskutueshëm të institutit të bashkimit familjar. Direktiva nga njëra anë eviton që shtetet anëtare të përfitojnë nga ky fleksibilitet dhe disa dispozita përjashtuese duke futur në legjislacionin e tyre kombëtar kufizime për ushtrimin e të drejtës së bashkimit familjar dhe nga ana tjetër nuk paragjykon të drejtën e shteteve anëtare që të mbajnë apo adoptojnë dispozita më të favorshme kundrejt personave të cilëve u aplikohet. Një nga pikat më të diskutuara gjatë adoptimit të Direktivës ishte ajo e përcaktimit të anëtarëve të familjes përfitues të së drejtës së bashkimit familjar. Duke marrë parasysh diferencën e madhe midis legjislacioneve kombëtare në këtë pikë, Komisioni e konsideroj si të pamundur zgjerimin e detyrimit për të autorizuar hyrjen dhe qëndrimin me qëllim bashkimin familjar edhe në avantazh të personave të tjerë të ndryshëm nga bashkëshorti dhe fëmijët minorë. Kështu që paraardhësit, fëmijët madhorë në ngarkim dhe partnerët jo të martuar janë futur nga Direktiva nën një regjim fakultativ dhe jo të detyrueshëm. Megjithatë Gjykata e Drejtësisë ka treguar në shumë vendime të saj një kujdes të veçantë për raportet familjare të ndërtuara dhe konsoliduar nga shtetasit e vendeve të treta duke zgjeruar në mënyrë progresive kategorinë e subjekteve të cilëve u njihet e drejta e bashkimit familjar dhe mënyrat e ushtrimit të kësaj të drejte. Mund të mendohet në këtë sens se garantimi të drejtave të njëjta me ato të qytetarëve të Unionit duhet tu njihet dhe qytetarëve të shteteve të treta, kryesisht atyre që kanë një lidhje të fortë me Komunitetin për shkak të kohëzgjatjes së tyre.

Literatura:

REGULATION (EEC) No 1612/68 OF THE COUNCIL of 15 October 1968 on freedom of movement for workers within the Community in *Official Journal L 257 , 19/10/1968.*

COUNCIL DIRECTIVE of 18 May 1972 extending to workers exercising the right to remain in the territory of a Member State after having been employed in that State the scope of the Directive of 25 February 1964 on coordination of special measures concerning the movement and residence of foreign nationals which are justified on grounds of public policy, public security or public health (72/194/EEC), in *Official Journal n. L 121 del 26/05/1972 pag. 0032 – 0032.*
http://www.eurotreaties.com/maastrichteu.pdf

Judgment of the Court of 5 June 1997 in joined cases C-64/96 and C-65/96 - Land Nordrhein-Westfalen v Kari Uecker and Vera Jacquet v Land Nordrhein-Westfalen in *European Court reports 1997 Page I-03171.*

Judgment of the Court of 7 July 1992 The Queen v Immigration Appeal Tribunal and Surinder Singh, ex parte Secretary of State for Home Department, Case C-370/90, in *European Court reports 1992 Page I-04265.*

COUNCIL DIRECTIVE 2003/86/EC of 22 September 2003 on the right to family reunification.

http://www.europarl.europa.eu/summits/tam_en.htm

COM (99) 368, në *Official Journal C 116* e 26 prillit 2000.

GUILD E., *Implementing Amsterdam: Immigration and Asylum rights in EC law*, Oxford, Portland, Oregon, 2001, fq. 241 vazhdim.

PRESIDENCY ConclusionS, Laeken european Council 14-15 dhjetor 2001,ne http://ec.europa.eu/smartregulation/impact/background/docs/laeken_concl_en.pdf

R. CHOLEWINSKY, *Family reunification and conditions placed on family members: Dismalting a foundamental right.*

E.BERGAMINI, *Libera circolazione delle persone, diritto di soggiorno e ricongiungimento familiare,* in *Codice della famiglia*, M.Sesta (a cura di).

A.LIGUORI *L'integrazione comunitaria e il diritto all'unità familiare dei cittadini dei Paesi terzi, in Rassegna di diritto pubblico europeo, 1-2/2002.*

N.COLACINO, *Il diritto al ricongiungimento familiare e la disciplina introdotta dalla Direttiva 2003/86/CE*.

A.Di PASCALE-M.PASTORE, *Il recepimento delle direttive sul ricongiungimento familiare e sui soggiornanti di lungo periodo*, në *Diritto, Immigrazione e Cittadinanza*, 1/2007.

Implemetimi i një modeli të ri të kartelës infermierore në repartin e pediatrisë Spitali Rajonal Vlorë

Punuan: Msc.Evis Allushi,Doc.Majlinda Zahaj, Msc Sonila Nika
Adresa Korresponduese: evismemushi@yahoo.com

Abstrakti
Implemetimi i një modeli të ri të kartelës infermierore në repartin e pediatrisë Spitali Rajonal Vlorë
Hyrje: Kartela infermierore është një mjet që dokumenton gjithë aktivitetin infermieror, individual dhe kolektiv, dhe është pjesë mjaft e rëndësishme e dokumentacioneve shëndetësore të pacientit, jep informacione të kuptueshme rreth gjendjes shëndetësor të një individi, dhe shërben gjithashtu edhe si informacion bazë për kryerjen e studimeve kërkimore-shkencore.Kartela që përdoret aktuaisht në repartin e pediatrisë është model miratuar nga Ministria e Shëndetësisë ,Mars 2003. Që nga ai moment në këtë repart vazhdon të përdoret i njëjti model,por duhet theksuar që ky model është i njëjtë me pjesën tjëtr të reparteve në spital. **Qëllimi** i këtij studim ka qenë: "Vlerësimi i aplikimi të një modelit të ri të kartelës infermierore në repartin e pediatrisë së Spitalit Rajonal Vlorë, me qëllim që të evidentohet përmirësimi i dokumentimit infermieror".**Objektivat** për realizimin e këtij qëllimi janë:Vlerësimi i aplikimi të një modelit të ri të kartelës infermierore në repartin e pediatrisë së Spitalit Rajonal Vlorë,Krahasimi i rubrikave të modelit të ri të kartelës infermierore pediatrike me ato të kartelës infermierore që përdoret aktualisht në repartin e pediatrisë.Vlerësimi i defekteve të kartelës infermierore që përdoret aktualisht në repartin e pediatrisë,Vlerësimi i përmirësimit të dokumentimit infermieror.**Hipoteza e studimit**:Aplikimi i një modeli të ri të kartelës infermierore në repartin e pediatrisë së Spitalit Rajonal Vlorë ka ndikim në përmirësimin e dokumentimit infermieror.**Materiali dhe metoda** Ky është një një studim eksperimental i realizuar në periudhën 15 mars -15 qershor 2013. Për realizimin e këtij studimi instrument matës që u përdorën ishin,pyetësori i vetadministruar,modeli i ri i kartelës infermierore dhe intervista drejtuar infermiereve që punonan me modelin e ri të kartelës infermierore.Në këtë studim u përdorën 300 kartela të modelit të ri , të cilat u shpërndanë në të dy repartet e pavionit të pediatrisë, për periudhën 3- mujore,pra 100 të tilla cdo muaj, dhe u bë krahasimi më mëyrën e plotësimit të kartelës aktuale që përdoret në këtë repart.**Rezultatet** e këtij studimi treguan se ndikimi i modelit të ri të kartelës infermierore ka qenë në drejtim të:Impaktit pozitiv që kjo kartelë ka patur te stafi shëndetësor infermieror, 90% e tyre e vlerësojnë mjaft të përshtatshme këtë kartelë:Kënaqësisë së infermiereve që punuan me këtë kartelë.Shtimit të rubrikave të reja specifike për kujdesin që infermieri duhet të japë ndaj pacientit.Dokumentimit më të lartë të punës infermierore në modelin e ri krahasuar me kartelën aktuale (OR=3.36).Saktësisë së plotësimit të modelit të ri të kartelës infermierore krahasuar me kartelën aktuale (OR=2.3).Pas saktësisë,sigurisht që një kartelë përcjell edhe tejcimin e informacionit, gjë e cila është përmirësuar nëpërmjet këtij modeli.Planet e kujdesit, qellimet, diagnozat, nderhyrjet e planifikuara dhe rezultatet e projektuara në modelin e ri të kartelës infermierore dhe pse janë prezente në masën 100% plotësimi i tyre është ende një koncept i diskutueshëm.Përmirësimit të njohurive të infermiereve.
Fjalët kyc: implementim, dokumentim infermieror

Hyrje

Kartela infermierore është një mjet që dokumenton gjithë aktivitetin infermieror, individual dhe kolektiv, dhe është pjesë mjaft e rëndësishme e dokumentacioneve shëndetësore të pacientit.
Kartela infermierore përbën një dokument ligjor permanent, i cili jep informacione të kuptueshme rreth gjendjes shëndetësore të një individi.
Po nuk duhet të harrojmë aspak që dokumentimi infermieror në kartelën infermierore, shërben gjithashtu edhe si informacion bazë për kryerjen e studimeve kërkimore-shkencore.
Dokumentimi në kartelën infermierore lehtëson konunikimin midis profesionistëve nga disiplina të ndryshme dhe në turne të ndryshme.
Kartela jep informacion për ndihmën e ofruar në mënyrë të organizuar.
Informacioni në këtë dokument është një burim të dhënash për sigurimin e cilësisë dhe programet e kolegëve të shëndetsisë.
Fillesa e këtij studimi ka qenë mungesa e studimeve të mëparshme lidhur me kartelën infermierore në vendin tonë. Modeli i kartelës infermierore që përdoret aktualisht në Spitalin Rajonal të Vlorës, është model i miratuar nga Sektori i Infermieristikës, në Ministrinë e Shëndetësisë në Mars të vitit 2003.
Ky model kartele u përpilua i njëtë për të gjitha repartet e spitalit, me përjashtim të Obsetrik-Gjinekologjisë,e cila pati një model më specifik.
Por edhe pse modeli që u rekomandua për t'u përdorur në këtë repart ishte i përshtatur, për vet natyrën specifike të punës aty, gjithsesi me inisiativën e vetë ekipit shëndetësor të Obsetrik-Gjinekologjisë, në kartelë u bënë ndryshime të tjera që lidheshin me pacientët e vegjël në repartin e Neonatologjisë.
Modeli i kartelës që u lançua për t'u përdorur në Spitalin Rajonal të Vlorës,por jo vetëm, ishte pjesë e “Dokument Themeltar I”, dokument zyrtar i përpiluar nga ana e Ministrisë së Shëndetsisë në Mars të vitit 2003.
Ky dokument përshkruante në detaje rregulloren e funksionimit, punësimit, kritereve që duhet të plotësojë çdo infermier sipas vendit të punës.
Por ajo për të cilën ne jemi të interesuar është përshkrimi që ky dokument i bën kartelës infermierore.
Që nga ajo periudhë, Mars 2003, e deri ne ditet e sotme, që përbëjnë 10 vjet, në spitalin Rajonal të Vlorës vazhdon të përdoret e njëjta kartelë.
Reparti i pediatrisë,repart në të cilin unë e kam shtrirë këtë studim, përdor të njëjtin model kartele sikundër edhe reparti i patologjisë apo kirurgjisë. Meqë në vendin tonë, jemi akoma larg implementimit të kartelave elektronike, vënia në punë e një modeli të përshtatur ,sidomos për repartin e pediatrisë ka qenë objektivi im primar për këtë studim.
Lloji i kartelës që është implementuar në këtë repart , mendoj se përmban të gjithë elementët infermierorë të rëndësishëm për t’u dokumentuar në kartelë, qoftë kjo në letër (pra dokumentimi manual) apo edhe në kompjuter.
Ashtu sikurse është përmendur edhe më sipër, nga shfrytëzimi i literaturës është evidentuar që në Shqipëri , deri ne ditët e sotme, nuk janë realizuar studime lidhur me kartelën infermierore, dokumentimin infermieror, apo çështje të tjera të cilat prekin pikërisht këtë dokument të rëndësishëm.
Ky studim në vetvete është mbështetur më së shumti në atë ç’ka duhet të përmbajë kartela infermierore, pra përmbajtja apo rubrikat përbërëse të kartelës infermierore, dhe se si secila prej tyre duhet të plotësohet nga ana e personelit shëndetësor infermieror, në mënyrë që të bëhet i mundur një dokumentim sa më i mirë i punës së infermiereve gjatë turnit përkatës,informacioni

të jetë sa më i saktë dhe të tejçohet në mënyrën më të mirë të mundshme midis kolegëve dhe skuadrës shëndetësore .

Metodologjia e studimit

Ky është një një studim eksperimental i realizuar në periudhën 15 mars -15 qershor 2013.
Në këtë studim u përdorën 300 kartela të modelit të ri, të cilat u shpërndanë në të dy repartet e pavionit të pediatrisë, për periudhën 3- mujore,pra 100 të tilla çdo muaj. Në këtë studim morën pjesë të gjitha infermieret e repartit të pediatrisë në Spitalin Rajonal Vlorë.
Për këtë studim instrumentat e përdorur janë:
I. Pytësor i vetadministruar.Ky pyetësor është aplikuar ne perfundim te periudhes se studimit tek te gjitha infermieret e pediatrise. Ky pyetësor është i ndarë në katër rubrika të cilat janë:
a.Të dhënat administrative
b.Të dhënat mbi kujdesin ndaj pacientit
c.Të dhënat asistenciale të përgjithshme
d.Të dhënat mjekoligjore
II.Kartela infermierore pediatrike
III.Intervista drejtuar infermiereve

Nr.	*Variablat*	*Përkufizimi operacional*	*Mjeti nëpërmjet të cilit është matur.*
Variablat e pavarur			
	Kartela infermierore	Modeli i ri i kartelës infermierore është një mjet që dokumenton gjithë aktivitetin infermieror, individual dhe kolektiv,dhe është pjesë mjaft e rëndësishme e dokumentacioneve shëndetësore të pacientit.	Nëpërmjet plotësimit që vetë infermieret kanë bërë në këtë kartelë.

Rezultatet

Rezultati i pre dhe post testit
Si pretest është përdorur pyetësori i vetadministruar dhe intervistat paraprake me infermieret e pediatrisë.
Tabela e mëposhtme paraqet rezultatet e pyetësorit, tek të gjitha infermieret përpara fillimit të studimit,dhe në fund të studimit tek infermieret të cilat kanë punuar me modelin e ri të kartelës infermierore.

Tab.1

Pyetesor mbi ecurine e karteles infermierore, (kartelës qe perdoret aktualisht dhe modelit të ri të implementuar), në Repartin e Pediatrise, Spitali Rajonal Vlorë			
Te dhenat administrative	**Po**	**Jo**	**Nuk përgjigjen**

	V	R	V	R	V	R
1.Ne kartelen infermierore a paraqiten keto te dhena?	100	100	0	0	0	0
1.1 Te dhena qe identifikojne spitalin	100	100	0	0	0	0
1.2 Te dhena qe identifikojne pavionin e pediatrise	100	100	0	0	0	0
1.3 Te dhenat personale te pacientit	100	100	0	0	0	0
1.4 Data e hyrjes se pacientit ne repart	100	100	0	0	0	0
1.5 Data e daljes se pacientit nga reparti	100	100	0	0	0	0
1.6 Data e transferimit te pacientit	0	89	100	0	0	11
Te dhena mbi kujdesin ndaj pacientit						
2.Ne kartelen infermierore a paraqiten keto elemente?						
2.1 Shenjat vitale	72	100	28	0	0	0
2.2 Identifikimi i nevojave baze	64	89	36	5	0	6
2.3 Perkufizimi i diagnozave infermierore	28	100	72	0	0	0
2.4 Percaktimi i qellimeve te kujdesjeve infermierore	28	100	72	0	0	0
2.5 Identifikimi i nderhyrjeve infermierore	45	79	55	19	0	2
2.6 Ditari infermieror	0	100	100	0	0	0
2.7 Shkalla e nivelit te dhimbjes	0	100	100	0	0	0
2.8 Vleresimi i planit te kujdesjeve infermierore	0	85	100	15	0	0

Te dhena asistenciale te pergjithshme						
3.Ne kartelen infermierore a paraqiten skedat e meposhtme?						
3.1 Skeda e terapise	100	100	0	0	0	0
3.2 Skeda e analizave laboratorike dhe diagnostikuese	93	98	0	0	7	2
3.3 Skeda ndihmese (bilanci hidrik,dieta e personalizuar)	21	85	0	0	79	15
3.4 N.q.s. po specifikoni secilen prej tyre	Bilanci hidrik,dieta e personalizuar			Bilanci hidrik,dieta e personalizuar		
Te dhena mjeko-ligjore						
4. Ne kartelen infermierore a paraqiten te dhenat ligjore te meposhtme?						
4.1 Te dhenat personale te pacientit jane raportuar qysh ne fillim?	94	99	0	0	6	1
4.2 Data/Ora/Firma e infermierit ne cdo nderhyrje?	81	100	0	0	19	0

4.4 Vendi i mbajtjes dhe ruajtjes se karteles infermierore	Në dollapin e medikamenteve në infermieri			Në zyrën e kryeinfermieres		
4.5 Kartela infermierore ne momentin qe perdoret dhe ruhet a ka nje numer rendor	76	95	11	0	13	5
4.6 Kartela infermierore kur arshivohet a e ka numrin qe i eshte bashkangjitur (nese e ka nje te tille) ?	76	95	11	0	13	5

**Ngjyra lejla identifikon kartelën aktule që përdoret në repartin e pediatrisë*
Ngjyra rozë identifikon modelin e ri të kartelës infermierore të implementuar në repartin e pediatrisë.
Vlerat janë të paraqitura në përqindje.

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme janë vërtet domethënëse.
Pjesa e parë e pyetësorit, që ka të bëjë me të dhënat administrative ,përgjithësisht si në kartelën aktuale ashtu edhe në modelin e ri i përmban të gjithë elementët të cilët përfshihen në pyetësor. Vetëm data e transferimit nga reparti,ku sipas përgjigjeve të infermiereve, nuk ekziston në kartelën aktuale.Ndërkohë që duke iu referuar përgjigjeve për modelin e ri, 89% e tyre janë përgjigjur pozitivisht, ndërkohë që 11% nuk kanë dhënë asnjë përgjigje.
Ndërkohë që ajo që bie në sy në këtë pyetësor, është rubrika e dytë lidhur me të dhënat e kujdesit ndaj pacientit. Përsa i përket perkufizimit të diagnozave infermierore dhe qëllimit të kujdesjeve infermierore, vetëm në 72% të rasteve janë prezente në kartelën aktuale.Kjo konfirmon që koncepti i diagnozave infermierore ende është i paqartë në vendin tonë.
Ditari infermieror është një element tjetër i cili mungon totalisht në modelin që përdoret aktualisht në repartin e pediatrisë, së bashku me shkallën e nivelit të dhimbjes.Thelbësor është edhe vlerësimi final i kujdesjeve infermierore i cili mungon totalisht në kartelën që përdoret në pediatri.Pra rubrika e dytë, e cila është edhe rubrika më e rëndësishme,që lidhet drejtpërdrejt me kujdesin ndaj pacientit të vogël, ka shumë elemente të cilët i mungojnë dhe i gjejmë të paraqitura në modelin e ri të kartelës infermierore.

Tabela nr.2
Paraqitja deskriptive e plotësimit të rubrikave të modelit të ri të kartelës infermierore

Rubrikat e modelit të ri të kartelës infermierore	Kartelat e plotesuara		Kartelat e paplotesuara
	Plotesuar sakte	Plotesuar gabim	
1	280	0	20
2	300	0	0
3	274	0	26
4	263	0	37
5	283	5	12
6	106	0	194
7	300	0	0
8	300	0	0
9	300	0	0
10	300	0	0
11	300	0	0
12	300	0	0

13	300	0	0
14	300	0	0
15	300	0	0
16	212	39	49
17	273	0	27
18	300	0	0
19	59	0	241
20	300	0	0
21	198	0	102
22	209	0	91
23	31	254	15
24	221	0	79
25	266	32	2
26	255	44	1
27	276	14	10
28	105	57	138
29	159	76	65
30	160	61	79
31	12	0	288
32	117	95	88
33	259	41	0
34	124	56	120

Paraqitja deskriptive e plotësimit të kartelës infermierore që përdoret aktualisht në repartin e pediatrisë

Tabela nr.3

Rubrikat e kartelës ekzistuese	**Kartelat e plotesuara**		**Kartelat e paplotesuara**
	Plotesuar sakte	Plotesuar gabim	
1	300	0	0
2	300	0	0
3	213	54	33
4	197	72	31
5	204	0	96
6	187	19	94
7	0	0	300
8	0	0	300
9	67	0	233
10	210	49	41
11	227	40	33

12	213	30	57
13	0	0	300
14	189	100	11
15	269	31	0
16	0	236	64
17	56	0	244
18	0	0	300

Në tabelën e mëposhtme shohim mënyrën e plotësimit të të dyja kartelave.

Tabela nr.4 Plotësimi i karelave infermierore të aplikuara në pediatri

Kartelat	E plotesuar		E paplotesuar
	Plotesuar sakte	Plotesuar gabim	
Modeli i ri i karteles infermierore	228	23	49
Modeli ekzistues i karteles infermierore	146	35	119

Për të parë se cilat janë gjasat e plotësimit,dhe saktësisë së plotësimit të modelit të ri të kartelës infermierore do të llogarisim raportin e gjasave (OR).

Tabela nr.5

		Plotesimi		
		Plotesuar sakte	Plotesuar gabim	Totali
Kartelat	Modeli i ri i karteles infermierore	228	23	251
	Modeli ekzistues i karteles infermierore	146	35	181
	Totali	374	58	432

Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme do të llogarisim raportin e gjasave për saktësinë e plotësimit të kartelës infermierore.
OR=a*d/b*c=7980/3358=2.3
Pra gjasat e plotësimit saktë janë 2.3 herë më të larta në modelin e ri sesa në kartelën ekzistuese.

Tabela nr.6

		Plotesimi i karteles		
		E plotesuar	E paplotesuar	Totali
Kartela	Modeli i ri i karteles infermierore	251	49	300
	Modeli ekzistues i karteles infermierore	181	119	300
	Totali	432	168	600

Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme do të llogarisim raportin e gjasave për plotësimin e kartelës infermierore.
OR=a*d/b*c=29869/8869=3.36
Pra gjasat e plotësimit të kartelës infermierore (pavarësisht faktit nëse janë plotësuar saktë apo gabim), janë 3,36 herë më të larta në modelin e ri sesa në kartelën ekzistuese.

Konkluzion

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i aplikimi të një modelit të ri të kartelës infermierore në repartin e pediatrisë së Spitalit Rajonal Vlorë, me qëllim që të përmirësohet dokumentimi infermieror.
Rezultatet e këtij studimi treguan se ndikimi i modelit të ri të kartelës infermierore ka qenë në drejtim të:

- Impaktit pozitiv që kjo kartelë ka patur te stafi shëndetësor infermieror, 90% e tyre e vlerësojnë mjaft të përshtatshme këtë kartelë.
- Kënaqësisë së infermiereve që punuan me këtë kartelë.
- Shtimit të rubrikave të reja specifike për kujdesin që infermieri duhet të japë ndaj pacientit.
- Dokumentimit më të lartë të punës infermierore në modelin e ri krahasuar me kartelën aktuale (OR=3.36).
- Saktësisë së plotësimit të modelit të ri të kartelës infermierore krahasuar me kartelën aktuale (OR=2.3).
- Pas saktësisë,sigurisht që një kartelë përcjell edhe tejcimin e informacionit, gjë e cila është përmirësuar nëpërmjet këtij modeli
- Planet e kujdesit, qellimet, diagnozat, nderhyrjet e planifikuara dhe rezultatet e projektuara në modelin e ri të kartelës infermierore dhe pse janë prezente në masën 100% plotësimi i tyre është ende një koncept i diskutueshëm.
- Përmirësimit të njohurive të infermiereve

Rekomandimet

- Duke iu referuar materialit të studiuar më sipër mendoj se disa rekomandime të nevojshme janë:
- 1-Ky studim duhet të shtrihet për një periudhë kohore 2-vjeçare në repartin e pediatrisë.
- 2-Të bëhet e mundur që në kurrikulat e Fakultetit të Shëndetit Publik (në të gjitha lëndët specifike infermierore), të jepen programet e duhura lidhur me mënyrën e plotësimit të

kartelës infermierore për çdo specialitet, në mënyrë që studentët të jenë të përgatitur përsa i përket plotësimit të dokumentacioneve infermierore.

- 3-Ngritja e një grupi pune për implementimin e modeleve specifike të kartelës infermierore në repartet e tjera të Spitalit Rajonal të Vlorës.

Literatura

1.Dokument Themeltar I, Ministria e Shëndetësisë, Mars 2003

2. Joint Commission on the Accreditation of Healthcare Organizations. 2003 standards for home health, personal care, and supportive services. Oakbrook Terrace, IL: Joint Commission Resources; 2003.

3. Joint Commission on the Accreditation of Healthcare Organizations. 2005 hospital accreditation standards. Oakbrook Terrace, IL: Joint Commission Resources; 2005.

4. Strauss A, Corbin J. Grounded theory in practice . London: Sage Publications; 1997

5.Huffman M. Redefine care delivery and documentation. Nurse Manage. 2004;35(2):34–8.

6. Johnson K, Hallsey D, Meredith RL, et al. A nurse-driven system for improving patient quality outcomes. J Nurs Care Qual. 2006;21(2):168–75.

7.Lindsay PM, Kelloëay L, McConnell H. Research to practice: nursing stroke assessment guidelines link to clinical performance indicators. AXON. 2005;26(4):22–7.

8.Yocum R. Documenting for quality patient care. Nursing. 2002;32(8):58–63.

9. Caldëell C, Komaromy D, Lynch F. Working together to improve record keeping. Nurs Stand. 2000;14(47):37–41.

10. Cowden S, Johnson LC. A process for consolidation of redundant documentation forms. Comput Inform Nurs. 2004;22(2):90–3.

11. Dimond B. Exploring common deficiencies that occur in record keeping. Br J Nurs. 2005;14:568–70.

12. McMath E, Harvey C. Complex wounds: a partnership approach to patient documentation. Br J Nurs. 2004;13(11):S12–6.

13. Metcalf C. Changing documentation to improve stoma care. Prof Nurse. 2000;15(5):307–10.

14. Korst LM, Eusebio-Angeja AC, Chamorro T, et al. Nursing documentation time during implementation of an electronic medical record. J Nurs Adm. 2003;33(1):24–30.

15. Poissant L, Pereira J, Tamblyn R, et al. The impact of electronic health records on time efficiency of physicians and nurses: a systematic review. J Am Med Inform Assoc. 2005;12:505

16. Sprague A, Trepanier MJ. Charting in record time. AWHONN Lifelines. 1999;3(5):25–30.

17. Castledine G. The blunders found in nursing documentation. Br J Nurs. 1998;7:1218.

18.Smith J, Crawford L. The link between perceived adequacy of preparation to practice, nursing error, and perceived difficulty of entry-level practice. JONAS Healthc Laë Ethics Regul. 2003;5(4):100–3

19. Dimond B. Exploring the legal status of healthcare documentation in the UK. Br J Nurs. 2005;14:517–8.

20. Frank-Stromborg M, Christensen A, Elmhurst D. Nurse documentation: not done or worse, done the wrong way—part I. Oncol Nurs Forum. 2001;28:697–702

21. Wilson AA. The quest for accountability: patient costs & outcomes. Caring. 1996;15(6):24–8.

22. Pearson A. The role of documentation in making nursing work visible. Int J Nurs Pract. 2003;9:271.

23. Davidson N, Egbert K, Merchant M, et al. An interdisciplinary documentation performance improvement project. J Nurses Staff Dev. 2004;20(5):236–41.
24. Metnitz PG, Vesely H, Valentin A, et al. Evaluation of an interdisciplinary data set for national intensive care unit assessment. Crit Care Med. 1999;27(8):1486–91.
25. Urquhart C, Currell R. Reviewing the evidence on nursing record systems. Health Informatics J. 2005;11(1):33–44.
26. Currell R, Urquhart C. Nursing record systems: effects on nursing practice and health care outcomes (Cochrane review). The Cochrane Library. 2003;3:CD002099.
27. Langowski C. The times they are a changing: effects of online nursing documentation systems. Qual Manag Health Care. 2005;14(2):121–5.

GRID COMPUTING DHE CLOUD COMPUTING

Cilat janë ndryshimet në zgjidhjet e sigurisë ne këto dy teknologji?

FJORALBA SOTA

UNIVERSITETI " ISMAIL QEMALI"

VLORË/SHQIPËRI

E-mail: fjoralba.sota@gmail.com

Abstrakt

Qëllimi: Grid computing lehtëson përdorimin e burimeve të shpërndara dhe është jashtëzakonisht popullor në implementimin e tij. Rrjetat kanë evoluar mjaftueshëm për të siguruar arkitekturën operative të tyre. Në anën tjetër, Cloud Computing ofron mundësi më të reja në virtualizimin e shpërndarë të burimeve, duke siguruar një arkitekturë on-demand me një model të thjeshtë për shërbimet e pagesave. Ky artikull përkufizon në mënyrën e duhur Grid dhe Cloud Computing. Gjithashtu në të diskutohen mekanizmat e sigurisë në këto dy teknologji dhe bazuar në implementimet aktuale të sigurisë në Grid, propozon një arkitekturë të thjeshtë për kontrollin e sigurt të aksesit dhe të përforcimit të policës së sigurisë për rrjetat Cloud. Në këtë artikull jepen ndryshimet midis Cloud dhe Grid Computing, përcakton se cilat nga çështjet e sigurisë duhet të konsiderohen, dhe se si disa prej tyre zgjidhen. Këtu do të tregohet edhe se si disa nga metodat ekzistuese të sigurisë që përdoren në një teknologji, do të përdoren tek tjetra.

Fjalë kyçe: Cloud Computing, Grid Computing

1. Hyrje

Cloud Computing është aktualisht një "master" në botën e Computing. Arsyeja është sepse ai ofron disa karakteristika që disa teknologji të mëparëshme kanë kërkuar për ta bërë.

Cloud Computing është i përshtatshëm për të gjithë përdoruesit, nga biznese në individualë, për disa arsye. Arritja më e realizuar e Cloud Computing nga pikëpamja e përdoruesit qëndron në faktin që pëerdoruesit kanë mundësinë të paguajnë: paguaj – për – përdorim (PPU) ose paguaj – në – kërkesë (POD). Në fakt , ne e kemi përdorur këtë model biznesi për vite me radhë; për shembull, furnizuesit e energjisë elektrike e kanë përdorur këtë metodë për të ngarkuar për energjinë e përdorur në shtëpi, ku familjet paguajnë për aq sa ata harxhojnë, në vend që të paguajnë çdo muaj. Një shembull tjetër do të ishtë për përdoruesit celularë pay-as-you-go. Ajo çfarë sistemi PPU ofron është fleksibilitet: ne paguajmë vetem për çfarë ne përdorim dhe kur ne e përdorim. Nuk është fakt i ri që Cloud Computing ka disa çështje të përbashkëta me teknologjitë më të vjetra, si Grid Computing, në të cilën burimet e shumë kompjuterave në një rrjet përdoren në të njëjtën kohë, duke mundësuar pëerdoruesit të ruajnë, zbulojnë dhe të tërheqin sasi të mëdha të dhënash. Cloud Computing po jep rezultate të mira dhe individët dhe organizatat po e përdorin atë. Megjithatë, ekzistojnë probleme që lidhen me këtë mjedis/sistem. Kjo

mënyrë e menaxhimit të sistemeve shfrytëzohet për përdorimin dhe kërkimin e burimeve që sigurohen nga qëndrat e të dhënave. Në këto mjedise janë implementuar përllogaritje paralele të ndërlikuara dhe ekzekutohen përmes këtyre burimeve të shpërndara. Ne duhet të marrim në konsideratë faktin që Grid dhe Cloud Computing kanë shumë karakteristika të përbashkëta në dizenjim dhe arkitekturë dhe duhet të jemi në gjëndje të ripërdorim disa nga zgjidhjet ekzistuese të sigurisë.

Qëllimi në këtë artikull është që të zbulojmë problemet kryesore të sigurisë dhe ti krahasojmë ato. Ne duhet të jemi në gjendje që të përcaktojmë se cila nga zgjidhjet mund të përdoret tek të dyja teknologjitë.

2. Background.

Kjo pjesë përmbledh konceptet bazë të Cloud dhe Grid Computing. Ne do të shikojmë pak më në thellësi mbi sigurinë.

2.1 Grid Computing.

Një "Grid" është një grup burimesh dhe kompjuterash heterogjenë. Ajo mund të përcaktohet si një arkitekturë që koordinon burime jo të centralizuara. "Grids" shpërndahen në shumë domain –e administrative dhe përfshijnë APIs standarte. Këto APIs e sigurojnë përdoruesin me akses në burime. Në "Grids" , një domain administrativ , VO është një grup burimesh që kontrollohen nga një autoritet i vetëm. Grids implementohen më së shumti me VOs dinamike [1]. VOs janë të përbëra nga grupe përdoruesish nga domaine të ndryshëm që kanë privilegje të ndryshmëm për të aksesuar burimet dhe shërbimet.

Kështu, siç tregohet në figurën 1, VO ka një shtresë të përbashkët policash nga domaine të ndryshme, e cila lejon ndarjen midis burimeve të koordinuara. Sfida e parë për sigurinë në Grids funksionaliteti ndër – domain për ndarjen e koordinuar të burimeve nëpër domaine të shumta.



Figura 1: Shtresa e polices me domaine të shumtë në një VO

2.2 Cloud Computing

Ka mënyra të shumta për të përkufizuar termin Cloud [1]. Ian Foster et . al në [1] e kanë përkufizuar atë si " një shkallë të gjerë të shpërndarë paradigmë në informatikë që është e drejtuar nga ekonomitë e shkallës , në të cilin një grup abstraktsioni , virtualizimi , shkallëzimi dinamik , fuqi e menaxhimit, magazinimit , platformat, dhe shërbimet shpërndahen sipas kërkesave (on-demand) për klientët e jashtëm në Internet " . Shërbimet kryesore që Retë (Clouds) kanë mundësuar që të arrihen nga ofruesit e shërbimeve janë diversiteti , shpërndarja dhe optimizimi në përdorimin e burimeve. Termi utility computing është përdorur në arkitekturën e Clouds . Abstraksioni i infrastrukturës dhe pika e ndërveprimit për klientët në Clouds janë përcaktuar si një Arkitekturë e Orientuar në Shërbime (SOA) .

Në terma të shkallës dhe të shërbimit në figurën 2 vihet re një ndryshim midis teknologjive grid dhe cloud. Clouds janë ndërtuar mbi një strukturë të bazuar në shërbime dhe virtualizim burimesh të ndryshëm nga Grid. SOA në Clouds zakonisht përcaktohet në tre shtresa të ndryshme , si tregohet ne Figuren 4 .

Shtresat e shërbimeve të Cloud Computing në SOA mund të përshkruhen si :

- Sipas kërkesave të përdoruesit infrastruktura si një shërbim (IaaS) siguron CPU virtuale , disqe , kujtesë . Virtualizimi lejon ofruesit IaaS të caktojë ndarje dhe në mënyrë dinamike të rivendosin burimet me fleksibilitet për të ndërtuar sistemet ad - hoc sipas kërkesave te klientit . Sidoqoftë , ofruesit janë përgjegjës vetëm për funksionimin e qendrës së të dhënave , ndërsa përgjegjësia e aplikacioneve është e përdoruesit



Figura 2: Krahasime arkitekturore midis Grids dhe Clouds

- Platforma si një shërbim (PaaS) vepron si një abstraksion në mes të shërbimit dhe të burimeve fizike. Përdoruesit kërkojnë një komponent software në platformë dhe ofruesi PaaS ofron platformën software ku sistemet veprojnë. Ai gjithashtu siguron ndërfaqet e programimit të aplikacionit (APIs) .
- Software si një shërbim (SaaS) siguron përdoruesit fundorë me shërbime të integruar nga ofruesit e SaaS , platforma e zhvillimit , që përbëhet nga hardware dhe aplikacionet nga Cloud .

SaaS janë paketa të kombinuara dhe implementohen në qendrën e të dhënave të ofruesit të SaaS ,I cili siguron akses të largët të përdoruesit . Ky përdorues thjesht shfrytëzon shërbimin mbi një ndërfaqe web dhe ka minimumin e vizibilitetit në krahasim me IaaS dhe Paas .

3. Siguria

3.1 Siguria në Grids

Platformat në Grids janë konsideruar të jenë dinamike dhe heterogjene . Siguria në Grids nuk është i drejtuar drejt sigurisë ndër domain, por synon në krijimin e një marrëdhënie të besuar të bazuar në VO cila vepron si një urë . Çështjet kryesore të trajtuara në sigurinë e Grids janë :

- Single Sign- On : duke bërë të mundur e përdoruesit për të hyrë vetëm për një herë dhe për të fituar akses në domaine të shumta Grids duke thjeshtuar detyrën e llogaritjeve dhe auditimit për ofruesit e rrjetit .
- Delegimi i të drejtave të aksesit në programe të tjera në Grid për të aksesuar në domaine të tjera me emër të përdoruesit .
- Privatësi dhe integritet për aksesim të burimeve, të cilat duhet të parandalojnë akses jo të autorizuar në domaine dhe për të parandaluar modifimin e të dhënave.
- Rezervim i Burimeve dhe autorizim për të dy burimet lokale dhe globale për të implementuar policat specifike të përdoruesit. Mekanizmat ekzistues të sigurisë në Cloud Computing janë zbatuar në mënyra të ndryshme . Megjithatë , Implementimet e standardizuara të Grid ofrojnë siguri si më poshtë :
- Security Assertion Markup Language (SAML)është një gjuhë e bazuar në përkufizimin XML për argumentet e sigurisë për të shkëmbyer të dhëna identiteti mes VOs apo domaineve të shumta të sigurisë për autorizimin dhe autentifikimin.
- Për aksesimin e burimeve në Grid janë krijuar Çertifikatat afatgjata X. 509 për çdo përdorues . Me qëllim për delegimin ndër- domain për autorizimin dhe autentifikimin, për çdo certifikatë X. 509 çertifikata të shumta jetëshkurtra X. 509 Proxy janë krijuar nga VOs në kufijtë e burimeve të ndryshme të domaineve të ndryshme .
- Extensible Markup Language Access Control

(XACML) është një gjuhë deklaruese për kontrollin e aksesit që implementohet në XML , dizenjuar për të shprehur , aksesuar të drejtat dhe policat e sigurisë . Aksesimi i burimeve në një Grid , kontrolli i aksesit dhe delegimi i të drejtave të aksesit për autentikimin ndër domain janë bërë me policat e përcaktuar XACML . Një nga middleëare më mbizotëruese për vendosjen Grid quhet Globus Toolkit (GT) [1] , i cili përdor teknologjinë e çelësit publik për të trajtuar disa nga çështjet e autentifikimit në Grid . Siguria Globus është e bazuar në Infrastrukturën e Sigurisë Grid (GSI) [3] . GSI kërkon SSL / TLS protokollin e sigurisë me shtresën e transportit dhe ajo gjithashtu specifikon një format për certifikatat X. 509 [7] . Një identitet është formuar duke përdorur një certifikatë X. 509 të ndërlidhur me çelësin privat . GSI është zgjeruar për të lejuar një përdorues me një certifikatë të vlefshme publike X. 509 për të deleguar privilegje të caktuara në një certifikatë të re të identitetit X. 509 . Ky mekanizëm mundëson një delegacion dinamik privilegjesh për një periudhë të shkurtër kohe , apo edhe për të deleguar të drejtat e aksesit te shërbimet dhe entitetet e krijuara në mënyrë dinamike. Krijimi dinamik i i certifikatave proxy X. 509 për këtë arsye thjeshtëson menaxhimin e domaineve me shtresa të besuara, si

për kërkesat e shtresave VO . Sherbimi me Arkitekturë të Hapur Grid (OGSA) [8] fut më shumë mundësi dhe sfida në infrastrukturën Grid . Versionet e mëvonëshme të GT përpiqen për të trajtuar shërbimet e sigurisë të OGSA duke fokusuar funksionalitetin e sigurisë në polica .Policat e publikuara përfshijnë kërkesat e mekanizëmit , formate simbolike , rrënjë të besuara dhe parametrat e tjera . Shërbimet e ndryshme të sigurisë mund të përshkruhen si më poshtë :

- Shërbim përpunimi të besueshëm për menaxhimin e vlefshmërisë se bisedave autentike;
- Shërbimi bisede i besueshëm për të lidhur mekanizma të ndryshëm të besimit në domaine të ndryshme ;
- Shërbimi ihartëzimit të identitetit për delegimin e identitetit nga një domain në tjetër;
- Shërbimi i Auditimit për një log-in të sigurt në përdorimin e burimeve për përdorues të veçantë[8].

3.2 Siguria Clouds

Siguria në cloud computing ka qenë një sfidë që nga fillimi . Meqë shërbimet Cloud ofrohen nga një ofrues i vetëm ,infrastruktura është konsideruar si një entitet . Përdoruesit aksesojnë në shërbimet Cloud në internet dhe në këtë mënyrë janë të lidhur me rreziqet e aplikacioneve web dhe akses të largët mbi rrjetin publik .

Në të vërtetë, Clouds duhet të ballafaqohen me kërcënime të ngjashme me ato në aplikacionet tradicionale web dhe qendrat e të dhënave . Ka shumë mundësi për të shfrytëzuar Clouds me arkitekturën aktuale të rrjeteve të shërbimeve cloud. Siç është diskutuar në [9] , disa nga sulmet e mundshme të përmblidhen si më poshtë :

• XML mbështjellja e elementit të nënshkruar : Një përdorim i përbashkët i nënshkrimeve XML është autentifikimi dhe autorizimi në mesazhet Simple Object Access Protocol (SOAP) në shërbimet e web-it . Nëse mesazhi është përgjuar , trupi origjinal mund të zhvendoset për të futur një element të ri , ndërsa tagu i nënshkrimit në XML mbetet në mesazhin SOAP . Pra , mesazhi modifikuar SOAP mbetet si një kërkesë e vlefshme me një nënshkrim autentik nga zotëruesi , por që mbante një kërkesë nga sulmuesi. [6] .

• Phishing dhe sulmet e bazuar në browser: Cross-site scripting dhe phishing janë probleme të mëdha që lidhen me mekanizmat e e bazuara në browser. Mekanizmi i autentifikimit i bazuar në browser është gjithmonë një dritare për sulmet në Clouds sepse browser-at mbështeten në palët e treta për të dhënë argumente autentifikimi (argumentet SAML) për akses në shërbimet Cloud ,

• Injektim Malware në Clouds : Një sulm i thjeshtë në sistemin cloud do të injektojë një aplikim me qëllim të keq mbi platformë . Kjo gjithashtu përfshin implementimin e shërbimeve të rreme në rrjetin Cloud

• Spoofing meta- data : Një nga sulmet tradicionale për shërbimet e internetit është spoofing ku Web Service Description Language (WSDL) e thirrur nga një përdorues është ndryshuar me qëllim për të performuar disa veprime të tjera .

• Mohimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i shërbimit : Një sulmues “përmbyt” burimet Cloud , duke konsumuar fuqinë e llogaritjes së ofruesit dhe përdoruesit e ligjshëm do të përballen me mohimin e shërbimit (DoS) . Si rrjedhojë , burimet nga raste të tjera të shërbimit gjithashtu do të preken , pra , duke shkaktuar Dos indirekt në të gjitha shërbimet e tjera që ndodhen në të njëjtin server .

3.3 Përforcimi i sigurisë në Clouds

Me modelin aktual të shërbimeve cloud , ofruesit e shërbimeve cloud marrin përgjegjësinë per shërbimet që ato ofrojnë (IaaS , Paas , SaaS) . Pra , siguria e aplikacioneve që veprojnë në shërbime , kryesisht në platformën IaaS dhe Paas , mbetet përgjegjësi e klientëve . Zgjidhjet e sigurisë janë zbatuar kryesisht në nivelin e aplikimit . Rreziqet dhe implikimet e sigurisë në Clouds drejtohen drejt çështjeve te mëposhtme :

• Firewalls dhe Siguria e Rrjetit : Të firewalls dhe rregullat për grupet e ndryshme të përdoruesve janë përdorur për filtrimin e aksesit të paautorizuar në shërbimet që ndodhen në qendrën e të dhënave . Ofruesit e shërbimeve cloud zakonisht implementojnë firewalle virtuale , të cilat janë filtra paketë , që veprojnë si aplikacione në mjedisin cloud . Klientët mund të lidhen me shërbimet Cloud mbi rrjetet virtuale private (VPN) për akses të largët të sigurt , që u jep atyre një shtresë rrjeti të izoluar [2] .

• Menaxhimi i Besimi dhe Identitetit (IDM) : Për një autentifikim të të sigurt të bazuar në browser dhe kontroll aksesi, brenda një çertifikatë X. 509 është dërguar një shenjë SAML . SAML në këtë mënyrë zëvendëson informata të tjera identifikuese në certifikatë . Pra ,shenja SAML është kufizuar tek çelësi publik i çertifikatës e cila heq varësinë e browser-it nga pala e tretë për certifikatat . Kjo përmirëson modelin e besimit për një qasje të bazuar browser në shërbime Cloud [9] . Për të siguruar përdoruesit me kontrollin qendror të aksesit, një menaxhim i besuar identiteti (IDM) me direktori aktive implementohet në cloud dhe të gjitha operacionet e autentifikimit dhe autorizimit janë kryer brenda firewall -it.

• Ruajtja dhe Mbrojtja e kodit : ofruesit e shërbimeve Cloud duhet të sigurojnë ruajtje të të dhënave dhe mbrojtje te kodit për klientët . Të dhënat private te ndjeshme kërkojnë akses të privilegjuar dhe siguria për shërbimin duhet të deklarohet si nga ofruesit për përdoruesit në marrëveshjen e përdoruesit . Burimet qendrës së të dhënave në sistemin cloud janë të ndarë nga të gjithë klientët . Dhe kështu , ndarja e të dhënave dhe izolimi është gjithashtu një çështje parësore dhe duhet të ketë një kufi virtual për të dhënat e ruajtura në cloud . [1] . Retë mund të strukturohen në mënyrë të ngjashme si në arkitekturën Grid.

Me marrjen e një kërkese nga ana e përdoruesit ,SEC - AP mbledh kredenciale të përdoruesit dhe në hapin 2 , konsultohet me direktorinë aktive për autentifikim të kërkesës . Pas autentifikimit të suksesshëm ,SEC - AP dërgon përsëri një certifikatë X. 509 tek klienti si shenjë besimi**.**

4. Çështjet e përbashkëta midis Cloud dhe Grid Computing

Siç u përmend më parë , cloud dhe Grid Computing janë teknologji të ngjashme shumë çështje të përbashkëta. Gjërat më të rëndësishme që të dy teknologjitë kanë të përbashkët :

1. Cloud dhe Grid ofrojnë marrëveshje në nivel të shërbimit (SLAs) për të garantuar disponueshmërinë në kohë, të themi , 99 për qind . Nëse shërbimit shtrihet nën nivelin e shërbimit të garantuar , konsumatori do të marrë kredi të shërbimit për marrjen e të dhënave vonë . " [3]
2. Për të arritur shkallëzueshmëri të mirë , të dhënat duhet të shpërndahen mbi shumë kompjutera [2] .
3. Njerëzit mund të jenë të frikësuar nga dërgimi i të dhënave të ndjeshme përmes një numri të madh të kompjuterave . [2] .
4. Të dhënat mund të kërkohen pa marrë parasysh vendndodhjen e tyre [2] .
5. Të dy sistemet duhet të jetë në gjendje për të përcaktuar sasinë e burimeve të papërdorura [3]
6. Të dhënat duhet të zhvendosen në mënyrë të përsëritur në kompjutera të largët , e cila gjeneron ngushtimin e procesit , sespe te dhënat nuk janë gjithmonë në dispozicion kudo dhe nganjëherë është e nevojshme për të bërë këto të dhëna në dispozicion [2]

5. Ndryshimet midis Cloud dhe Grid Computing

Meqë objektivi jonë është që të njohim ndryshimet midis dy teknologjive sidomos ne aspektin e sigurisë, kemi listuar ndryshimet midis Cloud dhe Grid Computing:

- Cloud Computing zakonisht operon në një grup kompjuterash homogjene, por Grid operon në kompjutera heterogjene [2] .
- Grid Computing është përqëndruar zakonisht mbi një kalkulues intensiv , ndërsa Cloud Computing ofron dy lloje të kalkulesesh : Standarte dhe intensive [3] .
- Grid Computing është e open-source , ndërsa Cloud Computing nuk është . [4]
- Shumica e Grid përdorin një model të skeduluar llogaritjeje batch , ndërsa në cloud Computing të gjithë përdoruesit të ndajnë të gjitha burimet në të njëjtën kohë .
- Grid nuk mbështeten në Virtualizim aq sa Cloud mbështetet[2] .
- Cloud Computing nuk suporton shumë vjetërsi sikurse Grid bën [2] , i cili është një " histori e derivimit të një produkti data , si dhe procedurat që janë aplikuar për të prodhuar produktin e të dhënave " [2] .
- Llogaritja me performancë të lartë është më e mirë e suportuar në Grid Computing se në cloud Computing [2] .
- Grid është e shpërndarë , ka shumë komunitete kërkimi për përdoruesin (duke përfshirë përdoruesit që aksesojnë burime nga domaine të ndryshme administrativë) dhe është grupuar në organizatat Virtuale [3] . Cloud Computing , zakonisht ka vetëm një komunitet kërkimor dhe një grup të përbashkët administratorësh te sistemit kujdeset për të gjithë Cloud .
- Grid Computing , duhet të ndajnë ndërfaqet e përdoruesit dhe të burimeve në mënyrë që të lejojë ofruesit për të lidhur burimet e tyre , ndërsa Cloud Computing përpiqet për të ndarë vetëm ndërfaqen e përdoruesit , ndërsa ndërfaqet e burimeve janë të fshehura .
- Në Grid Computing, modeli i besimit është i bazuar në delegimin e identitetit , ku përdoruesit mund të aksesojnë burimet , të cilat nuk janë shumë të virtualizuara në site të ndryshme Grid . Në Cloud burimet janë abstraktuar dhe virtualizuar dhe ky model besimi nuk ekziston deri sa çdo gjë eshtë në të njëjtën re (cloud).
- Ndërsa në Grid , ruajtja e file-ve shumë të vogla (p.sh. file 1 - byte) nuk është ekonomikisht e përshtatshme , në cloud Computing është . [3]
- Qasjet e ndryshme për besimin dhe sigurinë janë të gjitha të përcaktuara në pikën e ndërveprimit me pikën e zbatimit , zakonisht e quajtur (Pika e Perforcimit të Policës) Policy Enforcement Point (PEP) , ose Access Control Enforcement Point (AEP) . PEP dërgon kërkesën për autorizim në Policy Decision Point (PPD) për vlerësim . PPD merr kërkesën për autorizim nga PEP dhe vlerëson kërkesën përkundrejt policave të autorizimit të marra nga Pika e Administrimit të Policave (PAP) . Me miratimin dhe vlerësimin e policës së suksesshme , rezultati është dërguar përsëri në PEP , i cili më pas vepron duke lejuar kërkesën për të vazhduar në VO .

6. Krahasimi midis Zgjidhjeve të sigurisë në Cloud dhe Grid Computing

Në ditët e sotme , duke e ditur se Grid Computing është një teknologji shumë më e maturuar se Cloud informatikë , ne do të pranojmë se siguria është më e mirë në Grid se në cloud Computing . Ky mendim është ndarë nga Ian Foster , Yong Zhao , Ioan Raicu dhe Shiyong Lu [2] i cili ka thënë se " Modeli i sigurisë Cloud Computing duket të jetë relativisht i thjeshtë dhe më pak i sigurtë se modeli i sigurisë të adoptuar nga Grid Computing . " . Duke folur për mënyrën se si një software konsiderohet normalisht sigurt apo jo , ne mund të mendojmë për procesin e implementimit , ku testimi është bërë dhe të këqijat janë nxjerrë nga kodi . Pastaj është bërë krahasimi me cloud Computing , e cila është më pak e testuar se Grid Computing , ndoshta në të ardhmen më shumë të meta do të zbulohen . Për të krahasuar sigurinë Cloud dhe Grid , ne do të përdorim çështje të sigurisë nga pjesët e mëparshme dhe të tregojmë dallimet kryesore:

- Për sa kohë që Cloud Computing ka platforma më homogjene dhe Grid Computing ato më heterogjene dhe burime dinamike , Grid duhet të konsiderojë disa çështje që Cloud Computing nuk i pëlqen, sign –in të vetëm për të aksesuar në faqet e shumta të Grid , privatësinë , integritetin [2] .
- Përdoruesit Cloud mund të përdorin Cloud me thjeshtësi dhe menjëherë përmes një karte krediti, ndërsa siguria Grid është me strikte dhe nuk i ka këto karakteristika[2] .
- Qasja e rreptë të sigurisë e dhënë nga Grid Computing rrit sigurinë , duke ndihmuar për të parandaluar akses të paautorizuar [2] , ndërsa Cloud Computing nuk ka.

- Përcaktimi i një kornizë e cila do të përdoret për programin për cloud jep një mundësi shtesë për të menaxhuar sigurinë , ndërsa sistemi më i hapur i dhënë nga Grid nuk e bën[3] .
- Grid Computing , duhet të ndajë ndërfaqet e përdoruesit dhe burimeve për të lejuar ofruesve që të lidhin burimet e tyre , ndërsa Cloud Computing përpiqet për të ndarë vetëm ndërfaqen e përdoruesit , ndërsa ndërfaqet e burimeve janë të fshehur a.
- Meqë Cloud Computing mbështetet në aplikimet web , ajo ka dobësitë e aplikacioneve web , të cilat Grid nuk i kanë .
- Në Grid Computing të gjitha burimet janë të ndarë me përdorues të tjerë në mënyrë Siguria e makinerisë -së nuk duhet të kompromettuar . Në Cloud Computing , Virtualizimi është bërë normalisht direkt me mbështetjen e metodave të virtualizimit të proçesorëve , kështu që burimet mund të aksesohen në mënyrë abstrakte dhe më të sigurt .
- Grid Computing duhet të ketë IDs të shumta [5] , ndërsa Cloud Computing ka nevojë vetëm për një të tillë .
- Në Grid Computing , integriteti i të dhënave dhe konfidencialiteti duhet të merren parasysh . Integriteti nuk është normalisht i detyrueshëm në cloud computing , pasi që informacioni juaj është tashmë brenda një mjedis virtual , por fshehtësia është e nevojshme për të parandaluar sulmet.

6.1 Metodat që mund të përdoren për të dyja teknologjitë

Disa metoda që në ditët e sotme janë përdorur nga një prej teknologjive mund të përdoren në të ardhmen për të bërë tjetrën më të sigurt . Kjo është një çështje shumë interesante për shkak të mungesës së testimit që është bërë tashmë me cloud Computing për shkak të moshës së re të saj . Disa mundësi do të jepet në këtë pjesë :

• Siç u përmend më parë , Trusted Computing Group(TGC)[9] propozuan modulin Trusted platforme (TPM) , e cila është një chip me çelës Privat dhe algoritme kriptografike , të cilat nuk mund të rishkruhen . Kjo metodë është propozuar në cloud Computing , por , pasi që i njëjti chip mund të përdoret në domaine të ndryshme të Grid , duke përdorur kriptografinë e çelësit publik për të siguruar komunikimin .

• Një tjetër gjë që mund të konsiderohet janë metodat e menaxhimit të mardhënieve të besimit të përdorura në Grid Computing.

Në ditët e sotme , meqë APIs e përdorur nga ofruesit e ndryshme Cloud nuk janë të zakonshme dhe meqë nuk është shumë e mundur për të kombinuar ofruesit e shumte Cloud në të njëjtën kohë për shkak të mungesës së APIs standarde ,menaxhimi i marrëdhënieve të besimit nuk është i nevojshëm , por në qoftë se ne mendojmë për të ardhmen , ku ofruesit Cloud bien dakord të përdorin APIs të përbashkëta dhe mundësia e ndarjes së të dhënave dhe të kombinimit të reve të bëhet e mundur , metodat e menaxhimit të marrëdhënieve të besimit të përdorura në Grid mund të jenë te dobishme për cloud Computing .

7. Konkluzione

Në këtë artikull , kemi diskutuar në lidhje me teknologjitë aktuale në Grid dhe Cloud Computing , parë në këndvështrimin e arkitekturave të tyre dhe parimet e sigurisë . Për shkak se Grids kanë evoluar gjatë një periudhe më të gjatë , ata kanë arkitekturë më të maturuar të sigurisë . Unë kam treguar një numër të qasjeve dhe përshkrimet e mekanizmave të sigurisë që konsiderojnë Grids dhe Clouds . Pra , unë ilustruar problemet e rrjeteve Cloud dhe teknologjitë aktuale të përdorura për të kapërcyer pengesat . Kemi kontribuar duke propozuar një arkitekturë të thjeshtuar të nivelit të shërbimit , për të implementuar një sistem të sigurt të kontrollit të aksesit Megjithatë, teknologjia Cloud është ende ne evoluim dhe asnjë zgjidhje ende nuk mund të thuhet si mënyra më e mirë .

Shumë prej teknologjive janë sot në treg dhe disa prej tyre ndajnë veçoritë e tyre . Në këtë rast , siç është demonstruar , zgjidhjet tashmë ekzistuese të sigurisë mund të përdoren për teknologjitë e tjera . Përveç kësaj , në disa çështje të veçanta , teknologjitë e reja mund të jenë më të sigurta se ato të vjetra për shkak të projektimit të zgjidhjeve të reja të mund të jenë më të përshtatshëme për të shmangur problemet e sigurisë dhe do ta bëjnë këtë detyrë shumë më të lehtë .

Lidhur me këtë çështje , në këtë paper kam treguar se si teknologjitë e modulit Trusted platforme (TPM) të propozuar nga Trusted Computing Group (TGC) mund të përdoren për Cloud Computing siç është propozuar , por ajo mund të përdoret në fusha të ndryshme të Grid Computing , si dhe për të siguruar komunikimin përmes kriptografisë së çelësave publikë. Në anën tjetër , duke parë në të ardhmen , kemi konsideruar duke përdorur metodat e menaxhimit të mardhënieve të besimit , si ato të përdorura në Grid Computing , për t'u përdorur në cloud Computing kur ndërtimi i APIs të përbashkëta që lejojnë ndarjen e të dhënave mes të ofruesve Cloud .

8. Referencat

[1] Ian Foster. *What is the Grid? A Three Point Checklist.* July 2002. Argonne National Laboratory & University of Chicago

[2] Foster, I.; Yong Zhao; Raicu, I.; Lu, S. *Cloud Computing and Grid Computing 360-Degree Compared*. 2008.

[3]Judith M. Myerson . *Cloud computing versus grid computing*. March 2009. EECS

[4] Marc-Elian Begin. *Comparative Study: Grids and Clouds, Evolution or revolution.* May 2005.

[5] Marty Humphrey,Mary R. Thompson. *Security Implications of Typical Grid Computing Usage Scenarios*. 2009

[6] Michael McIntosh and Paula Austel. *XML signature element wrapping attacks and countermeasures*. 2005.

[7] V.Welch, I. Foster, C. Kesselman, O. Mulmo, L. Pearlman, J. Gawor, S. Meder, and F. Siebenlist. X.*509 Proxy Certificates for Dynamic Delegation*.2004.

[8] N. Nagaratnam, P. Janson, J. Dayka, A. Nadalin, F. Siebenlist, V. Welch, I. Foster, and S. Tuecke. *The Security Architecture for Open Grid Services. Technical.* 2002

[9] Jensen, M. and Schwenk, J. and Gruschka, N. and Iacono, L.L. *On Technical Security Issues in Cloud Computing.2009*

EUROPEAN ECONOMY UNDER AUSTERITY AND THE ALBANIAN ECONOMIC PERSPECTIVE

MSc. Florian MITI*

Prof. Dr. Albert Qarri

Msc. Blerina Dervishaj

Economics and Sustainable Development,

Department of Economics- University of Vlora.

Abstract

This article considers some anti-crises fiscal and monetary policies in the euozone and the main features of the Albanian economy in the light of the latest developments of the Albanian institutions to cope with the aftermaths of the global crises. A post reform analysis seems to give credit to the fact that eurozone's policymakers adopted austerity because of pre-crisis economical conditions so they were left with no other alternatives. The over restricted austerity measures adopted in the eurozone, are considered by Krugman in a regression with the growth rate in the period 2008-2012, showing a negative correlation between the two variables.
Finally, the Albanian structural reforms under implementation, give some encouraging results about GDP growth rate and the total public debt in the nearest future while running a "stress test".

Keywords: Austerity, economic crisis, structural reforms, devaluation, growth.

Introduction

The first part of this article presents the European economy and the recent developments by considering the fact that the last economic crisis forced radical adjustments in many member states of the eurozone as austerity.

In contrast with the USA, many European countries are still facing multiple troubles: high unemployment rates, deflationary pressures, GDP growth rate quite low and rising public debts.

Many economists believe that the austerity adjustments undertaken, did indeed worsen these indicators showing that countries performing worse than the others (e.g. with higher credit risks) before crises were the ones who suffered more restrictive conditions which has led then to a lower growth.

The second part considers the main economic indicators for Albania showing that the overall performance of the Albanian economy is stable even though seriously affected by the global crises. Many structural reforms are currently taking place will be implemented within 2016, while "stress test" scenarios predict positive results for the main economic indicators in the coming years.

I- European Economy under Austerity

Despite the prompt and vigorous response of many European countries to cope with the last financial and economical crisis, little tangible results have been seen so far. The overall European GDP growth rate is slightly higher than one percent, while national GDP-s of France, Spain and Italy are still declining.

On the other hand, if we look at the total eurozone's unemployment rate, we come up with a striking 12 % and dramatic peaks for Spain (26 % in the fourth quarter of 2013), and Greece (27,6 % in the same period).

Beside high unemployment rates and slowly growth, the annual inflation rate, at a timid 0.5 % in March 2014[1], can make prices quite nasty even to little shocks.

This crises forced radical adjustments as austerity although being in economical recession already in almost all eurozone countries so that now there is a vivid debate among the economists regarding the success of this policy.

---

* Lecturer at University of Vlora "Ismail Qemali"

[1] Source : European Central Bank

According to Lorenzo Smaghi[2], it is not austerity which has caused low growth, but the pre-crisis growth that lastly caused austerity. According to him, European policy makers, implemented austerity because they arrived at a point where they had no other choices.

The author uses a chart of Paul Krugman[3] to illustrate the negative (strong) correlation between austerity measures implemented by Eurozone countries (measured by the IMF in the period 2008-2012) and the growth rate over the same period since that the magnitude of the coefficient is higher than 1. Krugman's conclusion from these findings is that austerity is not the best way to cure public finances.

Chart_1.



As it can be seen, from the graph above, the results are biased because of Greece that can be considered as an outlier but, if the regression is run without Greece, the negative correlation still holds, even though it's magnitude is weaker now (see Chart 2 below).

Chart_2

[2] Visiting Professor at Harvard University
[3] New York Times Op-ed (Krugman 2013)



Authors like Martin Feldstein (2014)[4], propose other alternatives like sharply devaluating the euro so that a weaker euro would raise the costs of imports and potential prices of exports thus, increasing the inflation rate. It would also increase the average GDP in eurozone by stimulating exports and directing internal demand to domestic goods and services, thus improving the foreign balance with the rest of the world.

Given the ECB's mission of keeping inflation below 2 %, devaluation might be a tricky job, since the question is how to reduce the Euro's relative value while keeping its stability perception to the economic agents. The author suggests that the only way is by direct intervention in the currency market, by selling euro and buying other currencies.

Manasse P. and Baldini I. (2013) have shown that the crisis has slowed down the process of convergence between European economies. This has happened, due to mainly unsolved structural problems (rigidities in product and labour markets) within member states, facing demand shocks, austerity and credit crunches of different sizes.

According to Wood, R. (EconoMonitor 2013), austerity and internal devaluation are failing because rigidities in labour markets, preclude market forces (e.g. high unemployment) from driving down nominal wages sufficiently. Furthermore, there is insufficient competition in product markets in deficit countries and, consequently, domestic good prices do not fall simultaneously with nominal wages.

Suggestions to overcome this situation are various but can be synthesized by the fact that the economic stimulus must come from budgets that inject more money into the economy then they take away; by combining prices and wages policies and overt money financing budget deficits alongside with deeper structural and pro-growth reforms and, more gradual fiscal adjustments in the eurozone.

[4] Professor of Economics at Harvard University

II- The Albanian Economic Perspective

The ultimate global crisis exerted significant pressure on the Albanian economy. Particularly, regarding the strong economic trade connections with Italy and Greece, the crisis in these countries was reflected in the reduction of remittances and exports in the Albanian economy, which led to a significant slowdown of economic growth.

Chart_3: Quarterly GDP trend.



Source: INSTAT

During the first three quarters of 2013, the cumulative growth estimated from INSTAT was 0.4 percent, showing a significant reduction of the relative growth of 1.3 percent in 2012.

Growth is estimated to be generated almost entirely by foreign demand, mainly due to increased exports of goods by about 16 percent and falling imports by about 6 percent. While domestic demand despite a fiscal stimulus injected during the first half of 2014 remains quite weak. Private investment is estimated to be the weakest component of domestic demand and private consumption remains quite tepid.

The negative performance of private demand reflects also the internal consistency of tight financing conditions faced by private agents since the interest rate of loans, has remained at high levels, despite the monetary

policy followed by the Bank of Albania to reduce systematically the base interest rate.

The economic environment and financial pressures lead to a weak inflation during the past two years. The negative gap has also stopped the growth of labour costs per unit and has created an environment of low inflation pressures. On the other hand, imported inflation is slowing down, reflecting both a downward trend of inflation in Albanian trading partners as well as a stable exchange rate.

The average annual inflation in 2012 was 2%, being so within the limits of tolerance around the Bank of Albania.

The Albanian Ministry of Finance, by running a "stress test" has lately delivered some alternative scenarios about GDP (real) growth and Total Public Debt (as % of GDP) for the nearest future.

Chart_4: GDP Growth rate scenarios: baseline, pessimistic and optimistic.



Source: Ministry of Finance

Chart_5: Total public debt (%of GDP): baseline, pessimistic and optimistic.



Source: Ministry of Finance

In 2013, The total public debt, including its stock and the unpaid bills of the previous government is estimated to be 70,43 % of GDP where foreign debt is nearly 26,74 % of GDP.

This estimation of foreign debt portfolio of about 2589 million Euro, is distributed among three main currencies: EURO, USD and YEN, where the highest % is held in EURO as the shown in the figure below:

Chart_6 : Foreign debt in currency



Source: Ministry of Finance

Since the majority of the stock is in Euro, it makes the portfolio to be more exposed to exchange rate risks in the short term. Thus, a devaluation scenario of the EURO form the ECB, like the ones described in the first part, would be highly profitable for the Albanian government for paying these debts.

III-Main structural reforms

Main structural reforms in the goods and capital markets:

- Private Sector Development Policies consist in comprehensive reform of the legal and regulatory of business framework, aiming to improve the business climate, reducing administrative barriers; and implementation of the Small Business Act, SBA.
- Implementation of the Business Innovation and Technology.
- Reduce the cost and time of registering a new business.

- Simplification of licensing procedures.

Fighting informal economy:

- Increasing inspections by the State Labour Inspectorate;
- Frequent controls from Task Force Unit in the Department of Tax Investigation;
- Increasing use of fiscal devices.

Privatizations in strategic and non strategic sectors between 2014-2016:

- Privatization of the remaining state-owned package inf ARMO (14.9 % with an estimated value at around 22 million Euro).
- Privatization of the remaining 24 % package share in OSSH;
- Privatization of Albpetrol.

Reforms in the energy sector:

- Liberalization of the energy market, the introduction of private operators;
- In the context of market openness, significant investments are being undertaken to increase the transmission capacity and interconnection networks;
- Construction of big and medium HPP-s like Skavica, Devoll, Vjosa;
- Interaction with regional network of natural gas (TAP project);
- Developing the domestic transmission network and interconnection of electricity;
- Efficient use of energy;
- Developing the mining industry.

Reforms in financial sector.

In order to encourage the lending, regulatory changes will consider:

- Removal of capital requirements for annual growth of the credit stock if it is between 4% -10%;
- Increasing capital requirements for additional investments in banking sector for non-resident financial institutions;
- A general reduction by 5 % points of regulatory requirement in the level of minimum ratio of total liquidity, for the LEK and other currencies, compared to the existing level, according to the banks risk profile.

Reforms in the labour market through:

- Active state policies for increasing the employment,
- Employment promotion programs,
- Professional trainings,
- Unemployment benefits program,
- Labour Inspectorate,

- Offering quality education and professional training for youth and adults to meet the labour market needs,

Other reforms regarding:

- *Administrative reforms;*
- *Civil servant reforms,*
- *Review of Legislation for Planning and Territorial Development,*
- *Institutional and legal reforms in the field of tourism;*
- *Reforms in justice and*
- *Agricultural reform*

Conclusions

In many European countries, austerity has certainly caused low growth, but it was also the last option policymakers had to take since pre-crises conditions were characterised by unbalanced growth performances, pre-existing supply side structural problems in the markets of goods, labour mobility barriers (different languages and cultures) and loss of competitiveness in many member states.

The way out of this situation should rely on the fact that the economic stimulus must come from budgets that inject more money into the economy then they take away; combining prices and wages policies and overt money financing budget deficits alongside with deeper structural and pro-growth reforms and more gradual fiscal adjustments within the eurozone.

Global crisis has affected Albanian economy as well, “imported” especially form its biggest trading partners, Italy and Greece. GDP growth is actually at the historical minimum but yet positive, while monetary policy of the Bank of Albania is following the same line of FED and ECB.

Some structural reforms are already under implementation and show encouraging positive results about GDP growth rate and the total public debt for the nearest future.

References

Bini Smaghi, L. (2013): “Austerity and Stupidity”, VoxEU, 6 November.

Bini Smaghi, L (2013): “Austerity: European Democracies against the Wall”, CEPS

Blanchard, O. and D. Leigh (2013): “Growth Forecast Errors and Fiscal Multipliers”, IMF working paper 13/1.

Feldstein, M. (2014): “A weaker Euro for e stronger Europe”, Project Syndicate, 30 April.

Krugman, P. (2013): “How the Case for Austerity has Crumbled”, The New York Review of Books, 6 June.

Krugman, P. (2013): "The IMF on the Austerity Trap" New York Times, 10 March.

Manasse, P. (2013): “What’s wrong with Europe”, Centre for Economic Policy Research, Policy Insight No. 67.

Wood, R. (2013): “Europe: The Failure of Internal Devaluation, EconoMonitor, 13 November.

Institutions and Websites:

Bank of Albania-www.bankofalbania.org/

European-Central-Bank-http://www.ecb.europa.eu/

Eurostat News Release-Euro area unemployment rate at 12.1%-April 30, 2013

INSTAT-www.instat.gov.al/

Ministry of Finance-www.minfin.gov.al/

TradingEconomics-http://www.tradingeconomics.com

FORMAT E REJA TË PËRCAKTIMIT TË ATËSISË
(Rasti i Shqipërisë dhe përqasja e tij me sfidat e reja)

Autor; Jonada Zyberaj

Pedagoge pranë Universitetit "Ismail Qemali"

Departamenti i Drejtësisë

E Drejtë Familjare

Adresa: Universiteti "Ismail Qemali", Godina B, Vlorë

Email; jonadazyberaj@gmail.com

Instituti i prindërimit ka pësuar ndryshime të mëdha si rezultat i trendeve të reja sociale. Por pavarësisht ndryshimeve ai vazhdon të mbetet një prej institutive më të rëndësishëm të të drejtës familjare përmes të cilit përcaktohet statusi i fëmijës. I parë më tepër si një koncept ligjor, prindërimi nuk është domosdoshmërisht i lidhur me origjinën ose lidhjet biologjike të fëmijës.

Përcaktimi i amësisë sipas parimit "*madre es sempre certa*" dhe përcaktimi i atësisë bazuar në parimin e prezumimit ose atë të njohjes së atësisë, nuk janë më të vetmet parime që shërbejnë në përcaktimin e këtyre institutive. Parimi i "dhënies së pëlqimit" duket të jetë forma e re në përcaktimin e atit ligjor.

Ky punim ka për qëllim, që përmes analizës dhe krahasimit të legjislacionit Britanik (si një prej modeleve më liberal të legjislacioneve te vendeve Europiane, i cili ka parashikuar format e reja të përcaktimit të atësisë në rastet e riprodhimit artificial), të japi një paraqitje të parimeve, që aplikohen për përcaktimin e atësisë në rastet e riprodhimit artificial në mënyrë, duke sjellë një shembull për rastin Shqiptar.

Fjalët kyçe: *Atësi, pëlqim, prezumim, njohje e atësisë.*

Hyrje

Në Shqipëri, ligji mbi "Shëndetin Riprodhues" parashikon jo vetëm mënyrën natyrore të riprodhimit por për herë të parë edhe mundësinë për të përdorur metodat e riprodhimit artificial në rastet e infertilitetit. Ligji mbi "Shëndetin Riprodhues" parashikon edhe riprodhimin artificial heterolog përmes të cilit fertilizimi i vezëve të gruas bëhet nga sperma e një dhuruesi. (Ligji "Mbi Shendetin Riprodhues, 2003) Aplikimi i të tilla teknikave çon në dallimin midis babait biologjik dhe atij ligjor të fëmijës. Ky dallim ngre një pyetje thelbësore; cili prej të dyve do të ushtrojë përgjegjësinë prindërore? Si do të realizohet përcaktimi i atësisë?

Përcaktimi i atësisë shihet si një moment shumë i rëndësishëm pasi sjell pasoja personale dhe pasurore jo vetëm midis dy personave (babait dhe fëmijës) por në të njëjtën kohë ndikon edhe në marrëdhëniet midis tyre dhe të tretëve duke qënë se është përcaktues i statusit të fëmijës në shoqëri. Atësia sjell implikime private dhe publike të cilat përcaktojnë se si marrëdhëniet private dhe familjare drejtohen nga ligji.

Ndërkohë që amësia më së shumti është e qartë dhe e thjeshtë për t'u përcaktuar, në përcaktimin e atësisë ka patur gjithmonë një dozë "*misteri"*

"Kush është babai?" është kjo pyetja kyçe për fëmijët e lindur jashtë martese dhe për ata të lindur nga një marrëveshje mbi riprodhimin artificial heterolog apo surrogacie.

Atësia, ashtu si amësia, zakonisht ka patur për bazë lidhjet e gjakut por gjithashtu është përcaktuar edhe mbi bazën e sjelljes. Sjellja e interpretuar në kuptimin prindëror, përfshin sigurimin për ushqim dhe edukimin e fëmijës, marrjen pjesë në rritjen e tij dhe shprehjen e shqetësimit për fëmijën. (Rachel G. Fuchs, 2008)

Shembuj të sjelljes atërore mund të gjenden nga e drejta Romake si *pater familias* e deri tek legjislacionet moderne si *birësuesi*.

Instituti i njohjes së atësisë ka për qëllim arritjen e së vërtetës në përcaktimin e babait biologjik të fëmijës. Me përjashtim të disa rasteve, në përcaktimin e atësisë lidhjet biologjike kanë prioritet dhe konsiderohen të një interesi të vecnatë në ndërtimin e marrëdhenies prind-fëmijë. Metodat e riprodhimit artificial duket se nuk e kanë marrë parasysh nevojën për të zbuluar "të vërtetën" mbi babain gjenetik të fëmijës, për sa kohë ato ia atribuojnë të drejtën për t'u njohur si ati ligjor i fëmijës partnerit të nënës, duke mohuar kështu në disa raste të drejtat prindërore të babait biologjik.

Në pjesën e parë të këtij punimi do të bëhet një paraqitje e institutit të prindërimit dhe evoluimit të tij duke u përqëndruar në veçanti në përcaktimin e atësisë gjatë tranzitimit nga babai biologji tek ati ligjor. Në pjesën e dytë të punimit do të jepen parashikimet dhe metodat e reja të përcaktimit të atësisë në rastet e riprodhimit

artificial duke marrë si referencë legjislacionin Britanik. Se si legjislacioni shqiptar e përcakton atësinë dhe cila do të jetë përqasja e tij mbi aplikimin e metodave të riprodhimit artificial do të analizohen në pjesën e tretë.

Qëllimi i këtij punimi është të përpiqet ti japi përgjigje pyetjes "kush është babai ligjor?" përmes analizës së metodave të përcaktimit të atësisë sipas legjislacionit Britanik, i cili njihet si një prej legjislacioneve më liberal të Evropës, duke i dhënë kështu një mundësi referimi legjislacionit shqiptar i cili ende nuk është përballur me këto cështje të reja ligjore.

I. Nga babai "biologjik" drejt "atësisë" ligjore

Atësia si një koncept me shumë dimensione mund të analizohet në një këndvështrim social, ligjor dhe biologjik. Ligjërisht atësia përkufizohet si "statusi i të qënit prind dhe përgjegjësitë, që ai përfshin", përkufizim i cili përfshin si statusin biologjik dhe atë ligjor të prindit. (Në oxforddictionary.com)

A janë lidhjet biologjike të mjaftueshme dhe të domosdoshme për të përcaktuar prindin ligjor?

Një person mund të jetë prind pasi ai është paraardhësi biologjik i fëmijës. Por jo gjithmonë lidhjet biologjike përcaktojnë atësinë. Sipas të drejtës Romake, martesa ishte po ashtu një element thelbësor në përcaktimit e atësisë pasi riprodhimi konsiderohej vetëm si një e drejtë martesore, "…çdo akt martesor duhet domosdoshmërisht të ruajë marrëdhënien e saj të brendshme për lindjen e jetës njerëzore". (James T. Bretzke, SJ, 2013) Në këtë kuptim e drejta romake lidhte ngushtësisht institutin e prindërimit me atë të martesës. Fëmijët e lindur jashtë martese konsideroheshin të jashtëligjshëm dhe nuk gëzonin të njëjtin status dhe të njëjtat të drejta me fëmijët legjitim. Fëmijët e paligjshëm ndaheshin në dy kategori; fëmijët "natyror", që kishin lindur nga një bashkëjetesë e qëndrueshme midis një burri dhe një gruaje edhe pse jo të lidhur në martesë dhe fëmijët e lindur nga një burrë dhe një grua të palidhur as në martesë dhe as në konkubinat të cilët njiheshin si "spurious" ose "bastard". (R. D. Melville)

Fëmijët legjitim e përfitonin statusin nga ai i atit të tyre në kohën e konceptimit, kurse statusi i fëmijëve të jashtëligjshëm përcaktohej nga statusi i nënës së tyre në momentin e konceptimit. E drejta romake nuk parashikonte asnjë lloj marrëdhënie apo të drejta dhe detyrime midis fëmijëve të paligjshëm dhe babit të tyre.

Me zhvillimin e të drejtës romake gjatë periudhës Kristiane u parashikuan tre forma legjitimimi;

a. *legitimatio pur subseqeuns matrimonium*, kjo ndodhte kur fëmijët e lindur nga një lidhje konkubinati legjitimoheshin si rrjedhojë e martesës ligjore të prindërve të tyre.
b. *legitimiatio per curiae obligationem*, e cila realizohej kur babai e prezantonte fëmijën e tij të paligjshëm si pjesë të kurisë.

c. *legitimatio per rescriptum principe,* njihej në rastet kur legjitimimi realizohej përmes një urdhëri të perandorit. (A. E. Boniface, 2007)

Përmes proçedurës së legjitimimit një fëmijë i paligjshëm fitonte status të plotë me atë të fëmijës së ligjshëm.

Edhe në vendet common law përqasja ndaj fëmijëve të jashtëligjshëm ishte e njëjtë.

Fëmijët e lindur jashtë martese quheshin *"filius nullius",* që do të thoshte se nuk ishin fëmijë të askujt dhe se nuk mund të gëzonin të njëjtin status me fëmijët e ligjshëm.

Përcaktimi i atësisë së fëmijëve të lindur jashtë martese nuk ishtë më një problem kur gjatë Shekullit të XX statusi i tyre u barazua me atë të fëmijëve të lindur nga martesa. Deri në atë kohë martesa kishte shërbyer si një mënyrë e përshtatshme për të zgjidhur problemin e atësisë. *Pater est quem nuptiae demonstrate-* (babai është personi me të cilin është martuar nëna) ose i njohur ndryshe si prezumimi i atësisë, lidhte ligjërisht burrin me fëmijën e lindur nga bashkëshortja e tij. Sipas këtij parimi prezumohet se bashkëshorti i gruas është babai biologjik i fëmijës së saj. Kjo lidhje e fortë midis përcaktimit ligjor të atësisë dhe statusit marital të nënës motivohet nga nevoja e mbrojtjes së unitetit të familjes dhe interesit më të lartë të fëmijës. Kaq i fortë ishte parimi i prezumimit sa çdo person i tretë ishte i ndaluar të kundërshtonte atësinë e burrit të martuar. (J. Ives 2007) Me rritjen e numrit të fëmijëve të lindur jashtë martese u theksua nevoja e përcaktimit të lidhjeve gjenetike midis atit dhe fëmijës.

Në këtë kontekst, me qëllim përcaktimin e lidhjeve gjenetike u parashikua një institut tjetër, ai i "kundërshtimit të atësisë". Nëse ka dyshime se midis bashkëshortit të nënës dhe fëmijës nuk ka lidhje biologjike, ligji e njeh atë si ati i fëmijës deri sa vetë ati i prezumuar apo persona të tjerë të legjitimuar të kërkojnë kundërshtimin e atësisë.

Për fëmijët e lindur jashtë martese atësia përcaktohet përmes proçedurës së "njohjes" së atësisë. Ky institut fillimisht u parashikua për të përcaktuar atësinë vetëm te fëmijët e lindur jashtë martese dhe jo për ata të lindur nga martesa. Me parashikimin e institutit të "kundërshtimit të atësisë", "njohja e atësisë" aplikohet edhe në rastet kur atësia e prezumuar është kundërshtuar përmes një proçedure përpara një organi publik.

Ashtu si edhe Richard vëren "…më përpara atësia ishte diçka që duhej të zotërohej ose një status, që duhej të fitohej tani duket se është kthyer, të paktën nga pikëpamja ligjore, si diçka që duhet të përcaktohet nga AND." (Richards 2003)

Përkufizimi i Richard duket se nuk përbën të vetmin qëllim në përcaktimin e atësisë pasi ndryshimet e reja në shoqëri dhe në familje me përdorimin e metodave të riprodhimit artificial sollën, që çelësi në përcaktimin e atësisë të mos qëndroj më

në lidhjet biologjike midis atit dhe fëmijës edhe pse ka ende legjislacione të cilat besojnë dhe i qëndrojnë parimit se lidhjet gjenetike duhet të jenë i vetmi kusht për të përcaktuar atësinë.

Disa autorë tregojnë se trendi i ligjeve europiane mbi prindërimin ka tre element të përbashkët: *barazimin*; eleminimin e diskriminimit ne bazë të lindjes, të fëmijëve të kategorive të ndryshme (të ligjshëm dhe të paligjshëm), *liberalizimin;* në kuptimin e heqjes së kufizimeve të shumta mbi vendosjen dhe kundërshtimin e atësisë dhe *modernizimi;* duke i përshtatur ligjet e prindërimit me teknikat e reja të riprodhimit artificial, të cilat bëjnë të mundur konceptimin e fëmijës në mungesë të aktit seksual. (Senaeve 1993)

II. Format e reja të përcaktimit të atësisë. Parimi i "dhënies së pëlqimit"

Shekulli i XX-të solli ndryshime të mëdha sociale të cilat më vonë u reflektuan duke sjellë ndryshime ligjore. Që prej vitit 1978 koncepti i familjes dhe prindërimit është duke ndryshuar me shpejtësi. Atësia dhe amësia nuk janë më të ndërtuara mbi bazën e lidhjeve të gjakut duke qënë se metodat e riprodhimit artificial ndajnë konceptin e riprodhimit si një akt seksual duke mundësuar realizimin e tij përmes dhurimit të vezëve apo të spermës. Koncepti i atit ka kaluar nga ai që përcaktohej si paraardhësi i fëmijës në personin, që ka dëshirën dhe **qëllimin** për të patur fëmijë. Në kontekstin e teknikave të riprodhimit artificial qëllimet janë zegjdhje vullnetare, të qëllimshme, të cilat shprehin dhe bien dakort për t'u prezumuar si prindër ligjor. (Barlett 1988) Prind "i qëllimshëm" është ai që merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e një prindi. Sipas autorëve, që mbështesin këtë teori "…prindërimi është thelbësisht një marrëdhënie morale sesa biologjike". (Fuscaldo 2006)

Një tjetër element i rëndësishëm dhe thelbësor në përcaktimin e atësisë në rastet e riprodhimit artificial është edhe **"pëlqimi"**. Pëlqimi është shprehja së jashtmi e qëllimit. Burri që ka dëshirën të jetë ati i fëmijës së lindur përmes këtyre metodave duhet të ketë jo vetëm qëllimin por ai duhet të japi pëlqimin për realizimin e tyre.

Shumica e shteteve europiane, që kanë pranuar si metoda të riprodhimit artificial aplikimin e metodave heterologe dhe te surrogacisë, e kanë legjitimuar parimin e pëlqimit. Vendet europiane, për sa i përket teknikave të riprodhimit artificial ndjekin kryesisht dy modele: atë të konsideruar si të ngurtë dhe tjetrin, që konsiderohet më liberal. Duke patur parasysh se studimi i parimeve te reja të përcaktimit të atësisë bazohet në aksesin tek metodat e riprodhimit artificial do të merret si shembull analiza e legjislacionit Britanik.

Kjo formë e re e përcaktimit të atësisë përmes parimit të dhënies së pëlqimit do të zbatohet në ato raste kur ati i fëmijës nuk është paraardhësi i tij, pasi janë realizuar metodat e riprodhimit artificial përmes pjesmarrjes së dhuruesit.

Ky konfirmim pohon se në rastet e riprodhimit artificial homolog (ku materiali gjenetik u përket të dy prindërve) edhe pse konceptimi i fëmijës nuk ndodh nëpërmjet aktit seksual, atësia e tij do të përcaktohet si në rastet klasike. Nëse fëmija ka lindur nga martesa, atësia do të përcaktohet duke zbatuar parimin e prezumimit. Ati ligjor i fëmijës është bashkëshorti i nënës. Nëse fëmija ka lindur jashtë martese, atësia do të përcaktohet duke zbatuar parimin e njohjes së atësisë në aktin e lindjes ose përpara një organi publik.

Për fëmijët e lindur si rrjedhojë e zbatimit të inseminimit artificial (raste kur dhuruesi nuk është partneri i nënës), vendet europiane mbajnë të njëjtin qëndrim në lidhje me dhuruesin e spermës. Dhuruesit e spermës nuk trajtohen si ati ligjor i fëmjës ndërkohë bashkëshortët, që japin pëlqimin bashkëshorteve të tyre trajtohen si të tillë. (Schwenzer 2007)

Sipas Aktit Anglez të Fertilizimit Njerëzor të 1990 (HFEA 1990)

28 (2) Nëse—

(a) në kohën e vendosjes së embrionit ose të spermës dhe vezëve ose në kohën e inseminimit të saj, gruaja ka qënë e lidhur në martesë, dhe

(b) krijimi i embrionit i mbajtur nga ajo nuk është realizuar me spermën e bashkëshortit të saj,

atëherë në bazë të pikës (5) më poshtë, bashkëshorti do të trajtohet si ati i fëmijës përveç rastit kur tregohet se ai nuk ka dhënë pëlqimin për vendosjen tek bashkëshortia e tij të embrionit ose të spermës dhe vezëve ose të inseminimit të saj (sipas rastit).

Ky parashikim i legjislacionit anglez imponon një kusht thelbësor në prezumimin e atësisë, atë të dhënies së pëlqimit të bashkëshortit. Bashkëshorti që ka dhënë pëlqimin për metodën e riprodhimit artificial nuk mund të kërkojë kundërshtimin e atësisë. (Vonk 2007)

Britania e shtrin aplikimin e parimit të prezumimit edhe në bashkimet joformale me kusht që bashkëjetuesi të japi pëlqimin e tij. (HFEA, 2008)

Pëlqimi është një kusht i cili nuk i kërkohet vetëm bashkëshortit të nënës por edhe dhuruesit. Nëse dhuruesi nuk ka dhënë pëlqimin ai mund të jetë një subjekt i legjitimuar për të kërkuar kundërshtimin e atësisë.

Akti mbi Fertilizimin Njerëzor dhe Embriologjinë i vitit 2008 (HFEA 2008), parashikon një koncept të ri të prindërimit për partneren femër të nënës e cila është në një bashkim civil, duke e njësuar këtë parashikim me atë të çifteve heteroseksuale. Partneria femër e nënës duhet të trajtohet si prindi i fëmijës, përveç rasteve kur ajo nuk ka dhënë pëlqimin për proçedurën artificiale të riprodhimit. (HFEA, 2008)

Britania lejon regjistrimin e një burri të vdekur si babai ligjor i fëmijës nëse sperma e tij ose e një dhuruesi është përdorur nga bashkëshortja për të konceptuar një fëmijë pas vdekjes së tij por kur pëlqimi është marrë gjatë qënies gjallë. (HFEA, 2008)

Sipas legjislacionit anglez; burri i pamartuar mund të marri statusin e prindit ligjor me pëlqimin e nënës përmes regjistrimit në aktin e lindjes. (HFEA, 2008) Dhuruesi i gametëve nuk mund të kërkojë në gjykatë njohjen e atësisë dhe babai që ka dhënë pëlqimin nuk mund të kërkojë kundërshtimin gjyqësor të atësisë.

Legjislacioni anglez njeh dy kategori të dhuruesve të spermës. Ata që dhurojnë sperm në një qendër trajtimi dhe kanë dhënë pëlqimin për përdorimin e materialit të tyre gjenetik nga të tretët në përputhje me HFEA të vitit 1990 neni 28 dhe së dyti; dhurues të cilët nuk dhurojnë në një qendër trajtimi (të ashtuquajtur do it-yourself donors: DIY donors). Grupi i parë i dhuruesve nuk ka të drejta dhe detyrime në lidhje me fëmijën; statusi i tyre rregullohet nga HFEA 1990. Grupi i dytë ka të njëjtat të drejta dhe detyrime mbi fëmijën si çdo person tjetër i cili koncepton një fëmijë me një grua, që është beqare ose në një marrëdhënie me një person tjetër.

Akti i Surrogacisë i vitit 1985 e përkufizon nënë surrogate si një grua që mbart një fëmijë në zbatim të një marrëveshje të lidhur përpara se të fillojë të mbajë fëmijën, dhe e bërë me qëllim dorëzimin e fëmijës dhe të drejtave prindërore tek një person ose disa persona. (SAA, 1985) Marrëveshjet e surrogacisë nuk janë të detyrueshme nga ligji. Ky konfirmim në Aktin e Surrogacisë 1985 nënkupton se (a) "…duke qënë se ka një qëndrim të përbashkët mbi njohjen e nënës ligjore si nëna që e lind fëmijën, nëna surrogate nuk mund të detyrohet nga asnjë formë detyrimi kontraktor të japi fëmijën e saj. Ajo duhet të ketë zgjedhjen përfundimtare nëse do ta dorëzojë ose jo fëmijën e saj. Së dyti, prindërimi ligjor mund të vendoset vetëm përmes mjeteve të përcaktuara në ligj dhe jo atyre të përcaktuara në kontratë". (Brazier, M., Golombok, S. and Campbell, A. 1997)

Nëna surrogate do të jetë prindi ligjor i fëmijës sipas përcaktimit që bën ligji dhe ajo do të ketë përgjegjësi prindërore mbi fëmijën. Nëse nëna surrogate është e martuar, burri i saj do të jetë ati ligjor i fëmijës në sajë të martesës dhe do të ndajë përgjegjësinë prindërore me nënën e fëmijës. Nëse nëna surrogate është e pamartuar ajo do të jetë prindi ligjor i vetëm i fëmijës dhe personi i vetëm që do të ketë përgjegjësi prindërore sipas ligjit. (HFEA, 1990) Në të gjitha pohimet e bëra më lartë mbi mënyrën e përcaktimit të atësisë është e lehtë të dallojmë nga format klasike të përcaktimit të atësisë, të cilat janë prezumimi dhe njohja vullnetare, tek format e reja të përcaktimit si marrëveshjet e surrogacisë dhe dhënia e pëlqimit.

III. Përcaktimi i atësisë në Shqipëri.

Ligji shqiptar Nr. 8876 "Mbi shëndetin riprodhues" i vitit 2003 parashikon aplikimin e teknikave të riprodhimit artificial. (Ligj "Mbi shendetin riprodhues",

2003) Nga interpretimi i dispozitave të ligjit të mësipërm del si konkluzion se ky ligj jep mundësinë e aplikimit të të gjitha formave të riprodhimit artificial përveç riprodhimit post mortem. Edhe pse ligji ka një qasje të gjerë ndaj këtyre teknikave ende nuk ekziston një akt ligjor mbi riprodhimin për rregullimin në detaje të aplikimit të këtyre metodave, ndërkohë që përdorimi i tyre është tashmë një realitet në klinikat shëndetësore shqiptare. Ndërkohë që qindra fëmijë mund të kenë lindur si rrjedhojë e zbatimit të riprodhimit artificial, legjislacioni shqiptar nuk i ka ende mjetet e nevojshme ligjore për t'iu përgjigjur pyetjes që mund të ngrihet në këto raste; *kush është babai?*

Format e përaktimit të prindërimit janë parashikuar në Kodin e Familjes të Republikës së Shqipërisë. Sipas tij atësia mund të përcaktohet në dy mënyra:

- përmes prezumimit; për fëmijët e lindur nga martesa ose të konceptuar gjatë martesës.

-përmes njohjes së atësisë për fëmijët e lindur jashtë martese; e cila mund të aplikohet në dy forma (si njohje vullnetare e atësisë e realizuar përmes pëlqimit të nënës dhe njohja gjyqësore e atësisë). (Kodi I Familjes, 2003)

Neni 184 i K.F parashikon të drejtën për të "kundërshtuar atësinë e prezumuar":

"Burri, që sipas nenit 180 të këtij Kodi, prezumohet se është atë i një fëmije, mund të kundërshtojë atësinë e këtij fëmije"

Nëse kjo dispozitë do të zbatohej në kontekstin e riprodhimit artificial heterolog, do ti jepte mundësinë bashkëshortit të nënës të kundërshtojë atësinë e prezumuar edhe pse ai ka dhënë pëlqimin për dhurimin.

Në të njëjtin kontekst është neni 188 i K. F i cili parashikon;

"Burri që e quan veten si i ati i fëmijës së lindur jashtë martese, mund të kundërshtojë që një burrë tjetër, i cili e ka njohur fëmijën, të jetë i ati i tij. Kjo padi mund të ngrihet edhe kundër trashëgimtarëve të burrit që ka njohur fëmijën si të tij.E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e 1 viti nga regjistrimi i atësisë në regjistrin e gjendjes civile" i jep mundësinë dhuruesit të kundërshtojë njohjen e atësisë së një tjetri i cili me qëllim ka dhënë pëlqimin për të ushtruar të drejta prindërore mbi fëmijën e partneres së tij, të lindur nga aplikimi i teknikave të riprodhimit artificial.

IV. Përfundime

Format e reja të teknologjisë riprodhuese e kanë ndarë konceptin e mëparshëm biologjik të prindërimit në një koncept të ri ligjor. Këto forma të reja zgjerojnë nevojën për kontroll të kujdesshëm dhe parashikime të reja në përcaktimin e atësisë pasi atësia lidhet me mirëqënien e fëmijës dhe interesin më të lartë të tij.
Rregullat që drejtojnë riprodhimin artificial ndikojn në statusin e prindërve dhe të drejtat e tyre mbi pasaardhësin. Zgjerimi i vazhdueshëm i teknikave moderne të

riprodhimit artificial si dhe mundësitë dhe problemet që vijnë si rrjedhojë e përdorimit të tyre, kërkojnë një rivlerësim më të plotë se si ligji do ti caktojë të drejtat dhe përgjegjësitë prindërore. (Shultz 1990)

Për sa kohë legjislacioni shqiptar parashikon politika ligjore mbi konceptin dhe aksesin në teknikat e riprodhimit artificial është e nevojshme të parashikohen forma të reja prindërimit, të drejta dhe detyrime prindërore si dhe statusi i dhuruesit.
Parimi i dhënies së pëlqimit, i cili drejton marrëveshjen për aplikimin e riprodhimit artificial, duhet të parashikohet në ligj dhe pasojat e marrëveshjes midis palëve duhet të parashikohen duke vlerësuar qëllimin e palëve për të ndërmarrë ose jo përgjegjësi prindërore. Në këtë kontekst legjislatori shqiptar duhet të parashikojë mjetet ligjore dhe parimet që do të drejtojnë kontratat e riprodhimit artificial. Mangësia e këtyre parashikimeve e bën të pasigurt statusin e fëmijës duke qënë se babai ligjor mund të kundërshtojë prindërimin e tij edhe pse e ka përfituar atë si rrjedhojë e zbatimit të parimit të prezumimit dhe pëlqimit. Jo vetëm statusi i fëmijës por edhe ai i babait është i pasigurt në rastet e një fëmije të lindur jashtë martese pasi dhuruesi ka të drejtë të kundërshtojë statusin e atit ligjor përmes një procedure gjyqësore e cila bazohet në lidhjet gjenetike dhe në analizën e ADN.
Ajo çka vihet re duke i vënë ballë për ballë legjislacionin shqiptar me atë anglez është fakti se në legjislacionin shqiptar ekziston një situatë konfuze e cila konfirmon aksesin në metodat e riprodhimit artificial por ndërkohë e përcakton atësinë vetëm në terma të lidhjes gjenetike.
Ky konflikt normativ duhet të përfundojë, pasi legjislacioni duhet të sigurojë personat në zbatimin e të drejtave të tyre; “e drejta për të patur familje” është një e drejtë absolute e sanksionuar në Kushtetutën e Shqipërisë, duke patur kështu shteti detyrimin të garantojë zbatimin e kësaj të drejte dhe ti garantojë individët kundër çfarëdo forme të dhunimi të saj. (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998)

Literatura:

1. Bartlett, Re-Expressing Parenthood, 98 YALE L. 293, 306-15 (1988)
2. Brazier, M., Golombok, S. and Campbell, A. "Surrogacy: review for the UK Health Ministers of current arrangements for payments and regulation" Consultation document and questionnaire. In: Human Reproduction Update 1997, Vol. 3, No. 6 pp. 623–628. See also Re: X & Y (Foreign Surrogacy) [2008] EWHC 3030
3. Fuscaldo, Giulianna, 2006, "Genetic Ties: Are they Morally Binding?," Bioethics, p 64-76.
4. J. Ives, "Becoming a Father/Refusing Fatherhood: How Paternal Responsibilities and Rights are Generated." Centre for Biomedical Ethics Department of Primary Care and General Practice School of Medicine. The University of Birmingham. July 2007, p 10.
5. James T. Bretzke, SJ, "Handbook of Roman Catholic Moral Terms."
6. M Vonk " Children and their parent" A comparative study of the legal position of children with regard to their intentional and biological parents in English and Dutch law, ISBN 978-90-5095-732-8, Antwerpen – Oxford 2007, p 155.
7. M. M Shultz, Reproductive Technology and Intent-Based Parenthood: An Opportunity for Gender Neutrality, 1990Wis. L. Rev. 297 (1990), p 398.
8. R. D. Melville "A manual of the principles of Roman law relating to persons, property and obligations.", p 84
9. Rachel G. Fuchs, "Contested Paternity: Constructing Families in Modern France", John Hopkins University Press 2008, p 2.
10. Richards, M. 2003, "Assisted Reproduction and Parental Relationships," in Children and their Families: Contact, Rights and Welfare, A. Bainham et al., eds., Hart.
11. Schwenzer, I. (ed) Tensions Between Legal, Biological and Social Conceptions of Parentage. (Intersentia: 2007) (CJ-FA (2008) 5), p 12.
12. Senaeve, Patrick. 1993. The reform of affliation law in France and the Benelux Countries. In Parenthood in modern society: Legal and social issues for the twenty-first century, ed. John Eekelaar and Petar. Sarcevic, 93-111.Dordrecht: Martinus Nijhoff.
13. University of Pretoria, "Revolutionary changes to the parent child relationship".
14. Kushtetua e Republikës së Shqipërisë, 1998, 53.
15. Ligj Nr. 8876, date 04.04.2003, mbi "Shëndetit Riprodhues", neni 30-41.
16. The United Kingdom "Human Fertilization Act" 1990, art 27, 28.
17. The United Kingdom "Human Fertilization Act" 2008, art 36, 37, 39, 40, 42.
18. The United Kingdom Surrogacy Arrangements Act 1985, art 1.
19. Kodi i Familjes së Republikës së Shqipërisë, 2003, neni 180, 181, 184.
20. Parenthood. (2014). *In Oxford dictionary.com*
    http://www.oxforddictionaries.com/definition/english/parenthood
    Retrieved 3.23.2014

PREVALENCA E SËMUNDJEVE KARDIOVASKULARE NË SPITALIN E VLORËS PËR VITET 2009-2011, DEPISTIMI DHE PARANDALIMI I TYRE.

Msc. Juljana Xhindoli[1], Msc.Rezarta Petani[1], Msc. Denada Selfo[1], Msc. Mimoza Llavdaniti[2], MD.Kreshnik Shehu[2]

[1] *Faculty of Public Health,University "I.Qemali"Vlorë,* juli.xhindoli@hotmail.com,

[2] *Gjirokastër Hospital.*

Abstrakt:

Sëmundjet kardiovaskulare(SKV) janë shkaku i parë i vdekjeve në Europë. Megjithatë, SKV është dukshëm e parandalueshme. OBSH-ja përllogarit se, të marra së bashku , uljet modeste te vlerave të tensionit të gjakut, të obezitetit, të kolesterolit dhe të përdorimit të duhanit në të gjithë popullsinë, mund të përgjysmojnë incidencën e SKV. **Qëllimi:** Njohja me faktorët rriskant dhe ngarkesën SKV në popullatën e Vlorës në mënyrë që të implementohen masa parandaluese në shërbimin parësor pranë komunitetit. **Rezultatet:** Është një studim deskriptiv, me të dhëna nga regjistrat bazë të kartotekës së spitalit të shtrimeve me SKV për 2009-2011, shpërndarjen sipas grupmoshave, gjinisë dhe vendbanimit. Sëmundjet e aparatit të qarkullimit zënë: 7.9% të shtrimeve vjetore për 2009, 9.3% për 2010, 9.7% për vitin 2011 në Spitalin e Vlorës. Sëmundjet më të shpeshta janë: HTA, infarkti kronik- SIZ, kardiomiopatite dhe AVC-të. Sipas shperndarjes demografike rastet me SKV shihen në ***qytet***. Frekuenca e SKV rritet me rritjen e moshës së pacientëve. Më i prekur është seksi mashkull. Shihen raste prezente edhe në moshat e reja. Sipas grupmoshave rezulton 45-54 rreth 16%, 55-64 vjec 23%, dhe grupmosha 65+ përbën 55% të gjithë rasteve me SKV. **Rekomandime**: Depistimi dhe vleresimin e rriskut te individeve me anë të SCORE në shërbimin parësor.

Fjalë Kyc: prevalencë, sëmundje Kardio-Vaskulare, faktorë rrisku, parandalim, vlerësimi i riskut.

Hyrje. [1.] Sipas OBSH –së, sëmundja vaskulare ka shkaktuar 17.1 milionë vdekje në botë në vitin 2004 ose 29% te te gjitha vdekjeve në shkallë globale. Nga këto vdekje 7.2 milionë janë pasojë e sëmundjeve koronare të zemrës dhe 5.7 milionë janë shkaktuar nga goditja në tru.

Sëmundja kardiovaskulare është shkaku i parë i vdekjeve të grave dhe të burrave në Europë. Kjo përbën thuajse1/2 e të gjithë numrit të vdekjeve, që cdo vit janë mbi 4.35 milionë në 52 shtetet anëtare të Rajonit Europian të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), nga të cilat më shumë se 1.9 milionë kane ndodhur cdo vit në Bashkimin Europian (BE). Megjithatë, sëmundja kardiovaskulare është dukshëm e parandalueshme. OBSH-ja përllogarit se, të marra së bashku , uljet modeste te vlerave të tensionit të gjakut, të obezitetit,të kolesterolit dhe të perdorimit të duhanit në të gjithë popullsinë, mund të përgjysmojnë incidencën e sëmundjeve kardiovaskulare (SKV).

Në shumicën e vendeve të Europës Veriore, Perëndimore dhe Jugore, vdekshmëria nga SKVdhe incidenca e ndërlikimeve të saj janë ulur. Faktorë madhorë të kësaj rënieje raportohen të jenë: ndryshimet në mënyrën e jetesës , si dieta me më shumë fruta e perime, me më pak yndyrna shtazore dhe kalori, ulja e nivelit të duhanpirjes etj si dhe përmirësimi i sistemit të shërbimeve shëndetësore, si kapja e hershme dhe trajtimi i përshtatshëm i faktorëve të rrezikut, sidomos hipertensionit arterial, trajtimi më i mirë i urgjencës si dhe ndërhyrjet kirurgjikale në enët koronare.

Të gjithë ekspertët e shëndetësisë sot në botë besojnë se sëmundjet kardiovaskulare janë dukshëm të parandalueshme, duke evituar një numër të madh vdekjesh të parakohshme. Efektet më të mëdha dhe më afatgjata lidhur me parandalimin do të jepnin masat për sigurimin e një jetese të shëndetshme duke

shmangur ekspozimin ndaj faktorëve të rrezikut(ushqyerje e mirë, mospirje duhani, kufizim i alolit, aktiviteti fizik etj) Kontribut të rëndësishëm në uljen ose mbajtjen nën kontroll të rasteve te SKV ka edhe trajtimi i hershëm i faktorëve riskant.

A. Fakte rreth sëmundjeve Kardiovaskulare në vendin tonë[2].

Në Shqipëri vdekjet nga sëmundjet kardiovaskulare janë duke u rritur në numer absolut: rreth 290 raste vdekjesh për 100 mijë banorë në vitin 2008 (Vetëm 200 ne vitin 1991) nga shkaqe të lidhura me aparatin e qarkullimit të gjakut. Rreth 1/3 e tyre kanë si shkak problemet e shfaqura në arteriet që furnizojnë zemrën me gjak.

Ndër shkaqet e vdekjeve ne Shqipëri për vitin 2009 sipas grup-sëmundjeve sërish vendin e parë e zunë sëmundjet kardiovaskulare me 58% të gjithë vdekjeve, ndërsa sëmundjet tumorale përbënë 17% të të gjithë vdekjeve (Grafiku.1.)

Grafiku 2 . Vdekshmëria në vitin 2009 e paraqitur sipas grup-sëmundjeve .



Qëllimi: Njohja me faktorët e rrezikut të sëmundjeve kardiovaskulare si edhe ngarkesën e kësaj sëmundje në popullatën e Vlorës në mënyrë që të njohim dhe të implementojmë masat parandaluese në shërbimin parësor në shërbim të shëndetit të komunitetit.

Objektivi kryesor: Njohja me mënyrat e depistimit dhe parandalimit të sëmundjeve kardiovaskulare për të mbajtur nën kontroll sëmundshmërinë dhe uljen e vdekshmërisë nga kjo këto sëmundje.

Objektivat specifike :

- Njohja e prevalencës të popullatës së sëmurë me SKV në spitalin Rajonal Vlorë.
- Identifikimi i faktorëve te rriskut të sëmundjeve kardiovaskulare si kusht themelor për parandalimin e tyre.(shkak-pasojë)
- të ofrohen praktikat më të mira të këshillimit, në kujdesin parësor për sa i përket parandalimit, vlerësimit të rriskut dhe menaxhimit të sëmundjeve kardiovaskulare.
- të njohim sjelljet e shëndetshme për të arritur në ulje të SKV.

Vizioni i OBSH për të ardhmen[4] mbi sëmundjet kronike :

- Integrim I epidemiologjisë me menaxhimin dhe monitorimin.
- Fokusim dhe fuqizim të parandalimit.

- Harmonizim I programeve të sëmundjeve kronike me reformat e programet e sistemit shëndetësor në tërësi.

Faktorët e rriskut për sëmundjet kardiovaskulare [3] [1,4.]

Gjatë dekadave të fundit sëmundjet kardiovaskulare janë studiuar në mënyrë intensive dhe të thelluar, dhe tashmë ka një pamje të qartë të shkaktarëve të tyre. Shkaktarët janë të shumtë ndaj dhe quhen shumëfaktorialë dhe përbëhen nga një sërë karakteristikash social- biologjike, të cilat rrisin propabilitetin për të pësuar një problem të enëve koronare apo cerebrale.

Një pamje të këtyre karakteristikave apo faktorëve të rrezikut jepet në tabelen e mëposhtme, ku faktorët e rrezikut janë ndarë në tre grupe kryesore:

Faktorë biologjikë	**Faktorë të mënyrës së jetesës.**	**Karakteristika të përgjithshme**	
		Të pandryshueshëm	Te ndryshueshme
Presion I rritur I gjakut	Duhanpirja	Mosha	Të ardhurat
Kolesterol i lartë, Trigliceride te larta, LDL e lartë HDL e ulët	Dietë jo e shendetshme, e pasur me kalori dhe yndyrna	Gjinia	Edukimi
Hiperglicemi / diabet	Konsum i shtuar i alkolit	Histori familjare	Kushtet e jetesës
Mbipeshë / dhjamosje	Mungesë e aktivitetit fizik	Etnia	Kushtet e punës

Vlerësimi i rrezikut të semundjeve kardio-vaskulare sipas modelit te OBSH/ISH

Parandalimi i SKV është një grup i koordinuar veprimesh, ne nivel popullate ose nivel individual, me qëllim eleminimin dhe ndikimin e sëmundjeve kardiovaskulare, si dhe paaftesive te tyre përkatëse [4]

Diagramat e SCORE sipas modelit[5] të propozuar nga OBSH/ISH-së paraqesin rrezikun për 10 vjet per të patur një sëmundje kardiovaskulare(fatale ose jo për jetën), bazuar në kategori faktorësh rreziku, si: mosha, gjinia, presioni sistolik, duhanpirja, niveli i kolesterolit dhe prania ose jo e diabetit.

Tre veprime që duhet të kryen:

- mbledhja e të dhënave dhe gjykimi klinik
- Vleresohet rreziku i SKV-re duke përdorur SCORE me të dhenat e mbledhura.
- Vendoset mbi nivelin e menaxhimit të rriskut.

Kategorite e vleresimi te rriskut 10 vjecar [6]

Si mund të menaxhojmë rrezikun kardiovaskular[7.8] ?

Strategjitë e sjelljes :

• **Pirja e duhanit:** pirja e duhanit, në mënyrë aktive apo ekspozimin ndaj duhanpirjes pasive duhet të shmanget. Tu ofrohet ndihmë duhanpirësve për të lënë duhanin dhe nëse është e nevojshme të përdoren medikamente.

• **Ushqyerja:** të këshillohet për një dietë të shëndetshme (p.sh. fruta dhe perime 500 gr përditshme), per te parandaluar CVD. Rekomandohet **reduktimi I peshës** në njerëz mbipeshë dhe obezë .

• **Aktiviteti fizik:** të rriturit e të gjitha moshave duhet të kalojnë 2,5-5 orë në javë në aktivitet fizik të paktën me intensitet të moderuar (mbi 30 minuta në 4-5 dite të javës, por çdo lloj aktiviteti fizik është më i mirë se asgje).

Trajtimi i faktorëve të rrezikut:

• **Hipertensioni:** Strategjitë e rekomanduara të sjelljes në të gjithë pacientët me hipertension ose individët me presionin e lartë të gjakut normal. Niveli i presionit të gjakut <140 mmHg (systolic) dhe < 90 mmHg (diastolic) në të gjithë pacientët hypertensive.

• **Diabeti:** ndjekja e HbA1c për parandalimin e SKV-ve ne te sëmurët me diabet në: < 7,0% (< 53 mmol / mol).Përdorimi i Statinave për të gjithë pacientët diabetik në mënyrë për të reduktuar rrezikun kardiovaskular. Niveli i presionit te gjakut në diabet nuk duhet të kalojë : <140/80 mmHg.

• **Lipidet:** në pacientët me rrezik shumë të lartë për CVD, niveli I rekomanduar LDL kolesterolit eshte < 1,8 mmol / L (<~ 70 mg / dL) ose një ≥ 50% LDL-kolesterolit reduktimi kur niveli duhur nuk mund të arrihet. Në pacientët në rrezik të lartë CVD, rekomandohet një nivel i LDL- kolesterolit < 2. 5 mmol / L (<~ 100 mg / dL)

Materiale dhe metoda:

Studimi është deskriptiv i cili është i bazuar në mbledhjen e te dhenave nga regjistrave bazë të kartotekës së spitalit për të berë nje pershkrim te frekuences se semundjeve kardiovaskulare për 2009-2011, shpërndarjen sipas grupmoshave dhe vendbanimit, seksit.. Si popullate ne studim jane marre gjithe pacientet e shtruar në spitalin Rajonal të Vlorës për vitet 2009-2011 të trajtuar për semundje Kardio-Vaskulare (ketu përfshihen 16 diagnoza) sipas grupmoshave nga 15 vjec deri 65+ vjec.

Rezultatet dhe Diskutimi i rezultateve:

Sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut kanë përbërë: 7.9% ne vitin 2009 të gjitha shtrimeve vjetore, 9.3% në vitin 2010, dhe 9.7% të për vitin 2011 në Spitalin e Vlorës.

Në grafikun 1 shihen te klasifikuara të gjitha sëmundjet qe i përkasin semundjeve kardiovaskulare dhe ngarkesën e tyre për të tre vitet e studiuara. Shihet qarte që sëmundjet më të shpeshta jane në të tre vitet janë : HTA, infarkti kronik- SIZ, kardiomiopatite dhe AVC-të, dhe me pak të shprehura semundjet e tjera SKV.



Semundjet kardiovaskulare duket se kanë një frekuencë më të madhe në seksin mashkull në të tre vitet e studiuara. Në vitin 2009 me nje frekuence meshkuj 54% dhe femra 46% te rasteve. Ne vitin 2010 me nje dominancë te seksit mashkull me 55% kundrejt 45 % seksi femer. Në vitin 2011 seksi mashull 55% dhe femer 45%.(grafiku 2)



Ne të gjitha semundjet kardiovaskulare për 2009 shihet nje predominance e semundshmerise ne seksin mashkull në: infarkt akut (IAM), infarkt kronik (SIZ), sëmundje akute zemer-mushkri, semundje mushkërore kronike, , kardiomiopati, crregullime te përcimit te zemres, hemoragji nënaraknoidale (AVC), ishemi kalimtare e trurit, emboli dhe tromboza te arterieve, hemoroide.

Ndërsa seksi femër është më i prekur nga: HTA, perikardit akut ,crregullime të ritmit të zemrës, insuficenca kardiake, flebit dhe tromboflebit, varice të gjymtyrëve të poshtme duke vlerësuar dhe rriskun më të madhe në këto grupe.



Në grafikun 4 dhe 5 paraqitet shpërndarja demografike e rasteve fshat- qytet për të treja vitet ku shihet qartë për një shpeshtësi të rasteve me SKV më të shprehur në qytet. Raporti i rasteve me SKV ne vitin 2009 është 74% në qytet dhe 26% në fshat. Në vitin 2010 është 68% e rasteve në qytet dhe 32% në fshat. Në vitin 2011 kemi një raport qytet 70% dhe fshat 30%. Shpeshtësia e rasteve ne fshat ka nje tendencë të lehtë në rritje dhe ajo në qytet lehtësisht në ulje.



Grafiku 4 . Shperndarja demografike e SKV



Grafiku 4 . Shperndarja demografike e SKV



Grafiku.6. *Frekuenca e SKV- ve sipas grup-moshave.*

Frekuenca e SKV shihet që ka nje rritje me rritjen e moshës së pacientëve. Shihen raste prezente edhe në moshat e reja, grupmosha 45-54 rreth 16%, 55-64 vjec 23%, dhe grupmosha 65+ përbën 55% të gjithë rasteve me SKV .

Në ***vitin 2009*** grupmosha 5-14 vjec 0.5%, 15-24 vjec 2%, 25-34 vjec 1%, 35-44 vjec 3 %, 45-54 vjec 17% , 55-64 23% dhe mbi 65+ vjec 54% të rasteve.

Në ***vitin 2010*** grupmosha 5-14 vjec 0%, 15-24 vjec 0%, 25-34 vjec 1%, 35-44 vjec 4 %, 45-54 vjec 16% , 55-64 24% dhe mbi 65+ vjec 54% të rasteve.

Në ***vitin 2011*** grupmosha 5-14 vjec 0%, 15-24 vjec 1%, 25-34 vjec 1%, 35-44 vjec 4 %, 45-54 vjec 14% , 55-64 23% dhe mbi 65+ vjec 55% të rasteve.

Konkluzionet :

Pra duke parë dhe kategoritë e prekura më tepër, popullatën , grupmoshat më të rriskuara, sëmundjet më të shpeshta, shpërndarjen demografike atëherë përdorimi i mënyrave parandalimit del një domosdoshmëri për uljen e sëmundshmërise dhe vdekshmërisë së sëmundjeve kardiovaskulare. Sipas literaturës me anë të depistimit dhe të vlerësimit SCORE mund të vlerësojmë rrezikun dhe të marrim masa për menaxhimin e të tyre sipas kategorive të faktorëve të rriskut. Depistimi dhe monitorimi i gjithë individëve që paraqiten në shërbimin parësor duke i orientuar drejt sjelljeve të shëndetshme, eleminimin e faktorëve rriskues dhe ndërgjejësimi i tyre do të sillte një ulje të konsiderueshme të sëmundjeve kardiovaskulare.

Rekomandime:

- *Të përdoren Programe edukimi me rekomandime për menaxhimin e sëmundjeve kardiovaskulare nga shërbimi parësor.*
- *të vlerësohet rreziku i SKV-ve* n*ë praktikën e përditshme,* në burra mbi 40 vjec dhe gratë mbi 50 vjec ose në postmenopauzë, kur një ose me shumë faktorë rreziku janë të pranishëm si: pirja e duhanit, kequshqyerja ose mbipesha, inaktiviteti fizik, dislipidemitë, hipertensioni ose diabeti melitus, kur ka predispozitë familjare.
- Kapja në kohë e crregullimeve kardiovaskulare dhe ndjekja rigoroze e këshillave të ekipit mjekëor do të cojë në ulje të rasteve me SKV.
- të permirësohet shërbimi shëndetësor në përputhje me nevojat.
- Ndryshimet në stilin e jetës rekomandohen për të gjithë individët.

Bibliografia

[1] A: Ylli, S. Xinxo, J. Lakrori "Parandalimi i semundjeve kardiovaskulare në Kujdesin Parësor" 2005.

[2] Ministria e Shëndetësisë.(http://www.moh.gov.al/index.php/statistika)

[3] Konferenca e I Kombetare per "Politikat Shëndetesore ne Shqipëri" Strategjia e OBSH për shëndetin deri në 2020 Shëndeti në të gjitha politikat. Maj 2012.

[4] Konferenca e I Kombetare per "Politikat Shëndetesore ne Shqipëri" Strategjia e OBSH për shëndetin deri në 2020 Shëndeti në të gjitha politikat. Maj 2012.

[5] Read the 2012 Joint Guidelines in: European Heart Journal (2012) 33, 1635–1701 doi:10.1093/ eurheartj/ehs092 and European Journal of Preventive Cardiology 2012;19: 4:585-667. or visit www.escardio.org/guidelines

[6] Estimation of TOTAL RISK remains a core part of the 2012 guidelines.
Consider using the relative risk chart and the risk-age model. HDL-adjusted charts available at www.heartscore.org

[7] Read the 2012 Joint Guidelines in: European Heart Journal (2012) 33, 1635–1701 doi:10.1093/ eurheartj/ehs092 and European Journal of Preventive Cardiology 2012;19: 4:585-667.

[7] http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC2293958/bin/vhrm0303-313-03.jpg

[8] Read the 2012 Joint Guidelines in: European Heart Journal (2012) 33, 1635–1701 doi:10.1093/ eurheartj/ehs092 and European Journal of Preventive Cardiology 2012;19: 4:585-667.

Strategjitë e të nxënit të fjalorit në lidhje me moshën dhe individin

Phd **Kozeta Hyso**
Departamenti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti " Ismail Qemali' Vlorë
E-mail: khysi@univlora.edu.al

Abstrakt

Strategjitë, kanë kohë që njihen si procese shumë të rëndësishme që ndërmarrim për të mësuar një gjuhë të huaj. Ato përfshijnë teknika dhe elemente të procesit të mësuarit të gjuhës së huaj, të cilat varen nga studiuesi dhe janë të lidhura me faktorët e personalitetit, stilin e të mësuarit, moshën, gjininë dhe përkatësinë kulturore. Strategjitë e mësimit të fjalorit, duke qenë si një nën kategori e strategjive të përgjithshme të mësimit të një gjuhe të huaj dhe duke qenë specifike në llojin e tyre në përgjithësi, janë të rëndësishme për shkak se përvetësimi i fjalorit është një proces që kurrë nuk mbaron dhe shpesh paraqet vështirësi të pakapërcyeshme për moshën dhe individualitetin e studiuesit të gjuhës. Përvetësimi i fjalorit konsiderohet nga studiuesit si pjesa më e rëndësishme e të mësuarit të gjuhës në lidhje me moshën dhe individin.

Duke qenë se ka një mungesë të hulumtimeve në këtë fushë në Shqipëri, qëllimi i këtij studimi është që të japë një tablo paraprake të ndikimit të moshës dhe të aftësive të individit në strategjitë e të mësuarit fjalorit në faza të ndryshme

Fjalë kyçe: Strategji, mosha, individi, fjalor, motivim, të nxënit.

Hyrje

Dekadat e fundit kanë sjellë disa ndryshime në kërkimet dhe studimet në zhvillimin e fushës së arsimit në përgjithësi, po edhe në metodikat përkatëse për çdo periudhë zhvillmi. Ideja është, se eksperimentet që kanë dhënë një masë të madhe vlerësimesh nga shqyrtimi i një sërë subjekteve, na çojnë në arsyetimin logjik, që në fushën e mësimdhënies dhe të përvetësimit të gjuhëve të huaja, ndikim të rëndësishëm dhe pikë referimi për studime të mëtejshme janë mosha dhe veçantitë e individit

Ndikimi i moshës dhe individit në mësimin e gjuhës angleze

Ka dallime individuale mes personave që mësojnë gjuhën angleze, ku përfshihen personaliteti, motivimi, si dhe aftësitë për të mbajtur mend. Ato përcaktohen nga fakti se çdo person është një qenie njerëzore e veçantë dhe

unike. Strategjitë e të nxënit janë përfshirë tradicionalisht në taksonominë e dallimeve individuale dhe janë pjese përbërëse e aspekteve të procesit mësimor në gjuhën amtare, duke qenë se bazohen në atributet e vetindividëve. Veprimet dhe mendimet, të cilat janë të pranishme në përdorimin e strategjive mësimore, nuk shprehin në kuptimin e mirëfillte, dallimet individuale. Janë disa faktorë që përfshihen në tiparet dalluese të këtyre strategjive.

Këta faktorë përbëhen, për shembull, nga stilet e të mësuarit, strategjitë, variabilët afektive të mësuarit, aftësia e të mësuarit, gjinia, kultura dhe mosha. Stilet e të mësuarit dhe strategjitë e të nxënit, janë parë shpesh si të ndërlidhura, ashtu si stili i të mësuarit njohës me personalitetin.

Termi “stili i të mësuarit” i referohet një mënyre të mësuari të moduluar nga personaliteti, i lidhur me preferencat e gjera të mësuarit. Marrëdhënia midis stileve dhe strategjive të mësuarit është mjaft e ngushtë, në se strategjitë e përdorura përshtaten me stilin e të mësuarit të individit dhe nëse ato përdoren në mënyrë efektive. Megjithatë, stili i të mësuarit përshkruhet si strategji e përdorur në vazhdimësi në disa këndvështrime. Stilet veprojnë pa vetëdije individuale ndërsa strategjitë përfshijnë një zgjedhje të vetëdijshme
Nxënësit ndryshojnë shumë, veçanërisht në dy aspekte të përgjithshme:

1. nga mënyra, se si ata i përvetësojnë strategjitë e mësimit të një gjuhe të huaj.
2. nga llojet e veçanta të strategjive që ata përdorin.

Brenda këtyre dy aspekteve, faktorët që ndikojnë në këtë ndryshim janë parë në disa këndvështrime. Në ndryshimet vetjake janë marrë në shqyrtim, besimi për përvetësimin e gjuhës së synuar, faktorët fillestarë dhe rrethanor të ballafaqimit me të, mosha e individëve, cilësitë vetjake të tyre, vendndodhja ku do zhvillohet mësimi i gjuhës, detyrat që ju ngarkohen nxënësve, si edhe faktorët social, si grup moshat dhe gjinia e individëve të përfshirë në këtë proces.

Përvoja shkollore e mësimit të një gjuhe të huaj nëpërmjet fjalorëve është për fat të keq shpesh e lidhur me mërzinë që diktojnë listat e gjata të fjalëve, pjesëve që duhen mësuar përmendësh që në mendësinë e nxënësve shikohet vetëm në funksion të një provimi me gojë apo një testi me shkrim. Ndërsa për disa njerëz përpjekjet për të mbajtur mend, mund të mos jenë aq stërmunduese, por për të tjerët mund të jenë një mundim i madh. Megjithatë, në këtë këndvështrim, njohja e fjalorit është një parakusht për të folur një gjuhë të huaj. Nuk mund të ketë komunikim pa fjalë, pra duhen mësuar dhe duhen mbajtur mend fjalët, ndoshta përgjithmonë.

Zakonisht flitet për "kujtesë" në kuptimin e përveçëm, duke nënkuptuar me këtë një aftësi që gjithsecili prej nesh e ka në një masë më shumë ose më pak të gjerë. Natyrisht që edhe këtu kemi faktorë të moshës dhe individualitetit si përcaktues.

Është e qartë që faktori i moshës ndikon shumë në mënyrën, se si strategjitë e mësimdhënies përdoren. Kuptohet që për fëmijët strategjitë janë të thjeshta, ndërsa për të rriturit ato janë më të ndërlikuara. Një faktor tjetër po aq i rëndësishëm që ndikon në mënyrën e të mësuarit është stili i të mësuarit individual që, duket të jetë shumë i lidhur me strategjinë e përvetësimit të përdorur edhe pse pak hulumtime janë bërë për të. Një tjetër faktor është edhe masa e këtyre strategjive që mendohet të përdoren. Gjithashtu vlerësohet edhe tipi i strategjisë që zgjidhet për të nxitur e motivuar studiuesin.

Ndryshimet vetjake në ecurinë dhe përparimin gjuhësor

Faktorët e prirjeve vetjake janë ato më bazë që ndikojnë në këtë proces dhe në përcaktimin e llojeve të strategjive që duhen ndërmarrë për përdorim. Stili i të mësuarit dhe veçoritë e personalitetit janë po ashtu aq ndikues në zgjedhjen dhe përcaktimin e strategjive që duhen vënë në zbatim. Bëhet fjalë për mënyra të ndryshme të arsyetimit dhe të mësimit me fjalorë. As njëra nuk është më e mirë, se sa tjetra, ato janë të ndryshme, vetëm, se ju përkasin llojeve të ndryshme të personaliteteve. Faktorët rrethanorë dhe social janë të lidhur gjithashtu fort me përcaktimin e strategjive që do të ndërmerren dhe ato janë: natyra e gjuhës që do studiohet, klasa e zgjedhur për mësim, tipi i detyrave që përcaktohen për t'u dhënë dhe gjinia e individit që ka edhe ajo një lloj ndikimi po edhe veçantitë e saj në këtë proces. Disa njerëz përgjigjen më mirë në përvetësimin e një gjuhe të huaj, se sa të tjerët. Ata duket, se kanë një talent natyror në këtë drejtim. Kjo është ajo çka ka të bëjë me dallimin aq shumë të rëndësishëm, secili, sipas individualitetit.

Nxënësit ndryshojnë nga kapaciteti i njohurive për fjalëtqë ata shprehin në shkollë. Niveli i tyre social ekonomik, kushtet familjare, gjuha e përdorur në shtëpi dhe komuniteti ndikojnë dukshëm në mundësitë e zgjerimit të fjalorit. Disa individë kanë mangësi të theksuara në fjalor për shkak, se nuk kanë lexuar shumë. Niveli i mëvonshëm gjuhësor lidhet direkt me fjalët që ai/ajo i përdor apo dëgjon në jetën e përditshme.

Gjithashtu ata fëmijë që kanë ndjekur kopshtet kanë një përparësi më të madhe që të jenë më të përparuar në lexim dhe në rrjedhshmërinë e të folurit, krahasuar me ata që nuk e kanë pasur këtë eksperiencë. Nxënësit në fazat e hershme të studimit të gjuhës kanë një boshllëk të dukshëm në njohuritë e fjalorit, dhe prej stadit fillestar e në vazhdim të fazave të tjera gjuhësore, te disa, ky boshllëk zgjerohet edhe më shumë.

Individët që kanë mangësi në fjalor ndeshen në vështirësi për të kuptuar saktë tekstin e dhënë, pikërisht kjo e bën leximin më të vështir. Si rezultat ata mësojnë më pak fjalë, pasi nuk lexojnë shumë për t'u përballur dhe për të krijuar mundësi për përvetësim më të thellë. Nga ana tjetër nxënësit që kanë aftësi më të mira të fjalorit dhe njohje më të thellë të gjuhës, lexojnë më shumë, gjë që ndikon në përmirësimin e aftësive të tyre gjuhësore si dhe të njohurive të tyre që zhvillohen dhe përmirësohen vazhdimisht. Varfëria në

disa aspekte gjuhësore, si p.sh. në formimin fonetik, kuptueshmërinë e fjalëve, rrjedhshmërinë etj., gjithashtu ndikon në masa të njëjta, në thellimin e këtij boshllëku dhe në konceptimin e qartë, të asaj se sa shumë një lexues duhet të lexojë dhe të ndeshet me fjalorin e ri. Pra me kohë lexuesit e dobët mbeten shumë prapa.

Keith Stanovich (1986)e cilëson këtë fenomen si ¨Efekti Mattheu¨ me idenë që "i varfëri mbetet i varfër dhe i pasuri vazhdon të pasurohet". Pra siç përmendëm dhe më lartë, por edhe siç tregojnë edhe vëzhgimet tregojnë ky boshllëk thellohet edhe më shumë, pasi nxënësit kalojnë në fazat më të larta të studimit. Jeanne Chall (1983) e quan këtë "rënia e nivelit të katërt" për të shpjeguar kështu rënien e vazhdueshme që ndodh nga niveli i tretë te niveli i katërt në zhvillimin gjuhësor. Të gjitha këto bazohen në të dhënat dhe opinionet e mësuesve. Një arsye për këtë "rënie të nivelit të katërt" mund të jetë edhe mungesa e aftësisë së rrjedhshmërisë, shpejtësisë dhe saktësisë së njohjes së fjalëve apo e frazave.

Mungesa e rrjedhshmërisë sjell përfundimisht dështim në lexim dhe shmangien e shumë materialeve që kanë një nivel të lartë gjuhësor, apo janë pak më të vështirë.

Përkundrazi, në rastin e personave me njohuri të mira apo me një lloj talenti në përvetësimin e gjuhëve, problemindryshon. Ata kanë një ecuri të mirë dhe karakterizohen nga disa veçori tëpërbashkëta.

Sipas hulumtimit që i bëri kësaj çështje Rubin në 1975,nxori disa aftësi bazë të individëve që kanë lidhje me prirjete tyre të veçanta për përvetësimin e gjuhëve të huaja.

1. Aftësia për të gjetur zgjidhje për situata të ndryshme gjuhësore që ju parashtrohen
2. Dëshira dhe vullnet për të komunikuar.
3. Aftësia për të filluar pa ndrojtjebiseda apo dialogë.
4. Aftësia që kur flasin, ata kanë parasysh strukturat gramatikore dhe strukturën e fjalisë.
5. Aftësia që i nxit ata të kërkojnë praktika të dobishme dhe të shfrytëzojnë situatat e krijuara.
6. Aftësiapër të kontrolluar bisedën e tyre dhe të bashkëbiseduesve.
7. Aftësia për të analizuar kuptimin e ligjëratës që dëgjojnë dhe shprehin. Në këtë kontekst ata janë të aftë të dallojnë edhe personat e tjerë me veti të njëjta me ta dhe të hyjnë në bashkëpunim

E thënë më gjerë strategjitë e mësimit të një gjuhe të synuar e lehtësojnë procesin e mësimit dhe përvetësimit të saj. Është e qartë që çdo studiues gjuhe përdor strategjitë e tij në procesin e mësim nxënies, por kuptohet që përderisa përvetësimi i gjuhës varet nga shumë faktorë si mosha, gjinia, personaliteti, mënyra e të mësuarit, konceptimi vetjak,atëherë nuk mund të themi që një grup i caktuar strategjish janë më të mira dhe vlejnë për një

mësim nxënie të suksesshme dhe një grup tjetër nuk është ashtu, pasi e shikojmë që çdo individ ka veçantitë e tij të nxënit.

Disa tipare të grup moshës më të suksesshme në mësim nxënien e gjuhës së huaj .

Nga studimet dhe hulumtimet e bëra del, se grup moshat nga 7-11 vjeç janë zgjedhur si grup moshat më të suksesshme në përvetësimin e gjuhëve të synuara.

Nëse me ta ndiqen metoda të thjeshta bashkëpunimi në mësimdhënie, ata reagojnë shpejt dhe janë të gatshëm të përpunojnë materiale më të plota, se grup moshat e tjera. Këta fëmijë duan gjithmonë të mësojnë diçka të re. Sapo atyre ju jepet një informacion i ri, ata janë shumë të gatshëm ta përvetësojnë dhe ta komentojnë atë.

Këto hulumtime na flasin për një procedurë tashmë të njohur që sa më shpejt t'u fillohet fëmijëve mësimi i gjuhëve të huaja aq më i mirë është përvetësimi i tyre, nisur nga fakti shkencor i patjetërsueshëm që truri i fëmijës në këtë stad zhvillimi përthith të dhëna që kanë të bëjnë me gjuhët dhe kujtesa e tyre i rezervon në mënyrën më të mirë këto të dhëna.

Halliwell(1992) thotë që: “ Fëmijët kanë një gatishmëri mahnitëse në interpretimin e gjithçkaje edhe pse ata nuk i kuptojnë shumë mirë fjalë të veçanta apo edhe pak më gjerë, kanë kurajë të japim mendime dhe të hyjnë në diskutime, duke përdorur kështu ligjërata që nga ana gjuhësore nuk i njohin mirë, kanë kënaqësi kur fusin elementë të humorit dhe shakave në bisedat e tyre, zakonisht mësojnë në mënyrë jo të drejtpërdrejtë nga situata të ndryshme rrethanore dhe për çdo situatë të krijuar, imagjinata e tyre merr krahë dhe mbi të gjitha marrin kënaqësi të veçanta kur futen në diskutime dhe ndjehen të vlerësuar.

Në këto rrethana dhe nisur nga këto tipare bazë të kësaj grup moshe, del si detyrë e mësuesit të organizojë dhe të përdori të gjithë strategjitë e duhura për të rritur përvetësimin dhe mësim nxënien, duke realizuar kështu qëllimin përfundimtar të dy palëve të këtij procesi.

Përfundime

Nuk është e vështirë për të kuptuar rëndësinë që ka mosha dhe tiparet e individëve të ndryshëm në përvetësimin e fjalorit, jo vetëm për arritjen e mësimit të gjuhës së huaj, por edhe për të arritur suksese në fushat e përgjithshme shoqërore dhe ekonomike.

Sipas dallimeve të individualitetit për çdo studiues gjuhe, duhet të nxitet motivimi drejt përvetësimit maksimal të njohurive dhe interesit të mësimit të saj. Dihet tashmë se në arsimin modern, dy janë faktorët nxitës së këtyre interesave, mësimdhënia dhe i nxëni. Ato janë gjithashtu dy faktorë bazë që ndikojnë në procesin e përvetësimit. Në përgjithësi, në qoftë së mësuesit zhvillojnë një orë mësimi me shprehje frazeologjike standarde, kjo orë

mësimore do të bëhet e lodhshme dhe aspak tërheqëse për nxënësit. Kështu që mësuesit duhet të organizojnë aktivitete të larmishme për të mbajtur dhe nxitur interesin për gjuhën e dytë të huaj.

Për nxënës të veçantë mësuesi duhet të përdor metoda dhe teknika të veçanta që nxisin procesin e të mësuarit, përmirësojnë nivelin dhe krijojnë atmosferë të përshtatshme dhe mbështetëse. Në ditët e sotme, arsimi i orientuar drejt cilësisë po vihet në praktikë.

Përvetësimi i fjalorit është edhe në vartësi të gjinisë. Nxënëset femra përdorin më shumë strategji, se nxënësit meshkuj dhe janë të gatshme të harxhojnë më shumë kohë për të mësuar fjalorin dhe për ta përdorur atë në jetë.

Nxënësit e përparuar studiojnë më pak në kohë, përdorin strategji të veçanta për të mësuar fjalorin, janë më të shkathët në përdorimin e atyre që kanë mësuar dhe në vend që t'i përdorin mekanikisht ato, mundohen t'i përshtatin në situata reale dhe t'i pasurojnë me elementë gjuhësorë.

Strategjitë janë operacione të cilat nxënësi zbatohet për të ndihmuar mësimin, ruajtjen, tërheqjen dhe përdorimin e informacionit. Ato janë veprime specifike të ndërmarra nga nxënësi për të bërë mësimin e gjuhës, më të lehtë, më të shpejtë, më të këndshme, më shumë të orientuar, më efektive dhe më të transferueshme për situata të reja. Për më tepër, strategjitë janë efektive në vartësi të individualitetit dhe moshës së studiuesit të gjuhës së dytë. Nxënësit, që janë më të avancuar në një gjuhë, janë më të vetëdijshëm për përdorimin e strategjive më të dobishme në procesin e mësimit të gjuhës.

Nxënësit me moshë më të madhe përdorin strategji krejtësisht të ndryshme nga ata me moshë më të re dhe femrat kanë një gamë të gjerë të përdorimit të strategjisë se meshkujt. Faktorët e tjerë që kanë ndikim në zgjedhjen e strategjive janë: mosha, kombësia, tiparet e personalitetit, niveli i motivimit për të mësuar gjuhën, kërkesat ndaj vetvetes dhe pritshmëria e mësuesit.

Literatura

- Levin, P. (2004). *Write great essays: Reading and essay writing for undergraduates and taught postgraduates*. Maidenhead: Open University Press.
- Chall, J.S. (1983). Stages of reading development, New York: McGraw-Hill.
- Chall,J.S & Jacobs, V.A.(1983). Writing and reading in the elementary grades: Developmental trends among low-SES children.

- O'Malley, J Michael, Anna Uhl Chamot, Gloria Stewner-Manzanares, Lisa Kupper & Rocco P Russo (1985). Learning strategies used by beginning and intermediate ESL students, *Language Learning*, 35/1, 21-46
- Stanovich, K. E. (1986). Matthew effects in reading: Some consequences of individual differences in the acquisition of literacy. Reading Research Quarterly
- Rubin, J (1975). What the 'good language learner' can teach us, TESOL Quarterly, 9, 41-51.
- Gathercole, S.E. & Baddeley, A.D. (1989). Evaluation of the role of phonological STM in the development of vocabulary in children: A longitudinal study. Journal of Memory and Language, 28, 200-123.
- Halliwell B. (1992) Reactive oxygen species and the central nervous system.
- Oxford, R.L. (1990). Language learning strategies: what every teacher should know. Boston, MS: Heinle & Heinle Publishers.
- Schmitt, N. (1997). Vocabulary learning strategies. In N. Schmitt, & M. McCarthy (Eds.), Vocabulary: Description, acquisition and pedagogy (pp.199-227). Cambridge: Cambridge University Press.
- Schmitt, N & McCarthy, M. (1997). Editors' comments acquisition section. In N. Schmitt & M. McCarthy (Eds.), Vocabulary: description, acquisition and pedagogy (pp. 228-236).
- Sökmen, A. J. (1997). Current trends in teaching second language vocabulary. In N. Schmitt, & M. McCarthy (Eds.), Vocabulary: description, acquisition and pedagogy (pp.237-257). Cambridge: Cambridge University Press.
- Wen, Q., & Johnson, R. K. (1997). Second language learner variables and English achievement: a study of tertiary level English majors in China. Applied Linguistics.

TEMA: STRATEGJITË E PËRMBLEDHJES SË NJË TEKSTI ZHVILLUAR NGA STUDENTË TË NIVELEVE TË NDRYSHËM

Lavdosh Malaj
Department of Foreign Languages
Faculty of Humanities
University of Vlora
lavdoshmalaj@gmail.com

Përmbledhjet pasqyrojnë dallimet e mëdha midis strategjive të përdorura nga studentët të aftë dhe të dobët. Studentët e aftë prodhojnë struktura koherente gjuhësore dhe sintaksore. Studentët e aftë përdorin fraza semantike dhe parafjalore më shumë se studentët e dobët. Kështu, nxënësit e aftë nuk shtrembërojnë idetë e tekstit origjinal, por shtrembërojnë rendin kryefjalë-folje. Kur ata përmbledhinr, mund të dallojnë lehtë mënyrën në të cilën ata kombinojnë idetë në dy ose më shumë paragrafë. Përmbledhjet pasqyrojnë se studentët shkruajnë fjali shumë të gjata.

Fjalët kyçe: përmbledhje, i aftë, dobët, tekst, ide, gjuhësore.

Hyrje

Aftësia për të shkruar një përmbledhje të efektshme mund të jetë aftësia më e rëndësishme për të kuptuar dhe interpretuar tekstin, dhe për të shkruar që mund të ketë një student. Duhet të jemi në gjendje të përdorim aftësinë e përmbledhjes e të kuptojmë nocionin tekst.

"Teksti është një tërësi e formuar nga një numër fjalish që janë koherente dhe me kuptim", shkruan Mayordomo. Kur duam të analizojmë këtë tekst duhet të marrim parasysh se si janë lidhur këto fjali me njëra-tjetrën dhe idetë që ato shprehin. Por kur teksti është shumë i gjatë, çfarë bëjmë? Në këtë rast, ne përdorim një përmbledhje të shkurtër të tekstit qe lexuesi të përcaktoj më shpejt qëllimin e tekstit. Duhet të përmendim strategjitë e përmbledhjes të cilat nxënësit duhet t'i kenë të qarta në përmbledhjen e cdo teksti letrar apo shkencor.

Këto strategji janë:

- Planifikimi
- Hartimi
- Përdorimi i fjalëve vet
- Përdorimi i fjalëve të gjetura në tekst
- Përgjithësimi i ideve

- Renditja
- Shtimi informacion vet
- Komente personale
- Redaktimi

Gjithashtu, përmbledhja e një teksti letrar është një nga strategjitë më efikase në mësimdhënie dhe në mësimnxënie. Duke vlerësuar efikasitetin e përmbledhjes si strategji e rëndësishme në formimin e studentëve, një studim i veçantë u bë me studentët e Universitetit të Vlorës. Strategjitë e përmbledhjes të zhvilluar nga studentë të Universitetit të Vlorës, tregojnë se si këta studentë përdorin idetë, lidhjet sintaksore, semantike dhe gjuhësore, si dhe gabimet që ata bëjnë në nivelin e fjalisë. Një nga faktorët që dallon studentët e mirë dhe ata të dobët, është zhvillimi i ideve të tekstit origjinal. Studentët e dobët thjesht kopjojnë strukturat e tekstit origjinal, ndërsa studentët e mire punojnë me këto ide.

Studentët e mirë				
Idetë e tekstit	Në një fjali	Në një paragraf	Në dy paragrafe	Total
1	3	2	1	6
2	2	1	-	3
3	1	1	-	2
4	2	-	1	3

Tabela 1. Idetë e perdorura (Studentët e mirë)

Studentët mesatarë				
Idetë e tekstit	Në një fjali	Në një paragraf	Në dy paragrafe	Total
1	3	1	-	3
2	2	1	-	5
3	1	-	-	1
4	2	1	1	4

Tabela 2. Idetë e perdorura (Studentët mesatarë)

Studentët e dobët				
Idetë e tekstit	Në një fjali	Në një paragraf	Në dy paragrafe	Total
1	3	-	1	4
2	2	1	-	5
3	1	-	-	1
4	2	1	-	3

Tabela 3. Idetë e perdorura (Studentët e dobët)

Gjithashtu, lidhjet semantike (kuptimore) brenda fjalisë ose midis fjalive, ndryshon te studentët me nivele të ndryshme. Studentët e mirë kanë rezultate shumë të mira në njësitë sintaksore krahasuar me rezultatet e studentëve të dobët. Studenti i mirë e arrin këtë gjë duke përdorur përemra anaforik. Për shembull:

Përdorimi i përemrave anaforikë

paragraph 1, line 2: *These targets → which*
paragraph 1, line 4: *European Union → it*
paragraph 4, line 4: *In addition, the changes →They*
paragraph 4, line 4) *Emissions will occur again in the future → they will continue to occur*
paragraph 7, line 2*: such as the Russian Federation, Canada, and the Scandinavian and Baltic countries*
paragraph 7, line 3: *northern countries→ Them*

Studenti i dobët përdor përemër anaforikë, por nuk arrin të krijojë një lidhje midis fjalive. Studenti i dobët thjeshte përdor fjalitë e tekstit origjinal pa i kombinuara ato në një tërësi koherente.

Studentët e aftë arrijnë kohezioni brenda fjalisë dhe midis fjalive duke përdorur fraza parafjalor që vendosin marrëdhëniet mes emrave dhe foljeve, për të arritur kohezionin në fjali. Ndërsa, studenti i dobët përdor mjetet lidhëse që ndodhen në tekstin origjinal. Përveç kësaj, studenti i mirë përdor shprehjen parafjalor, ose mjete lidhëze në mënyrë më efikase se sa studentët e dobët. Përdorimi i një sërë frazash parafjalore ndihmon të ndodh kohezioni i ideve komplekse në përmbledhje. Gjithashtu, në përmbledhje studentët bashkojnë dy ose me shumë fjali bashkë; bashkërenditje ose nënrenditje, por ka ndryshim në sasinë e përdorimit te fjalëve lidhëse, *por, dhe*, që shumë gjuhëtar i konsiderojnë lidhëza. Çfarë janë lidhëzat? Në përkufizimin e sotëm; *lidhëza është ajo pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që lidh dy gjymtyrë fjalie ose dy fjali dhe shpreh marrëdhënie sintaksore midis tyre(Gramatika e Gjuhës Shqipe, 1995)*. Kjo është vetëm kur duam të bëjmë një analize të thjeshte morfo-sintaksore ne kuadrin e fjalisë ose paragrafit, ne nuk kemi folur për përmbledhjen e fjalisë apo të paragrafit, por kemi folur për përmbledhjen e tekstit së bashku me koherencën, idetë dhe kohezionin e këtij teksti. Duke i diskutuar ne kuadrin e tekstit këto mjete lidhëze janë emëruar si **konektorë tekstual – si mjete që realizojnë vazhdimësinë logjike të tekstit** (K. Dibra& N. Varfi Gjuhësi Teksti, Albatros,2007).
Ne përmbledhjen e tekstit, një nga strategjitë e rëndësishme është prodhimi dhe ruajtja e ideve kryesore të tekstit origjinal. Prodhimi i ideve ne përmbledhje behet me ane të strategjisë së kombinimit të këtyre ideve

brenda paragrafit dhe me paragrafët e tjerë. Rezultatet tregojnë se studentë me nivele aftësie të ndryshme janë përgjithësisht në gjendje të kombinojnë idetë e në një paragraf, por e gjejnë të vështirë për të kombinuar idetë që shtrihen në dy ose më shumë paragrafë. Ky rezultat mbështet studimet e parë (Johns 1985b; Sherrad 1986), ku theksohet se edhe studentët e mirë janë në gjendje për të kombinuar idetë, kur ato janë ne te njëjtin paragraf, por hasin vështirësi dhe nuk kanë rezultate të mira kur idetë shtrihen në të gjithë paragrafët.

Në tekste, ku shumë nga idetë janë të vendosura në paragrafët të veçanta, studentët e gjejnë të përshtatshme për të riprodhuar ato pa pasur nevojë për të kombinuar ato me ide të gjetura në paragrafë të tjerë. Kjo do të thotë se në qoftë se dy ose tre ide janë në të njëjtin paragraf, student nuk e shikojnë të arsyeshme t'i kombinojnë ato me ide të tjera në paragrafë të ndryshëm. Përmbledhjen e tekstit dhe kombinimi i ideve varen edhe nga organizimi i teksti; si dukuria kohezive, veprimi, koha edhe aspekti, që realizojnë dhe sigurojnë vijimësinë logjike të ligjërimit, koherencën e tekstit. Të dhënat mbi aftësitë e studentëve për të kombinuar ide, tregon se studentët preferojnë të kombinojnë ide qe janë në te njëjtin paragraf, ndërsa studentët e mire i lidhin këto ide me ide të ngjashme në paragrafë të ndryshëm. Kombinimi i ideve nga paragrafë të ndryshëm varet se si idetë janë të lidhura jo vetëm me organizimin semantik, por edhe me organizimin tematik, pragmatik të tekstit.

Një tjetër strategji e përmbledhjes se tekstit është përgjithësimi gjuhësor dhe sintaksor. Në përgjithësi, studentët shkruajnë fjali të gjata, jo të thjeshta dhe preferojnë të kopjojnë pa ditur se sa të ndërlikuara janë këto fjali. Rezultate tregojnë se studentët e dobët nuk e kanë kuptuar tërësisht tekstin origjinal dhe përpiqen të riprodhojnë këto ide të ngatërruara që nuk e plotësojnë njëra-tjetrën dhe nuk kanë marrëdhënie logjike, ndërsa studentët e mirë kanë zhvilluar ide të sakta. Këto rezultate tregojnë se përmbledhjet e studenteve nuk e përdorin përgjithësimin gjuhësor si një strategji për përmbledhjen. Ata prodhojnë fjali indirekte, duke shpresuar që do të përcjellin disi mesazhin e synuar. Ndërsa përmbledhjet studentëve të mirë kanë zhvillime të sakta e të koordinuara mirë. Mund të thuhet se studentët e dobët kanë dy probleme; kuptimin të tekstit origjinal, si dhe prodhimin e informacionit të kërkuar.

Përgjithësimi sintaksor është fshirja e ideve kryesore si rezultat i një moskuptimi të tekstit origjinal, apo për shkak të një prodhimi të keq në procesin e përmbledhjes. Edhe këtu kemi rezultate të ndryshme midis studentëve të mirë dhe të dobët. Kjo vihet re te prodhimi i ideve, ku studentët e mirë prodhuan katër ide nga pesë që kishte teksti origjinal, ndërsa studentët e dobët mund të prodhonin gjerë në dy ide por kishte dhe raste që nuk prodhonin asnjë ide.

Gjatë procesit të përmbledhjes, vihen re raste deformimi. Këto deformime janë të dallueshme ne heqjen e ideve të rëndësishme të tekstit origjinal e në shtimin e atyre ideve që nuk ekzistojnë në këtë tekst. Heqja e informacionit apo ideve te rëndësishme të tekstit, ka ndryshim midis studentëve të dobët

dhe të mirë. Studentet e dobët heqin pothuajse më shumë se dyfishin e ideve apo informacionit që heqin studentët e mirë. Kjo ndodh për shkak të mosaplikimit të procesit të njohjes (Goodman, 1996). Por, deformimi nuk ndodh vetëm në heqjen e informacionit, por ndodh edhe kur shtohet informacion. Deformimi ndodh për arsye se informacioni i shtuar nuk lidhje me informacionin e tekstit origjinal. Si shtimi i ideve apo informacionit ashtu dhe heqja e këtyre ide apo informacionit tregon se studentët kane probleme me kuptimin e tekstit origjinal.

Deformimi tjetër që ndodh në procesin e përmbledhjes së tekstit, është në fjali, duke ndryshuar kuptimin e tekstit origjinal. Kjo ndodh sepse kemi përdorimin e gabuar të emrit, si dhe mospërputhjen e foljes me kryefjalën (emrin). Rezultatet e përmbledhjeve tregojnë se studentët e mirë nuk i deformojnë ose thyejnë raportin emër-folje dhe rregullat e marrëveshjes së tyre. Në përmbledhjet e studentëve të dobët, vihen re shumë gabime gramatikore në marrëdhënien kryefjalë-folje. Në pasaktësitë e këtyre studentëve vihet re te përdorimi i përemrave vetor ne vet, numër dhe gjini. Te njëjtat gabime ndodhin edhe me përdorimin e foljeve. Këto deformime jo vetëm që çrregullojnë idetë e tekstit, por edhe nuk zhvillojnë qëllimin e studentit.

Tabela e mëposhtme tregon deformimet në nivelet e ndryshme në tekst:

Nr	Nivel ideje		Nivel fjalie	
Studentët	Informacioni i hequr	Informacioni i shtuar	Kryefjalë e gabuar	Folje e gabuar
Studentët e mirë	7	2	1	-
Studentët mesatar	10	7	3	2
Studentet e dobët	2	-	8	12

Tabela 4. Deformimet në nivelet e ndryshme në tekst

Rezultatet e këtyre përmbledhjeve tregojnë se studentët e dobët riprodhojnë idetë e tekstit origjinal, ndërsa studentët e mirë jo. Ndryshimi tjetër midis të dy niveleve është se studentët e mirë i koordinojnë idetë shumë më mirë dhe nuk i deformojnë ato siç bëjnë studentët e dobët.

Gjithashtu, studentët e niveleve të ndryshme shkruajnë fjali të gjata dhe tek niveli i studentëve të dobët kemi shumë mangësi në koherencë.

Përfundimet

Përmbledhjet tregojnë se nxënësit e aftë janë më të prirur për të perifrazuar idetë kryesore krahasuar me studentët e dobët, të cilët preferojnë të riprodhojne idetë pa i transformuar ato.
Në mënyrë të ngjashme, nxënësit e aftë lidhin idetë e tyre me më shumë kohezion , duke përdorur fraza anaphorike dhe semantike më shpesh se studentët e dobët, të cilët përdorin idetë në mënyrë shabllone.
Dallimi mes studentëve të aftë dhe studentët të dobët është më e theksuar kur është fjala për përdorimin e ideve , në të cilën disa dispozita janë të bashkuara në të tjerë për të prodhuar strukturave sintaksore koherente. Përmbledhjet sugjerojne se nxënësit e aftë janë shumë më mirë se studentët e dobët në mënyrënse si ata koordinonjë idetë.
Megjithatë, nuk ka dallime të mëdhaja mes nxënësve të mirë dhe mesatar - në mënyrën se si ata përdorin fjalet lidhese. Përmbledhjet tregojnë se nxënësit e mirë janë më efikas dhe kanë tendencë që të deklarojnë idetë kryesore në një mënyrë të përgjithësuar. Përveç kësaj , përmbledhjet tregojnë se studentët e mirë dhe mesatare, në përgjithësi, nuk thjeshtojnë idetë dhe janë më të aftë për identifikimin e këtyre ideve.
Mbi të gjitha , përmbledhjet e studentëve konfirmojnë që studentët e mirë, ndryshe nga studentët e dobët, nuk shtrembërojnë idetë e tekstit origjinal .

Përmbledhjet tregojnë se nxënësit me nivele të ndryshme janë vetëm në gjendje për të kombinuar idetë që ata mund të gjejnë në një paragraf; por e gjejnë të vështirë për të lidhur idetë që ndodhen në dy ose më shumë paragrafë. Përmbledhjet tregojnë se nxënësit me nivele të ndryshme shkruajnë fjali të gjata, por në përgjithësi nuk shtojnë mendime personale që nuk paraqiten në tekstin origjinal.

Referenca

Brown, A. S., Day, J. D & R. S. Jones (1983). The development of plans for summarizing texts. .

Campbell, J., Smith, D. & Brooker, R. (1998). From conception to performance: How undergraduate students conceptuaiize and construct essays

Carrell, P. L. (1992). Aëareness of text structure: Effects on recall. Language Learning

Ellis, R. (1987). Understanding second language acquisition. Oxford: Oxford University Press.

Goodman, K. S. (1996). On reading. Portsmouth, NH: Heinemann Smith

Horiba, Y. (1996). Comprehension Processes in L2 reading: Language competence, textual coherence, and inferences

Johns, A. M. (1984). On reading to summarize: a definition and steps for introductory teaching

Johns, A. M., & Mayes, P. (1990). An analysis of Summary Protocols of

University ESL students. Applied Linguistics
Klodeta Dibra & Nonda Varfi (2007) Gjuhësi Tekst, Albatros, Tirane
Smith, F. (1994). Understanding reading: A psycholinguistic analysis of reading and learning to read (5th ed.). Hillsdale, NJ: Erlbaum.
Taillefer, G. (1996). L2 reading ability: Further insights into the short-circuit hypothesis. Modern Language Journal, 80, 461-477.
Ëinograd, P. N. (1984). Strategic difficulties in summarizing texts. Reading
Research Quarterly
Zëann, R. A., & Broën, C. M. (1996). The influence of language proficiency and comprehension skills on situation model construction.

Modele të rinj të volatilitetit në tregjet financiare:

zbatim në rendimente aksionarë të rajonit të Ballkanit

Visar MALAJ[1] (PhD), Vincenzo Gentile[2] (PhD)

[1]*University of Tirana, Faculty of Economy, Department of Economics. Mail: visarmalaj@feut.edu.al*

[2] *Dipartimento di Scienze Economiche, Facoltà di Economia, Università del Salento.*
Mail: vincenzo.gentile@unisalento.it

Abstrakt

Procesi i volatilitetit lidhet me ecurinë e variancës së kushtëzuar të rendimenteve të asetit në kohë. Ky është një subject me interest ë theksuar, për shkak të se variabiliteti i rendimenteve të asetit varet nga koha dhe është përmban 'memorie të gjatë'. Në këtë punim, analizojmë disa formulime të reja, inovative, të modeleve MEM (Multiplicative Error Model). Ky model është përkufizuar nga Engle (2002) për procese positive dhe jepet si prodhimi i një faktori të kushtëzuar autoregresiv dhe një termi gabimi, i cili merr vetëm vlera positive. Ne zbatojmë këta modele në volatilitetin e aksioneve të disa kompanive të rëndësishme ndërkombëtare që operojnë në rajonin e BAllkanit, të listuara në bursat përkatëse. Ne përdorim programin kompjuterik R 2.12.2 për optimizimet përkatëse, një paketë 'open source' për analizë dhe modelim statistikor.

Fjalë kyçe: Tregje aksionare, pasiguri, volatilitet, modele MEM, rajoni i Ballkanit.

Hyrje

Pasiguria është thelbësore në modelimin e serive kohore financiare. Në shumë teori që lidhen me aksionet, pasiguria e lidhur me çmimin është një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e çmimit për riskun. Kjo lidhje analizohet shpesh me anë të variancës së kushtëzuar nga fakroti kohë. Në veçanti, shumë seri financiare, si rendimentet aksionare, nuk kanë një strukturë komplekse autokorrelacioni, por paraqesin varësi të gjatë në disa transformime të tyre, si për shembull rendimentet në katror. Në dekadën e fundit, volatiliteti i rendimenteve aksionare ka qenë në fokus të analizës teorike dhe empirike, falë edhe zhvillimit teknologjik. Volatiliteti shpreh magnitudën e ndryshimeve të çmimit të një aksioni të caktuar. Ky është një komponent që duhet marrë në konsideratë në vlerësimin e riskut të investimit në këto tregje. Një volatilitet i lartë tregon se çmimi i një aksioni mund të largohet shumë nga mesatarja e vetë me kalimin e kohës, pra investitori mund të regjistrojë humbje ose fitime të mëdha.

Volatiliteti i realizuar është një proçes pozitiv me varësi të theksuar kohore, e cila vërtetohet nga rënia e lehtë hiperbolike e funksionit të autokorrelacionit. Granger dhe Joyeux (1980) dhe Hosking (1981) sugjerojnë përdorimin e modeleve ARFIMA (fractionally integrated autoregressive moving average) për të 'kapur' varësinë e qëndrueshme në seritë kohore të fushave të ndryshme. Engle dhe Russell (1998) propozojnë një metodë të ndryshme për anlizën e të dhënave që regjistrohen në intervalë të caktuar kohorë si transkasionet financiare. Autorët sugjerojnë një model të ri statistikor, të quajtur ACD (autoregressive conditional duration), i cili mund të konsiderohet si pjesë e modeleve GARCH (conditional heteroskedasticity model), i përkufizuar nga Bollerslev (1986). Engle (2002) zgjeron analizën duke formuluar klasën e modeleve MEM (multiplicative error model) për vlerësimin e proçeseve jo-negativë. Ky model specifikohet nga një term gabimi që shumëzon mesataren e kushtëzuar, e cila ndjek një dinamikë të llojit GARCH.

Ne sugjerojmë në këtë punim një formulim origjinal dhe fleksibël të familjes MEM ku proçesi i volatilitetit të realizuar mund të shihet si një përzierje e dy shpërndarjeve Gamma me koefiçentë të ndryshëm për mesataren e kushtëzuar dhe parametra të ndryshëm për formulën e densitetit sipas De Luca dhe Gallo (2007). Në këtë analizë formulojmë gjithashtu, një specifikim alternative (origjinal) të familjes MEM me parametra variabël, të cilët varen nga e shkuara e serisë kohore. Artikulli është i organizuar si vijon. Në seksionin 2 përkufizohet nga ana analitike modeli MEM me disa karakteristika kryesore të tij. Në seksionin 3 përshkruhen formulimet që sugjerojmë, si dhe një aplikim empirik në volatilitetin e realizuar të disa kompanive ndërkombëtare që operojnë në rajonin e Ballkanit, të listuara në tregjet financiarë përkatës. Në seksionin 4 jepen disa shënime përmbyllëse.

2. Materiali dhe metodat

Modelet MEM përdoren në shumë kontekste, në veçanti në modelimin e rendimenteve në katror apo atyre në vlerë absolute. Në analizën tonë ne përqëndrohemi në volatilitetin e realizuar të çmimit të një aseti financiar. Konsiderojmë r_t, log-rendimenti ditor në kohën t me mesatare statistikisht zero. Struktura e përgjithshme e modeleve MEM përshkruhet për herë të parë nga Engle (2002) për volatilitetin e realizuar. Një model MEM(p,q) ka këtë formë:

$$y_t = «_t £_t$$

ku, duke u kushtëzuar nga informacioni i shkuar I_{t-1}, $«_t$ është një proçes jo-negativ i parashikueshëm. Evolucioni i $«_t$ varet nga një vektor

parametrash të panjohur θ, $«_t = «_t(g)$. $£_t$ ndjek një shpërndarje me suport jo-negativ, me mesatare 1 dhe variancë të panjohur $\pm^2$. Pra, kemi:

$$£_t | I_{t-1} \sim D(1, \pm^2).$$

Këto përkufizime na sigurojnë:

$$E(y_t | I_{t-1}) = «_t$$

$$V(y_t | I_{t-1}) = \pm^2 «_t^2$$

Për mbylljen e modelit, përshtatim një funksion densiteti për $£_t$ dhe specifikojmë një ekuacion për mesataren e kushtëzuar $«_t$. Një zgjedhje e zakonshme në shumë studime është përdorimi i shpërndarjes eksponenciale, një rast i veçantë i shpërndarjes Gamma.

$$£_t | I_{t-1} \sim Gamma(¤, 1/¤),$$

ku ¤ >0, $E(£_t | I_{t-1}) = 1$ dhe $V(£_t | I_{t-1}) = 1/¤$. Funksioni i densitetit kushtëzuar nga gabimet $£_t$ është:

$$f(£_t | I_{t-1}) = \frac{1}{\Gamma(¤)} ¤^{¤} £_t^{¤-1} \exp\{-¤£_t\}.$$

Mund të konkludojmë se y_t ndjek një shpërndarje Gamma të kushtëzuar nga e shkuara,

$$y_t | I_{t-1} \sim Gamma(¤, «_t / ¤)$$

me funksion densiteti

$$f(y_t | I_{t-1}) = \frac{1}{\Gamma(¤)} \frac{¤^{¤}}{«_t^{¤}} y_t^{¤-1} \exp\{-¤ \cdot y_t / «_t\}.$$

Pra, në këtë rast kemi:

$$E(y_t | I_{t-1}) = ¤ \cdot \frac{«_t}{¤} = «_t$$

$$V(y_t | I_{t-1}) = ¤ \cdot \frac{«_t^2}{¤^2} = \frac{«_t^2}{¤}.$$

Konsiderojmë për $«_t$, ekuacionin më të thjeshtë, GARCH(p,q).

$$«_t = \mu + \sum_{i=1}^{p} \sim \cdot y_{t-i} + \sum_{j=1}^{q} \quad {}_j \cdot «_{t-j}.$$

Vlerësojmë parametrat që përmban $«_t$, le t'i quajmë θ. Funksioni *log-likelihood* i dobishëm për vlerësimin është:

$$\log L(y_t;\overline{\ }) = l(y_t;\overline{\ }) = c - ¤\sum_{t=1}^{T}\left(\log «_t + \frac{y_t}{«_t}\right)$$

,

Ku *c* është një konstante pa rëndësi për vlerësimin e modelit dhe që varet nga Φ. Maksimizojmë funksionin në lidhje me *θ:*

$$\sum_{t=1}^{T}\left(\frac{x_t - «_t}{«_t^2}\right)\frac{\partial «_t}{\partial \overline{\ }} = 0 .$$

Ne përftojmë vlerat $\overline{\ }^{\wedge}_{SMV}$ me anë të *proçedurave përsëritëse* të Paketës R.

$$\overline{\ }^{\wedge}_{SMV} = \arg\max_{-} l(y_t;\overline{\ })$$

Shpërndarjet e probabilitetit duke respektuar *hipotezat e rregullsisë statistikore* do të jenë:

$$\sqrt{T}(\overline{\ }^{\wedge}_n - \overline{\ }) \overset{asy}{\sim} N(0, V_{as})$$

$$\overline{\ }^{\wedge}_n \overset{asy}{\sim} N(\overline{\ }, \frac{1}{T}V_{as}),$$

ku $V_{as} = J^{-1}$ është varianca asimptotike.

$$J = E\left[-\frac{\partial^2 l(y_t;\overline{\ })}{\partial \overline{\ }\partial \overline{\ }'}\right] ,$$

$$\hat{J} = -\frac{1}{T}\sum_{i=1}^{T}\frac{\partial^2 l(y_t;\overline{\ })}{\partial \overline{\ }\partial \overline{\ }'} = \frac{1}{T}\sum_{i=1}^{T}\frac{\partial l(y_t;\overline{\ })}{\partial \overline{\ }}\frac{\partial l(y_t;\overline{\ })}{\partial \overline{\ }'}\Big|_{\overline{\ }=\overline{\ }'}$$

Për verifikimin e hipotezës zero $H_0 : \overline{\ }_i = \overline{\ }_{i,0}$, përdorim testin e Studentit *t:*

$$t = \frac{\overline{\ }^{\wedge}_i - \overline{\ }_{i,0}}{\sqrt{V_{ii}}} ,$$

ku $\overline{\ }^{\wedge}_i$ është vektori rresht *i* dhe V_{ii} është elementi *(i,i)* i matricës $\frac{1}{T}\hat{V}_{as} = \frac{1}{T}\hat{J}^{-1}$.

Konsiderojmë një formulim të veçantë të modeleve MEM. Termi i gabimit $£_t$ ndjek një shpërndarje Gamma me parametra variabël. Le të quajmë y_t volatilitetin e realizuar të një aksioni çfarëdo. Kemi: $y_t = «_t £_t$. Termi i gabimit ka formën që vijon.

$$£_t \sim Gamma(ª_t, 1/ª_t),$$

me

$$ª_t = ¢_0 + ¢_1 \cdot y_{t-1} + ¢_2 \cdot ª_{t-1},$$

ku $¢_0, ¢_1, ¢_2 > 0$.

Forma e përgjithshme e ekuacionit së mesatares të kushtëzuar, e vlefshme për të gjitha specifikimet është si vijon.

$$«_t = µ + \sum_{i=1}^{p} ~ \cdot y_{t-i} + \sum_{j=1}^{q} \quad {}_j \cdot «_{t-j} .$$

Konsiderojmë gjithashtu një model, pjesë e familjes MEM, ku termi i gabimit shpërndahet sipas një perzierjeje Gammash me pesha fikse. Mesatarja e përgjithshme e termit të gabimit është gjithmonë e barabartë me

1. $$£_t = \begin{cases} £_{1,t} \, with \ prob. \quad ® \\ £_{2,t} \, with \ prob. (1-®) \end{cases}$$

$$£_{1,t} \sim Gamma(ª_1, ¥_1)$$

$$£_{2,t} \sim Gamma(ª_2, ¥_2)$$

ku $0 < ® < 1$.

Duke vendosur kushtin e mesatares së barabartë me 1, kemi:

$$¥_2 = \frac{1-®ª_1¥_1}{(1-®)ª_2} .$$

Proçedura e diagnostikimit të një modeli të vlerësuar përfshin si teste statistikorë, ashtu edhe metoda grafike të bazuara në mbetjet. Megjithatë, në disa modele të rinj të bazuar në përzierje shpërndarjesh, *Mbetjet e Pearsonit* nuk janë shumë të përshtatshme. Teknika e diagnostikimit që përdoret në këtë punë bazohet në Mbetjet Kuantile. Këto mbetje mund të ndërtohen për çdo model duke përdorur funksionin e shpërndarjes kumulative të vëzhgimeve. Ideja e Mbetjeve Kuantile e ka zanafillën nga Rosenblatt (1952) dhe u zhvillua nga Dunn dhe Smyth (1996).

Shënojmë me $F(y; «, ¤)$ funksionin e shpërndarjes kumulative të $P(«, ¤)$.

Nëse *F* është i vazhdueshëm, atëherë $F(y_i; «, ¤)$ ka shpërndarje uniforme në intervalin unitar. Mbetjet Kuantile janë të llogaritura sipas formulës:

$$r_{t, \hat{¯}_T} = \Phi^{-1}\left(F_{t-1}(\hat{¯}_T, y_t) \right),$$

ku Φ^{-1} është e anasjellta e funksionit të shpërndarjes kumulative të shpërndarjes normale standard. Pra, nëse Mbetjet Kuantile kanë karakteristika të tilla, modeli është i specifikuar në mënyrë korrekte dhe parametrat janë të vlerësuar në mënyrë konsistente.

3. Rezultatet

Konsiderojmë fillimisht volatilitetin e realizuar të aksionit *Avon International*, një kompani e rëndësishme kozmetikësh që operon në rajonin e Ballkanit. Periudha e zgjedhur është 5 vjeçare, nga 31/10/2008 në 20/12/2013. Seria kohore e volatilitetit të realizuar është ndërtuar si rrënja katrore e variancës së realizuar.

Provojmë të modelojmë seritë e volatilitetit të realizuar me të dy formulimet MEM. Shikojmë fillimisht se çfarë ndodh me modelin VP. Më poshtë kemi ekuacionin e variancës së kushtëzuar, ku $p = 2$ dhe $q = 1$:

$$«_t = \mu + \sim_1 \cdot y_{t-1} + \sim_2 \cdot y_{t-2} + \quad {}_1 «_{t-1} .$$

Mund të vërejmë në tabelën e mëposhtme vlerësimin dhe nivelin *p-value të vëzhguar* për shtatë parametrat për dy aksionet. Fiksojmë *a priori* një vlerë prej 5% për pranimin e hipotezës zero. Pra, ne pranojmë *'H0: Parametri është zero'* nëse *p-value i vëzhguar* është më i madh se 5% dhe anasjelltas nëse është më i vogel se 5%. Siç mund të shikojmë në tabelë, ne refuzojmë hipotezën zero në të gjitha rastet, duke veçuar vetëm rastin e parametrit $¢_1$, një tregues pozitiv për diagnostikimin e modelit.

Avon International			***Piraeus Bank***	
Parameter	**Estim.**	**p-value**	**Estim.**	**p-value**
μ	0,015	~0	0,0009	~0
$\sim_1$	0,0048	0,0106	0,0046	0,001
$\sim_2$	0,631	~0	0,33	~0
$_1$	0,054	0,0205	0,0913	~0
$¢_0$	0,281	~0	0,27	~0
$¢_1$	0,1143	0,76	0,47	0,83
$¢_2$	0,3085	~0	0,2117	~0

Tabela 1. Testimi i parametrave, modeli VP.

Kontrollojmë tani nëse modeli është i specifikuar drejt me anë të *Metodës së Mbetjeve Kuantile.* Në figurat 1 dhe 2 kemi paraqitur grafikun e Mbetjeve Kuantile, grafikun kuantil-kuantil (nëse shpërndarja i afrohet normales standard), funksionin e autokorrelacionit global (ACF) dhe atij parcial (PACF) të Mbetjeve Kuantile dhe të Mbetjeve Kuantile në katror për të dy aksionet. Vërejmë se përshtatja është përgjithësisht e mirë.



Figura 1. Grafikët e Mbetjeve Kuantile për Avon International, modeli VP.



Figura 2. Grafikët e Mbetjeve Kuantile për Piraeus Bank, modeli VP.

Provojmë tani të vlerësojmë seritë tona kohore me anë të formulimit tjetër MEM, atij MIX. Ky model është një përzierje e dy Gammave me koefiçentë të ndryshëm për mesataren e kushtëzuar. Ekuacioni për mesataren e kushtëzuar është: $«_t = \mu + \sim_1 \cdot y_{t-1} + \sim_2 \cdot y_{t-2} + \ _1 «_{t-1}$.

Avon International			*Piraeus Bank*	
Parameter	Estim.	p-value	Estim.	p-value
a_1	11,000	~0	35,000	~0
a_2	25,000	~0	44,000	~0
μ	0,038	~0	0,097	~0
$\sim_1$	0,215	~0	0,115	~0
$\sim_2$	0,119	0,112	0,324	0,301
$_1$	0,308	~0	0,651	~0
$¥_1$	0,23	~0	0,475	~0
®	0,061	~0	0,032	~0

Tabela 2. Testi i parametrave, modeli MIX.

Ne përdorim *metodën ML (Maximum Likelihood)* për vlerësimin e parametrave tanë. Siç mund të shihet nga tabela 2, refuzojmë hipotezen zero pothuajse në të gjitha rastet, duke përjashtuar vetëm rastin e koefiçentit $\sim_2$. *P-value* në këtë rast është më i madh se 5%, pra ne pranojmë hipotezën zero, koefiçenti është statistikisht i barabartë me zero.



Figura 3. Grafikët e Mbetjeve Kuantile për Avon International, modeli MIX.

Për diagnostikimin e modelit përdorim përsëri *Metodën e Mbetjeve Kuantile.* Pra, do të kontrollojmë nëse Mbetjet Kuantile janë të pavaruara dhe me shpërndarje normale standard. Nëse kjo është e vërtetë, modeli është i specifikuar drejt dhe parametrat janë të vlerësuar në mënyrë konsistente. Nëse jo, mbetjet kanë karakteristika të ndryshme, si ndërvarësi, autokorrelacion apo shpërndarje jo-normale. Në figurat 3 dhe 4 kemi paraqitur grafikun e Mbetjeve Kuantile, grafikun kuantil-kuantil (nëse shpërndarja i afrohet normales standard), funksionin e autokorrelacionit global (ACF) dhe atij parcial (PACF) të Mbetjeve Kuantile dhe të Mbetjeve Kuantile në katror për modelet e vlerësuar. Vërejmë në grafikun kuantil-kuantil, se pikat i përshtaten më së miri shpërndarjes normale. Funksionet e autokorrelacioneve globale dhe parciale janë brenda kufijve të lejueshëm. Mund të konkludojmë se modeli është i specifikuar drejt dhe parametrat janë vlerësuar në mënyrë konsistente.



Figura 4. Grafikët e Mbetjeve Kuantile për Piraeus Bank, modeli MIX.

4. Përfundime

Objektivi kryesor i këtij punimi është studimi i disa modeleve ekonometrikë dhe disa teknikave statistikore për modelimin e volatilitetit të rendimenteve aksionarë. Proçeci i volatilitetit lidhet me ecurinë e variancës së kushtëzuar në kohë. Në këtë punë, paraqitëm dy formulime të modeleve MEM, të cilët përbehen nga një përzierje (shperndarjesh) Gamma me parametra variabël dhe nga përzierja e dy Gammave me koefiçentë të ndryshëm për mesataren e kushtëzuar. Ne përdorim një metodë 'universale' të kontrollit të modelit, atë të 'Mbetjeve Kuantile'. Vëzhguam në të gjitha rastet një përshtatje të kënaqshme të Mbetjeve Kuantile me shpërndarjen normale standard dhe

gjithashtu, sinjale pozitive për pavarësinë. Nga vlerësimi i dy modeleve në seritë kohore reale, mund të themi se të dhënat i përshtaten mirë specifikimeve Gamma. Dy formulimet duket se e 'thithin' totalisht rënien e ngadaltë të funksionit të autokorrelacionit.

Mendojmë se në të ardhmen, analiza duhet të shtrihet në disa drejtime. Së pari, duhet të testojmë ekuacione të tjera për mesataren e kushtëzuar. Së dyti, ne duhet të zbulojmë variabla të tjerë që ndikojnë në peshat e shpërndarjeve dhe së fundi, duhet të krahasojmë performancat e modeleve të ndryshëm në parashikime, ku mënyra të tjera të modelimit të variancës së realizuar të merren në konsideratë.

Literatura

- Andersen, T.G., Bollerslev, T., Diebold, F.X., Labys, P. (2003): Modeling and Forecasting Realized Volatility, *Econometrica*, *71*, 579–625.
- Bollerslev, Tim (1986). "Generalized Autoregressive Conditional Heteroskedasticity". *Journal of Econometrics* 31 (3): 307–327.
- De Luca G., Gallo G.M. (2007), Time-varying mixture MEM for realized volatility, S.Co 2007, Book of Short Papers.
- Ding, Z., Granger, C. W. J. and Engle, R. F.: 1993, A long memory property of stock market returns and a new model, Journal of Empirical Finance 1, 83—106.
- Dunn, P.K., and G.K. Smyth (1996): "Randomized Quantile Residuals," Journal of Computational and Graphical Statistics, 5(3), 236—244.
- Engle, R.F. (2002): New Frontiers for ARCH Models, *Journal of Applied Econometrics*, *17*, 425-446.
- Engle, R.F., Gallo, G.M. (2006): A Multiple Indicators Model for Volatility Using Intra-Daily Data. *Journal of Econometrics*, *131*, 3–27.
- Engle, R.F., Russell, J.R. (1998): Autoregressive Conditional Duration: a new model for irregularly spaced transaction data. *Econometrica*, *66*, 1127–1162.
- Granger, C. W. J. and Joyeux, R. (1980). "An introduction to long-memory time series models and fractional differencing". *Journal of Time Series Analysis* **1**: 15–30.
- Hosking, J.R.M. (1981), 'Fractional differencing', Biometrika 68(1), 165-176.
- Lanne, M. (2006): A Mixture Multiplicative Error Model for Realized Volatility, *Journal of Financial Econometrics*, *4*, 594-616.
- Rosenblatt, M. (1952) "Remarks on a multivariate transformation". Annals of Mathematical Statistics, 23, 470–472.
- Crato, Nuno & de Lima, Pedro J. F., 1994. "Long-range dependence in the conditional variance of stock returns," Economics Letters, Elsevier, vol. 45(3), pages 281-285.
- Cox, D. R.; Snell, E. J. A general definition of residuals. Journal of the Royal Statistical Society B, London, v. 30, n. 2, p. 248-254, Mar. 1968.

AFTËSIMI PRAGMATIK DHE KOMUNIKATIV I NXËNËSVE TË GJUHËS SË HUAJ

Dr. Marsela Harizaj

Departamenti i Gjuhëve të Huaja

Fakulteti i Shkencave Humane

Universiteti "Ismail Qemali"

Vlorë, Shqipëri

marselaharizaj@yahoo.com

Abstrakt

Gjuha e huaj që nxënësit studiojnë është një mjet për komunikimin real dhe jo thjesht objekt studimi. Nxënësve u nevojitet pasurimi i njohurive të formave, kuptimeve dhe funksioneve gjuhësore. Nxënësit e gjuhës kanë probleme përsa i përket përdorimit pragmatik të gjuhës dhe përvetësimit të shprehive që u mundësojnë komunikimin. Me rëndësi të madhe është fakti se një kombinim i shkëlqyer i kompetencës pragmatike, komunikative dhe asaj gjuhësore u mundëson nxënësve arritjen e komunikimit.

Ky studim është kryer për të nxjerrë në pah problemet që hasin nxënësit e gjuhës angleze me përdorimin pragmatik të gjuhës në funksion të komunikimit. Pjesë e këtij studimi janë nxënësit që studiojnë gjuhën angleze si gjuhë të huaj në shkollat të ciklit 9-vjeçar dhe të mesëm si dhe studentë të gjuhës angleze të Universitetit të Vlorës. Në këtë studim është bërë një paraqitje teorike dhe praktike mbi problemet e përdorimit pragmatik të gjuhës, përvetësimin e shprehive, teknikat dhe strategjitë efikase që ndihmojnë nxënësit për kapërcimin e vështirësive. Përfundimet janë diskutime mbi këto problematika të nxjerra nga vëzhgimet e orëve mësimore të gjuhës angleze.

Fjalë kyç: aftësimi pragmatik, kompetenca komunikative, shprehitë komunikative

1. Hyrje

Gjuha është një mjet komunikimi. Të mësosh një gjuhë do të thotë të performosh akte të të folurit komunikativ me anë të gjuhës. Në metodën e mësimit të gjuhës për qëllime komunikimi, komunikim do të thotë përdorimi i gjuhës për qëllime të ndryshme: për të bërë kërkesa, për të dhënë këshilla, për të rënë dakort, për të kundërshtuar, për të nxitur njerëzit të bëjnë gjëra të ndryshme e kështu me rradhë. Sipas *Kuadrit të Përbashkët Evropian i Referencës për Gjuhët, (2006)* nxënësi është përdoruesi i gjuhës, dhe gjuha përdoret për të kryer akte të ndryshme të komunikimit, të cilat përfshijnë fusha të ndryshme nga jeta personale, publike, profesionale dhe edukative. Ka ndryshime rrënjësore midis përdorimit të gjuhës amtare dhe përpjekjes

për të mësuar një gjuhë, për të cilën nuk kemi shumë njohuri. Këto ndryshime shpjegojnë sjelljet e njerëzve në klasat e gjuhës së huaj dhe jashtë tyre. Ndryshimi rrënjësor është se njerëzit e përdorin gjuhën e tyre, në rastin tonë gjuhën shqipe jashtë klasës. Gjuha amtare mësohet nëpërmjet një procesi të gjatë biologjik dhe zhvillimi natyral të saj, ndërsa gjuha e huaj nuk përftohet biologjikisht, prandaj gjuha amtare dhe gjuha e huaj në mënyrën se si përvetësohen ndryshojnë nga njëra- tjetra.

Richards & Rodgers (1999) në studimet e fundit mbi gjuhën dhe metodat e mësimdhënies, theksojnë se gjuha shihet nga tre pikëpamje: strukturore, funksionale dhe ndërvepruese. Vështrimi i parë mbi gjuhën është tradicional dhe e sheh atë si sistem i elementeve strukturore të lidhura, të cilat shërbejnë për zbërthimin e kuptimit. Vështrimi i dytë e sheh gjuhën si mjet për të shprehur kuptimin funksional. Vështrimi i tretë e sheh gjuhën si mjet për të realizuar lidhjet ndërvetjake dhe ato shoqërore ndërmjet individëve.

Canale & Swain (1980) mbi aftësinë komunikuese dhe rëndësinë e saj identifikojnë katër dimensionet e aftësisë komunikuese të cilat sipas tij janë: kompetenca gramatikore, sociolinguistike, ligjërimore dhe ajo strategjike. Nxënësve duhet t'u jepet mundësia ta dëgjojnë gjuhën ashtu siç flitet në komunikimin real. Ata vetë duan të përdorin strategji për të përmirësuar shkallën e të kuptuarit. Larsen (2000). Po në të njëjtën mënyrë Savignon (1997) shpjegon se në komunikim interpretohet, negociohet dhe kuptimi tekstit nxirret duke përdorur kompetencën gramatikore, ligjërimore dhe atë sociolinguistike.

Kjo do të thotë se në ligjërim përdoren forma të ndryshme gjuhësore për të shprehur funksionet. Këto varen nga lloji i bisedës dhe pjesëmarrësve, pra është e rëndësishme të dihet se *kush flet, me kë flet* që të arrihet qëllimi i bisedës. P.sh., Nëse folësi do që dikush të mbyllë derën mund të përdori fjalitë e mëposhtëme:

Close the door please! (joformale) Mbylle derën të lutem!

Would you mind if you close the door? (formale) Ju vjen keq nëse mbyllni derën ju lutem?

Këto zgjedhje varen edhe nga situata dhe konteksti në të cilat përdoren. Për këtë duhet të shikohet kuptimi formal i asaj që thuhet apo shkruhet, të kuptohet se cili është qëllimi i dërguesit, qëllimi i mesazhit dhe të përpiqemi të kuptojmë *funksionin* e tij.

Një faktor tjetër i rëndësishëm është interpretimi i situatës shoqërore në të cilën ndodh komunikimi. Gjuha s'ka vetëm funksion kuptimor, por edhe shoqëror. Lloshi (2001) thekson se gjuha i shërben edhe një larmie funksionesh shprehëse e shoqërore dhe midis tyre nuk ka ndarje të prerë, nuk shkëputet funksioni përshkrues (vetjak) nga funksionet ndërpersonale (sociale) të gjuhës. Për këtë arsye përvetësimin e gjuhës qoftë ajo gjuhë

amëtare apo e huaj duhet ta shohim nga një vështrim tjetër që është ai pragmatik.

2. Aftësimi i kompetencës pragmatike në gjuhë të huaj

Pragmatika është shkenca që sheh përdorimin e gjuhës nga njerëzit realë për qëllimet e tyre, por edhe brenda aftësisë së tyre për ta kapur gjuhën. Lloshi (2001) Ndërsa për Littlewood (2002) aftësia e komunikimit gjuhësor përmban në vetvete disa përbërës: një përbërës gjuhësor, një përbërës socio-gjuhësor, një përbërës pragmatik. Pra, kur flasim për format gjuhësore dhe përdorimin pragmatik të tyre bëhet lidhja midis zgjedhjes së fjalëve të duhura për një kontekst të dhënë, për personin e duhur, kur dhe si t'i thuhet diçka, pra është e rëndësishme të dihet se si të përdoret fjala dhe për ta kuptuar këtë duhet të dihet se çfarë është kompetenca pragmatike:

- *Aftësia për të përdorur gjuhën për qëllime të ndryshme.*
- *Aftësia për ta kuptuar gjuhën e folësit dhe qëllimin e tij.*
- *Aftësia për të përdorur fjalët në fjali për qëllime të ndryshme.*

Në këtë drejtim, Kasper & Rose (2002) theksojnë se nëpërmjet zhvillimit të aftësisë pragmatike, folësit janë në gjendje të bëjnë zgjedhjet e tyre gjuhësore në përputhje me rrethanat, duke ditur qëllimin e bisedës për krijimin e identiteteve dhe marrëdhënieve shoqërore. Studimet tregojnë se një mosnjohje e thellë e gramatikës nuk i pengon folësit të zhvillojnë aftësinë për të ndërvepruar dhe zhvilluar aftësinë komunikuese.

Ora e mësimit quhet tradicionale kur mësuesi është në qendër të procesit mësimor, ku të folurit nuk është në nivel të barabartë, sepse flet vetëm mësuesi. Duke pasur parasysh këtë kufizim, aftësimi pragmatik i bazuar në përdorimin e materialeve autentike në klasë është një mjet i rëndësishëm për nxënësit që e studiojnë anglishten si gjuhë të dytë dhe veçanërisht e rëndësishme për ata që e studiojnë atë si gjuhë të huaj duke marrë një input pragmatisht të përshtatshëm që në fazat e para të përvetësimit të gjuhës. Këtu mund të citojmë një thënie nga Kasper & Schmidt (1996) ku nënvizojnë: *"Roli i përdorimit të gjuhës në kontekst është tepër i rëndësishëm në klasat e gjuhës së huaj, ku mundësia për të zhvilluar një ndërveprim të plotë është tepër e kufizuar."*

Pra nxënësit mësojnë në klasë, sepse jashtë saj ata përgjithësisht komunikojnë në gjuhën e tyre, përveç rasteve kur grupmoshat e ndryshme e mësojnë gjuhën për arsye punësimi apo e mësojnë atë në mjedise reale gjuhësore. Lloshi (2001) thekson se pragmatika sheh a i plotëson gjuha funksionet e komunikimit dhe të ndërveprimit. Ajo përqëndrohet tek përdoruesit e gjuhës dhe kushtet e përdorimit të saj. Pra me fjalë të tjera gjuha duhet të mësohet për ta përdorur qartë, në situatën e duhur dhe në kontekstin e duhur.

3. Strategjitë dhe teknikat efikase për përvetësimin e shprehive komunikative

Të mësosh nxënësit është një detyrë sa e bukur, aq edhe e vështirë. Duke qenë se i foluri kufizohet në klasë, jo të gjithë nxënësit janë të aftë të komunikojnë. Gjithashtu detyrat e ofruara nuk janë gjithnjë komunikative. Për këtë arsye duhen gjetur strategji të mësimdhënies, të cilat ndihmojnë nxënësit në mësimnxënie. Strategjitë e përdorura duhet të ndryshojnë sipas moshës dhe ecurisë së nxënësve. Sipas Schwabit (1994) është alarmuese, nëse një mësues përdor të njëjtat strategji në mësimdhënie. Për këtë arsye strategjitë duhet të variojnë.

Kjo paraqet një sfidë të veçantë për mësuesit sepse duhen gjetur mënyrat më efikase që mësuesit mund të përdorin për t'i ndihmuar nxënësit të kapërcejnë barrierat në konceptin e një mësimdhënie kuptimplotë. Nxënësit tanë kanë probleme të mëdha përsa i përket përdorimit pragmatik të gjuhës angleze, formave apo përdorimit sipas funksioneve gjuhësore si edhe përvetësimit të shprehive të duhura sipas konteksteve të dhëna.

Këto koncepte lidhen edhe me vetë strategjitë që nxënësit përdorin për të mësuar që sipas Cohen & Weaver(1998) janë: strategjitë njohëse, gjuhësore dhe emocionale. Përdorimi i modeleve të ndryshme dhe mjeteve ndihmëse pamore si grafika, piktura, diagrama, tabela ndihmojnë nxënësin të kuptojë më mirë informacionin e dhënë duke lidhur idetë dhe konceptet. Mjete pamore bëjnë që gjuha dhe përmbajtja të krijojnë lehtësim tek të nxënit.

Kjo strategji është shumë e mirë si për grupmoshat 12- 14 ashtu edhe për 15- 17 vjeç. Strategjitë që përdoren në mësimdhënie varen edhe nga stilet e mësimnxënies. Kjo duket edhe nga veprimtaritë që jepen. Ka nxënës që punojnë mirë me tabela, por ka edhe nga ata që punojnë mirë me anë të dëgjimit. Nëse në klasë nxënësit kanë stile të ngjashme të të nxënit lehtësohet programimi i orës mësimore, por nëse ka nxënës me stile të ndryshme të të nxënit, atëherë dhe përzgjedhja e paraqitja e mësimit dhe veprimtarive kërkon përdorimin e strategjive e teknikave të reja.

Në përgjithësi pavarësisht moshës së nxënësve mënyra me e mirë për t'i dhënë dhe praktikuar nga ana e nxënësve shprehitë janë paraqitja e tyre me anë të disa teknikave.Teknika që përdoret më shumë sot është breinstorming (vërshim i shpejtë i ideve apo stuhi mendimesh) i cili është paraqitja e idesë kryesore dhe lidhjet që ka ajo me nëndarjet e saj. Musai (2003) Kjo lloj teknike përdoret gjerësisht në mësimdhënien e sotme në veprimtaritë komunikative jo vetëm në gjuhën e huaj por edhe për lëndë të tjera. Është teknikë efikase, sepse zhvillon zgjidhjen krijuese të një problemi, zhvillon mendimin kritik të nxënësit zhvillon aftësinë njohëse.

Për të rritur aftësinë komunikuese të nxënësve mund të përdoren tema të tilla, të cilat u japin mundësi nxënësve të përdorin shprehitë e nevojshme në bazë të situatës. Kualida(1996) Tema të tilla mund të jenë

moti, udhëtimet, etj. Kjo është një teknikë shumë e mirë si për shpjegimin e temave të reja, fjalorin, shprehjet komunikative, idetë e një detyre që ka për bazë dëgjimin etj.

Hartat e fjalëve janë një teknikë e shkëlqyer për ta ndihmuar fëmijën në përvetësimin e fjalëve. Sipas Richardit(1990) këto mund të përdoren shumë mirë gjatë veprimtarisë të nxemjes, pra faza përgatitore, si tek pjesa e leximit, ashtu edhe për të shpjeguar aftësinë gjuhësore të shkrimit. Me anë të punës me role nxitet bashkëpunimi, rritet përvetësimi dhe mund të përdoret shumë mirë për grupmoshat 8-15 vjeç. Duke marrë role bëhet përshtatja e rolit, kështu që edhe shprehjet komunikative edhe aftësitë gjuhësore praktikohen më së miri.

Të shkruarit është një teknikë, e cila ndihmon nxënësit të shkëmbejnë mendimet. Konceptet jepen në copëza letrash dhe çdo nxënës i bashkangjit idetë e veta. Ato mund të përmbajnë pyetje dhe ata japin idetë e tyre për shembull: *Si do të veprojmë ne…..? How do we….? Çfarë do të thotë të…? What would it take to…?* Shkallëzimi i të dhënave të reja i ndihmon nxënësit të kuptojnë konceptet dhe lidhjet e tyre.

Teknikë tjetër po aq efikase sa të lartëpërmendurat është diskutimi. Musai(2003) thekson se diskutimi përbën një teknikë të nxëni që përfshin shkëmbim idesh, të nxënë aktiv dhe pjesëmarrjen e të gjithë atyre që janë të interesuar. Diskutimi është i efekshëm për nxënësit sepse i motivon, i aftëson në zbatimin e koncepteve, rrit të kuptuarin dhe zhvillon aftësinë e nxënësit të gjuhës së huaj për të zgjidhur probleme.

4 . Metodologjia

Konceptet e nxënësit mbi strategjitë dhe teknikat për përvetësimin e shprehive komunikative

Në këtë pjesë do të fokusohemi tek problemet që hasin realisht nxënësit për ta përvetësuar gjuhën, për ta përdorur jashtë klasës, probleme me përvetësimin e shprehive që përdoren në komunikim, ashtu si në gjuhën amtare, probleme me aftësitë gjuhësore dhe ndihmëse, strategjitë që përdorin nxënësit dhe ato që përdoren në klasa për t'i kapërcyer ato. Pyetjet mbi këtë koncept janë kryer me nxënës të klasave VII-XII. Shkollat e përzgjedhura janë katër me numër të barabartë klasash për secilën shkollë. Numri i nxënësve është 250 nxënës dhe 50 studentë. Pyetjet janë përzgjedhur për klasat sipas nivelit gjuhësor.

Koncepti i mësimnxënies dhe komunikimi

Pyetja e parë ka të bëjë me aftësitë gjuhësore dhe nivelin e tyre. *A beson në aftësitë e tua gjuhësore për nj*ë *mësimnxënie shumë të mirë drejt komunikimit? Po 34% Jo 56%* Pra siç e shikojmë edhe nga pyetësori, nxënësit nuk kanë shumë besim në vetvete, sepse ndihen të pasigurt për ta bërë këtë. Nga vëzhgimet nxënësit kanë më shumë probleme me të folurin, i cili pasohet nga të lexuarit dhe të shkruarit që kanë pothuajse përqindje të

njëjtë, ndërsa dëgjimi i pason me një përqindje më të ulët, por praktikisht nuk ka shumë dallime midis njëra –tjetrës.

Koncepti i përvetësimit të shprehive komunikative

Për këtë koncept kjo pjesë e pyetësorit përmban tre pyetje hulumtuese të cilat janë kryer me 250 nxënës dhe 50 studentë; nxënësit janë kryesisht të klasave VIII- XII, ndërsa studentët janë studentë të gjuhës angleze në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë. Numri i klasave të përzgjedhura është 10 klasa. Pyetjet hulumtuese për këtë koncept janë: *Ç'kupton me shprehi komunikative? - A je në gjendje të hapësh, të mbyllësh dhe të bësh biseda të ndryshme në gjuhën angleze ashtu siç je i aftë në gjuhën shqipe (specifiko)? Po 37% Jo 63%.* Janë rreth 56% e nxënësve që kanë shprehur pothuajse të njëjtin mendim. Janë ato shprehi që përdoren për të komunikuar dhe shprehur mendimet , ndjenjat tek të tjerët. 30% *e nxënësve kanë dhënë përgjigjen e dytë.* Nuk e di-12 % *Kur shpreheni në gjuhën angleze mendoni shqip apo anglisht?78%* janë përgjigjur se mendojnë në gjuhën shqipe dhe përdorin fjalë të shqipes në gjuhën angleze ose formulojnë fjalitë dhe bëjnë përkthim fjalë për fjalë.

Leksiku që nxënësit zotërojnë dhe njohin nuk është i mjaftueshëm për të komunikuar ashtu siç veprojnë në gjuhën shqipe. Përsa i përket po këtyre pyetjeve drejtuar studentëve të gjuhës angleze kemi të njëjtat komente të cilat po i paraqesim në mënyrë të përmbledhur:

Komente të nxënësve :

- ✓ Aftësia dhe saktësia e të folurit si në shqip ashtu edhe në anglisht.
- ✓ Me shprehi komunikative kuptoj shprehje që përdoren gjatë komunikimit.
- ✓ Kuptoj të gjesh fjalët e duhura për komunikim.
- ✓ Të jesh i aftë të komunikosh dhe të përshtatësh fjalët.

Komente të studentëve të gjuhës angleze:

- ✓ Me shprehi komunikative kuptoj pak a shumë mënyrën se si shprehemi në mënyrë formale ose joformale. Si i zgjedhim fjalët në bazë të situatës që ndodhemi.
- ✓ Më shprehi komunikative kuptojmë shprehjet që ne përdorim në jetën e përditëshme. Këto shprehi përdoren në bazë të personit që i drejtohemi dhe moshës.
- ✓ Me shprehi komunikative kuptoj përdorimin e formave të ndryshme në bazë të funksioneve gjuhësore në varësi të asaj që dua të them vendit, personi, situatës.

Cilat janë strategjitë që përdoren në klasë për ta përdorur gjuhën për qëllime komunikimi? *Përshkruaj.*	*Vlerësimi në %*
të mësuarit e shprehive në situata të caktuara	*10%*
të mësuarit nëpërmjet detyrave praktike	*22%*
të mësuarit përmendësh lexim –përkthim	*43%*
të mësuarit e shprehive në detyrat në klasë	*20*
Të tjera	*8%*

Tabela.1 Strategjitë e përvetësimit të shprehive të përdorura në klasë

Siç vihet re edhe nga përgjigjja, pjesa më e madhe mësojnë përmendësh, gjë e cila nuk i ndihmon, sepse duhet mësuar me logjikë dhe në mënyrë praktike. Pra nxënësit kanë probleme të theksuara në komunikim dhë përvetësim të gjuhës. Nëse strategjitë dhe teknikat e përmendura përdoren rregullisht dhe të kombinuara ashtu siç e theksuam të grupuara sipas moshës dhe nivelit gjuhësor, atëhere këto vështirësi do të kapërcehen.

Përfundime

Pjesa më e madhe e nxënësve të gjuhës angleze kanë vështirësi, të nisin një bisedë dhe të ndërtojnë një bisedë të thjeshtë. Që të ketë aftësim në komunikim nxënësit duhet të praktikojnë lloje të ndryshme komunikimi ku të përdorin shprehitë e duhuara në format e duhura sipas funksioneve të ndryshme gjuhësore, që të shprehin lirshëm mendimet e tyre në bazë të vendit, folësit dhe situatës. Përdorimi i strategjive dhe teknikave të ndryshme të aftësive gjuhësore dhe ato strukturore forcon dhe rrit aftësinë komunikuese të nxënësve tanë dhe të shprehive.

Komunikuesi më i mirë i një gjuhe të huaj nuk është gjithmonë personi i cili manipulon strukturat gjuhësore, por personi i cili ka aftësi të fillojë dhe vazhdojë një bisedë, një situatë që përfshin atë dhe dëgjuesin, duke marrë parasysh njohuritë që ka secili. Çdokush që studion një gjuhë të huaj ka nevojë të zhvillojë aftësitë gjuhësore duke u ekspozuar në situata ku theksi vihet tek gjuha reale. Është e rëndësishme që nxënësit t'i përdorin njohuritë, për të komunikuar qartë dhe saktë.

Për këtë e rëndësishme është të kuptohen dhe të shprehen kuptimet shoqërore, të njihet përdorimi pragmatik i fjalëve dhe shprehjeve që përdoren në komunikim. Kjo mund të arrihet nëse mësuesi përdor strategjitë dhe teknikat e duhura në lidhje jo vetëm me moshën dhe nivelin gjuhësor, por edhe me objektivat dhe pritshmëritë e nxënësve. Përdorimi i veprimtarive të larmishme komunikative dhe përdorimi i gjuhës në kontekstin e dhënë do t'ju mundësojë nxënësve përvetësimin e gjuhës dhe komunikimin.

Literatura

Canale,M & Swain, M.(1980): Theoritiocal bases of communicative approaches to second language teaching and testing. Applied Linguistic. fq.1-47

Cohen A.D., Weaver S.J.(1998): Strategies-based instructions for second language learners.in Renandya & G.M.Jacobs. Learners and language learning.SEAMEO.fq.1-25

Kasper, G., & Schmidt, R. (1996): Developmental issues in interlanguage pragmatics. Studies in Second Language Acquisition, 18, 149–169.

Kasper G., Rose K. R. (2002): Pragmatic development in a second language. Oxford, UK: Blackwell.

Kuadri i Përbashkët Evropian I referencave Për Gjuhët.(2006); MASH.SH.B. Filara.fq.18.

Kualida.(1996): Aspekte të mësimdhënies.Tiranë.fq.22

Larsen Freeman Diane.(2000): Techniques and Principles in Language Teaching . Oxford University Press.fq.131.

Littlewood ,William.(2002): Communicative Language Teaching. Cambridge University press. fq.4

Lloshi Xh. (2001): Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika. SHBLU(bot.2-të). 293-294. 288.297.298

Musai, Bardhyl (2003): Metodologjia e Mësimdhënies.(2003).fq.198.

Richards, J.C., (1990): The Language Teaching Matrix, Cambridge University Press.

Richards, J.C. & Rodgers, T.S. (1999): Approaches and Methods in Language Teaching.Cambridge: Cambridge University Press.fq. 17-71

Savignon S. (1997): Communicative Competence: Theory and Classroom Practice (2nd editin. Sydney: Mc Graw Hill Companies. Language Teaching fq.105-181

Schwab Joseph. (1994): Structure of the disciplines.Chicago: Rand Mc.Nally.

E DREJTA E PRONËS SI NJË E DREJTË KUSHTETUESE NË RAPORT ME INTERESIN PUBLIK SI NJË KUFIZIM KUSHTETUES

Msc. OLJANA HOXHAJ

Departamenti i Drejtësisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

oljana.hoxhaj@gmail.com

Abstrakt

Prona private dhe publike sanksionohen si baza e sistemit ekonomik në Republikën e Shqipërisë. Kushtetuta afirmon një mbrojtje të njëjtë si per pronën publike edhe për pronën private. E drejta e pronës private ka një status kushtetutor dhe lidhje të ngushtë me lirinë individuale. Ne kete kontekst ajo konsiderohet si një e drejtë individuale, por duhet të theksojmë se në thelb pronësia është një kategori sociale, e cila nuk mund të ushtrohet vetëm, pasi ka karakter shoqëror. Pronësia i shërben mirëqënies së përgjithshme publike, por pavarësisht kësaj, ajo është një kategori kushtetuese e kufizueshme. Fokusi i këtij punimi janë kufizimet për interesin publik. Këto kufizime kryhen vetëm kundrejt një shpërblimi të drejtë. Çdo privim nga e drejta e pronës duhet të jetë kërkuar nga interesi publik, por asnjëherë këto kufizime nuk duhet të prekin thelbin e kësaj të drejte. Praktika gjyqësore ka evidentuar vështirësi në përcaktimin e kufijëve, të cilët nuk duhen tejkaluar, pasi e çnatyrojnë thelbin e të drejtës së pronësisë.

Fjalët kyce: e drejta e pronësisë, interes publik, kushtetutë, shpronësim.

1. Hyrje

1.1 Një vështrim historiko-kushtetues mbi të drejtën e pronësisë

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e vitit 1998 e sanksionon të drejtën e pronësisë krahas ekonomisë së tregut dhe lirisë së veprimtarisë ekonomike, si baza të sistemit ekonomik në Shqipëri.[1] Kushtetuta shqiptare bën një rregullim të përgjithshëm të pronës private dhe i referohet rregullimit ligjor, si për çështjet që lidhen me fitimin dhe tagrat e pronësisë, ashtu dhe për çështjet që lidhen me kufizimet përkatëse. Ajo përcakton vetë mënyrat e fitimit të pronës private, duke sanksionuar shprehimisht ato klasike, si: me dhurim, me trashëgimi, me blerje. Gjithashtu, me anë të një rezerve ligjore të përforcuar, ajo i referohet mënyrave të tjera klasike që mund të parashikohen vetëm në Kodin Civil, duke mos lënë shkas për parashikime të tjera të fitimit të pronësisë.

Ky formulim kushtetues tregohet më strikt në raport me kushtetutat e vendeve te tjera, të cilat për këtë cështje i drejtohen thjesht ligjit. Kjo dispozitë është ndoshta, një reagim ndaj përvojës së regjimit monist,

[1] Neni 11 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë 1998.

periudhë në të cilën, në mënyre unikale, si ne asnjë vend tjeter të Evropës Lindore, ndodhi shtetëzimi i të gjithë pasurisë së qytetarëve, sic ishte rasti i Tokës.[2]Nëse do të bënim nje retrospektivë në rregullimin e marrëdhënieve të pronësisë ne vitet 1945-1976, rezulton se objektivi i parë i pushtetit ishte shtetëzimi i mjeteve kryesore të prodhimit. Kjo mund te realizohej vetëm nëpërmjet reformimit të sistemit ligjor të brendshëm. Ecuria e këtij procesi fillon me miratimin e Kushtetutës së vitit 1946, ligj i cili përbënte aktin e parë rregullues të marrëdhënieve të pronësisë.

Miratimi i aktit themelor të shtetit, u pasua nga ligje dhe akte të tjera nënligjore, nëpërmjet te cilave shteti forcoi në mënyrë graduale sistemin e ekonomisë së centralizuar. Kushtetuta e miratuar ne 14 mars 1946, në përmbajtjen e saj përkufizonte karakterin dominues të pronës shtetërore në raport me llojet e tjera të pronës. Në këtë kushtetutë, çështjeve të pronësisë i kushtohen disa nene në kapitullin e dytë, të titulluar "Rendi shoqëror dhe ekonomik". Në këtë konkekst është sanksionuar se:

"Në Republikën Popullore të Shqipërisë mjetet e prodhimit përbëhen prej pasurisë së përbashkët të popullit që gjendet në duart e shtetit, prej pasurisë së organizatave kooperativiste popullore dhe prej pasurisë së personave privatë, fizikë ose moralë."[3]

Në një interpretim të zgjeruar që mund t'i bëjmë përmbajtjes së dispozitave të kësaj kushtetute, arrijmë të kuptojmë se ajo hodhi bazat juridike te shpronësimit të individëve në favor të individëve të tjerë privatë që nuk kishin tokë ose kishin një sasi të pamjaftueshme. Në zbatim të këtij synimi parashikohej se :

"Pronësia private mund të kufizohet ose shpronësohet kur e lyp interesi i përgjithshëm e në bazë të një ligji. Me ligj do të caktohet se në ç'rast dhe sa do te shpërblehet pronari".[4]

Krahas ndryshimeve ekonomike-shoqërore në përgjithësi, ndryshimet vazhduan edhe në fushën e marrëdhënieve të pronësisë mbi tokën, duke eleminuar totalisht marrëdhëniet e vjetra. Për të realizuar një angazhim të tillë u miratua një ligj i posaçëm i reformës agrare. Nga tërësia e dispozitave të këtij ligji, synohej t'i bëhej një shpërndarje e barabartë e tokës bujqësore dhe nga kjo të përfitonin, popullsia në fshat. Në këtë ligj sanksionohej se:

"Do të ishin objekt shpronësimi çifligjet e shtetit, pronat bujqësore të konfiskuara përgjithësisht, pronat bujqësore private, tokat e enteve fetare, si dhe tokat e dhëna emigrantëve nga reforma agrare e mbretit Zog. Këto toka të shpronësuara do t'u ndahen shtetasve shqiptarë që nuk kanë tokë të tyre ose kur kjo tokë është e pamjaftueshme."[5]

---

[2] Omari L, Anastasi A, (2008) "E Drejta Kushtetuese", ABC, Tiranë, faqe 106.
[3] Neni 7 i Kushtetutës së vitit 1946
[4] Neni 11 i Kushtetutës së vitit 1946
[5] Neni 1 i ligjit nr. 108, date 29.08.1945 "Mbi Reformën Agrare"

Në periudhën 1945-1976, lidhur me rregullimin juridik të pronësisë mbi tokën janë miratuar edhe disa ligje të tjera organike, në të cilat gjejnë pasqyrim parimet e Kushtetutës së vitit 1946. I tillë konsiderohet Dekreti nr. 2083, date 6.7.1955 "Mbi pronësinë". Nga përmbajtja në tërësi e dispozitave të dekretit, rezulton se njiheshin juridikisht tre subjekte të pronësisë mbi token, të cilët janë: shteti, kooperativat bujqësore dhe personat privatë. Në këtë dekret është parashikuar se:

"Pasuritë mund të jenë në pronësi të shtetit dhe të organizatave kooperativiste ose shoqërore (pronë socialiste) si dhe të personave (pronë personale dhe private)".[6]

2. Metodat

Për realizimin e këtij punimi kam aplikuar metoden cilësore, e cila është siguruar nga burime dytësore, kryesisht libra si dhe nga një vështrim i detajuar mbi legjislacionin kushtetues shqiptar dhe legjislacionit evropian.

3. Pronësia si një e drejë e afirmuar paralelisht me proçeset demokratike në Shqipëri

Pronësia, përgjithësisht vlerësohet si një marrëdhënie shoqërore, por edhe juridike, pra si një marrëdhënie që e gjen ekzistencen e saj vetëm nëpërmjet disa rregullave veprimi të parashikuara nga ligji. Këto rregulla të komunikimit juridik janë të përcaktuara edhe për subjektet e pronësisë. Ligji njeh si tagra apo pushtet të pronarit mbi sendin, të drejta të tilla si e drejta e posedimit, gëzimit dhe disponimit. Këto të drejta ushtrohen nga pronari brenda disa kufijve të parashikuar me ligj. Krahas të drejtave që i njihen pronarit, ligji njëkohësisht i detyron personat e tjerë, që të mos kryejnë veprime, të cilat do të përbejnë shkelje të të drejtave të pronarit. Përmbajtja e pronësisë si element i rëndësishëm i marrëdhënieve juridike tregon të drejtat dhe detyrimet që vendosin palët.

Ndryshimi i sistemit politik në Shqipëri pas vitit 1990, solli ndryshime edhe ne strukturën ekonomike të shoqërisë. Karakteri i ri i marrëdhënieve shoqërorë do të sillte edhe ndryshime themelore në format e pronësisë në përgjithësi dhe të pronësisë mbi tokën në veçanti. Deri në vitin 1990 forma kryesore e pronësisë ishte forma shtetërore dhe shteti konsiderohej pronari më i madh. E gjithë toka, pavarësisht nga natyra e saj, konsiderohej si pronë shtetërore dhe të gjithë subjektet e tjerë kishin vetëm të drejtën e përdorimit dhe të administrimit.[7]

Proçeset e reja ekonomiko-shoqërore, të cilat diktuan kalimin e ekonomisë nga ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu, kërkonin dhe zgjidhjen e problemit të pronësisë mbi tokën. Kjo do të thotë që forma e pronësisë mbi tokën do të ndryshonte duke u transferuar nga pronari i deri atëhershëm që

---

[6] Dekreti nr. 2083, date 6.7.1955 "Mbi pronësinë", neni 3.
[7] Mecani D,(2008), "Pronësia mbi Tokën", Triptik, Vlorë, faqe 76.

ishte shteti, te subjekte të tjerë. Në mënyrë të natyrshme këto ndryshime do të shoqëroheshin edhe me aktet ligjore përkatëse. Ishte ligji "Për dispozitat kryesore kushtetuese", si një ligj themeltar i shtetit, i cili hapi rrugën për nxjerrjen e akteve të tjera juridikë, që do të sanksiononin më pas rregullimin e marrëdhënieve në ekonominë e tregut.[8]

4. E drejta e pronës sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

E drejta e pronësisë garantohet në rendin ligjor te Komunitetit, në përputhje me idetë e përbashkëta të kushtetutave të vendeve anëtare, të cilat janë reflektuar gjithashtu në Protokollin e Parë të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

"Çdo person fizik ose juridik autorizohet të gëzojë në paqe pronat e tij ose posedimet e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përvecse për interesin publik dhe kur i nënshtrohet kushteve të siguruara nga ligji dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

E drejta e garantuar në pjesën e parë të këtij Artikulli, nuk duhet të ndikojë mbi të drejtën e shtetit për të kaluar ligje të cilat i konsideron të nevojshme për ushtrimin e kontrollit mbi përdorimin e pronës në përputhje me interesat e përgjithshme, apo për të siguruar pagesën e taksave apo kontributeve të tjera përfshirë gjobat."[9]

Shteti mund të zbatojë ligje të tilla kur vlerësohen të nevojshme për të kontrolluar pronën në përputhje me interesin e përgjithshëm, ose të sigurojë pagesën e dëmit, taksave, kontributeve, ose sanksioneve të tjera. Duke deklaruar se personat autorizohen të gëzojnë në paqe pronën e tyre, dispozitat e kësaj rregulloreje parashikojnë dy mënyra në të cilat të drejtat e zotëruesit të një prone mund të kufizohen. Kufizimi synon t'i heqë pronarit të drejtën e tij, ose të ngushtojë ushtrimin e kësaj të drejte. Në çështjen *Liselotte Hauer V. Land Rheinland-Pfalz*[10] është e pakontestueshme që ndalimi i mbjelljeve të reja nuk mund të konsiderohet një akt që i heq pronarit të drejtën mbi pronën e vet, për sa kohë ai mbetet i lirë ta shesë atë, ose ta vendosë në përdorim tjetër, që nuk është i ndaluar. Nga ana tjetër nuk ka dyshim që ky ndalim, e ngushton përdorimin e pronës.[11]

Kur trajton çështje lidhur me të drejtën e pronës, Gjykata është përpjekur t'i zgjidhë ato pak a shumë në të njëjtën mënyrë si ka trajtuar cështjet e garantuara në *Art 8-11*. Kjo për arsye të uniformitetit me mënyrën sesi trajtohen çështjet kur kemi një ndërhyrje nga shteti në një të drejtë. Gjykata është shprehur në mënyrë të përsëritur se *Art 1* përmban tre rregulla të

---

[8] Ligji nr. 7491, datë 29.04.1991 :Për dispozitat kryesore kushtetuese".
[9] Protokolli 1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njerut.
[10] Liselotte Hauer V. Land Rheinland-Pfalz, 1979 E.C.R 3727, 13 Dhjetor 1979.
[11] Anastasi A, (2009), "E Drejta Kushtetuese e Krahasuar", Dajti 2000, Tiranë, faqe 107

diferencueshme.E para është e një natyre të përgjithshme, ku parashtrohet parimi i mosndërhyrjes në të drejtën e pronës. Kjo vihet re në fjalinë e parë të paragrafit të parë. Rregulla e dytë paraqet mundësinë për të ndërhyrë në të drejtën e pronës kur përmbushen disa kushte te caktuara dhe kjo duket ne fjaline e dyte, ndërsa e treta shton se shteti ka të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e pronës në përmbushje të interesave të përgjithshme.

Në paragrafin e dytë paraqitet mundësia që shteti të përpilojë ligje, të cilat i konsideron të nevojshme për arritjen e këtij qëllimi. Këto tre rregulla janë konfirmuar në mënyrë të përsëritur nga nga Gjykata nëpërmjet vendimeve të saj, ku ajo është shprehur se:

"Këto tre rregulla nuk janë "të ndara" në kuptimin që: nuk janë të pavarura dhe të palidhura me njëra-tjetrën. Rregulla e dytë dhe e tretë, janë të fokusuara vecanërisht te e drejta e gëzimit të pronës, ndaj duhen parë dhe trajtuar duke marrë parasysh parimet e përgjithshme të përmendura në rregullën e parë."[12]

4.1 Raste nga praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka shqyrtuar një numër cështjesh ku i është dashur të përcaktojë natyrën e "pasurisë" sipas nenit 1 të Protokollit 1. Krahas interpretimit logjik të termit që përfshin pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, Gjykata ka vendosur se termi "pasuri" përfshin të gjitha "të drejtat e fituara" që një individ mund të ketë, duke përfshirë asete të tilla të së drejtës private, si të drejtën për të lidhur marrëveshje qiraje[13] ose aksione e pretendime monetare të bazuara në kontrata ose dëme jashtëkontraktore[14].

Ai gjithashtu përfshin të drejtat e fituara në sistemet e sigurimeve shoqërore apo të pensionit[15], nje "shpresë legjitime" se njeriu do të jetë në gjendje të zhvillojë pasurinë në përputhje me një plan zhvillimi të regjistruar si duhet[16], vullneti i mirë i rrezikuar nga drejtimi i marrëdhënieve profesionale[17]dhe pretendimet për kompensim për pasurinë e shpronësuar. Sipas Konventës, asnjë pasuri nuk ekziston deri në kohën kur dikush mund të kryejë një pretendim ndaj pasurisë. Me fjalë të tjera, e drejta e pronës nuk e përfshin të drejtën për të fituar pronësinë.

Pra, në çështjen *Marckx kunder Belgjikës* (1979), të diskutuar për nenin 8 dhe 14, Gjykata ka konstatuar se një nënë, të cilës i mohohej e drejta për t'i lënë në trashegim pasuri të bijës, kishte pësuar një shkelje të të drejtave të saj sipas nenit 1, Protokolli 1, por e bija nuk kishte pësuar shkelje, sepse shpresa

---

[12] Tozaj D, Muka B, (2010) "Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut", faqe 232
[13] Mellacher dhe te tjerë kundër Austrisë,1989.
[14] Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë, 1994.
[15] Vasilipoulou kunder Greqise, 2002.
[16] Pine Valley Developments Ltd, dhe te tjerë kundër Irlandës 1991.
[17] Van Marled dhe të tjere kundër Holandës, 1986.

për të marrë pasuri, nuk mbrohej nga ky nen.[18] Ne çeshtjen *Loizdou*,[19] u shqyrtua një pretendim i ngritur për shkelje të së drejtës së pronësisë. Kjo ankesë konsistonte në ndarjen e Qipros dhe vështirësitë që duhet të përballonin grekët e Qipros, si rezultat i refuzimit të aksesit në pronat e tyre. Arsyetimi i Gjykatës mbështetej te detyrimi pozitiv që ka shteti për të siguruar mundësinë që pronari ose poseduesi të ketë akses në pronën e tij.

5. Interesi Publik si një kufizim kushtetues në gëzimin e të drejtës së pronësisë

E drejta për pronë private, si një e drejtë themelore kushtetuese, shoqërohet nga mundësia për kufizim. Kufizimet paraqiten në dy forma: *së pari*, shpronësime ose kufizime që barazohen me shpronësimin dhe *së dyti*, kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronësisë. Kushtetuta parashikon mundësinë për shpronësime ose kufizime të tjera që barazohen me shpronësimin. Këto kufizime duhet të bëhen vetëm për interes publik dhe vetëm kundrejt një shpërblimi të drejtë. Shpronësimi si dhe kufizimet e tjera që barazohen me të, janë forma më e rëndë e kufizimit të pronësisë private. Në këto raste kemi një transferim të sforcuar të pronës te pronari tjetër, siç ndodh gjatë shpronësimit për një nevojë publike. Madje, shpronësimi është konsideruar si një privim nga e drejta e pronësisë private, ndaj duhet të shoqërohet qartë nga ekzistenca e disa kushteve themelore, për të qënë në përputhje me Kushtetutën.[20]

Pra, kufizimi i parë që rëndon mbi pronësinë rrjedh nga akti më i lartë i shtetit. Kështu, Kushtetuta përcakton se krahas veprimtarisë ekonomike ekzistojnë dhe kufizime, të cilat vendosen vetëm për arsye të rëndësishme publike. Nëse pronari do ta ndjente veten të rrezikuar se e drejta e pronësisë do të kufizohej apo do te mohohej lehtesisht, kjo do të dëmtonte rëndë jo vetëm interesat e pronarit, por të shoqërisë në tërësi. Për këtë arsye, në rastet e kufizimit të pronësisë nëpërmjet shpronësimit, ky proçes duhet t'i nënshtrohet disa rregullave rigorozisht të përcaktuara. Këto rregulla i gjejmë të sanksionuara edhe në Kodin Civil, në të cilin është parashikuar se : *"sendet mund të shpronësohen vetëm për interesa publikë të njohura me ligj dhe vetëm kundrejt një shpërblimi të drejtë."*[21]

Në legjislacionin tonë të brendshëm gjendet edhe një ligj i posacëm për shpronësimet për interesa publike, i cili ka një përmbajtje të ngjashme edhe me legjislacionet e vendeve të tjera të zhvilluara. Ky është ligji nr. 8561, date 22.12.1999 *"Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik."* Gjatë viteve të fundit kanë qënë jo të pakta rastet e shpronësimit për interesa publike, në të cilat, një

---

[18] Gomien D, (2005), "Udhëzues i shkurtër i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut", Këshilli i Evropës, Strasbourg, faqe 125-126.
[19] Loizidou kundër Turqisë (Aplikim 15318/89) ,18 dhjetor 1996.
[20] Omari L, Anastasi A, (2008), "E Drejta Kushtetuese", ABC, Tiranë, faqe 154
[21] Neni 190 i Kodit Civil.

vend të veçantë e zënë edhe shpronësimet e tokave. Kufizim tjetër i pronësisë së tokës për interesa publike përbëjnë edhe ato të parashikuara në Kodin Civil dhe në ligje të tjera të vecanta, që kanë të bëjnë me kategori sendesh me vlerë historike, arkeologjike, kulturore etj. Duke iu referuar dispozitave të Kodit Civil,*" te gjtha sendet me vlerë si më sipër, pasi nxirren nga toka kalojnë në pronësi të shtetit. Pronari, në pronën e të cilit janë zbuluar sendet me këto vlera, është i detyruar të lejojë kryerjen e gërmimeve në tokën e tij".*[22]

Kufizime të tilla që lidhen me këto kategori pasurish, parashikohen dhe nga ligje të tjera të posaçme. Në ligji nr.7867, datë 12.10.1994 *"Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme"*, është parashikuar se: "*Pronari nuk mund të shesë apo të zhvendosë pasuritë kulturore të ndodhura në sipërfaqe të tokës. Pronari i tokës ka të drejtë të kryejë punime në tokën e tij për ta shfrytëzuar atë, por pronari nuk ka të drejtë të kryejë punime me qëllim për zbulimin e pasurive kulturore që mund të gjenden në tokën e tij*."[23]

4.1 Jurisprudenca kushtetuese shqiptare dhe qëndrimi i saj mbi nocionin"interes publik"

Gjykata Kushtetuese konstaton se një ndër kriteret kushtetues që duhet patur në konsideratë është "interesi publik". Çdo ndërhyrje ndaj pronës mund të justifikohet vetëm nëse është në interesin publik ose të përgjithshëm. Marrja e pronës në bazë të një politike të llogaritur për të arritur drejtësi shoqërore brenda komunitetit, mund të përshkruhet saktësisht si politikë në interesin publik. Prandaj, i njihet e drejta ligjvënësit që, për arsye të ekzistencës së interest publik, të mund të kufizojë hapësirën e disponimit të pronës private. Me qëllim që një nderhyrje e tillë ndaj të drejtës së pronës të jetë e justifikuar, është e domosdoshme që të ekzistojë dhe një marrëdhënie përpjesëtimore midis mjeteve të përdorura dhe synimit që kërkohet të realizohet.

Mbi këtë bazë, sistemi ligjor duhet të përmbajë një sërë garancish procedurale për të siguruar që ndikimi i tij mbi të drejtën e pronës të mos jetë arbitrar dhe i paparashikueshëm. Nga koncepti i të drejtës së pronës që ka pranuar kushtetuta shqiptare, nuk rrjedh asnjë e drejtë absolute për shpërblim të plotë. Çështja e detyimit për dëmshpërblim në vetvete dhe kufijtë e tij, përcaktohen nga rastet konkretë. Objektivat legjitim të interesit publik, si ato që ndiqen në kuadrin e masave të reformës ekonomike, ose masat e hartuara për të arritur drejtësi më të madhe shoqërore, mund të kërkojnë një rimbursim më të vogël se vlera e tregut.[24]

---

[22] Neni 187 i Kodit Civil.

[23] Neni 2 i ligjit nr.7867, datë 12.10.1994 "Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme"

[24] Anastasi A, (2009),"E Drejta Kushtetuese e Krahasuar", Dajti 2000, Tiranë, faqe 119.

6. Raporti ndërmjet të drejtës për pronë dhe interesit publik sipas Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut

Konventa Evropiane garanton të drejtën e gëzimit të pacënueshëm të pronës. Ashtu si dhe në shumicën e të drejtave të tjera substantive të garantuara prej saj, shteti mund të kufizojë ushtrimin e të drejtës së pronës. Ai mund ta privojë një individ nga prona e tij, "për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji"dhe gjithashtu mund të zbatojë ato ligje që i konsideron të domosdoshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm.

E rëndësishme është që të tregohet kujdes në mënyrën se si realizohet proçesi i kufizimit në interes të dobisë publike, sepse kufiri ndarës mes tyre është shumë i padukshëm. Kërkohet që çdo shtet anëtar të respektojë rigorozisht proçedurat e parashikuara në ligjet e veçanta, të cilët duhet të përputhen parimisht me dispozitat e afirmuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata Evropiane ka një praktikë të pasur me çështje në qëndër të të cilave është kufizimi i të drejtës së pronësisë.

Në shqyrtimin e çështjes *Sporrong dhe Lonnroth,* gjykata rikonfirmoi qëndrimin e saj se konventa, si një e tërë, kërkon të arrihet një balancë ndërmjet interesave të komunitetit dhe të drejtave themelore të individit. Gjykata i shtjelloi pikëpamjet e saj në këtë drejtim në çështjet *Lithgou dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe *James dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar.* Në çështjen e fundit, aplikantët kundërshtonin zbatimin e një ligji britanik, që lejonte disa qiramarrës afat-gjatë të disa ndërtesave të banimit, të blinin të drejtën e pronësisë së qiradhënësit me një vlerë më të ulët se vlera e tregut në kohën ë transaksionit.[25]Gjykata, duke mos deklaruar shkelje të së drejtës së pronësisë, deklaroi:

Nocioni i "interesit publik", është domosdoshmërisht i gjerë. Gjykata duke e konsideruar normale që hapësira e vlerësimit që kanë ligjvënësit për zbatimin e politikave ekonomike dhe shoqërore, duhet të jetë më e gjerë, respekton gjykimin e ligjvënësit në lidhje me atë që është në "interesin e publikut", përveçse, kur ai gjykim është haptazi pa bazë të arsyeshme. Një marrje prone e kryer në përputhje me politikat e ligjshme sociale, ekonomike apo më gjerë, mund të jetë në "interesin e publikut"edhe nëse komuniteti në tërësi nuk e përdor apo nuk e gëzon drejtpërdrejtë pronën e marrë.

Arbitrariteti ishte gjithashtu në çështjet *Katikaridis dhe te tjere kundër Greqisë* dhe *Tsomtsos dhe të tjerë kundër Greqisë.* Këto çështje kishin të bënin me shpronësimin e pronës për qëllimin e ndërtimit të një autostrade, shoqëruar me zbatimin e një ligji që përcaktonte një prezumim të pakundërshtueshëm se përfitimet që dilnin nga përmirësimi i rrugës përbënin kompensim të përshtatshëm për individët e prekur. Gjykata konstatoi se mungesa e fleksibilitetit të sistemit në dhënien e kompensimeve dhe në

[25] James dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, (1986).

veçanti pamundësia për një vlerësim gjyqësor të humbjeve të vërteta të pësuara si rezultat i shpronësimit përbënin shkelje të nenit 1 të Protokollit 1.[26]

Një tjetër rast i trajtuar nga Gjykata është çështja në të cilën, aplikantët pretendonin se një vendim i qytetit të Stokholmit, që e autorizonte qytetin të shpronësonte çdo pronë që dëshironte, me shkaqe praktikisht të pakufizuara, përbënte shkelje të së drejtës së tyre të pronësisë në kuptimin e nenit 1 të Protokollit 1. Gjykata konstatoi se ndonëse shpronësimet në fjalë u linin teorikisht pronarëve të drejtën për të përdorur dhe disponuar pronën e tyre, në praktikë mundësitë e tyre për ta bërë një gjë të tillë ishin aq të reduktuara, sa që vënia në jetë e të drejtës suedeze shkelte në fakt të drejtën për gëzimin e pacënueshëm të pasurisë.[27]

7. Konkluzione

E drejta e pronës është një e drejtë, e cila zë një vend të rëndësishëm në sistemin juridik për shkak të karakterit të saj shoqëror. Ajo afirmohet si një e drejtë kushtetuese, duke u sanksionuar ne aktin themelor të shtetit shqiptar në një nen të vecantë. Në trajtimin e këtij punimi, e drejta e pronës është trajtuar në një korelacion të ngushtë me kufizimin për interesin publik. Ashtu siç njohja dhe garantimi i kësaj të drejte ka një status kushtetutor, po ashtu dhe kufizimi i saj vetëm për interes publik, është një kufizim kushtetues. Kufizimi bëhet me ligj, i cili natyrisht, duhet të jetë në pajtim me frymën e kushtetutës dhe parimet e saj.

Eshtë e domosdoshme që kufizimet për interesin publik të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe garancisë së thelbit, duke mos i lejuar asnjë hapësirë ligjvënësit që të cënojë thelbin e të drejtës së pronësisë. Në këtë punim, krahas trajtimit të legjislacionit tonë në etapat evolutivë të tij, një hapësirë të konsiderueshme i kam rezervuar praktikës së gjykatave shqiptare dhe praktikës së pasur të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Qëllimi ishtë për të parë në plan krahasimor standartet e ofruara nga legjislacioni i brendshëm në raport me atë ndërkombëtar.

Njëkohësisht, është e arsyeshme të kemi në vëmendje edhe shkallën e respektimit të kufizimeve të parashikuara nga KEDNJ, duke e konsideruar këtë si një detyrim kushtetues. Përgjithësisht, vlen të theksohet fakti se në thelb, legjislacioni shqiptar ka të sanksionuara parime të njejta ose të përafërta me legjislacionin ndërkombëtar. Nëse çështja do të mbetej vetëm në kuadrin teorik, nuk ka shumë vend për debat, por në kuadrin praktik, e drejta e pronesisë, veçanërisht kufizimet e kësaj të drejte për interes publik, shtrojnë shumë elementë për t'i patur në konsideratë.

Referenca

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë 1998

[26] Katikaridis dhe te tjere kundër Greqisë, (1996).
[27] Sporrong dhe Lonnroth kundër Suedisë, (1982).

Omari L, Anastasi A, (2008) : “E Drejta Kushtetuese”, ABC, Tiranë
Ligji nr. 8561, date 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”
Kushtetuta e Shqipërisë e vitit 1946
Ligji nr. 108, date 29.08.1945 “Mbi Reformën Agrare”
Dekreti nr. 2083, date 6.7.1955 “Mbi pronësinë”
Mecani D, (2008) : “Pronësia mbi Tokën”, Triptik, Vlorë
Ligji nr. 7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”
Protokolli 1 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njerut
Liselotte Hauer V. Land Rheinland-Pfalz, (1979) E.C.R 3727,13 Dhjetor 1979
Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
Anastasi A,(2009) : “E Drejta Kushtetuese e Krahasuar”, Dajti 2000, Tiranë
Tozaj D, Muka B (2010) : “Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut”
Mellacher dhe te tjerë kundër Austrisë,(1989)
Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë, (1994)
Vasilipoulou kunder Greqise, (2002)
Pine Valley Developments Ltd, dhe te tjerë kundër Irlandës (1991)
Van Marled dhe të tjere kundër Holandës, (1986)
Gomien D, (2005) : “Udhëzues i shkurtër i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, Këshilli i Evropës, Strasbourg
Loizidou kundër Turqisë (Aplikim 15318/89) ,18 dhjetor 1996
Ligji nr.7867, datë 12.10.1994 “Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme”
Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
Katikaridis dhe te tjerë kundër Greqisë, (1996)
Sporrong dhe Lonnroth kundër Suedisë, (1982)

MODELIMI I UDHËTIMEVE TË GJENERUARA DHE TË TËRHEQURA NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË VLORËS

Ing.Pëllumb Cacaj[1], Prof.as. Kristofor Lapa[2]
Departmenti i Inxhinjerisë Mekanike dhe Navale, Universiteti i Vlorës
pellumb_cacaj@yahoo.it
kristoforlapa@gmail.com

ABSTRAKT

Transporti rrugor në Shqipëri ka njohur një zhvillim relativisht të shpejtë në vitet e fundit. Mbas vitit 1990, për shkak të rritjes së numrit të mjeteve dhe të lidhjeve me vendet fqinje, doli nevoja e përmirësimit dhe zhvillimit të infrastrukturës rrugore. Të njëjtat nevoja lindën edhe në zonat urbane. Sistemi rrugor i ndërtuar në kohën e komunizmit nuk ishte i aftë të përballonte fluksin e mjeteve. Përmirësimi i cilësisë së rrugëve, ndërtimi i rrugëve të reja, ndërtimi i infrastrukturës së re rrugore në zonat informale, kërkon një projektim dhe planifikim të mirë të flukseve të trafikut. Aktualisht nuk përdoren metoda inxhinjerike nga autoritetet lokale në planifikimin e transportit dhe flukseve të trafikut mbi rrjetin rrugor. Ky punim është një ndihmë në këtë drejtim. Në vazhdim do të japim punën intensive që është bërë për mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e tyre si një nga fazat kryesore në procesin e modelimit të sistemit të transportit mbi rrjetin rrugor të qytetit të Vlorës. Këto të dhëna do të përpunohen dhe përdoren në modelimin e udhetimeve të gjeneruara dhe të tërhequra, si bazë e proceseve të tjera të modelimit, prej nga varet edhe saktesia e rezultateve.

FJAKËKYÇ – Vlora, gjenerim, tërheqje, modelim, transport, sistem

HYRJE

Zhvillimi i infrastruktures rrugore të qytetit të Vlorës është i lidhur me zhvillimin dhe rritjen e qytetit si dhe me zhvillimin e portit. Mbas vitit 1990, qyteti njohu një zhvillim të fuqishëm urban dhe demografik edhe pse në mënyrë të pakontrolluar. Në periferi të qytetit u krijuan disa zona informale me banorë të ardhur nga zona rurale. Edhe brenda qytetit pati një rritje të pakontrolluar të ndërtimeve, jashtë sandarteve urbane. Sistemi rrugor i qytetit, megjithë këtë zhvillim urban dhe demografik, përveç përmirësimit të saj, ka njohur shumë pak

ndryshime. Numri i mjeteve ka ardhur gjithmonë në rritje. Kështu, nëse në vitin 2000 numuri i tyre ishte rreth 7000 mjete, sot është rreth 15000 mjete.

Megjithë këtë, nga organet kompetente nuk ka një studim për flukset e trafikut mbi rrjetin rrugor. Egziston një studim i bërë në vitin 2002, në bashkëpunim me Institutin e Transportit në Tiranë, por ai nuk mbështetet mbi ndonjë metodë inxhinjerike, por vetëm në paraqitjen grafike të kryqëzimeve dhe të drejtimeve të lëvizjes së mjeteve.

Nga gjithe kjo është e nevojshme të bëhet planifikimi i flukseve të trafikut dhe mbi bazën e vlerave të dala të gjykohet edhe për masat që duhen marrë. Ky planifikim na lejon të gjykojmë se ku janë më të nevojshme dhe ku duhet të orientojmë investimet për rrugët.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe mbledhja e të dhënave që duhen për të filluar procesin e planifikimit. Këto të dhëna mblidhen në institucione të ndryshme dhe duhet të përfshijnë një periudhë sa më të gjatë kohe dhe lidhen me popullsinë, bizneset, numrin e mjeteve, rrjetin rrugor, etj.

Gjenerimi dhe tërheqja e udhëtimeve në një zonë urbane mbështetet mbi keto të dhëna. Të gjitha këto duhet të lidhen në mënyre statistikore midis tyre nëpërmjet regresioneve matematikore. Mbas rivlerësimit të udhëtimeve dhe rillogaritjeve kemi krijuar kushtet për të vazhduar me tej me llogaritjet e tjera që bëhen në procesin e planifikimit.

PËRMBAJTJA

Për studimin tonë do t'i referohemi zonës urbane të qytetit të Vlorës. Si fillim duhet të marrim, nga zyra e urbanistikës në bashkinë e qytetit, hartën në të cilën është e përfaqësuar e gjithë zona urbane e qytetit e ndarë në lagje, të cilat do të jenë edhe zonat e studimit. Nga sistemi rrugor do të nxjerrim një rrjet rrugor që është gjykuar si kryesor.

Nga zyra e gjendjes civile kemi marrë numrin e popullsisë. Po kështu, kemi marrë të dhënat për biznesin nga zyra e taksave të bashkisë si dhe numrin e automjeteve nga zyra e DRSHTRR Vlorë. Përve këtyre, kami bërë matje të flukseve të trafikut mbi rrjetin rrugor. zonat me potencial të lartë zhvillimi do t'i shënojme me 1, dhe ato me potencial të ulët zhvillimi me 0. Të gjitha këto i vendosim në tabelën e mëposhtëme.

Lagje	Popull	Aktivit.	Nr Mjeteve	Mj. Hyrje	Mj. Dalje	Z. Zhvillim
Uji Ftohte	8962	324	689	131	143	1
I.Boletini	9032	262	856	1775	885	1
Pavaresia	8532	247	754	1409	125	1

10 Korriku	9122	296	585	213	1299	1
L. Sallata	4228	108	369	1119	1505	1
Kushtrimi	7520	132	529	824	215	0
Rilindja	5530	187	557	104	1179	1
H. Cakrerri	4792	114	380	642	810	0
4 Heronjte	4852	112	395	474	99	0
Partizani	5116	127	436	161	639	1
15 Tetori	6270	142	540	752	550	0
O. Haxhiu	4552	143	429	208	656	1
Lirim	7458	145	587	143	228	0
1 Maji	5842	156	312	71	152	0
Q. Derri	5387	104	545	338	59	1
24 Maji	7362	198	698	959	354	1
11 Janari	6782	124	428	1114	1036	0
Bashkimi	6798	167	625	1998	1743	1
28 Nendori	7125	180	566	282	294	1
Deshmoret	6234	180	602	1119	1179	0

Tabela 1. Të dhënat e mbledhura në institucione dhe matjet e flukseve të trafikut

Studimi jonë do të mbështetet në modelin klasik të planifikimit të transportit, i cili kalon në katër etapa. Etapa e parë është gjenerimi dhe tërheqja e udhëtimeve. Kjo është edhe faza për të cilën do të bëjmë edhe studimin.

Etapa e dytë lidhet me shpërndarjen e udhëtimeve, që do të thotë ndërtimi i një matrice të udhëtimeve origjinë-destinacion. Etapa e trete ka të bëjë me ndarjen e sistemit të transportit. Etapa e katërt ka të bëje me ngarkimin e këtyre flukseve të llogaritura në matricën e udhëtimeve mbi rrjetin rrugor.

Ky model do të zhvillohet mbi hapsirën urbane të qytetit të Vlorës, e cila është ndarë në zona me anën e TRANSCAD-it dhe paraqitja e zonave jepet më poshtë. Çdo zonë në mënyrë konvencionale do të paraqitet me centroidën e zonës. Centroida gjendet në qendrën e gravitetit të zonës. Përveç zonave të brendëshme përcaktojmë edhe zonat e jashtëme që janë pesë të tilla. Të dhënat e këtyre zonave janë marrë nga Plani Kombëtar i Transportit.



Figura 1. Paraqitje grafike e qytetit të Vlorës me zonat e ndara, me centroidat përkatëse si dhe rrjeti rrugor kryesor

ANALIZA ME REGRESSION

Gjatë përpunimit të modelit të marrë në studim të gjenerimit dhe të tërheqjes së udhëtimeve, përdoren metodat e regresionit. Regresioni mund të jetë linear ose i shumëfishtë. Regresioni linear paraqet një vijë të drejtë, dhe quhet vija e vërtet e regresionit dhe funksioni ka formën e mëposhtëme:

$$E(Y_i) = a + bX_i \quad (1)$$

ku parametrat e popullsise *a* dhe *b* përcaktojnë vijën dhe vlerësohen nga të dhëna të thjeshta. Një parametër vlerësues i regresionit linear është R^2 i cili i merr vlerat nga 0 në 1. Regresionet e shumëfishtë janë një zgjatje e regresionit linear i cili zgjidhet për më shumë parametra të regresionit.

Një aspekt tjetër i gjenerimit dhe tërheqjes së udhëtimeve është parashikueshmëria për një periudhë të caktuar. Nëse do të duhet të parashikojmë për një periudhë të mëvonshme, psh viti 2030, midis shumë metodave që përdoren, zgjedhim teknikën e *faktorit të rritjes*. Ekuacioni bazë i tij është:

$$T_i = F_i t_i \quad (2)$$

ku T_i dhe t_i janë respektivisht parashikimi i udhëtimeve për të ardhmen dhe ato aktuale në zonën *i*, ndërsa F_i është faktori i rritjes. Faktori i rritjes është i lidhur më variabla si popullsia (P), të ardhurat (I) dhe numri i mjeteve në pronësi (C) në një funksion si më poshtë:

$$F_i = \frac{f(P_i^d, I_i^d, C_i^d)}{f(P_i^c, I_i^c, C_i^c)} \quad (3)$$

ku f mund të jetë një funksion pa parametra, dhe shënimet *d* dhe *c* përshkruajnë vitin korrent dhe të pritshmin.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Pasi kemi mbledhur të gjitha të dhënat që janë të nevojshme për çdo zonë, si dhe kemi bërë matjet e flukseve të trafikut për çdo hyrje të zonës, mund të fillojmë procesin e modelimit duke përdorur regresionin linear. Në fillim llogarsim gjenerimin e udhëtimeve. Pas provash të shumta kundrejt variablave të tjera do të nxjerrim ekuacionin llogaritës të gjenerimit për periudhën korrente me variabël të varur 'udhëtime në dalje'. Ky ekuacion është:

$$Y = 3{,}085\ a - 4{,}1502\ b - 330{,}4522 \quad (4)$$

ku: **c**onstant = -330.4522, **a** (numuri i mjeteve) = 3.0850,
b (aktivitete) = -4.1502

E njëjta gjë bëhet edhe për tërheqjen e udhëtimeve për vitin korrent. Ekuacioni i llogaritjes së udhëtimeve të tërhequra me regression, me variabël të varur 'udhëtime në hyrje', do të jetë:

$$Y = 1{,}9172a + 0{,}5189b - 692.505 \quad (5)$$

ku : **c**onstant = -692,5054, **a** (nr. mjete) = 1,9172,
b (aktivitete) = 0,5188

Duke përdorur faktorin e rritjes do të bëjmë parashikimin e udhëtimeve për të ardhmen për periudhën referuese, viti 2030. Nga llogaritjet del që faktori i rritjes

eshte 6.1569. Me anën e këtij faktori bëjmë llogaritjet për numrin e udhëtimeve të gjeneruara dhe të tërhequra prej secilës zonë.

Tashmë jemi në gjendje të llogarisim udhëtimet e gjeneruara dhe ato të tërhequra për vitin 2030 për të cilin do të bëhet parashikimi. Duke përdorur regresionet matematikore dhe do të kemi këtë ekuacion me variabël të varur 'udhëtime në dalje':

$$Y = -2.945\ a + 0.525\ b + 1128.742\ c + 1538.046 \quad (6)$$

ku: **c**onstant = 1538.046, **a** (Nr_mj_'30) = -2.945,
b (mjete_hyrje_'30) = 0.525,**c** (z._zhvillim) = 1128.742

Edhe për llogaritjen e udhëtimeve të tërhequra për vitin 2030, dhe do të nxjerrim këtë ekuacion me variabël të varur 'udhëtime në hyrje':

$$Y = 4.2641\ a + 0.5902\ b - 7.1691c - 798.571 \quad (7)$$

ku: **c**onstant = -798.571, **a** (Nr.Mjete_'30) = 4.2641,
b (Mjdalje_'30) = 0.5902, **c** (Aktivitete_'30) = -7.1691

Tashmë, mund të nxjerrim tabelën me llogaritjet e gjenerimit dhe të tërheqjes së udhëtimeve. Kjo tabelë duhet te na garantoi që numri i udhëtimeve të gjeneruar nga zona O_i të jetë i barabartë me udhëtimet e tërhequra nga zona D_j, sipas barazimit të mëposhtëm:

$$\sum_i O_i = \sum_j D_j \quad (8)$$

Nga plani kombëtar kemi nxjerrë udhëtimet e gjeneruara dhe të tërhequra për zonat e jashtëme për vitin 2013 dhe vitin 2030 dhe i kemi vendosur në tabelën e mëposhtëme. Si përfundim, duke kyer këtë procedurë të balancimit të udhëtimeve me TRANSCAD, mund të japim tabelën përfundimtare të balancuar për të gjitha udhëtimet e gjeneruara dhe të tërhequra nga secila prej zonave, për të dy vitet e marra në shqyrtim:

Lagje	ID	Gen_'13_B	Att_'13_B	Gen_'30_B	Att_'30_B
U. Ftohte	1	450	691	1517	697
I. Boletini	2	1223	1384	1606	1964
Pavaresia	3	971	804	1713	1106
10 Korriku	4	246	1084	1001	640
Myzeqe	5	495	439	1789	790
L. Sallata	6	360	782	1167	1486

Kushtrimi	7	754	426	1909	497
Rilindja	8	612	970	374	1412
H. Cakrerri	9	369	449	1335	694
4 Heronjte	10	423	114	951	349
Partizani	11	488	467	475	889
15 Tetori	12	746	618	895	1196
O. Haxhiu	13	400	462	380	792
Lirim	14	879	426	400	940
1 Maji	15	15	36	487	435
Q. Derri	16	919	376	181	1256
Autosrada	17	2127	1725	4255	4036
24 Maji	18	1001	815	754	1299
11 Janari	19	475	654	1487	1045
Triport	20	33	7	225	153
L. Kalaja	21	948	574	1455	1479
Laberia	22	19	22	79	106
Bashkimi	23	905	1386	1487	2436
28 Nendori	24	669	536	1499	565
Deshmoret	25	780	1055	548	1705
	Totali	16304	16304	27969	27969

Tabela 2. Tabela e balancuar e gjenerimit dhe tërheqjes së udhëtimeve për vitin 2013 dhe 2030

Tabela e udhëtimeve të balancuara eshtë bazë për të bërë matricën e udhëtimeve në fazën e dytë, ajo e ndërtimit të matrices O-D dhe shpërndarjes së udhëtimeve.

KONKLUZIONE

Duke analizuar sa më sipër mund të themi që egzistojnë të gjitha mundësitë që edhe në një zonë urbane, siç është edhe qyteti i Vlorës, të përdoren me sukses metoda inxhinjerike të planifikimit të flukseve të trafikut mbi rrjetin rrugor.

Për këtë është e nevojshme që institucionet që disponojnë të dhënat e mësipërme, t'i ruajnë ato mbi bazë vjetore dhë t'i vënë ato në dispozicion të personave apo institucioneve që merren me modelimin e flukseve të trafikut. Një aspekt shumë i rëndësishëm në këtë drejtim është edhe përgatitja e specialistëve që duhet të merren me modelimin.Gjithashtu, për të pasur një saktësi më të madhe në llogaritje, janë të nevojshme edhe të dhëna të tjera që lidhen me

nivelin ekonomik të banorëve të zonës, strukturën e moshës, numri i strukturave të banimit, prania e insticucioneve social-kulturore, etj.

Këta janë faktorë që ndikojnë në rritjen e vlerës së R2 duke ju afruar vlerës 1. Sa më afër kësaj vlere, aq më afër të vërtetës do të jemi. Nxjerrja e këture të dhënave dhe përpunimi i tyre, do të jetë objekt i punës në të ardhmen.

Përfundimi i llogaritjeve të fazave të tjera të tjera të modelimit të flukseve të trafikut, janë shumë të varura nga nga faza e gjenerimit dhe e tërheqjes së udhëtimeve, pasi të gjitha llogaritjet e mëtejshmë mbështeten mbi tabelën e balancuar.

LITERATURA

Willumsen L, Ortuzar J. (2011). Modelling Transport. 4th edition

Cascetta E. (2009). Transportation system analysis: Model and applications. 2nd edition

Censusi i popullsisë dhe banesave, viti 2011

Statistikat e zyrës së taksave, Bashkia Vlorë, viti 2011

Statistika të DRSHTRR Vlorë, viti 2011

Harta në AUTOCAD e Bashkisë Vlorë, marrë nga zyra e urbanistikës

Plani i trafikut i Bashkisë Vlorë, viti 2001

Plani Kombëtar i Transportit, viti 2010 Manuali i përdorimit për TRANSCAD

Marco Fuhrman Appunti sulla regressione lineare

DUHANPIRJA TE STUDENTËT E FAKULTETIT TË SHËNDETIT PUBLIK TË UNIVERSITETIT TË VLORËS.

[1]Rudina Çerçizaj, [1]Emirjona Kiçaj [1]Ela Peto, [2]Neritan Qirici,
rudina2005@hotmail.com

[1]Fakulteti i Shëndetit Publik, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
[2]Drejtoria e Shëndetit Publik, Vlorë,

Abstract

Hyrje:Puna në sistemit shëndetsor u krijon mundësinë të influencojnë te pacientët në lënien e duhanit nëpërmjet këshillimit dhe shembullit të tyre.

Qëllimi i studimi. Të përcaktohet prevalenca e duhanpirjes tek studentët e Fakultetit të Shëndetit Publik të Universitetit të Vlorës.

Materiali dhe metoda: Ky është një studim cross – sectional i realizuar në vitin e tretë të stdimit 2013-2014. me studentët infermier të Universitetit të Vlores.Në këtë studim u shpërnda një pyetsor i vetëadministruar (GHPSS).Në këtë studim morën pjesë 267 studentë.

Rezultatet.: Mosha mesatare e pjesmarësve ishte 20.0 vje. 16% ishin meshkuj dhe 84% ishin femra. Pytësori u plotësua nga 90% e pjesmarrësve. Duhanpirës aktual ishin 16% e këtij grupi. 31% e meshkujve dhe 35% e femrave janë duhanpirës me raste. Duhanpirësit aktual janë më shumë meshkuj, 39%, sesa femra, 11%. Nga 46% e duhanpirseve aktual u raportua se kishin marrë njohuri më të plota për duhanin. Numri i duhanpirësve aktual që kanë dashur ta lënë është 53%. Rreth 70% e studentëve e kanë kuptuar nevojën e nje jete të shëndetshme.dhe 38% mendojnë se profesioni i tyre u jep mundësi të japin kontributin e tyre në luftën kudrejt duhanpirjes..

Konkluzion:Zakoni ndaj pirjes së duhanit. është njësoj si grupmoshat tjera.Pasurimi i mëtejshëm i kurikulave mësimore do të do të ndihmonte më shumë studentët infrmierë në luftën kundrejt duhanpirjes duke u kushtuar më shumë vëmendje për këtë problem.

Rekomandime. Është e qartë se përdorimi i duhanit është një problem global, dhe pirja e duhanit nga profesionistët e ardhshëm të shëndetësisë ku futen edhe studentët infermier, është një arsye për t'u shqetësuar. Me mungeshën e rregullave zyrtare dhe të rreptë apo politikave për shpallje duhanit dhe përdorimin, vlerësohet se përdorimi i duhanit në mesin e profesionistëve të shëndetësisë dhe studentëve pleqsh nuk mund të përmirësohet nëse janë bërë përpjekje të tjera. Mungesa e rregullave zyrtare dhe të rrepta apo politikave për ndalimin e përdorimit të duhanit prej profesionistëve të shëndetësisë dhe studentëve infermierë nuk ndihmon në përmiërsimin në paksimin e duhanpirjes.

Fjalët kyçe: Duhan,.student infermier, universitet, duhanpirës actual, njohuri.

Hyrje: Pirja e duhanit është një shkak i madh i sëmundjeve të parandalueshme dhe vdekjeve në mbarë botën. Organizata (Aina 2009) Botërore e Shëndetësisë (OBSH) inkurajon programeve të monitorimit dhe të kontrollit të duhanit)WHO 1998). Mospirja e duhanit prej personelit shëndetësorë është rëndësishme jo vetëm për shëndetin e tyre, por edhe për rolin e tyre si këshillues përballë pacientëve (Braun B 2004). Pacientët i shohin personelin shëndetësor si modele për jetën e shëndetshme, duke përfshirë mospirjen e duhanit (C. W. Warren 2005), (Hollis J 2000). Për më tepër, personeli që pi duhan është i pabesushëm nga pacientët (Lenz B 2008). Infermieret janë grupi më i madh profesionisëve të shëndetsisë kanë lidhje të afërt me pacientët dhe me përgjegjësi të madhe për një shoqërie pa tym (Smith 2008), (Zillich AJ 2004), (Sotiropoulos A 2004).

Zakonet e studentëve infermiereve, qëndrimet dhe njohuritë kanë një rol kyç për të kuptuar dinamikën e pirjes së duhanit në të ardhmen në popullsinë e përgjithshme (Vardavas C 2009).

Qëllimi i studimi. Të përcaktohet prevalenca e duhanpirjes tek studentët e Fakultetit të Shëndetit Publik të Universitetit të Vlorës.

Materiali dhe metoda: Ky është një studim cross – sectional i realizuar në vitin e tretë të stdimit 2013-2014. me studentët infermier të Universitetit të Vlores.Në këtë studim u shpërnda një pyetsor i vetëadministruar (GHPSS).Në këtë studim morën pjesë 267 studentë.

Rezultatet: Mosha mesatare e pjesmarësve ishte 20.0vjeç. 16% ishin meshkuj dhe 84% femra. Pytësori u plotësua nga (90%) e pjesmarrësve

Grafiku 1. ***Paraqitja grafike e shpërndarjes së pjesmarësve sipas duhanpirjes aktuale***

.



31% e meshkujve dhe 35% e femrave janë duhanpirës aktual..

Grafiku 2.Shperndarja e pjesëmarrsve sipas duhanpirjes me raste.



Duhanpirës aktual jane meshkuj sesa femra. 39% kundrejt 11%.Nga duhanpirsit actual 46% nga ata actual qe kane raportuar se kanë marrë më shumë njohuri për duhanpirjen.

Grafiku 3. ***Shpërndarja sipas Duhanpirësve actual sipas njohurive të marra***



Numri duhanpirësve aktual të cilët dëshironin ta lënë është 53%. 70% e studentëve mendonin që të janë një model i jetese të shëndetshme, por vetëm një pjesë 38% të totalit është njohur të ketë një rol në këshillimin në lënien e duhanit.

Konkluzion:Zakoni ndaj pirjes së duhanit. është njësoj si grupmoshat tjera.Pasurimi i mëtejshëm i kurikulave mësimore do të do të ndihmonte më shumë studentët infrmierë në luftën kundrejt duhanpirjes duke u kushtuar më shumë vëmendje për këtë problem.

Rekomandime. Është e qartë se përdorimi i duhanit është një problem global, dhe pirja e duhanit nga profesionistët e ardhshëm të shëndetësisë ku futen edhe studentët infermier, është një arsye për t'u shqetësuar. Me mungeshën e rregullave zyrtare dhe të rreptë apo politikave për shpallje duhanit dhe përdorimin, vlerësohet se përdorimi i duhanit në mesin e profesionistëve të shëndetësisë dhe studentëve pleqsh nuk mund të përmirësohet nëse janë bërë përpjekje të tjera. Mungesa e rregullave zyrtare dhe të rrepta apo politikave për ndalimin e përdorimit të duhanit prej profesionistëve të shëndetësisë dhe studentëve infermierë nuk ndihmon në përmiërsimin në paksimin e duhanpirjes.

Referencat

Aina B, Onajole A, Lawal B, Oyerinde O: **Promoting cessation and a tobacco free future: willingness of pharmacy students at the University of Lagos, Nigeria.***Tobacco Induced Diseases* 2009, **5:**13. PubMed Abstract | BioMed Central Full Text |PubMed Central Full Text

Braun BL, Fowles JB, Solberg LI, Kind EA, Lando H, Pine D: **Smoking related attitudes and clinical practices of medical personnel in Minnesota.***Am J Prev Med* 2004, **27:**31622. PubMed Abstract | Publisher Full Text

C. W. Warren, N. R. Jones, J. Chauvin, and A. Peruga, "Tobacco use and cessation counselling: cross-country. Data from the Global Health Professions Student Survey (GHPSS), 2005-7,"Tobacco Control, vol. 17, no. 4, pp. 238–247, 2008.

Hollis JF: **Population impact of clinician efforts to reduce tobacco use.***Population based smoking cessation, proceedings of a conference on what works to influence cessation in the general population. Smoking and Tobacco Control Monograph*2000., (12)

Josseran L, King G, Guilbert P, Davis J, Brucker G:**Smoking by French general practitioners: behaviour, attitudes and practice.***European Journal of PublicHealth* 2005, **15:**3338. PubMed Abstract Publisher Full Text

Lancaster T., Stead L., Silagy C., Sowden A. Effectiveness of interventions to help people stop smoking: Findings from the cochrane library. BMJ. 2000;321:355–358. [PMC free article][PubMed]

Lenz B: **Beliefs, knowledge, and self-efficacy of nursing students regarding tobacco cessation.** *American Journal of Preventive Medicine* 2008, **35:**494-500. Publisher Full Text

Smith DR: **The historical decline of tobacco smoking among United States physicians: 1949-1984.***TobaccoInducedDiseases* 2008, **4:**9. PubMed Abstract | BioMed Central Full Text |PubMed Central Full Text

Sotiropoulos A, Gika A, Spanou E, Dimitrelos D, Karakostas F, Skliros E, Apostolou O, Politakis P, Pappas S: **Smoking habits and associated factors among Greek physicians.***Public Health* 2007, **121:**333-340. PubMed Abstract | Publisher Full Text

Zillich AJ, Aquilino ML, Farris KB: **Knowledge and attitudes about smoking cessation among pharmacy technicians.***J Am Pharm Assoc* 2004, **44:**578-82. Publisher Full Text

Vardavas C, Bouloukaki I, Linardakis M, Tzilepi P, Tzanakis N, Kafatos A: **Smoke-free hospitals in Greece: Personnel perceptions, compliance and smoking habits.***Tobacco Induced Diseases* 2009, **5:**8. PubMed Abstract | Publisher Full Text |PubMed Central Full Text

Vardavas CI, Kafatos A:**Smoking policy and prevalence in Greece: An overview.***Eur J Pub Health* 2007, **17**(2)**:**211-3. Publisher Full Text

WHO, "Guidelines for controlling and monitoring the tobacco epidemic," Edited by WHO, Geneve, Switzerland, 1998.

FREKUENCA E INFEKSIONEVE TË RRUGËVE RESPIRATORE TEK FËMIJËT E NDJEKUR AMBULATORISHT NË VLORË NË PERIUDHËN JANAR 2013-JANAR 2014

Msc Saemira Durmishi, Msc Rozeta Luci, Msc Glodiana Sinanaj,
Msc Brunilda Subashi, Msc Denada Selfo
Fakulteti I Shëndetit Publik, Universiteti "Ismail Qemali"Vlorë

Abstrakt

Hyrje: Ndryshimi i kushteve klimaterike ka bërë që me shtimin e lagështisë në ajër të shfaqen në masë sëmundjet dhe problemet respiratore te moshat e mesme, të mëdha por sidomos te fëmijet. Shfaqja e sëmundjeve, të rrugëve respiratore zhvillohet në forma të ndryshme dhe shfaqet në menyra të ndryshme, duke dëmtuar aparatin respirator.Nga infeksionet e traktit respirator rrezikohen të gjitha grupmoshat, por ato me të prekurat ngelen fëmijët.**Qëllimi i studimit:** Të vlerësohet ndjekja e fëmijëve me probleme respiratore në kushte ambulatore, cilësia e shërbimit, dhe ecuria e sëmundjes në keto kategori pacientësh. **Objektivat:** Të vlerësohet niveli i sëmundshmërise, efektiviteti i trajtimit të këtyre problemeve respiratore te fëmijët dhe grupmoshat më të prekura.

Materiali dhe metodat: Në studim jane përfshirë 706 fëmijë që janë trajtuar për problemet e tyre respiratore nga mjekë specialist pediatër pranë qendrave shëndetësore ne harkun kohor janar 2013 – janar 2014. Rezultatet dhe të dhënat janë marrë nga rregjistrat, statistikat ambulatore dhe kartelat individuale të këtyre fëmijëve. **Rezulatet:** Janë ndjekur në këtë qëndër gjithsej 706 fëmijë me probleme respiratore te cilët përbëjnë 11.6% të gjithë fëmijëve (në total 6075 fëmijë), që kanë frekuentuar dhe marre këshillim, vaxinim, mjekim, dhe trajtim. Në të gjithë fëmijët e trajtuar për problemet respiratore % më të madhe e zë grupmosha 1-5 vjeç me 35.2%, duke u ndjekur nga grupmosha 5-10 vjeç ku zë 32.5% të problemeve te rrugëve te frymëmarrjes më pas renditen grupmoshat 0-1 vjeç me 17.2% , 10-14 vjeç me 15.2%. Po tu referohemi shifrave për problemet respiratore do të zinin vendin e parë rinofaringitet me 36.9%, më pas anginat me 17 %, infeksionet virale 10.2%, astma bronkiale 6.8%, bronkiti difuz 6.6%, otiti akut 6.2%, trakeobronkit 6%, trakeit akut 3.9%, laringit akut 2.9%, rinosinozit 1.6%,bronkiolit difuz 0.8% dhe bronkopneumoni 0.8%. Nga të gjitha problemet që kanë shfaqur këta fëmijë vetëm 3.8% e tyre jane shtruar në spital për ndihmë të specializuar dhe vetëm 6.6 % rezultojnë që të jenë të sëmurë kronik.**Konkluzione:** Rezultatet tregojnë se ka një diferencë persa u përket grupmoshave më të prekura, lidhur me frekuentimin e çerdhe, kopësht, shkollë. Eshtë për tu vlerësuar fakti se nga të gjithë fëmijët që shfaqin probleme respiratore dhe paraqiten te mjeku specialist pediatër vetëm nje % shumë e vogël janë hospitalizuar dhe pjesa tjeter kane pasur nje ecuri shumë te mire.

Fjalë kyç: Problem respirator, Rinofaringit, Astma bronkiale.

Msc Saemira Durmishi
saemira2@gmail.com

FREKUENCA E INFEKSIONEVE TË RRUGËVE RESPIRATORE TEK FËMIJËT E NDJEKUR AMBULATORISHT NË VLORË NË PERIUDHËN JANAR 2013-JANAR 2014

Msc Saemira Durmishi, Msc Rozeta Luci, Msc Glodiana Sinanaj,
Msc Brunilda Subashi, Msc Denada Selfo
Fakulteti i Shëndetit Publik Universiteti "Ismail Qemali"Vlorë

Infeksionet virale të traktit respirator, janë shkaku më i zakonshëm i sëmundjeve te njeriu, si te të rriturit ashtu edhe te fëmijët. Këto infeksione, mund të shfaqen si një variant i gjerë sëmundjesh nga rrufa e thjeshtë, e deri te pneumonia e rëndë. Shfaqja e sëmundjeve, te rrugëve respiratore zhvillohet në forma të ndryshme dhe shfaqet në menyra të ndryshme, duke dëmtuar jo vetem aparatin respirator. Këto sëmundje mbeten problematike nëse nuk kapen në kohë, pasi ndikojnë në dobësimin e imunitetit të organizmit. Ato më së shumti prekin moshën nën 5 vjeçare, ndërsa me rritjen e fëmijëve forcohet edhe imuniteti i organizmit ndaj këtyre infeksioneve dhe këto patologji bëhen më të rralla. Shumica e fëmijëve zhvillojnë 3-8 ftohje të zakonshme brenda vitit që mund të shoqërohen me infeksione të rrugëve të sipërme ose të poshtme respiratore. Shpeshtësia e këtyre infeksioneve është më e madhe te fëmijët parashkollorë dhe tek ata që i ekspozohen ambienteve me duhan. Shkak më i shpeshtë i paraqitjes të infeksioneve respiratore te fëmijët është mungesa e zhvillimit të imunitetit specifik ndaj shkaktarëve ne veçanti te latantët dhe fëmijët parashkollorë. Infeksioneve të rrugëve të poshtme respiratore në shumicën e rasteve u paraprijnë ftohjet ose infeksionet e rrugëve të sipërme respiratore që në përqindje më të madhe i shkaktojnë viruset. Infeksionet akute të traktit të poshtëm respirator shkaktojnë morbiditet dhe mortalitet në masë të konsiderueshme te fëmijët, sidomos në vendet më pak të zhvilluara. Si faktorë predispozues për shpeshtësinë e këtyre infeksioneve në vendet akoma në zhvillim janë përshkruar varfëria, të ardhurat e kufizuara të familjes, ndotja e ajrit, malnutricioni, pesha e ulët e lindjes, mungesa e gjidhënies si dhe menaxhimi i vonuar shëndetësor. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë 20% e vdekjeve te fëmijët nën 5 vjet janë për shkak të infeksioneve të rrugëve të poshtme respiratore dhe 90 % e tyre shkaktohen nga pneumonia. Viruset janë shkaktarët më të shpeshtë të infeksioneve të rrugëve të poshtme respiratore te latantët dhe fëmijët e vegjël dhe paraqesin problem madhor shëndetësor. Infeksionet e natyrës bakteriale zakonisht janë sekondare, dhe shoqërojnë infeksionet virale të traktit të sipërm ose të poshtëm respirator. Nga infeksionet e traktit respirator, rrezikohen të gjitha grupmoshat, por ato me te prekurat ngelen femijet. Këto infeksione, mund të jenë të lehta, të mesme ose të rënda. Mund të shfaqen pneumonitë e ndryshme virale te fëmijët, të cilët mund të jenë si komplikime të gripit ose parainfluencës,

bronkiti, bronkioliti, format e rënda të pneumonisë të cilat mund të shkaktojnë pamjaftueshmëri respiratore. Pasqyra klinike tek infeksionet virale karakterizohet me rrjedhje të hundëve, dhimbje ne fyt, kollitje, plogështi, dhimbje koke, dhimbje të muskujve, ethe, temperaturë etj, ndërsa në rastet më të rënda edhe vështirësi në frymëmarrje. Infeksionet e rrugëve të frymëmarrjes, janë njëri nga shkaqet e vdekshmërisë së foshnjave, si pasojë e pneumonive që ato shkaktojnë.

Qellimi i studimit: Të vlerësohet ndjekja e fëmijëve me probleme respiratore në kushte ambulatore, cilësia e shërbimit, dhe ecuria e sëmundjes në keto kategori pacientësh.

Objektivat: Të vlerësohet niveli i sëmundshmërise, efektiviteti i trajtimit të këtyre problemeve respiratore te fëmijët dhe grupmoshat më të prekura.

Materiali dhe metodat: Në studim jane përfshirë 706 fëmijë që janë trajtuar për problemet e tyre respiratore nga mjekë specialist pediatër pranë qendrave shëndetësore ne harkun kohor janar 2013 – janar 2014. Fëmijët janë ndarë sipas grup-moshave 0-1 , vjeç 1-5, vjeç 5-10 vjeç dhe 10-14 vjeç dhe janë ndjekur në vazhdimësi nga mjek specialist pediatër pranë qëndrave shëndetësore në harkun kohor janar 2013 – janar 2014. Rezultatet dhe të dhënat janë marrë nga rregjistrat, statistikat ambulatore dhe kartelat individuale të këtyre fëmijëve. Në këto kartela u moren të dhëna lidhur me moshën, nëse ishin fëmijë te rritur ne shtepi, apo ne grup, si dhe të dhëna për llojin e problemit të shfaqur, të dhëna lidhur me periudhat e ndryshme te vitit, mënyrën e trajtimit dhe ecurinë e sëmundjes së trajtuar nga mjek familjeje specialist pediatër.

Probleme të frymëmarrjes tek fëmijët

Të sëmuresh, që do të thotë të bësh njohjen me viruse e baktere, është e vetmja mënyrë që ka fëmija për të krijuar pak e nga pak mbrojtjen vetjake (imunitetin). Natyrisht, sa më i vogël është fëmija, aq më pak antikorpe (trupa mbrojtës) ka, prandaj preket më lehtë nga një kollë ose një ftohje. Për këtë arsye mjeket pediatër konsiderojnë normal jo fëmijën që nuk është sëmurë asnjëherë, por atë që nuk tejkalon një numër të caktuar të sëmundjeve dhe konkretisht:

- 6 infeksione të frymëmarrjes nga 0-1 vjeç
- 5 ose 6 infeksione të frymëmarrjes nga 1-2 vjeç
- 4 ose 5 infeksione të frymëmarrjes nga 3-4 vjeç
- 3 ose 4 infeksione të frymëmarrjes nga 5-10 vjeç.

Në problemet e frymëmarrjes, përfshihen frymëmarrjet e zhurmshme, të shpejtuara, dhe mos- ngopja me frymë. Tek fëmijët, mos mbushja me frymë mund të mos jetë e natyrshme nga që mundësitë shprehëse i kanë më të pakta në krahasim me të rriturrit. Fëmija me vështirësi të mëdha frymëmarrjeje, ka nevojë urgjente të trajtohet në spital, dhe të gjithë këta fëmijë që ecuria e sëmundjes nuk ka qënë e mirë janë shtruar për një shërbim më të specializuar, sidomos rastet kur problemet e frymëmarrjes acarohen në

mënyrë të papritur meritojnë një vëmendje të menjëhershme. Shifra maksimale e shpeshtësisë së frymëmarrjes për çdo minutë, për moshën nën 2 muajsh është 60 herë në minutë, për moshën 2-12 muajsh është 50 herë në një minutë, për moshën 1-5 vjeç është 40 herë në minutë dhe për moshën mbi 5 vjeç është 30.

Rastet e fëmijëve të derguar në spital nga mjekët e familjes

Fëmija shtrohet në spital vetëm në raste kur kujdesi për të cilin ai ka nevojë nuk mund t'i ofrohet në shtëpi ose në shërbimin ambulator. Sherbimi shendetesor parësor dhe spitalor organizohen në mënyrë të tille që të sigurojnë për fëmijët vazhdimesinë e kujdesit.

Sipas të gjitha statistikave rastet e shtrimeve në spital si pasojë e problemeve të frymëmarrjes janë në shifra të ulta rreth 3.8% e tyre të cilët përveç frymëmarrjes tepër të shpejtuar, kanë pasur edhe njeren prej shenjave të tjera si:

- Buzët apo gjuhën që marrin nuanca blu
- Përgjumësi jo të zakonshme
- Paaftësi për tu përtypur dhe për të biseduar
- Temperaturë më të lartë se 38 gradë dhe më të ulët se 36 gradë dhe
- Vjell ç'do gjë që fut në gojë

atëherë fëmija mund të ketë një problem serioz në frymëmarrje gjë e cila çon në komplikacione prandaj nuk është trajtuar më nga mjeku i familjes në qëndrën shëndetësore.

Transmetini i infeksioneve

Pjesa më e madhe e fëmijëve të marrë në studim rezulton të jenë me problem të infeksioneve acute të rrugëve të frymëmarrjes të cilat janë shfaqur menjëhere ose pasi fëmija ka kaluar një grip, rrufë, fruth, kollë të mirë etj. Sipas vendit të vendosjes së mikrobit dhe forcës së veprimit të tij në rrugët e frymëmarrjes janë shfaqur te këta fëmije ato infeksione që rezultojnë më të shprehura siç janë rinofaringitet dhe angina. Sipas të gjitha studimeve të mëparshme infeksionet respiratore janë mjaft ngjitëse. Transmetimi i tyre bëhet nga personi i sëmurë tek një tjetër i shëndoshë, nëpërmjet spërklave të ajrit të kontaminuar me virus dhe periudha e shfaqjes është 1-5 ditë pas ekspozimit. Infeksionet variojnë nga të lehta deri në të rrezikshme për jetën, siç janë laringotrakeobronkiti (croupi) ose bronkioliti. Çdo infeksion viral stimulon zhvillimin e një infeksion bakterial, që normalisht është bronkopneumonia. Disa nga shenjat e virozës janë temperatura e lartë 38-39 deri në 40 gradë, të vjella, rrufë dhe pak kollë. Ndërsa shenjat e komplikacioneve pneumonare janë atëherë kur fillojnë të dalin shenjat respiratore në pah, kur temperatura nuk është më aq e lartë por fillon vështirësia në frymëmarrje, sekrecionet dhe kollë e forte.

SHPËRNDARJA E PROBLEMEVE RESPIRATORE SIPAS GRUP-MOSHËS

Problemet e shfaqura	0-1 vjec	1-5 vjec	5-10 vjec	10-14 vjec
Angina	2	33	54	20
Rinofaringit	78	103	47	23
Inf.viral	16	20	28	8
Astma bronkiale	-	17	18	11
Trakeit akut	1	8	13	6
Trakeobronkit	6	22	11	4
Otit akut	7	16	19	2
Bronkit difuz	12	17	12	8
Bronkiolitis difuz	1	4	1	-
Laringit akut	-	8	10	4
Rinosinozit	-	-	7	4
Bronkopneumoni	-	4	1	1



Komplikacionet

Komplikacionet janë të ndryshme, që nga bronkopneumonia e deri tek infeksionet në rrugët urinare, por dhe të veshit. Persa u perket rasteve të studiuara te kartelat e fëmijëve ajo që u vu re është se, nëse një femije gjatë tri ditëve të para nuk ka një përmirësim dhe kur fillon një temperaturë mbi 38 gradë dhe nuk mund të ulet, kur fillon kolla e fortë me gëlbazë, sidomos natën, por edhe gjatë ditës, kur ka edhe dhimbje të gjoksit edhe vështirësi në frymëmarrje, atëherë këto janë shenja të cilat na bëjnë që të mendojmë se duhet të kemi një komplikacion. Pas vizitës nuk është e nevojshme trajtimi me antibiotikë. Vetëm në rastet kur mjeku ka vendosur se ka kaluar në bronkopneumoni, ose ka kaluar në komplikacion gripi, është e nevojshme fillimi i antibiotikëve. Në raste të tjera jo, megjithëse mund të pish antibiotikë është gjendje virale që nuk ndikohet në përmirësim dhe medikamentet krijojnë rezistenca bakteriale.
Kur imuniteti i organizmit të sëmurit nuk është i mirë, kalohet në komplikime siç mund te jene:

bronkopnemumonia	infeksione të veshit
infeksione urinare	bronkitet acute

Bronkopneumonia edhe pse është një sëmundje tepër e përhapur dhe që shkaktohet nga disa shkaqe të ndryshme tek fëmijët që ne morëm në studim kjo ishte në shifra shumë të vogla ku vetem 0.8% e tyre na rezultuan me nje komplikacion të tillë. Megjithatë, një prej faktorëve kryesor që ndikon në zhvillimin e kësaj sëmundje janë luhatjet e temperaturave. Shenjat kryesore të sëmundjes së bronkopneumonisë janë temperaturat e larta që shkojnë deri në 38 gradë, si dhe rrjedhjet e sekrecioneve nga hunda. Bronkopneumonia mund të kthehet edhe në laringit dhe në të tilla raste, karakterizohet nga një kollë e thatë dhe e fortë gjatë natës.
Anomalia e shkëmbimit të gazrave, pakësimi i oksigjenit në gjak, si dhe shtimi i gazit karbonik, krijon në fytyrën e të femijeve ngjyrën mavi, e cila vihet re sidomos në pjesën e buzëve. Këta të sëmurë janë gjithnjë të lodhur dhe në gjendje plogështie, por nuk mungojnë edhe rastet kur këta të sëmurë shfaqin edhe shqetësime të tipit, turbullim i vetëdijes. Bronkopneumonitë ndodhin si shkak i humbjes së elasticitetit të muskujve të bronkeve. Këto të fundit mund të mbyllen për shkak të moshës dhe mbylljes së bronkeve, gjë e cila favorizon infeksionin. Komplikimet më të shpeshta të bronkopneumonisë shfaqen kryesisht te fëmijët. Rekomandimet në këto raste janë, dhënia e vaksinës së gripit tek fëmijët e vegjël deri pa mbushur akoma tre vjeç

Faringiti: Fëmijët që ishin trajtuar pranë qendrave shendetesore nga specialistët pediatër në pjesën më të madhe të tyre rreth 36.9 % rezultojnë me infeksion të faringut. Dhimbja e fytit është shenja më e shpeshtë e infeksionit që mund të godasë një nga zonat e këtij organi, nga bajamet tek faringu. Përgjegjës janë në përgjithësi viruset dhe bakteret, por ndonjëherë

dhimbja e fytit mund të jetë një reagim ndaj irrituesve si: pluhuri, tymi, smogu (ajri i ndotur) dhe ajri shumë i thatë. Infeksionet e fytit, të tilla si bajamet/tonsilitis, rezulton te jene të rralla tek fëmijët nën një vjeç. Ato janë më të zakonshme tek fëmijët në kopshte ose që sapo kanë filluar shkollën dhe që ekspozohen në një shkallë më të madhe ndaj baktereve. Fëmija ka dhimbje kur gëlltitet, mund të thotë se e ka fytin e tharë, mund të ketë temperaturë, kollë, ulje zëri. Në përgjithësi fëmija ka një temperaturë të lehtë në mëngjes,rrjedhje të hundëve dhe vështirësi në frymëmarrje, nganjeherë inflamacion të syve dhe të veshëve ,teshtitje, gërhitje, kollitje. Ne pjesën më të madhe të rasteve femijët ishin ata që frekuentonin çerdhet dhe kopështet, gjithashtu faktor favorizues ishte stina e ftohtë dhe e lagësht.

Laringiti: Infeksioni i laringut shkaktohet nga të ftohtit dhe fyti i tharë. Në qoftëse nuk çon në bllokim të rrugëve të frymëmarjes, nuk është problem serioz. Në fëmijët që ishin ndjekur pranë mjekut të familjes shenjat më të përgjithshme ishin humbja e zërit dhe ngjirja,edhe pse në shifra të ulta rezultoi se fëmijët kishin vështirësi dhe dhimbje gjatë gëlltitjes, kollë të thatë dhe ethe të lehta.
Shumica e rasteve të laringitit nuk zgjasin. Fëmija duhet të pushojë mundësisht në një mjedis të lagësht, ku të qarkullojë ajri. Laringiti është inflamacion i mukozës së laringut i shfaqur në formën akute,subakute dhe kronike.Është një nga çrregullimet më të shpeshta të shfaqura në laring. Laringiti quhet akut kur simptomat zgjasin më pak se 3 javë. Kjo karakterizohet me vazodilatacion dhe infiltrim të mukozës me polimorfonukleare. Pra është një reaksion inflamator ndaj futjes së një agjenti të huaj, ku paraqitet me edemë dhe skuqje të mukozës. Laringiti është pasojë e inflamacionit nga invadimi i mikroorganizmave ose shkaktarëve irritues, traumatik, metabolik , alergjik,autoimunë ose idiopatik. Në pamje kemi skuqje dhe edemë të laringut kryesisht regjionit subglotik. Ngjirja e zërit gjatë laringitit akut shpjegohet me edemën e kordave vokale.

Bronkitet dhe Bronkiolitet
Bronkiti zakonisht nuk është serioz tek fëmijët mbi 1 vjeç. është një maisje e bronkeve që paraprin ose i bashkangjitet maisjes së rrugëve të frymëmarrjes (grip, trakeit ose laringit). Një sëmundje tipike gripi, shfaqet shpesh gjatë dimrit, kur fëmijët jetojnë në mjedise të mbyllura dhe thithin ajrin e ndotur të qytetit. Në shumicën e rasteve shkaktohet nga viruse, por mund të shkaktohet edhe nga baktere ose irritues të tjerë (tymi, ajri i ndotur). Në fëmijët e trajtuar ambulatorisht ato zinin nje % rreth 6.6 ose 47 raste në total
Bronkitet ndodhin kur infeksionet virale çojnë në mbushjen e tyre me mukus, apo bllokimin e tyre. Shenjat e bronkitit janë kollë e thatë që mund të kalojë në kollë me gëlbazë jeshile apo të verdhë, temperaturë të lartë dhe mundet edhe në mungesë oreksi. Nëse fëmija vazhdon të bëhet më keq dhe ka vështirësi në frymëmarrje, mund të dyshohet për një infeksion të rëndë ose madje edhe për pneumoni.

Zakonisht bronkiti shërohet brenda një jave, pa lënë gjurmë. Por ka disa fëmijë që rezultonin të kishin kollë me gëlbazë (në mënyrë të veçantë natën) për periudha të gjata dhe e rimarrin infeksionin dhe 5-6 herë.
Për të luftuar këtë "ndjeshmëri bronkiale është e rëndësishme që nenat te jene te kujdesshme per femijet e tyre

Bronkioliti është më serioz, sepse mund të sjellë vështirësi në frymëmarrje dhe vihet re te fëmijët e vegjël. Rastet që ne studiuam me bronkiolit difuz ishin vetem 6 ose 0.8 % dhe i përkisnin grupmoshes 1-5 vjeç dhe kryesisht ishin femije deri ne vitin e dyte te jetes. Shkaktarë janë viruset, në 80% të rasteve shkaktarë është virusi respirator sinciciel (VRS).
Në kartelat klinike të këtyre fëmijëve u vu re se ata paraqiteshin me kollë dhe frymëmarrje te vështirë, që mund të sillte edhe vështirësi në ushqyerje. Fëmija kishte temperaturë dhe zbehje të përgjithshme. Gjuha dhe buzët mund të merrin ngjyrë blu. Shërimi bëhet në spital. Antibiotikët nuk kanë efekt, jepen nëse dyshojmë në infeksion sekondar. Me rëndësi është rehidratimi i cili kryhet në mënyrë intravenoze me të ashtuquajturën terapia suportive.

Astma Sipas statistikave të marra astma bronkiale te fëmijët e studiuar rezulton të jetë në shifrat 6.6 % dhe të renditet e katerta, sipas grupmoshës më të prekur nga astma janë fëmijët 5-10 vjeç dhe 1-5 vjeç respektivisht me 18 dhe 17 raste,11 raste i perkasin moshes 8-14 vjeç. Persa u perket fëmijëve 0-1 vjeç nuk kemi asnjë rast. Në thelb, sëmundja e astmës konsiderohet si sëmundja e pamundësisë së të marrit frymë.Është sëmundje kronike, që prek rrugët e frymëmarrjes. Kur situata rëndohet, atëherë kemi të bëjmë me një krizë astme. Në raste të tilla, rrugët e frymëmarrjes mund të mbyllen në mënyrë të tillë që të mos arrijnë dot ta çojnë oksigjenin e mjaftueshëm tek organet jetike.Infeksionet e rrugëve të frymëmarrjes rëndojnë gjendjen e sëmundjes së astmës. Sipas mjekëve pediater roli i infeksionit në përkeqësimin e gjendjes së astmës është i ndërlikuar.

Shënjat **e infeksioneve respiratore te fëmijët e marrë në studim**
Një ndër shqetësimet që vihet re te fëmijët e moshës infantile, është ai i rrugëve të frymëmarrjes. Fëmijë me temperaturë të lartë dhe me probleme serioze në rrugët e sipërme të frymëmarrjes. Vihen re bllokime dhe acarime, gjatë procesit të frymëmarrjes. Këto janë sëmundje virusale, të cilat shkaktohet jo vetëm prej temperaturave të paqëndrueshme, por edhe të mungesës së lagështisë së ajrit.
Pothuajse te pjesa me e madhe e fëmijëve që ne studiuam shenjat ishin ato gripale si:

- ✓ Vështirësi në frymëmarrje dhe në ushqyerje
- ✓ Frymëmarrje e përshpejtuar apo me fishkëllima
- ✓ Kollë me ose pa gëlbazë
- ✓ Pagjumësi dhe mungese oreksi
- ✓ Temperaturë e lartë ose normale

Këto shenja zakonisht zgjasnin 3-5 ditë. Kjo përsa i përket formës së lehtë të sëmundjes. Fëmijët që sipas kartelave rezultonin të ishin më rëndë kishin shfaqur shqetësime nervore të shoqëruara me të dridhura dhe mavijosje te buzës

Simptomat

- Rrjedhje të sekrecioneve nga pjesa e hundës
- Temperaturë subfebrile që shkon nga 37 deri në 38
- Kollë e thatë dhe e fortë e theksuar gjate orëve të natës
- Marrja e frymës rëndohet
- Frymëmarrja bëhet e sipërfaqshme dhe shpeshtohet
- Dhimbje të muskujve të kraharorit
- Të sëmurët janë në ankth, kanë ndjenjën sikur po mbyten

Grafiku I shpërndarjes së problemit respirator



Rezulatet: Janë ndjekur në këtë qëndër gjithsej 706 fëmijë me probleme respiratore te cilët përbëjnë 11.6% të gjithë fëmijëve (në total 6075 fëmijë), që kanë frekuentuar dhe marre këshillim, vaxinim, mjekim, dhe trajtim. Në të gjithë fëmijët e trajtuar për problemet respiratore % më të madhe e zë grupmosha 1-5 vjeç me 35.2%, duke u ndjekur nga grupmosha 5-10 vjeç ku zë 32.5% të problemeve te rrugëve te frymëmarrjes më pas renditen grupmoshat 0-1 vjeç me 17.2%, 10-14 vjeç me 15.2%. Vihet re se ka një diferencë të vogël midis seksit femër me 45.7% kundrejt 54.3% që janë fëmijë të seksit mashkull. Gjithashtu mund të themi se më të dukshme këto probleme janë te fëmijët qe frekuentojnë grupet si çerdhe dhe kopësht, krahasuar me fëmijët që rriten në shtëpi. Po tu referohemi shifrave për problemet respiratore do të zinin vendin e parë rinofaringitet me 36.9%, më pas anginat me 17 %, infeksionet virale 10.2%, astma bronkiale 6.8%, bronkiti difuz 6.6%, otiti akut 6.2%, trakeobronkit 6%, trakeit akut 3.9%, laringit akut 2.9%, rinosinozit 1.6%, bronkiolit difuz 0.8% dhe

bronkopneumoni 0.8%. Nga të gjitha problemet që kanë shfaqur këta fëmijë vetëm 3.8% e tyre jane shtruar në spital për ndihmë të specializuar dhe vetëm 6.6 % rezultojnë që të jenë të sëmurë kronik.

Përfundime

Nga ky studim shohim se grup-mosha më e prekur e fëmijëve me infeksione të rrugëve respiratore ka qenë grup-mosha 1-5 vjeç. Më të shpeshta problemet kanë qenë në stinën e dimrit dhe në pranverën e hershme. Mjekimi në kohë dhe në mënyrë adekuate i ftohjeve të zakonshme sezonale apo të infeksioneve të rrugëve të sipërme të frymëmarrjes ka rëndësi të madhe në parandalimin e infeksioneve të rrugëve të poshtme respiratore. Diagnostikimi dhe trajtimi adekuat i këtyre infeksioneve i administruar nga kujdesi parësor shëndetësor, është pjesë e strategjisë shëndetësore për të parandaluar morbiditetin dhe mortalitetin. Gjatë punës studimore –shkencore vlerësohet cilësia e shërbimit, kontrolli dhe këshillimi i vazhdueshem i fëmijëve 0-14 vjeç nga mjekët e familjes pranë Qëndrave Shëndetësore. Gjithçka është e defaktuar dhe e pasqyruar me tabelat përkatëse, gjë që tregon se parimi i mjekësisë "Të parandalosh është më mirë se të kurosh" lidhet me jetën si e pazëvëndësueshme dhe me pritshmerite tona!. Specialistët e Shëndetit Publik duhet të fokusojnë punën e tyre për të rritur shkallën e informimit tek nënat e reja, duke sensibilizuar fëmijët në shkolla për rritjen e higjienës personale, dhe duke futur në institucionet parashkollore programe të reja me qëllim mbrojtjen nga këto infeksione

Bibliografia

1. *Respiratory tract infections in children in developing countries.- Cashat-Cruz M, Morales-Aguirre JJ, Mendoza-Azpiri M*
2. *http://www.aanma.org/faqs/ëelcome-to-precious-breathers/respiratory-diseases/*
3. *Clinical managment of acute respiratory infections in children: a WHO Memorandum. Bulletin of the World Health Organization, 59: 707-7 16*
4. *http://www.bebaime.com/udhezues-shendeti-semundjet/infeksionet-respiratore-femijet-me-te-prekur-nga-problemet-me-frymemarrjen*
5. *http://www.patient.co.uk/doctor/LRTI-in-Children.htm*
6. *Acute lower respiratory tract infections in children: possible criteria for selection of patients for antibiotic therapy.-Frank Shann, Kate Hart, David Thomas*
7. *http://www.mjeku24.com/44-probleme-shendetesore-tek-femijet-2/*
8. *http://www.ikub.al/femra_category/903120039/article-infeksionet-e-fyt/default.aspx*

VLERSIMI I ANIJEVE DHE MBROJTJA E MJEDISIT DETAR NË GJIRIN E VLORËS

Msc. SHKËLQIM SINANAJ

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Shqipëri
Fakulteti i Shkencave Teknike
Departmenti Shkencave Detare

Abstrakt

Derdhjet e naftës janë tipike në aktivitetin e anijeve, ose nëpërmjet shkarkimeve operative apo aksidentale, veçanërisht në rrugët e transportit detar të detyrueshme si ngushtica e Sazanit apo dhe Gjiri i Vlorës me portin e mallrave dhe të peshkimit. Për shkak të aktiviteteve të anijeve, dhe pranisë së ndotjeve detare, zhvillimi i ekosistemit në zonën e gjirit është ndër më të ultat në këtë rajon. Ekosistemi përgjatë bregdetit, sidomos në këndin veri-perëndimor, po kërcënohet nga erozioni i vazhdueshëm si pasojë e dendësisë së anijeve të peshkimit dhe anijet që transportojnë karburante. Përveç ndotjeve të naftës, aktivitetet e anijeve shkarkojnë lloje të tjera të mbeturinave të dëmshme të tilla si mbeturina detare, substanca të rrezikshme dhe të dëmshme që janë burimet e ndotjes detare. Me rritjen e trafikut të anijeve, regjimi aktual për mbrojtjen e mjedisit mund të mos jetë i mjaftueshëm për mbrojtjen e mjedisit detar të kësaj zone. Sa më shumë anijet përshkojnë gjirin dhe ngushticën, siguria dhe shqetësimet mjedisore do të bëhen më akute për shtetin tonë. Ky matërial shqyrton këtë situatë dhe propozon masat e mundshme ligjore për shtetet bregdetare për të rritur pushtetin e tyre rregullator dhe zbatues që janë të kufizuara nga aplikimi i Pjesës III të Konventës LOSC. Masat e propozuara ligjore sigurojnë një platformë për të forcuar pushtetin e tyre dhe për të siguruar që mjedisi detar i Gjirit të Vlorës mund të mbrohet nga ndotja e anijeve.

Fjalë Kyçe – Gjiri i Vlorës, transport detar, anije peshkimi, ambjent detar, trafiku detar, derdhjet e naftës.

1. Hyrje

Ndotja e mjedisit detar nga anijet të të gjitha llojeve, duke përfshirë anijet e peshkimit, është i kontrolluar rreptësisht nga Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet (i njohur si MARPOL). Mjedisi detar është një aspekt kritik, i rëndësishëm i menaxhimit të peshkimit e cila nuk është konsideruar në mënyrë adekuate në të kaluarën. Ajo ka treguar se luhatjet në mjedisin detar ndikojnë në suksesin e peshkimit, popullatat e peshkut dhe ekosistemet e tyre (FAO, 1994).

Mjedis detar, i cili përfshin zonat detare dhe bregdetare mbështet habitatet produktive dhe mbrojtëse të tilla si rizoforë, shkëmbinj nënujorë korale dhe dunat ranore. Mjedisi detar po përballet me një numër të presioneve, që dalin nga nevojat e popullsisë, dhe përdorime të shumta që zonat bregdetare dhe detare mund te kenë. Këto presione kontribuojnë në shterimin e burimeve

detare dhe degradimi i mjedisit detar. Në mungesë të menaxhimit të mirë, këto presione mund të rezultojë në stres të rëndë.
Objektivi primar i këtij punimi është për të treguar se ndotja e mjedisit detar të zonës është prezente dhe se kuadri aktual ligjor nuk është i plotë për të realizuar mbrojtjen e mjedisit detar dhe përsa i përket zbatimit të juridiksionit aktual ka vend për tu përmirësuar.
Masat aktuale për mbrojtjen e mjedisit të parashikuara në konventën LOSC, nga organizata ndërkombëtare detare (IMO) dhe konventa të tjera ndërkombëtare të lidhura me mjedisin nuk janë të mjaftueshme për të zbutur ndotjen e mjedisit detar dhe dëmtimin e tij i cili rezulton në rritje të vazhdueshme çdo vit.
Objektivi i dytë është të vlerësojë ndikimin e ndotjeve detare nga trafiku detar dhe kryesisht nga anijet e peshkimit dhe marrjen e masave për parandalimin e tyre duke patur parasysh që kjo është një zonë e mbrojtur detare nga qeveria shqiptare.
Objektivi i tretë i punimit është që të propozojë masat e mundshme ligjore dhe të politikave për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit detar të ngushticës së Sazanit dhe Gjirit të Vlorës.
Ky studim është i rëndësishëm në realizimin e vizionit për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm të zonës së mbrojtur detare të gjirit të Vlorës. Kjo është një punë që do të plotësojë kuadrin ekzistues që lidhen me politikat ligjore që rregullojnë sigurinë e lundrimit dhe mbrojtjen e mjedisit detar të zonave të mbrojtura detare. Ajo identifikon çështjet që ende nuk janë përmendur ndonjëherë dhe sugjeron zgjidhje për çështjet e pazgjidhura. Për më tepër, ky studim ka për qëllim t'ju paraprijë studimeve të mëvonshme që mund të ndërmeren në këtë fushë.

2. Materiali dhe metodat

Gjiri i Vlorës mbart në vetvete kushte të shkëlqyera për strehimin dhe lundrimin e të gjitha mjeteve të lundrimit. Ai është gjiri më i madh i bregdetit shqiptar, që nis që nga Kepi i Plakës (Treport), vazhdon drejt jugut, duke krijuar formën e një krahu të hapur deri në gjirin e Shën Janit (Kepi në veri të Karaburunit). Në hyrje të tij gjendet ishulli i Sazanit me një largësi prej 17 km nga qyteti i Vlorës. Gjiri i Vlorës ka një gjatësi prej 19 km, gjerësi prej 9.5 km dhe thellësi 54 m. Pjesa perëndimore e tij që shtrihet përgjatë gadishullit të Karaburunit është e tipit abraziv dhe shkëmbor ndërsa pjesa lindore përbëhet nga një bregdet i ulët ranor, i paisur me një sërë plazhesh të mëdhenj e të vegjël.
Çështjet që kanë të bëjnë me ndotjen nga trafiku detar në zonat e mbrojtura janë të shumta dhe praktikisht ato janë të lidhura me natyrën e zonës, me trafikun detar, me gjendjen e porteve dhe mënyrën e menaxhimit të trafikut. Diskutimet mbi çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit detar dhe sigurinë e lundrimit në këtë zonë kërkojnë një vëmëndje të vazhdueshme të cilat mund të përfshijnë:

- Mundësinë që anijet të plotësojnë standartet e nevojshme për lundrim duke patur parasysh përmirsimet teknike, përdorimin e karburanteve të një cilësie të mirë dhe zbatimi i rregullave të konventave ndërkombëtare për ruajtjen e mjedisit detar nga ndotjet;
- Propozimi i masave për mbrojtjen e mjedisit në zonën e mbrojtur detare, duke patur parasysh se kjo është një zonë veçanërisht e ndjeshme nga ndotja për faktin se është një zonë e populluar dhe turistike;
- Marja e masave të mundshme të njëanshme për të rregulluar lëvizjen e anijeve të peshkimit përmes gjirit dhe ndalimi i peshkimit me të gjitha format e tij;
- Diskutimi mbi aplikimin e kontrollit në lidhje me lëvizjen e anijeve të peshkimit dhe krijimi i një agjensie apo dispeçerie për të kontrolluar regjimin e lundrimit për të gjitha anijet që merren me peshkim apo aktivitete të tjera të pa kontrolluara dhe të pa liçensuara.

Zona e marë në studim është Gjiri i Vlorës me një trafik të anijeve të transportit të pasagjerëve, anijet e transportit të karburanteve, anijet e peshkimit, anijet e transportit të mallrave që operojnë në portet respektive të tyre.

Figura 1. Trafiku detar në Gjirin e Vlorës.

2.1 Rreziqet e lundrimit në Gjirin e Vlorës

Mesatarisht, rajoni përreth gjirit të Vlorës karakterizohet nga lagështia e lartë dhe reshje të konsiderueshme, dhe shpejtësia e erës është relativisht e lehtë. Duke pasur parasysh se gjiri dhe rrethinat e tij janë të vendosura në një zonë të ngushtë, këto zona janë subjekt për shira të rrembyshëm, stuhi dhe erërat të drejtimit veri jug të forta. Rrymat e ujit në hyrjen veriore të ngushticës së Sazanit janë të forta. Ndërkohë në jug rrymat janë akoma më të forta për shkak të erërave të jugut që shtohen nga gryka e Dukatit. Këto karakteristika mund të ndikojnë negativisht në lundrimin e anijeve duke vështirësuar detarët për të lundruar dhe manovruar me anijet në gji. Përveç kësaj rreziqe të tjera të lundrimit në gji mund të përfshijnë një nga këto forma:

- Manovrimi i gabuar në lundrim;
- Pengesat në hyrje - dalje në ngushticën e kanalit të Sazanit;
- Siguria e pajisjeve të lundrimit;
- Trafiku gjatë navigimit në gji;
- Respektimi i rregullave të qëndrimit në spirancë;

Gabimi njerëzor është gjithashtu një formë e rrezikut lundrues që duhet të merret parasysh në vlerësimin e rreziqeve të mjedisit detar në det. Promovimi i rregulloreve që kanë të bëjnë me sigurinë detare përmes IMO është gjithashtu e rëndësishme në shmangien e ngecjes në cekëtinë të anijeve dhe përplasjet në det. Rreziqe të tjera të lundrimit në det përfshijnë trafikun kryq nga mjete të vogla të pa kontrolluara që kryejnë një peshkim të pa kontrolluar në gji. Këto rreziqe mund të bëjnë lundrimin përmes gjirit më të vështirë dhe në këtë mënyrë mund të rris gjasat e ndodhjes së aksidenteve detare që mund të rezultojë në ndotjen e mjedisit detar.

3. Rezultate dhe Diskutime

Industria e peshkimit detar në Shqipëri kontribuon në mënyrë të konsiderueshme për ekonominë kombëtare në aspektin e të ardhurave ekonomike për vendin dhe punësimin e një personeli të madh njerëzish. Ajo luan një rol kyç në ekonominë e Shqipërisë, megjithatë, anijet e peshkimit kanë qenë një kontribues i rëndësishëm për incidentet e ndotjes të raportuara të autoriteteve detare. Peshkatarët kanë një përgjegjësi të shtuar të mos e ndotin detin që siguron jetesën e tyre. Kërkesat e reja, që hyri në fuqi nga 1 janari 2013, ndalojnë shkarkimet e mbeturinave në det nga anijet, përveç në raste shumë të rralla. Industria e peshkimit është një nga industritë që duhet investuar për të rritur sigurin e anijeve dhe standartet për të ruajtur të pa dëmtuar mjedisin detar. Kjo është e lidhur me shqetësimin e ruajtjes së gjirit nga peshkimi me mjete që dëmtojnë faunën e tij. Pavarësisht nga kjo, industria e peshkimit do të vazhdojë të jetë një nga aktivitetet kryesore ekonomike për popullsinë e zonës.

Industria e peshkimit në Vlorë është e bazuar vetëm në gjuetinë e peshkut me anë të mjeteve detare anije peshkimi të madhësive të ndryshme. Ka rreth 86 anije të cilat aktualisht merren me peshkim në zonën e gjirit dhe jashtë tij.

Nga këto anije rreth 60 janë të çertifikuara nga regjistri detar Durrës me dokumentacion të rregullt. Këto janë anije aktive për peshkim dhe sipas llojit të gjuetisë ndahen në katër sektorë kryesore.

Figura 2. Grafiku i anijeve të peshkimit të ndara sipas sektorëve.

Llojet i gjuetisë që kryejnë janë: me rrjeta fundore, me grepa, me mrezhda dhe me koshilok. Rreth 60% e tyre janë të ardhura nga importi dhe rreth 40% janë të trashëguara nga vendi. Anijet e peshkimit rezultojnë të jenë të madhësive që varjojnë nga 10-33 m gjatësi. Gjendja teknike është e një niveli shumë të ulët me një moshë mesatare rreth 35 vjet. Mesatarja e ditëve të punës në muaj është për anijet me rrjeta fundore rreth 12 ditë në muaj ndersa anijet e tjera rreth 10 dite. Mungon furnizimi me karburant kështu që anijet detyrohen të shkojne në Itali dhe Greqi për karburant. Anijet që marrin karburantin jashtë vendit detyrohen të funksionojnë si anije portuale me pagesa taksash dhe një trafik më të madh. Në këtë këndvështrim ato duhet që të zbatojnë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga konventa MARPOL. Nga inspektimet e shpeshta rezulton se asnjë anije nuk është e pajisur me depozitat për mbledhjen e mbeturinave të vajit që grumbullohet nga shfrytëzimi i anijes.
Nuk ka impiante të filtrimit dhe ndarjes së karburanteve nga ujrat në mbetjet e motorave të cilat janë të detyrueshme sipas konventës MARPOL. Gjithashtu nuk ka asnjë kompani që të jetë e liçensuar për tërheqjen e mbeturinave qoftë ato të vajrave dhe naftës por dhe mbeturinat e tjera në bordin e anijes. Si pasojë e këtyre mangësive mbetjet e ujrave të përziera me naftë dhe vaj të motorave derdhen në det duke bërë një rrezik të madh për mjedisin detar të Gjirit të Vlorës. Porti i peshkimit ka nevojë për pastrim, thellim dhe ndërtimin e kalatave të reja për qëndrimin e anijeve. Rreziku i ndotjes së mjedisit detar të Gjirit të Vlorës shtohet me rritjen e trafikut detar. Ky trafik jepet nga grafiku më poshtë.



Figura 3. Trafiku detar i anijeve në një muaj në Gjirin e Vlorës.

Ky rrezik varet nga dy faktor kryesor që janë trafiku dhe prezenca e rrezikut të ndodhjes së një ndotje. Kjo varësi mund të shprehet me ekuacionin e mëposhtëm.

Rreziku potencial i ndotjes = Trafik x Prezenca e rrezikut

Trafiku në gjirin e Vlorës është i përfaqëuar nga sasia e mjeteve detare të cilat hyjnë dhe dalin në portet respektive. Prezenca e rrezikut është kryesisht nga anijet e peshkimit të cilat nuk i plotësojnë standartet e MARPOL.

3.1 Trafiku bregdetar në gjirin e Vlorës

Çështja e trafikut detar dhe lëvizja e mjeteve në zonën bregdetare në gji ka vend për tu diskutuar. Ajo duhet të ishte një prej çështjeve më të diskutuara gjatë gjithë kohës kur bëhet fjalë për rregullat e sigurimit të lundrimit në ngushtica dhe gjire. Mjetet e vogla detare mund të paraqesin rreziqe në lundrimin e anijeve të tjera si ato të transportit të pasagjerëve apo anijet që transportojnë ngarkesa të ndryshme. Shumica e këtyre mjeteve detare janë mjete të paregjistruara, të pakontrolluara, të vjetra dhe që nuk sigurojnë zbatimin e rregullave të lundrimit në det. Trafiku detar në gji përfshin anijet tregtare, anijet e peshkimit, anijet e karburanteve dhe anijet e pasagjerëve.

Muaji	**Tragete**	**Tregëtare**	**Tankera**	**Jahte**	**Peshkimi**	**Të tjera**
Janar	23	1	7		86	5
Shkurt	19	-	7	2	86	1
Mars	17	2	9	1	86	1

Prill	23		13	6	86	4
Maj	26	5	13	45	86	3
Qershor	24	2	12	64	86	5
Korrik	20	3	12	84	86	13
Gusht	36	5	12	116	86	8
Shtator	21	2	11	41	86	6
Tetor	18	3	15	13	86	3
Nëntor	22	2	11	5	86	4
Dhjetor	24	3	11	4	86	6

Tabela 1. Trafiku detar në Gjirin e Vlorës për vitin 2013.

Zonat më të rrezikshme në trafik janë zona midis portit detar të Vlorës dhe portit të peshkimit ku kryqëzohen rrugët për hyrjen dhe daljen e anijeve. Këtu operojnë dhe pjesa më e madhe e mjeteve të vogla që përdoren nga popullsia e kësaj zone për peshkim. Një rëndësi të madhe ka dhe sistemi i njoftimit të lundrimit nga anijet. Vihet re se kryesisht anijet e vogla qoftë ato të peshkimit amator apo dhe ato detar nuk zbatojnë rregullat e njoftimeve në kapitenerinë e portit që eshtë përgjegjsja kryesore për rregullimin e trafikut në këtë zonë.
Në rritjen e sigurisë në trafik mund të japim disa sugjerime të tjera:

- Përmirësimi i komunikimit ndërmjet anijeve dhe anijet me kapitenerinë;
- Raportimi i vendndodhjes në mënyrë permanente;
- Monitorimi, mbikëqyrja dhe ndjekja e lundrimit në rastet e motit të keq;
- Përmirësimi i lundrimt të anijeve;

Edhe pse nuk ka pasur kurrë një fatkeqësi detare që përfshin një përplasje në mes të trafikut ai është një rrezik që duhet të merret parasysh në përmirësimin e sigurisë për lundrimin e anijeve.

3.2 Shkarkimi i mbeturinave në det nga anijet e peshkimit

Ka shumë lloje të mbeturinave të gjeneruara në bordin e anijeve të peshkimit janë të ndaluara nga shkarkimit në det, duke përfshirë: trale dhe rrjeta peshkimit, litar sintetik, litar peshkimi, shishe plastike, ambalazhe mbajtëse, qese plastike, copë litari artificial, bojëra, letra, lecka, shishe. Mbeturinat e ushqimit, jo të kontaminuara nga çdo lloj tjetër e mbeturinave, mund të shkarkohen në det, ndërsa anija e peshkimit është në tranzit me kusht që mbeturina është shkarkuar sa më shumë larg të jetë e mundur nga toka më e afërt, por në çdo rast jo më pak se 3 milje detare. Përveç kësaj, sasi të vogla të ushqimit mund të hidhen direkt në det me qëllim të veçantë të të ushqyerit të peshkut. Megjithatë, kapiteni i anijes së peshkimit duhet të marri parasysh ligjet vendore ose mund të kërkohet leje në Kapitenerinë e Portit.
Humbja e veglave të peshkimit mund të dëmtojnë mjedisin detar ose të krijojnë një rrezik lundrimi. Shumë kafshë detare vdesin si rezultat i

ngatërrimit në rrjeta, ose kapërdijnë masa të hedhura plastike. Të gjitha këto materiale lëshohen në det nga ekuipazhet e anijeve të peshkimit. Nëse është e mundur, veglat e peshkimit duhet të kenë panele të degradueshme të materialit natyror për të reduktuar potencialin e ndotjes së mjedisi detar.

4. Përfundime

Duke patur parasysh se zona është e kushtëzuar nga aktiviteteti i anijeve, masat e propozuara nuk do të jenë tërësisht të zbatueshëm nëse rrugët alternative mund të jenë krijuar për të zbutur varësinë e aktiviteteve detare në gji. Prandaj, është e rëndësishme për zonën bregdetare të vazhdojë mbështetja për planet ekzistuese për të krijuar një alternativë më të mirë për menaxhimin e integruar të saj. Kjo përfundimisht do të promovojë një situatë e cila mban një ekuilibër më të mirë midis të drejtave të lundrimit, mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit detar të zonës detare të Gjirit të Vlorës. Konkluzioni i përgjithshëm që nxirret është se ligjet aktuale, rregulloret dhe masat për sigurinë e lundrimit dhe kontrollin e burimit të ndotjeve nga anijet në zonën e mbrojtur detare të Gjirit të Vlorës nuk janë të mjaftueshme. Ky përfundim është i bazuar në faktin se në përgjithësi mjetet e transportit detar dhe anijet e peshkimit nuk janë në standartet e kerkuara nga konventat ndërkombëtare. Si rrjedhim ky burim ndotjesh do të jetë prezent në ambjentin detar dhe i rrezikshëm në ekosistemin detar të zonës së mbrojtur detare.
Një opsion në dispozicion në ndihmë të mbrojtjes së zonës bregdetare është që të propozojë masa shtesë mbrojtëse në kuadër të kompetencës së IMO të tilla si përcaktimi i zonës si zona të veçanta nën MARPOL 73/78. Është e rekomanduar gjithashtu që duhen bërë përpjekje për të nxitur më tej zhvillimin e mekanizmave të bashkëpunimit që ekzistojnë midis institucioneve shtetërore dhe atyre private që përdorin këto mjete detare.
Duke patur parasysh se zona detare është zonë ku lundrojnë anijet, veçanërisht ato të peshkimit dhe të transportit të karburanteve masat e propozuara nuk do të jenë tërësisht të zbatueshme nëse ekuipazhet e tyre nuk do të jenë të ndërgjegjshme për ti zbatuar ato. Prandaj është e rëndësishme për përdoruesit e këtyre mjeteve të vazhdojë mbështetjen për planet ekzistuese për të mbrojtur këtë zonë. Kjo përfundimisht do të promovojë një situatë e cila mban një ekuilibër më të mirë midis të drejtave të lundrimit dhe mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit detar të zonës bregdetare të Gjirit të Vlorës.

5. Falënderime

Falenderoj Organizatën e Menaxhimit të Peshkimit Vlorë për informacionin mbi gjendjen dhe sasinë e anijeve të peshkimit në portin e peshkimit Vlorë.

6. Literatura

1. Marine pollution risk assessment for the Pacific Islands Region. pp 1-2.
2. International Convention for the Prevention of Pollution by Ships 1973 and 1978 Protocol (MARPOL).
3. United Nations Convention on Law of the Sea 1982 (UNCLOS)
4. Ligji Nr. 8905 date 06. 06. 2002 Per Mbrojtjen e Mjedisit Detar nga Ndotja dhe Demtimi.
5. Ligji Nr. 8990 date 23. 01. 2003 Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis.
6. Jones, M. M. 1994a. Fishing debris - What is Washing Up? Australian Fisheries. 53(11). pp 18-23.
7. Discards and fishing debris of the tuna fisheries in the south west pacific and Indian oceans. http://www.sjpub.org/sjeer/sjeer-203.pdf
8. The International Tanker Owners Pollution Federation Ltd. (ITOPF), 'Oil Tanker Spill Statistics: 2007' (ITOPF, 2008), pp 1-5.
9. Navigational hazards in international maritime chokepoints: A study of the straits of Malacca and Singapore. http://www.uq.edu.au/isaasiapacific/content/mohdmohdrusli7-2.pdf

MBROJTJA E TË DREJTAVETË PUNËTORËVE NË BASHKIMIN EVROPIAN

Stela MEÇAJ, Uarda ROSHI

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

stela.mecaj@yahoo.com

Abstrakt

Ligji i punës ka si qëllim fillestar korrigjimin e pabarazive ekonomike dhe përgjegjësive sociale në marrëdhëniet e punës. Që në fillesat e saj, e drejta komunitare e punës synonte përkufizimin e situatës së punësimit,si faktor kyç rreth të cilit do të zhvilloheshin një tërësi të drejtash të tjera. Traditat kombëtare janë shumë të ndryshme në formulimin dhe zbatimin e ligjit dhe politikës së punës.Shpejtësia e përparimeve teknologjike, rritja e konkurrencës e lidhur me globalizimin, evoluimin e kërkesës konsumatore dhe rritjen e konsiderueshme në sektorin e shërbimeve e theksojnë në ditët e sotme nevojën për rritjen e fleksibilitetit.Në kuadër të ndryshimeve ekonomike, denacionalizimit dhe ndërkombëtarizimit të tregjeve të punësnjë hap i rëndësishëm do të ishte përmirësimi dhe plotësimi i legjislacionit të punës me dispozita që marrin në mbrojtje punën, që krijohet nga biznesi vendas për të shmangur tendencën globaliste të transferimit të punës në ato vende ku puna dhe aktorët e saj janë të pa mbrojtur dhe krahu i punës kushton më lirë. Qëllimi i këtij punimi është evidentimi i vlerave praktike të të drejtës komunitare të punës dhe rëndësinë ekonomike dhe politike që merr në kuadër të Bashkimit Evropian.

Fjalët kyçe: e drejta komunitare e punës, punësimi, punëtor, i vetpunësuar.

Key words: community labor law, employment, employee, self-employed.

1. Hyrje

E drejta komunitare e punës është pjesë e të drejtës komunitare dhe qëllimi parësor i saj është rregullimi i marrëdhënieve të punës, të drejtave e detyrimeve të punëmarrësve dhe punëdhënësve në shtetet anëtare.Në nivelin e BE-së e drejta komunitare e punës në këtë aspekt mbulon dy fusha të gjera: Së pari, kushtet e punës, duke përfshirë edhe orët e punës, punësimin me kohë të plotë, të pjesshëm dhe pushimin e punëtorëve. Së dyti, informimin dhe konsultimin e punonjësve edhe në rastet e shkurtimeve kolektive nga puna. Që në fillimet e tij, Komuniteti Evropian është angazhuar për të arritur nivele të larta të punësimit dhe të mbrojtjes sociale, kushte të mira jetese dhe përmirësimin e kushteve të punës. Komuniteti Evropian për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e Traktatit të KE-së, veçanërisht nenet 136 dhe139, ka për detyrë të mbështesë

dhe të plotësojë aktivitetet e shteteve anëtare nëpërmjet miratimit të rregulloreve, që përcaktojnë standardet minimale në nivel evropian përsa i përket kushteve të punës dhe të punësimit si dhe tëdrejtën e informimit dhe konsultimit të punonjësve. Shtetet Anëtare do të zhvendosin pastaj ligjin e BE në legjislacionin kombëtar dhe do të marrin masat e nevojshme efektive për zbatimin e tij, duke siguruar një nivel të ngjajshëm mbrojtje.

2. Zhvillimi historik i të drejtës komunitare të punës

Traktati themelues i Parisit (1951). Megjithëse, qëllimi kryesor i traktatit ishte krijimi i një tregu të përbashkët, ai ofroihulumtime të rëndësishme në të drejtën kombëtare të punës duke ofruar një krahasim të ligjeve të ndryshme dhe duke hapur kështu rrugën për integrim.

Në Traktatin e Romës(1957)shqetësimi kryesor mbështetej në faktin, se dispozitat ekonomike dhe sociale nuk do të ndikonin në kushtet e konkurrencës brenda tregut të përbashkët.Traktatit i Romës fiksoi disa kërkesa minimale, të tilla si:

1. Lëvizja e lirë e punëtorëve.

2. Liria e vendosjes.
3. Liria për të ofruar shërbime në një shtet tjetër.
4. Barazinë në trajtim në mes të punëtorëve kombëtar dhe emigrant.

5. Krijimi i institucionit të Fondit Social Evropian, i cili kishte për qëllim të përmirësonte mundësitë e punësimit për punëtorët në tregun e brendshëm.

6.Neni 19 i TKEE parashikonte detyriminpër të paguar punëtorët në mënyrë të barabartë për burrat dhe gratë për punë të barabartë. Ky artikull i hapi rrugën një jurisprudence shumë të gjerë të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Në vitin1970, u hartua raporti Warner që përmbante elementët kyç për reformat e viteve pasardhëse (p.sh zbatimi i politikave strukturore dhe rajonale, vëmendje për politikat kombëtare ekonomike).Në samitin e 1972, u vendosën themelet për Fondin Evropian të Zhvillimit Rajonal, që synonte sigurimin e rritjes ekonomike dhe zvogëlimin e pabarazivenë komunitet.Në vitin 1974, u nis nga Këshilli “Programi i Veprimit Social”, i cili parashikonte masa të tilla si krijimin e një fondi social për punëtorët emigrant dhe me aftësi të kufizuara. Në vitet 80 (në saj të personazheve, si Presidenti i Komisionit Jacques Delors) ka pasur një vlerësim të fortë të politikave evropiane sociale.

Për më tepër, me miratimin e "Aktit Unik Evropian" në vitin 1987dhe ndryshimet, që solli në pjesët kryesore të Traktatit, me nenin 118/a iu dha Këshillit kompetenca për miratimin me shumicë të kualifikuar të

rezolutave për përmirësime inkurajuese, sidomos të kushteve të punës, sigurisë së mjedisit në punë dhe shëndetit të punonjësve.

Neni 118/b i beson Komisionit detyrën e zgjerimit dhe zhvillimit të dialogut në mes të partnerëve social në nivel evropian.
Në bazë të nenit 100 është bërë i detyrueshëm informimi i punonjësit nga ana e punëdhënësit, për kushtet e kontratës ose marrëdhënies së punës.Në vitin 1989, është miratuar "Karta e Komunitetit për të Drejtat Sociale Themelore të Punëtorëve", e cila përbën një shembull të mirë të vullnetit të shprehur nga shtetet anëtare për t'i dhënë tregut unik një dimension social, që nuk ishte theksuar sa duhet nga Akti Unik. Në vitin 1997, në Traktatin e Amsterdamit ishin përfshirë një numër dispozitash për politikat e punësimit. Në Lisbonë u zhvillua akoma më mirë ky aspekt, me objektivin kryesor për ta bërë ekonominë evropiane konkurruese dhe më dinamike.

3. Disa parime të të drejtës komunitare të punës

Parimet e përgjithshme, e ashtuquajtura "e drejtë komunitare e pashkruar" janë përpunuar nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në ushtrimin e detyrës së vet për të siguruar respektimin e të drejtës komunitare në interpretim dhe në zbatim të traktatit[1]. Parimet themelore në dimensionin social dhe të punës janë përcaktuar në bazë të kontekstit ekonomik e politik.

Parimi i lirisë së lëvizjes.

Liria e lëvizjes së punëtorëve mbështetet në dy parime: ndalimin e diskriminimit të bazuar në kombësi dhe trajtimin e barabartë me shtetasit e tyre[2].

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit. Ky parim nënkupton braktisjen e çdo lloj diskriminimi të bazuar mbi kombësinë, gjininë[3], pagesën[4], pushimi nga puna, të drejtat sindikale[5], aksesin në banesë etj.

Parimi i bashkëpunimit.
Ky parim synon konkretisht bashkëpunimin e vazhdueshëm mes shërbimeve të punësimit të shteteve anëtare nëpërmjet largimit të çdo pengese ligjore, që kufizon lirinë e lëvizjes dhe marrëdhëniet e punës të punëmarrësve në shtetet anëtare.

---

[1]Zajmi, I. "E Drejta Europiane", Botimi i Dhjetë, Tiranë 2010, fq. 168.
[2]GJED, Çështja 415/93 Union Royale Belge des Sociétés de Football Association ASBL v Jean-Marc Bosman (1995).
[3]GJED, 8 prill 1976, Case 43/75 Gabrielle Defrenne kundër Société Anonyme Belge de Navigation Aérienne Sabena [1976] ECR 455 (Defrenne II).

[4]GJED,12 shkurt 1974 Case152-73, Giovanni Maria Sotigu v Deutche Budespost.
[5]C-438/O5 International Trasport Warkers Federation Finish seamen's union /Viking Line abp.

Parimi i subsidiaritetit. Parimi i subsidiaritetit përcakton faktin se, Komuniteti nuk do të ndërmarrë masa të rregulloj, atë që rregullohet në mënyrë më të efektshme në nivel kombëtar apo rajonal. Ky parim krijon një ekuilibër midis Bashkimit Evropian nga njëra anë, në përcaktimin e objektivave të përbashkëta për komunitetin dhe përgjegjësive konkrete të shteteve anëtare nga ana tjetër për realizimin e veprimtarisë së detajuar për arritjen e këtyre objektivave.

Parimi i sigurisë dhe fleksibilitetit. Synon të siguroj, që qytetarët e BE-së të mund të gëzojnë një nivel të lartë të sigurisë në punë, të mund të gjejnë lehtë punë në çdo fazë të jetës së tyre dhe të kenë shanse të mira për zhvillimin e karrierës në një mjedis ekonomik që ndryshon me shpejtësi. Ky parim gjithashtu ka si synim të mbështesë si, punëtorët ashtu dhe punëdhënësit për të shfrytëzuar mundësitë, që globalizimi paraqet për ta.

Afrimi i integruar.
Nëpërmjet këtij parimi synohet të shpjegohet fakti, se udhëzimet e punësimit nuk janë vetëm për politikat e punësimit, por shtrihen gjithashtu edhe në politikat e arsimit, politikat rajonale e sociale duke e vënë theksin në shkëmbimin dhe ndarjen e eksperiencave mes shteteve anëtare të komunitetit. Ky parim është i lidhur ngushtësisht me parimin e besnikërisë reciproke ndërmjet shteteve anëtare.

4. Zhvillimi i të drejtës komunitare të punës në Bashkimin Evropian

Modeli tradicional reflektonte disa supozime kryesore në lidhje me marrëdhëniet e punësimit. E veçanërisht: i) supozimin e një marrëdhënie pune të përhershme, me kohë të plotë ii) në supozimin se marrëdhëniet e punës janë të rregulluara nga kodi i punës në përputhje me kontratën e punësimit dhe iii) në supozimin se një punëdhënës është përgjegjës për respektimin e detyrimeve të vendosura për të[6]. Tendenca e kompanive për të rishikuar politikën e tyre të investimeve afatshkurtër, shpërndarja e informacionit dhe e teknologjive të komunikimit, kanë shtyrë kompanitë për tu organizuar në një mënyrë më fleksible. E gjitha kjo shoqërohet me evolucionin e organizimin e kohës së punës, pagave dhe numrit të të punësuarve në faza të ndryshme të ciklit të prodhimit. Këto ndryshime kanë krijuar një kërkesë për shumëllojshmëri më të madhe në

[6]Dossier dal libro verde sulla modernizzazione del diritto del lavoro alla comunicazione sulla flexicurity, a cura di Clement Massimiani di riceca in diritto del lavoro Europeo,Universita degli studi di Catania, p. 6,2007.

kontratat e punës, qofshin këto të mbuluara apo jo në mënyrë eksplicite nga BE dhe legjislacioni kombëtar[7].

Modeli tradicional i marrëdhënies së punës nuk mund të jetë i përshtatshëm për të rritur mundësitë e globalizimit. Termat dhe kushtet e punësimit tepër mbrojtëse mund të dekurajojnë punëdhënësit të punësojnë gjatë periudhave të rimbëkëmbjes ekonomike. Modelet alternative të kontratave mund të rrisin aftësinë e kompanive për të zhvilluar krijimtarinë e tyre, të stafit si dhe për të zhvilluar avantazhet konkurruese. Qëllimi i këtyre metodave alternative ishte zhvillimi i një fleksibile "margjinale" që do të thotë krijimi i formave më fleksibile të punësimit me nivele të ulëta të mbrojtjes kundër pushimit nga puna, në mënyrë që të lehtësojë aksesin e të ardhurve të rinj dhe njerëzve në kërkim të një pune, duke i lejuar ata që të kenë një zgjedhje më të madhe në çështjen e mundësive të punësimit[8].

Në nivelin e BE-së, përveç studimeve të shumta janë marrë një seri masash legjislative dhe politika, për të përcaktuar si të implementohen forma të reja të punësimit fleksibël për të garantuar një minimum të drejtash sociale për të gjithë punëtorët. Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe të punës për punësimin me afat të caktuar, me afat të pacaktuar, me kohë të pjesshme pune, si dhe për punësimin sezonal u vunë në dukje fillimisht në Kartën Sociale të 1989 dhe në programin e mëvonshëm për zbatimin e Kartës Sociale[4]. U zhvillua nje debat intensiv për faktin nëse do të ndërmerreshin iniciativa në nivel Komuniteti në lidhje me këto marrëdhënie të punës, e cila çoi në adoptimin e direktivave për punën me kohë të pjesshme[9] dhe punësimin me afat[10]. Kjo bëri të detyrueshme barazinë në trajtim nga ana e shteteve anëtare midis punonjësëve me kohë të pjesshme, të punësuarve të përkohshëm dhe punëtorëve me kohë të plotë në përputhje me parimin e barazisë në trajtim.

Në shumicën e shteteve anëtare, ligjet e punës dhe të sigurimeve shoqërore janë të dizenjuara për të siguruar mbrojtjen e punonjësve në pozita të caktuara pune. Ata jo gjithmonë janë në gjendje të ndihmojnë punëtorët në kalimin e tyre nga një status në një tjetër, në kontekst të ndërprerjeve jo vullnetare të marrëdhënieve të punës (të tilla si shkarkimi dhe papunësia) ose ndërprerje

---

[7]Dossier dal libro verde sulla modernizzazione del diritto del lavoro alla comunicacione sulla flexicurity, a cura di Clement Massimiani di ricerca in diritto del lavoro Europeo, Universita degli studi di Catania, p. 7, 2007.

[8]Prospettive dell'occupazione dell' OCSE, "Regolamentazione della protezione dell'occupazione ed efficiacia del mercato del lavoro". Edizione 2004, capitolo 2.

[9]Direktiva 97/81/CE e lidhur me marrëveshjen kuadër për punën me kohë të pjesshme të përfunduar nga Unice dhe nga CEEP e CES.

[10]Direktiva 1999/70/CE që lidhet me marrëveshjen kuadër për punë me afat të caktuar të realizuar nga UNICE dhe nga CEEP E CES.

vullnetare të marrëdhënieve të punës (trajnimi profesional, përgjegjësitë familjare, lindjes ose leje për të sëmurë). Një problem tjetër i praktikës ka të bëjë me shfaqjen e formave të ndryshme të punës atipike, që e kanë bërë më pak të qartë kufirin midis ligjit të punës dhe ligjit tregtar. Dallimi tradicional ndërmjet termit "punonjës" dhe i "vet-punësuar" nuk pasqyron më së miri realitetin ekonomik dhe social të punës, sepse mund të lindin kundërshti në lidhje me natyrën juridike të marrëdhënies së punës kur natyra e vërtetë e punës është e fshehur apo e maskuar[11].

5. Liria e lëvizjes së punëtorëve

Lëvizja e lirë e punëtorëve, përbën arritjen më të lartë të të drejtës komunitare të punës, sepse synon të mbrojë individët, të cilët dëshirojnë të ushtrojnë në territorin e një shteti anëtar një biznes ose të punësohen, (duke iu referuar kështu personave të punësuar, personave të vet-punësuar).

Për të gjithë punëtorët ekzistojnë rregulla të caktuara e përkatësisht:
• rregulla që lidhen me pranimin, banimin, dëbimin nga territori i shtetit, të cilat janë parakusht për ushtrimin e ndonjë aktiviteti.

• rregulla që kufizojnë lëvizjen e lirë të personave për arsye të politikës publike, sigurisë publike ose shëndetit publik duke u përpjekur për të pajtuar ruajtjen e sovranitetit të shtetit në këtë çështje me nevojën për të shmangur diskriminimin[12].
Neni 39[13] i Traktatit përcakton një seri të të drejtave të punëtorëve të lidhura ngushtë "me lirinë e lëvizjes".

Këto të drejta janë:
•për të pranuar ofertat e punësimit;
•për të lëvizur lirisht brenda territorit të shteteve anëtare për këtë qëllim;
•për të qëndruar në një nga shtetet anëtare dhe për të kryer një punë në të njëjtat kushte si punëtorët vendas:
•për të qëndruar në territorin e një shteti anëtar pasi ka qenë i punësuar.
Cilët përfshin koncepti i të punësuarit?

---

[11]Dossier dal libro verde sulla modernizzazione del diritto del lavoro alla comunicacione sulla flexicurity, a cura di Clement Massimiani di ricerca in diritto del lavoro Europeo, Universita degli studi di Catania, p. 12, 2007.
[12]Shiko: Case152-73, Giovanni Maria Sotigu v Deutche Budespost.
[13]Gazzetta ufficiale delle Comunità europee, **"**Versione Consolidata del Trattato che Instituisce la Comunita Europea" art 39.

Termi “punëtorë” zbatohet për punëtorët që janë shtetas të shteteve anëtare[14].

- Koncepti i të punësuarit, përfshin jo vetëm personat me kontratë afatgjatë, por dhe të përkohshme e sezonale.
- Aktiviteti ekonomik i pranuar në sensin e gjerë: përfshi dhe sportistët profesional.
- Qarkullimi i lirë për aktivitete në sensin e gjerë por me kufizime për pozicione pune në administratën publike apo rastet e punëve, që kanë rëndësi për rendin, sigurinë dhe shëndetin publik.

Cilat janë konkretisht disa nga pengesat në realizimin e qarkullimit të lirë?

Disa nga pengesat kryesore në realizimin e qarkullimit të lirë do të përmendim:
1. Njohja e diplomave dhe e kualifikimeve (përpjekje për njohjen e arsimimit të lartë, si të diplomave me mbi tre vite të studimit dhe disa kualifikime në një kohë më të shkurtër). 2. Aksesi në informacionin mbi ofertat e punës në vendet anëtare. 3. Së fundi, gjuha (e ndyshme në shtete anëtare të ndryshme).

6. Punësimi

Traktati i Amsterdamit ka shtuar në Traktatin e KEE një titull të ripër punësimin dhe në nenin 2, përcakton detyrat e Komunitetit për të promovuar një nivel të lartë të punësimit. Në nenin 3 thuhet se veprimi i Komunitetit përfshin promovimin e koordinimit të politikave të shteteve anëtare, duke zhvilluar një strategji për punësimin. Aktivitetet e koordinimit do të realizohen përmes një ekzaminimi fillestar të gjendjes së punësimit në Evropë të kryer nga Këshilli Evropian, pas të cilave ai nxjerr konkluzionet përkatëse.

Mbi këtë bazë, Këshilli i Bashkimit Europian do të bëjë çdo vit udhëzimet, që do të merren në konsideratë nga shtetet anëtare në politikat e tyre për punësim. Këto udhëzime miratohen me shumicë të kualifikuar pas konsultimit me Parlamentin, Komitetin Ekonomik dhe Social të Rajoneve dhe Komitetin e Punësimit. Në lidhje me veprimet e mbështetjes dhe të integrimit, neni 123 i TKE parashikon marrjen e masave për të zhvilluar shkëmbimet e informacionit dhe praktikave më të mira.

---

[14]Rregullorja 1612/68 sanksionoi zbatimin e termit puntorë, kur këta të fundit janë shtetas të shteteve anëtare dhe ky interpretim është përdorur gjerësisht nga GJED.

Koordinimi i politikavenë kuadër të partneritetit për rritje ekonomike e punësim dhe koordinimit të metodave në fushën e politikave e të përfshirjes sociale mundësojnë ndër të tjera sigurimin dhe lëvizjen e plotë të punëtorëve në të gjithë Evropën në kuadër të Traktateve. Metoda të tilla, koordinojnë objektivat dhe veprimet konkrete, të vendosura në nivel të BE-së, e aplikohen më pas në formën e planeve nacionale të veprimit.Shtetet anëtare tregojnë një kujdes të veçantë, që punëdhënësit t'u garantojnë punonjësve kushtet e punësimit të fiksuara në vendin anëtar në territorin e të cilit zhvillohet aktiviteti ose ushtrohet profesioni nga subjekti konkret dhe konsistojnë konkretisht në:

- Periudhën maksimale të punësimit dhe periudhën minimale të pushimit;
- Nivelet minimale të pagës përfshirë dhe shumat për shpërblimin e orëve suplementare të punës;
- Kushtet e sigurisë në punë dhe kushtet e higjenës. Punëdhënësit janë të detyruar të sigurojnë kushtet në punë në të gjitha aspektet, që lidhen me punën;
- Kushtet e punës për gratë shtatëzanë dhe marrjen e masave për sigurimin e tyre;
- Barazia e trajtimit kundrejt gjinive;
- Zgjatja minimale e lejeve të paguara vjetore të punës;
- Të drejtën e informimit të punonjësit në lidhje me marrdhënien e punës.

Cilat janë rastet kur ruhet statusi i të punësuarit?

Qytetarët evropianë, që nuk janë të punësuar do të mbajnë statusin e të punësuarit vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
- Për shkak të paaftësisë së përkohshme të shkaktuar nga aksidente apo sëmundje, që nuk janë në gjendje të punojnë.
- Nëse bëhen të papunë pa vullnetin e tyre dhe kanë qenë të punësuar për më shumë se një vit dhe janë të regjistruar në zyrat e punës si punëkërkues.

Cila ishte risia që solli direktiva 2004/38, në lidhje me qëndrimin e përhershëm në një shtet anëtar, cilat janë kushtet që duhet të plotësohen dhe kur fitohet kjo e drejtë?

Pas qëndrimit për një periudhë prej 5 vitesh në mënyrë të vazhdueshme në një nga shtetet anëtare, kombësinë e të cilit qytetari evropian nuk e gëzon, ai dhe familja e tij fitojnë të drejtën e qëndrimit të përhershëm. Megjithatë, të punësuarit dhe familjet e tyre mund ta fitojnë të drejtën e qëndrimit të përhershëm edhe nëse nuk qëndrojnë në një nga shtetet anëtare për 5 vjet në mënyrë të vazhdueshme nëse plotësohen disa kushte specifike e konkretisht: Nëse kanë më pak se tre vjet, që qëndrojnë në shtetin pritës kur plotësohet të paktën njëra nga kushtet e mëposhtme:
-Në rast të daljes në pension;
-Në rast se pëson dëmtim të konsiderueshëm; .

-Në rast vdekje (të drejtën e qëndrimit e fitojnë familjarët).
Të punësuarit dhe familjarët e tyre gëzojnë të gjitha avantazhet shoqërore edhe nëse këta të fundit nuk janë të lidhur me kontratën e punës.Këto avantazhe gëzohen njëkohësisht nga familja e tij edhe në rast vdekje të punonjësit. Të punësuarit në shtetet anëtare, që nuk kanë kombësinë e atij shteti do të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe të njëjtin trajtim si të punësuarit vendas për vete dhe për familjarët e tyre. Ndalohet çdo praktikë, që direkt apo indirekt diskriminon subjektet e mësipërme në çdo mënyrë dhe në çdo fushë.

Direktivat e punësimit, në BE janë të bazuara në katër shtylla strategjike. Ato janë: mundësitë për punësim, ndërmarrësia, përshtatshmëria, dhe mundësitë e barabarta.

Shtylla e parë (*mundësitë për punësim*) ka të bëjë me anën e ofertës së tregut të punës. Ajo angazhohet për masat aktive në vend të atyre pasive dhe për reduktimin e mungesës së kualifikimit (p.sh. masat që synojnë luftimin e papunësisë afatgjatë dhe të të rinjve; kualifikimi në kontekst të mësimit afatgjatë).

Shtylla e dytë (*ndërmarrësia)* ka të bëjë me krijimin e vendeve të reja të punës duke zvogëluar shpenzimet. Kjo shtyllë synon ngritjen e mundësive të reja për punësim në një shoqëri të bazuar në dije, në sektorin e shërbimeve dhe një mbështetje për nismat për punësim rajonal dhe lokal.

Shtylla e tretë (*përshtatshmëria*)ka lidhje me krijimin e marrëveshjeve fleksibile në organizimin e punës duke përcaktuar si përgjegjës, jo vetëm qeveritarët për politikat e punësimit, por edhe partnerët social. Këto masa synojnë modernizimin e organizimit të punës.

Shtylla e katërt (*mundësitë e barabarta)* ka të bëjë me masat në drejtim të zvogëlimit të dallimeve të bazuara në specifikat gjinore në tregun e punës.

Konkluzione

Vlerat praktike të të drejtës komunitare të punës qëndrojnë kryesisht në mundësinë për të realizuar standarte, që janë më specifike se standartet ndërkombëtare për të akorduar me probleme konkrete rajonale dhe për të siguruar njëtrajtshmëri, unifikim ligjor rajonal, si dhe avantazhe reciproke gjithëpërfshirëse. E drejta komunitare e punës ofron një konceptim relativ të marrëdhënieve të punës të ndryshëm nga përkufizimet dogmatike e tradicionale, të cilat shpesh kanë pasur tendencën ta etiketojnë të drejtën e punës si një standart të pastër të ndarë nga fenomenet e tjera shoqërore si: ekonomia dhe politika. Në këtë kontekst, ajo ndihmon për të kuptuar se si ndryshon rregullimi ligjor i marrëdhënieve të punës në kuadër të ndryshimeve ekonomike, denacionalizimit dhe ndërkombëtarizimit të tregjeve të punës.Dialogu social në nivel kombëtar, sektorial dhe të ndërmarrjeve është një nga instrumentet më të

rëndësishëm të përdorur për implementimin e formave të reja të fleksibilitetit të brendshëm, me qëllim që rregullat e zbatueshme për vendin e punës të jenë të përshtatshme me realitetin e ndryshimit ekonomik.Zhvillimet e marrëdhënieve mes të drejtës së punës dhe marrëveshjeve kolektive janë të domosdoshme dhe paraqesin një rëndësi të veçantë për shkak se, marrëveshje të tilla rregullojnë çështje të reja (ristrukturimi, konkurrenca) dhe aplikohen për kategori të reja të punonjësve (punëtorë të përkohshëm).Garantimi i të drejtës së lëvizjes së lirë të punëtorëve, përbën arritjen më të lartë të të drejtës komunitare të punës e veçanërisht sepse mbi bazën e saj u sanksionua një gamë e gjerë të drejtash për punëmarresin. Nëse në fushën e të drejtave të individëve, po sanksionohen gjithmonë e më shumë të drejta të reja e të qëndrueshme nuk mund të themi të njëjtën gjë për mbrojtjen e të drejtave kolektive e veçanërisht po t'i referohemi jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Bibliografia

Direktiva 2004/38 "Mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit Evropian dhe familjarëve të tyre për të banuar dhe lëvizur lirisht brenda territorit të Shteteve Anëtare".

Direktiva 2005/36/EC "Për njohjen e kualifikimeve profesionale".

Direktiva e 2006/54/ec "Për trajtim të barabartë për burrat dhe gratë në çështje të punësimit dhe profesionit".

Dossier dal libro verde sulla modenizzazione del diritto del lavoro alla comunicazione sulla flexicurity, a cura di Clement. Massimiani di riceca in diritto del lavoro Europeo, Universita degli studi di Catania.

Il diritto Europeo del lavoro e la carta dei diritti fondamentali dell'UE versione ridota, a cura di Brian Berusson.

I.Zajmi "TreguiPërbashkëtEuropian", OMBRA GVG, Tiranë, 2010.

Prospettive dell'occupazione dell'OCSE, edizione 2004, capitolo 2 "Regolamentazione della protezione dell'occupazione ed efficiacia del mercato del lavoro".

Case152-73, Giovanni Maria Sotigu v Deutche Budespost.

Gazzetta ufficiale delle Comunità europee, **"**Versione Consolidata del Trattato che Instituisce la Comunita Europea" art 39.

Regulation 1612/68 stipulated the implementation of term workers when the latter are nationals of member states, and this interpretation is widely used by the ECJ.

ECJ, 8 april 1976, Case 43/75 Gabrielle DefrennevsSociétéAnonymeBelge de Navigation Aérienne Sabena [1976] ECR 455 (Defrenne II).

ECJ, 12 february 1974 Case152-73, Giovanni Maria Sotigu v DeutcheBudespost.

ECJ, Case415/93 Union Royale Belge des Sociétés de Football Association ASBL v Jean-Marc Bosman (1995).

ZGJIDHJA NUMERIKE E NJË PROBLEMI JOLINEAR TË DOBËT QË MODELON LËKUNDJET NË LINJAT ELEKTRIKE

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë

Fakulteti i Shkencave Teknike

MSc.Valmir Bame, MSc. Oltiana Toshkollari

Departamenti i Matematikës/Departamenti i Shkencave Kompjuterike

valmirbame@gmai.com, o.toshkollari@gmail.com

ABSTRAKT

Në këtë artikull do të diskutojmë për lekundjet e telave të tensionit në linjat elektrike, me një pikë fikse dhe pika tjetër është e lidhur me një deshpot (e cila redukton lëkundjet krijuar nga faktorë të jashtëm, zakonisht të energjisë së erës).

Fjalët kyçe: *ekuacion, lëkundje, valë, numerike, kordë, koeficient*

Hyrje

Për shkak të dinamikës së problemeve nga fusha të ndryshme të shkencës që modelohen si ekuacione diferenciale me derivate të pjesshme, trajtimi i tyre zë një vend të rëndësishëm në matematikë. Në këtë studim do të trajtojmë zgjidhjen numerike të ekuacioneve diferenciale me derivate të pjesshme. në këtë punim do të përqendrohemi tek ekuacioni hiperbolik. Gjithashtu, kemi trajtuar zgjidhjen numerike të një problemi jolinear të dobët që modelon lëkundjet në linjat elektrike, kodin e ekzekutimit në Matlab dhe figurat përkatëse.

1. EKUACIONI HIPERBOLIK, NJË METODË E SHTJELLUR DHE NJË E PASHTJELLUR PËR ZGJIDHJEN NUMERIKE TË EKUACIONIT HIPERBOLIK

Trajta më e thjeshtë e ekuacionit hiperbolik është ajo që paraqet lëkundjet e lira të një korde homogjene të kufizuar. Ky quhet ekuacioni i valës dhe jepet nga:

$$\frac{\partial^2 u}{\partial t^2} - \frac{\partial^2 u}{\partial x^2} = 0 \qquad \text{në} \qquad D: \begin{cases} 0 \le x \le 1 \\ 0 < t \le +\infty \end{cases} \tag{1.1}$$

Me kushte fillestare

$$u(x,0) = f(x), \quad \frac{\partial u}{\partial t}(x,0) = g(x) \qquad 0 \le x \le l \tag{1.2}$$

Ku *f(x), g(x)* janë funksione të njohura

Dhe kushte kufitare

$$u(0,t) = \ddot{}\,(t),\ u(l,t) = \cdot\ (t)\ \ 0 < t \le +\infty$$

1.1 Një metodë e shtjellur dhe një e pashtjellur për zgjidhjen numerike të ekuacionit hiperbolik

Ekuacioni valës i *rendit të dytë* në hapësirën një përmasore ka trajtën:

$$\frac{\partial^2 u}{\partial t^2} = c^2 \frac{\partial^2 u}{\partial x^2} \tag{1.3}$$

ku *c* është një konstante pozitive dhe u(x,t) është i varur nga kushtet fillestare

$$u(x,0) = f(x), -\infty < x < \infty \ \text{ dhe}$$

$$u_t(x,0) = g(x), -\infty < x < \infty. \tag{1.4}$$

Zgjidhja analitike e dhënë nga *d'Alambert* që u zbulua më 1968 dhe është:

$$u(x,t) = \frac{1}{2}[f(x-ct) + f(x+ct)] + \frac{1}{2c}\int_{x-ct}^{x+ct} g(\,,\,)d\,,\ . \tag{1.5}$$

Metoda e shtjellur me diferencave të fundme për ekuacionin e valës të rendit të dytë është:

$$\frac{u_i^{j+1} - 2u_i^j + u_i^{j-1}}{k^2} = c^2 \frac{u_{i+1}^j - 2u_i^j + u_{i-1}^j}{h^2} \tag{1.6}$$

e cila mund të shkruhet si më poshtë:

$$u_i^{j+1} = 2u_i^j - u_i^{j-1} + r^2(u_{i+1}^j - 2u_i^j + u_{i-1}^j). \tag{1.7}$$

Me anë të kësaj skeme të shtjellur vlerat e *u*-së në një nivel *j+1* njehsohen me anë të vlerave të *u*-së në dy nivele *j* dhe *j*-1 si në **Figurën 1.**



Figura 1 Një skemë e shtjellur për ekuacionin hiperbolik

Një skemë e pashtjellur e ekuacionit të valës së rendit të dytë jepet si më poshtë:

$$\left(u_{i+1}^{j+1} - 2u_i^{j+1} + u_{i-1}^{j+1}\right) + 2\left(u_{i+1}^j - 2u_i^j + u_{i-1}^j\right) + \left(u_{i+1}^{j-1} - 2u_i^{j-1} + u_{i-1}^{j-1}\right) \tag{1.8}$$

$$= \frac{4}{r^2}\left(u_i^{i+1} - 2u_i^j + u_i^{j-1}\right)$$

i cili mund të rishkruhet si:

$$-u_{i-1}^{j+1} + 2\left(1 + \frac{2}{r^2}\right)u_i^{j+1} - u_{i-1}^{j+1} \tag{1.9}$$

$$= 2\left(u_{i+1}^j - 2\left(1 + \frac{2}{r^2}\right)u_i^j + u_{i-1}^j\right) + \left(u_{i-1}^{j+1} - 2\left(1 + \frac{2}{r^2}\right)u_i^{j-1} + u_{i-1}^{j-1}\right)$$



Figura 2 Një skemë e pashtjellur e ekuacionit hiperbolik

2. ZGJIDHJA NUMERIKE E NJË PROBLEMI JOLINEAR TË DOBËT QË MODELON LËKUNDJET NË LINJAT ELEKTRIKE

2.1 Modeli matematik

Le të jetë l gjatësia e linjës elektrike me densitet $°$ dhe me tension T. Marrim koefiçientin e shuarjes $\sim$ i cili bënë shuarjen e lëkundjeve të shkaktuara nga era. Supozojmë se kemi vetëm lëkundje sipas një drejtimi (po e marrim sipas drejtimit z). Shënojmë me $u(x,t)$ këtë lëkundje e cila tregon spostimin e telit të tensionit në pikën x në momentin e kohës t. Për thjeshtësi të problemit do të themi se:

- Shuarja e brendshme e kordës është e papërfillshme
- Densiteti $°$ është konstant në të gjithë gjatësinë e kordës
- Forca e erës F vepron në mënyrë uniforme përgjatë gjithë kordës dhe vepron në mënyrë jolineare
- Ekuacioni i zhvendosjes vertikale të kordës është:

$$° \tilde{u}_{tt} - T\tilde{u}_{xx} = -° g + F \tag{2.1}$$

- Me kushte:

$$\tilde{u}(0,t) = 0 \qquad \tilde{u}_t(0,t) = 0 \qquad T\tilde{u}_x(l,t) + \sim \tilde{u}_t(l,t) = 0 \tag{2.2}$$

Mund të tregohet se forca e erës mund të përafrohet me madhësinë:

$$F = \frac{° dv_\infty^2}{2}\left(a_{0+} \frac{a_1}{v_\infty}\tilde{u}_t + \frac{a_2}{v_\infty^2}\tilde{u}_t^2 + \frac{a_3}{v_\infty^3}\tilde{u}_t^3 \right) \tag{2.3}$$

Shpejtësia e rrymës uniforme e erës v_∞ dhe koefiçientët a_0, a_1, a_2, a_3 varen nga F (forca e erës). Për të thjeshtuar kushtet kufitare fusim transformimin e mëtejshem:

$$\tilde{u}(x,t) = \bar{u}(x,t) + g\frac{\overset{\circ}{}}{T}u_s(x) \tag{2.4}$$

Ku $u_s(x) = \frac{1}{2}x^2 - lx$ është zgjidhje e qëndrueshme e problemit (meqënëse është e pavarur nga koha).

Prej kesaj nxjerrim se: $u_s''(x) = 1$ dhe $u_s(0) = 0$

Pasi bëjmë këtë zëvëndësim do të kemi:

$$\circ\,\bar{u}_{tt} - T(\bar{u}_{xx} + \frac{\circ\, g}{T}) = -\circ\, g + F \tag{2.5}$$

Nga do të nxjerrim se:

$$\circ\,\bar{u}_{tt} - T\bar{u}_{xx} = F \tag{2.6}$$

Më pas fusim edhe variablat $\bar{x} = \frac{®}{l}x, \quad \bar{t} = ct, \quad v(\bar{x},\bar{t}) = \frac{c}{v_\infty}\bar{u}(x,t)$,

Duke bërë disa shndërrime si më poshtë tek ekuacioni (6):

$$\frac{d}{d\bar{t}}v(\bar{x},\bar{t}) = \frac{c}{v_\infty}\cdot\frac{d}{dt}\bar{u}(x,t)\cdot\frac{dt}{d\bar{t}} = \frac{1}{v_\infty}\cdot\frac{d}{dt}\bar{u}(x,t) = \frac{\bar{u}_t(x,t)}{v_\infty} \tag{2.7}$$

$$\frac{d}{d\bar{x}}v(\bar{x},\bar{t}) = \frac{c}{v_\infty}\cdot\frac{d}{dx}\bar{u}(x,t)\cdot\frac{dx}{d\bar{x}} = \frac{c\cdot l}{v_\infty\cdot ®}\cdot\sqrt{\frac{\circ}{T}}\cdot\bar{u}_x(x,t) \tag{2.8}$$

$$v_{\bar{t}\bar{t}}(\bar{x},\bar{t}) = \frac{\partial^2}{\partial\bar{t}^2}v(\bar{x},\bar{t}) = \frac{\partial}{\partial\bar{t}}\left[\frac{\partial}{\partial t}\bar{u}\left(x,t\right)\cdot\frac{\partial t}{\partial\bar{t}}\right]$$

$$v_{\bar{t}\bar{t}}(\bar{x},\bar{t}) = \frac{\partial^2}{\partial t^2}\bar{u}\left(x,t\right)\cdot\left(\frac{\partial t}{\partial\bar{t}}\right)^2 + \frac{\partial}{\partial t}\bar{u}\left(x,t\right)\cdot\frac{\partial^2 t}{\partial\bar{t}^2}$$

$$v_{\bar{t}\bar{t}}(\bar{x},\bar{t}) = \frac{\partial^2}{\partial t^2}v(\bar{x},\bar{t})\cdot\left(\frac{\partial t}{\partial\bar{t}}\right)^2 = \frac{1}{c^2}\cdot\frac{\partial^2}{\partial\bar{t}^2}\bar{u}\left(x,t\right)$$

$$v_{\bar{t}\bar{t}}(\bar{x},\bar{t}) = \frac{\bar{u}_{tt}\left(x,t\right)}{c^2} \tag{2.9}$$

$$v_{\bar{x}\bar{x}}(\bar{x},\bar{t}) = \frac{\partial^2}{\partial\bar{x}^2}v(\bar{x},\bar{t}) = \frac{\partial}{\partial\bar{x}}\left[\frac{\partial}{\partial x}\bar{u}\left(x,t\right)\cdot\frac{\partial x}{\partial\bar{x}}\right]$$

$$v_{\bar{x}\bar{x}}(\bar{x},\bar{t}) = \frac{\partial^2}{\partial x^2}\bar{u}\left(x,t\right)\cdot\left(\frac{\partial x}{\partial\bar{x}}\right)^2 + \frac{\partial}{\partial x}\bar{u}\left(x,t\right)\cdot\frac{\partial^2 x}{\partial\bar{x}^2} = \frac{\partial^2}{\partial x^2}\bar{u}\left(x,t\right)\cdot\left(\frac{\partial x}{\partial\bar{x}}\right)^2$$

$$v_{\bar{x}\bar{x}}(\bar{x},\bar{t}) = \left(\frac{l}{®}\right)^2 \cdot \frac{\partial^2}{\partial x^2} \cdot \bar{u}\left(x,t\right) = \left(\frac{l}{®}\right)^2 \bar{u}_{xx}\left(x,t\right)$$

$$v_{\bar{x}\bar{x}}(\bar{x},\bar{t}) = \left(\frac{l}{®}\right)^2 \bar{u}_{xx}\left(x,t\right) \tag{2.10}$$

Duke kryer disa zëvëndësime do të marrim:

$$\frac{® v_\infty \sqrt{T°}}{l}\left[\frac{\partial^2}{\partial t^2} v(\bar{x},\bar{t}) - T\frac{\partial^2}{\partial x^2} v(\bar{x},\bar{t})\right] = F \tag{2.11}$$

Ose e shkruar në një trajtë të njohur:

$$\frac{\partial^2}{\partial t^2} v(\bar{x},\bar{t}) - T\frac{\partial^2}{\partial x^2} v(\bar{x},\bar{t}) = \frac{F \cdot l}{® \cdot v_\infty \cdot \sqrt{T°}} \tag{2.12}$$

Sipas ekuacionit (3), ekuacioni (10) merr trajtën:

$$\frac{\partial^2}{\partial t^2} v(\bar{x},\bar{t}) - T\frac{\partial^2}{\partial x^2} v(\bar{x},\bar{t}) = \frac{d \cdot v_\infty}{2 \cdot c}\left(a_{0+}\frac{a_1}{v_\infty}\tilde{u}_t + \frac{a_2}{v_\infty^2}\tilde{u}_t^2 + \frac{a_3}{v_\infty^3}\tilde{u}_t^3\right) \tag{2.13}$$

Pasi do të zëvëndësojmë ekuacionin (7) tek ekuacioni (12) do të kemi:

$$v_{\bar{t}\bar{t}}(\bar{x},\bar{t}) - v_{\bar{x}\bar{x}}(\bar{x},\bar{t}) = \frac{d \cdot v_\infty}{2 \cdot c}\left(a_{0+}a_1 v_{\bar{t}} + a_2 v_{\bar{t}}^2 + a_3 v_{\bar{t}}^3\right) \tag{2.14}$$

Mund të tregojmë se me anë të një përafrimi, ky ekuacion merr trajtën:

$$v_{\bar{t}\bar{t}}(\bar{x},\bar{t}) - v_{\bar{x}\bar{x}}(\bar{x},\bar{t}) = \frac{a \cdot d \cdot v_\infty}{2 \cdot c}\left(v_{\bar{t}} + \frac{1}{3}v_{\bar{t}}^3\right) \tag{2.15}$$

Duke shënuar $£ = \frac{a \cdot d \cdot v_\infty}{2 \cdot c}$ do të kemi:

$$v_{\bar{t}\bar{t}}(\bar{x},\bar{t}) - v_{\bar{x}\bar{x}}(\bar{x},\bar{t}) = £ \cdot \left(v_{\bar{t}} + \frac{1}{3}v_{\bar{t}}^3\right) \qquad \text{(ku} \quad 0 < £ << 1) \tag{2.16}$$

Me anë të transformimit të Laplasit, ne mund të bëjmë një linearizim të këtij ekuacioni, për thjeshtësi pune në zgjidhjen e këtij problemi dhe përfundimisht do të kemi trajtën:

$$v_{\bar{t}\bar{t}}(\bar{x},\bar{t}) - £ \cdot v_{\bar{t}} - v_{\bar{x}\bar{x}}(\bar{x},\bar{t}) = 0 \tag{2.17}$$

Për sa i përket kushteve kufitare edhe ato do të pësojnë të njëjtat transformime:

$$v(0,\bar{t}) = 0 \tag{KK1}$$

$$v_{\bar{x}}(®,\bar{t}) + \sim \cdot £_1 \cdot v_{\bar{t}}(®,\bar{t}) = 0 \quad v(0,\bar{t}) = 0 \qquad v(0,\bar{t}) = 0 \tag{KK2}$$

Ku duhet të përcaktohen edhe kushtet fillestare:

$$v(\bar{x},0) = ¤\left(x\right) \tag{KF1}$$

$$v_{\bar{t}}(\bar{x},0)=\Psi\left(\bar{x}\right) \qquad \text{(KF2)}$$

2.2 Zgjidhja numerike

Le të shprehim në mënyrë numerike (me anë të metodës së diferencave të fundme):

$$u_{\bar{t}\bar{t}}=\frac{u\left(x,t-1\right)-2u\left(x,t\right)+u\left(x,t+1\right)}{k^2}-\frac{k^2}{12}\frac{\partial^4 u}{\partial \bar{t}^4}\left(x_i,\text{¦}_j\right)$$

(2.18)

Ku $\frac{k^2}{12}\frac{\partial^4 u}{\partial \bar{t}^4}\left(x_i,\text{¦}_j\right)$ është një gabim i vogël, i cili mund të neglizhohet, prandaj mund të themi se:

$$u_{\bar{t}\bar{t}}=\frac{u\left(x,t-1\right)-2u\left(x,t\right)+u\left(x,t+1\right)}{k^2} \qquad (2.18')$$

$$u_{\bar{x}\bar{x}}=\frac{u\left(x-1,t\right)-2u\left(x,t\right)+u\left(x+1,t\right)}{h^2}-\frac{h^2}{12}\frac{\partial^4 u}{\partial \bar{x}^4}\left(\text{¶}_i,y_j\right) \qquad (2.19)$$

Ku $\frac{h^2}{12}\frac{\partial^4 u}{\partial \bar{x}^4}\left(\text{¶}_i,y_j\right)$ është një gabim i vogël, i cili mund të neglizhohet, prandaj mund të themi se:

$$u_{\bar{x}\bar{x}}=\frac{u\left(x-1,t\right)-2u\left(x,t\right)+u\left(x+1,t\right)}{h^2} \qquad (2.19')$$

Në rastin e përgjithshëm, për derivatet e pjesshme të rendeve të para do të kemi diferenca të fundme nga para dhe nga pas. Sipas rastit, ne do të zgjedhim atë që do të na interesoj.

2.3 Metoda e diferencave te fundme nga para

$$u_{\bar{t}}=\frac{u\left(x,t+1\right)-u\left(x,t\right)}{k}-\frac{k}{2}\frac{\partial^2 u}{\partial \bar{t}^2}\left(x_i,t_j+{}^{-}{}_j k\right)$$

(2.20)

Ku $\frac{k}{2}\frac{\partial^2 u}{\partial \bar{t}^2}\left(x_i,t_j+{}^{-}{}_j k\right)$ është një gabim i vogël, i cili mund të neglizhohet, prandaj mund të themi se:

$$u_{\bar{t}}=\frac{u\left(x,t+1\right)-u\left(x,t\right)}{k} \qquad (2.20')$$

$$u_{\bar{x}}=\frac{u\left(x+1,t\right)-u\left(x,t\right)}{h}-\frac{h}{2}\frac{\partial^2 u}{\partial \bar{x}^2}\left(x_i+\text{«}_i h,t_j\right) \qquad (2.21)$$

Ku $\frac{h}{2}\frac{\partial^2 u}{\partial \bar{x}^2}\left(x_i+\text{«}_i h,t_j\right)$ është një gabim i vogël, i cili mund të neglizhohet, prandaj mund të themi se:

$$u_{\bar{x}} = \frac{u(x+1,t) - u(x,t)}{h}$$

2.4 Metoda e diferencave te fundme nga pas

$$u_{\bar{t}} = \frac{u(x,t) - u(x,t-1)}{k} - \frac{k}{2}\frac{\partial^2 u}{\partial \bar{t}^2}\left(x_i, t_j + {}^{-}{}_j k\right) \qquad (2.22)$$

Ku $\frac{k}{2}\frac{\partial^2 u}{\partial \bar{t}^2}\left(x_i, t_j + {}^{-}{}_j k\right)$ është një gabim i vogël, i cili mund të neglizhohet, prandaj mund të themi se:

$$u_{\bar{t}} = \frac{u(x,t) - u(x,t-1)}{k} \qquad (2.22')$$

$$u_{\bar{x}} = \frac{u(x,t) - u(x-1,t)}{h} - \frac{h}{2}\frac{\partial^2 u}{\partial \bar{x}^2}\left(x_i + «_i h, t_j\right) \qquad (2.23)$$

Ku $\frac{h}{2}\frac{\partial^2 u}{\partial \bar{x}^2}\left(x_i + «_i h, t_j\right)$ është në gabim i vogël, i cili mund të neglizhohet, prandaj mund të themi se:

$$u_{\bar{x}} = \frac{u(x,t) - u(x-1,t)}{h} \qquad (2.23')$$

Nga transformimet që kemi bërë le të zëvëndësojmë (17'), (18') dhe (21') tek ekuacioni (16) dhe ai do të marrë trajtën

$$\frac{u(x,t-1) - 2u(x,t) + u(x,t+1)}{k^2} - £\frac{u(x,t+1) - u(x,t)}{k} - \frac{u(x-1,t) - 2u(x,t) + u(x+1,t)}{h^2} = 0 \qquad (2.24)$$

$$u(x,t+1) = \frac{k^2}{h^2}\left[u(x-1,t) + u(x+1,t)\right] - \left(\frac{2\cdot k^2}{h^2} - 2 + £\cdot k\right)u(x,t) - (1 + £\cdot k)\cdot u(x,t-1) \qquad (2.24')$$

Me kushte fillestare:

$$u(x,0) = ¤(x) \qquad \text{(KF1)}$$

$$u(x,1) - u(x,0) = dt * \Psi(x) \quad \text{ose ndryshe} \quad u(x,1) = dt * \Psi(x) + ¤(x) \qquad \text{(KF2)}$$

Dhe me kushte Kufitare:

$$u(0,t) = 0 \qquad \text{(KK1)}$$

$$v(®, \bar{t} + 1) = \frac{d\bar{t}}{\sim \cdot £_1 \cdot dx} \cdot v(® - d\bar{x}, \bar{t}) + (1 - \frac{d\bar{t}}{\sim \cdot £_1 \cdot dx} + 1) \cdot v(®, \bar{t}) \qquad \text{(KK2)}$$

3. PËR TË PARË SE Ç'NDODH ME TELIN E TENSIONIT, MË KONKRETISHT LE TË PERDORIM KODIN E SIMULIMIT TE KËTIJ PROÇESI NË MATLAB:

```
%** Ky eshte kodi i cili modelon lekundjet e telave te tensionit me nje skaji te fiksuar **%
dx=.01;
dt=.001;                % Koha e një hapi
c = 1;                  % Shpejtësia e zërit
L = 4;                  % Gjatesia e kordes
 stopTime = 30;         % Koha e vezhgimit te procesit ne sekonda
 r = c*dt/dx;       % r eshte nje variabel qe tregon nje shprehje numerike
 n = L/dx + 1;      % numri i nyjeve ne te cilat behet studimi
 x=pi*[0:dx:L]/L;   % konvertimi i gjatesise [0:L] ne [0,pi]
 eps=0.0001;        % koeficienti i deshpotit
 current=0.0004*cos(2*x);
 past=0.0002*cos(2*x);
for  t=0:dt:stopTime    % Llogarit pozicionin pasardhës të valës
future(1)=0;            % zhvendosja e kordes ne nyjen 1, ne momentin e
kohes 't+1'
future(2:n-1)=r^2*(current(1:n-2)+current(3:n))-2*(r^2-
1+eps*dt/2)*current(2:n-1)-(1+eps*dt)*past(2:n-1);
            % zhvendosja e kordes ne nyjen 2 deri ne nyjen e 'n-1',
            % ne momentin e kohes 't+1'
future(n)=eps*current(n)+(1-eps)*current(n-1);
% zhvendosja e kordes ne nyjen n, ne momentin e kohes 't+1'
past=current ;
current=future ;        % Krijimi i grafikut
if mod(t/dt,10) == 0
plot ([0:dx:L],current)
axis([0 L -2 2])
pause (.001)
end
end
```



Figura 3. Simulimi në Matlab

Konkluzione

Në këtë punim trajtuam zgjidhjen numerike të ekuacioneve diferenciale me derivate të pjesshme të tipit hiperbolik i cili kishte kuptim për $0 < \varepsilon << 1$ ($\varepsilon \approx 0$) ashtu siç mund të themi se funksioni që trajtuam nuk ka kuptim për $\varepsilon \geq 1$. Bazuar në metodën me diferenca të fundme u përqëndruam në rastin e ekuacionit hiperbolik në trajtën e shtjellur. Në metodën e shtjellur për arsye se llogaritjet e vlerave të një niveli mund të kryhen vetëm në varësi të vlerave të një niveli më poshtë, pra të pavarura atëherë këto mund të përshtaten shumë mirë për tu llogaritur në procese të ndryshme. Nga ekzekutimi i kodit numerik të problemit në Matlab vërejmë se lëkundja e telit të tensionit me kalimin e kohës shuhet në varësi të koeficientit të deshpotit.

Referenca

[1] Analizë Numerike në ekuacionet me derivate të pjesshme; Lulëzim Hanelli, Flora Osmani.

[2] Numerical Analysis; Seventh Edition, Richart L. Burden, J.Douglas Faires.

[3] Numerical solution of partial differential equations; Dr. Louise Olsen-Kettle.

[4] Spectral Methods for Hyperbolic Problems; Eitan Tadmor.

[5] Hyperbolic Functions; Amy L. Shutz, Jim Leëis, Livia Miller.

[6] Sequential and Paralel Methods for solving First-Order Hyperbolic Equations; M. A. ARIGU, E.H. TËIZELL, A.B. GUMEL.

“TE NXËNIT E BAZUAR NË PROBLEME: ÇFARË DHE SI E MËSOJNË STUDENTËT ANGLISHTEN PROFESIONALE?”

PhD. Veneranda Hajrulla
Department of Foreign Language Teaching
University “Ismail Qemali”
Albania
e-mail: venerandahajrulla@yahoo.com

ABSTRAKT

Kërkimet mbi metodën e organizimit dhe prezantimit të kurrikulës së gjuhës së huaj nxjerrin në pah nevojën për ndryshim. Konteksti historik dhe teorik na drejton te qasja mësimore e të Mësuarit të Bazuar në Probleme, si një alternativë efektive. MBP është një strategji e shkëlqyer, sepse ka potencialin e përfshirjes së studentëve në aktivitete të përbashkëta që ofrojnë reagime të menjëhershme duke përforcuar përmbajtjen gjuhësore. Koncepti qëndror i MBP është të mësuarit e përmbajtjes në po të njëjtën mënyrë si përmes leksionit, duke u përpjekur të zgjidhin probleme të profesionit të ardhshëm.

Me këtë studim u përpoqëm të përshkruajmë përdorimin e MBP[1] në klasat e AQP[2] duke përcaktuar përmirësimet në aftësitë gjuhësore të studentëve, sa i dukshëm është ky përmirësim në aftësitë gjuhësore profesionale, që gjatë procesit të MBP përforcohen përmes dinamikës së grupit, realitetit të vendit të punës, njohurive të përmbajtjes. Të gjitha rezultatet e këtij studimi treguan se përdorimi i MBP motivoi në mënyrë praktike, efektive, përfshirëse, aftësitë gjuhësore me gojë dhe me shkrim të studentëve, duke i lënë vend rekomandimeve për kurrikulën në të ardhmen.

Fjalë Kyçe:
Të Mësuarit e bazuar në probleme, të mësuarit e vetëdrejtuar, lehtësues, probleme të formuluara keq, dinamika e grupit, zgjidhja e problemeve,

[1] MBP (Të Mësuarit e Bazuar në Probleme)
[2] AQP (Anglishte për Qëllime Profesionale)

1. Hyrje

Objekt i këtij studimi është përdorimi i të Mësuarit të Bazuar në Probleme (MBP) në mësimin e gjuhës angleze. Qëllimi i studimit është të hulumtojë si dhe sa ndikon përdorimi i MBP në rritjen e aftësive gjuhësore në një klasë të Anglishtes për Qëllime Profesionale. (AQP) Studimi merr përsipër t'u japë përgjigje pyetjeve të mëposhtme kërkimore:

- *Pyetja e parë:* A përmirësohen aftësitë gjuhësore të studentëve nga përdorimi i MBP në klasat e AQP?
- *Pyetja e dytë:* Cilat aspekte të aftësive gjuhësore të studentëve përmirësohen në mënyrë të konsiderueshme gjatë përdorimit të MBP në klasat e AQP?
- *Pyetja e tretë:* Si i përgjigjen studentët përdorimit të MBP në mësimin e AQP?

1.1 Metodologjia e studimit

Ky studim është i tipit cilësor. Studimi bazohet në tri metoda që garantojnë trekëndëzimin: anketimi, studimi i rastit, vëzhgimi. Hulumtimi kalon në disa faza. Në fazën e parë kryhet studimi dhe paraqitja e kuadrit teorik, Në fazën e dytë mblidhet informacioni nëpërmjet metodave dhe instrumenteve të përcaktuar. Në fazën e fundit përpunohet, analizohet dhe interpretohet informacioni i mbledhur. Projekt-kërkimi mori formatin në vijim:

Tabela 1.1 ***Projekt – kërkim***

Fokusi kërkimor
⇩
Korniza teorike
⇩
Studim pilot
⇩
Pyetësori i popullatës
⇩
Subjektet
⇩
Ese e shkruar
⇩
Mbledhja e të dhënave
⇩
Analiza e të dhënave

Tabela 1.1 përshkruan Projekt - kërkimin. Në të shpjegohet si filloi hulumtimi me një fokus kërkimor për kuadrin teorik. Pas kësaj janë pilotuar instrumentet. Më pas u përcaktua popullata, u përzgjodh kampioni i studimit. Për mbledhjen e të dhënave u përdorën instrumente të ndryshëm. Projekt-kërkimi përfundoi me një analizë të të dhënave të grumbulluara.

1.2 Përfitimet që sjell MBP në aftësitë gjuhësore të studentëve

Pyetja e parë kërkimore: A përmirësohen aftësitë gjuhësore të studentëve nga përdorimi i MBP në klasat e AQP? Kërkimi u përqëndrua në përfitimet që sjell MBP në aftësitë gjuhësore të studentëve, të dhënat për këtë janë marrë përmes prezantimit të një problemi të strukturuar keq. U gjet se studentët kishin përfituar në aspektet e mëposhtme gjuhësore:

1.2.1 *Aftësia* për të vendosur *shkrimin* e përgjigjes ndaj ankesës

Aspekti i parë që tregon se studentët kanë përfituar përmes MBP, ishte të qenit të aftë për të arritur në përfundimin, se u duhej të shkruanin një letër si përgjigje ndaj njërit prej ankuesve, pas zgjidhjes së problemit të strukturuar keq. Ky *vendim* për të shkruar këtë letër erdhi natyrshëm, nëpërmjet procesit të zgjidhjes së problemeve, nisur nga problemi i keqstrukturuar në MBP. Ky rezultat mbështetet nga Bosher dhe Smalkosli [3]- vetë studentët vendosin mbi llojin e veprimit që duhet ndërmarrë pas përfundimit të çdo detyre.

Vendimi për të shkruar këtë *Letër* drejtuar ankuesit, ishte në vetvete një arritje, pasi ajo tregoi se studentët kishin kuptuar mjaftueshëm problemin dhe situatën, për të konkluduar *se përgjigjja* ndaj ankuesit *ishte një zgjidhje e përshtatshme dhe e nevojshme.* Kjo letër tregoi se përdorimi i MBP kishte përmirësuar aftësitë e të shkruarit në veçanti, dhe ato gjuhësore në përgjithësi, në klasën e anglishtes për qëllime profesionale AQP.

Në lidhje me këtë, Zhonglei [4] dhe Dunlap [5] përforcojnë se studentët në MBP, marrin nismën për të gjetur zgjidhjet e mundshme për problemet, nëpërmjet
zbulimit të njohurive të reja, duke u përfshirë në situatat e të mësuarit të vetëorientuar e të pavarur.

1.2.2 *Aftësia* për të shkruar *përgjigjen e ankesës*

Aftësia e studentëve për të shkruar letrën ndaj ankesës, si pjesë e përgjigjes së grupit për zgjidhjen e problemit të ndërtuar keq, tregoi se përdorimi i MBP kishte përmirësuar *aftësitë gjuhësore të studentëve* në AQP . Këta studentë nuk ishin mësuar se si të shkruanin një letër, as nuk ishin informuar se çfarë do të përfshinte përmbajtja e letrës si përgjigje ndaj ankesës. Kjo, në MBP, është e njohur si '*boshllëk njohurish*' dhe nëpërmjet kalimit në procesin e MBP mundësohet *mbushja* e këtij *boshllëku*. Këta studentë u përfshinë kështu *në të nxënit e vetëdrejtuar.*

---

[3] Bosher & Smalkosli (2002)
[4] Zhonglei (2004)
[5] Dunlap (2005)

2. Diskutim mbi përparimin e përgjithshëm të studentëve

Fakti se studentët ishin në gjendje të arrinin në përfundimin se, një prej zgjidhjeve të problemit, ishte përgjigjia zyrtare, me shkrim, ndaj klientit/firmës që kishte parashtruar ankesën, tregoi se përdorimi i MBP kishte sjellë përfitime në aftësitë e tyre gjuhësore. *Të shkruarit e përgjigjes me formatin e duhur, me përmbajtjen e saktë, me një gjuhë e strukturë shumë më efektive se në para test, ishte me të vërtetë një përmirësim mjaft i arrirë.*

Gjatë procesit të mbërritjes në këtë zgjidhje dhe shkrimit të përgjigjes, studentët u përfshinë në mënyrë të pavetëdijshme në procesin njohës të kërkimit të njohurive për të mbushur boshllëkun e tyre për këtë lloj dije. Këta studentë kërkuan njohuritë e fakteve specifike të cilat ndihmuan që ata të njohin, të fitojnë dhe të identifikojnë informacionin faktik që ishte lidhur me çështjen e të kuptuarit të problemit. Përveç kësaj, njohuritë renditëse iu mundësuan atyre të njohin dhe të identifikojnë zhvillimet, sekuencat, marrëdhënien shkak - pasojë në zgjidhjen e problemit, njohuritë e interpretimit. Të qenit analitik, ndihmoi në deduksionin e deklaratatave dhe argumenteve.

Me pak fjalë, nevoja për të arritur në një zgjidhje në këtë situatë me bazë problemi, i solli studentët në procesin e ndërtimit të njohurive; u plotësuan mangësitë si dhe aftësitë e nevojshme në zgjidhjen e problemeve. Më e rëndësishmja, kjo metodë e të mësuarit në një situatë të simuluar u mundësoi studentëve të kuptojnë nevojën për t'u përgjigjur siç duhet, dhe kjo ishte t'i përgjigjeshin zyrtarisht një ankese.

2.1 Përmirësimet në *aftësitë e shkruara* gjuhësore.

Aftësitë gjuhësore të studentëve të cilat kishin përfituar nga MBP u panë në gjuhën e përdorur në Letrën e Përgjigjes ndaj problemit të formuluar keq, drejtuar parashtruesit të ankesës.

Aspektet e aftësive gjuhësore që studentët kishin përmirësuar në këtë letër ishin:

- numri i përgjithshëm i fjalëve,
- numri mesatar i fjalëve në fjali,
- numri i përgjithshëm i fjalive të tilla si: fjali të thjeshta, fjali të përbëra, dhe fjalori.

Të dhënat mbi *pyetjen e dytë* kërkimore *Cilat aspekte të aftësive gjuhësore të studentëve përmirësohen në mënyrë të konsiderueshme gjatë përdorimit të MBP në klasën e AQP?* u morën përmes përdorimit të instrumenteve të tilla si paratest dhe pastest, nga një listë verifikimi e vëzhgimeve të përmirësimeve në aftësitë e gjuhës së folur. U konstatua se studentët kishin përmirësuar ndjeshëm jo vetëm aspektet gjuhësore **të shkrimit,** por edhe dhe **të të folurit**.

Aspektet **gjuhësore të shkrimit** që u përmirësuan dukshëm, ishin ***gramatika, shenjat e pikësimit, fjalori dhe shprehjet, aspektet retorike***. Krahasimi i pikëve të fituara prej tyre në letrat paratest dhe pastest janë përmbledhur në Tabelen 1.2 më poshtë:

Tabela 2.1: Pikët e mbledhura nga përgjigjet para dhe pas test.

Nr	Aftësi Gjuhësore	Pikët									
		studenti 1		studenti 2		studenti3		studenti 4		studenti 5	
		Para test	Pas test	Para test	Pas Test	Para test	Pas test	Para test	Pas test	Para test	Pas test
1	Gramatikë	3	5.5	0	1.5	3	6.5	7	7	1	2
2	Drejtshkrimi	4	4.5	4.5	4	4.5	4.5	4.5	4.5	5	4
3	Pikësimi	4.5	4.5	4.5	4	4.5	4	2.5	5	4.5	4
4	Fjalori dhe Shprehjet	6	10	8	8	3.5	10	8	10	7	6
5	Aspektet Retorike (a)Bindëse & Të besueshme (b)Të qarta & Të përshtatshme	6 1.5	8 1.5	7 1	8 0.5	5 1	7 1.5	6 1	7.5 1.5	2.5 1	5.5 1
	Totali	25	34	25	26.5	21.5	33	29	35.5	21	22.5

Aspektet gjuhësore të shkrimit që u përmirësuan dukshëm pas përdorimit të MBP në klasën e AQP, janë si më poshtë:

(a) Gramatika

Studentët 1 dhe 3, bënë përmirësime të dukshme në aspektin gramatikor duke shënuar më shumë se 20 për qind të pikëve në pastest. Përmirësimet tek studentët 2 dhe 5 kanë qenë të parëndësishme, sepse shkonin më pak se 20 për qind. Pati shumë gabime gramatikore në letrat e tyre pastest. Studentja 4, niveli gjuhësor i së cilës ishte i përparuar, nuk

regjistroi asnjë përmirësim. Ajo mori të njëjtat pikë, si për paratestin, ashtu edhe për pastestin. Në ndërtimin gramatikor të fjalive, u vërejt se fjalitë e letrave pas test të studentëve, ishin në formën veprore, në vend të pësores dhe si të tilla, lexoheshin më lehtë, kishin më pak gabime. Sipas Lawrence & Tebeaux (1982)[6], fjalitë aktive janë më të drejtpërdrejta, më të shkurtuara pasi në to përdoret rendi i zakonshëm, kryefjalë-folje-kundrinor. Ato janë të shkurtra, të thjeshta për t'u ndërtuar dhe më afër anglishtes së folur.

Kjo shpjegon gabimet e pakta gramatikore të gjetura në letrat e studentëve, pra, kishin bërë përmirësime të dukshme në pastestet e tyre. Fjalitë aktive theksonin emrin, ndërsa fjalitë e pësores theksonin foljen. Përveç kësaj, fjalitë pësore kishin fraza parafjalore dhe kryefjalët e fjalive u zhdukën nga pozicionet e tyre fillestare në fjali. Prandaj Wainwright thekson se shkrimtarët "kurrë nuk duhet të përdorin pësoren" dhe shton se "kjo ndodh sepse përdorimi i pësores " është me kosto , sjell humbje potenciale të qartësisë, sidomos nëse lexuesi nuk është efikas " (1994: 8).[7]

Krahas kësaj, çdo fjali duhet të përbëhet nga një kryefjalë dhe çdo paragraf duhet të jetë i kufizuar në diskutimin e një teme të vetme. Disa prej studentëve, sidomos studentët 2 dhe 5, nuk përcaktonin dot temën kryesore të fjalive të tyre para se t'i formulonin ato, si rezultat, shumë prej fjalive të tyre përmbanin disa mendime.

Fokusi i studentëve duhet të jetë mbi lexuesin dhe problemet e tij, duke ndihmuar atë të kuptojë letrën me fjali të thjeshta dhe të shkurtra. Fjalitë në përgjigjet e studentëveve duhet të synojnë realizimin e mesazhit qëllimor, dhe rregullimi i kujdesshëm i pjesëve përbërëse të fjalive, në mënyrën e rendin e duhur, do të garantonte një mesazh të qartë e të plotë.

(a) Shenjat e pikësimit

Nuk pati përmirësime në shenjat e pikësimit, me përjashtim të studentes 4, e cila bëri përmirësim të dukshëm. Ajo nuk bëri gabime pikësimi në pastest. Pikësimi është një komponent i rëndësishëm në shkrimin e letrave.

Letrat luajnë një rol të spikatur në projektimin e imazhit të çdo organizate, por letrat që ishin plot me gabime pikësimi, ose portretizonin një imazh negativ të organizatës, ose shkaktonin keqkuptim mesazhi . Wainwright (1994)[8] arsyeton që zgjedhja e fjalive të shkurtra krahasuar me ato të gjata do të minimizonte gabimet e pikësimit e të drejtshkrimit.

(b) Fjalori dhe shprehjet

---

[6] Lawrence & Tebeaux (1982).
[7] Wainwright (1994: 8).
[8] Wainwright (1994).

Siç mund të shihet nga tabela, studentët 1 dhe 3 patën përmirësime të konsiderueshme në fjalor dhe shprehje, studenti 3 pati ndryshimin më të madh të pikëve që ishte gjashtë e gjysmë, ndërmjet paratestit e pastestit. Studenti 1 u përmirësua me katër pikë. Studenti 3 përdori fjalor dhe shprehje më të përshtatshme në pastest në krahasim me paratestin e tij, i cili ishte fjalëshumë, me përsëritje dhe mungonin shprehjet e nevojshme.

Në përgjigjet ndaj ankesave, është e rëndësishme që shkrimtari të shkruajë duke përdorur fjalorin e duhur, të pasuruar me shprehje efektive që do të përcillte mesazhin e nevojshëm te ankuesi. Në të kundërt, ky i fundit mund të keqinterpretojë veprimet e shkrimtarit.

Studentja 4, gjithashtu mori pikë të plota në pastest (dhjetë pikë), por përmirësimi i saj nuk ishte i konsiderueshëm pasi duke qenë me një nivel të mirë gjuhësor, pikët e saj në paratest ishin gjithashtu të larta (tetë). Ndryshimi mes para testit e pastestit ishte dy pikë, si rrjedhojë nuk ishte shumë i rëndësishëm. Studentja 5, e cila nuk arriti të bëjë ndonjë përmirësim, mori pikët më të ulëta në pastestin e saj (shtatë pikë), në krahasim me para testin (gjashtë). Studentja 3, ishte e vetmja e cila në pastest kishte pikët më të ulëta se sa në paratest. Në paratest, ajo përdori fjalë jashtë kontekstit dhe fraza të gabuara. Probleme të njëjta u gjetën edhe në pastestin e shkruar prej saj, duke ndikuar në kredibilitetin e letrës së saj.

(c) Aspektet retorike

Kjo aftësi gjuhësore e cila u nda në dy aspekte, dëshmoi përmirësime të konsiderueshme në *aspektin e besueshmërisë e bindjes*. Aspektet retorike referuar gjuhës dhe shprehjeve të përdorura, vendosën besimin, duke njohur shqetësimin, duke shprehur sinqeritetin me fjalë e fraza me tone pozitive, me gjuhë mirëkuptimi.

- ***Bindës e të besueshëm***

Të gjithë studentët shënuan pikë të larta për motivet bindëse dhe besueshmërinë në komponentët retorike, në pastestet e tyre. Studentët 1, 3 dhe 5, përmirësuan ndjeshëm në këtë drejtim, sidomos studentja 5 me diferencën më të lartë të pikëve ndërmjet paratestit (dy pikë e gjysmë) dhe pastestit (pesë pikë). Përmirësimet e studentëve 2 dhe 4 ishin të parëndësishme. Letra e studentët 2 ishte shumëfjalëshe, andaj ishte e vështirë të ndiqje argumentet e saj. Nëse ajo nënkuptonte që, për arsye theksimi, ose ndonjë shkak tjetër, letra duhej të ishte me shumë fjalë, ky vendim mund të pezmatonte lexuesit.

Spikati mjaft gjuha përfshirëse si "*ne" dhe " për ne*", për të nxitur përfshirjen krahas faljes, e pranimit të gabimeve që kishte bërë kompania. Kjo dha një ndjenjë të vërtetë keqardhjeje nga ana e tyre për gabimet e bëra.

Ata shkruan me besueshmëri duke dhënë prova të forta, paraqitën pikat e tyre dhe zgjidhjet për problemet e ankuesit nëpërmjet arsyetimit logjik (që ishte pranimi i gabimeve) , duke shpjeguar se si kishin ndodhur dhe si do t'i ndreqnin problemet. Wainwright ka pohuar se për të qenë bindës dhe efektivë, studentët

duhet të sigurohen që letrat e tyre të jenë "të thjeshta, pozitive, aktive e konçize" (1994: x)[9].

Grafiku 2.1 i përmirësimeve gjuhësore *para* dhe *pas* **MBP**, në shkrimin e letrave, sipas leximit të **tabelës 2.1**



3. Përmirësime domethënëse në aftësitë gojore gjuhësore.

Aspektet gojore, që u përmirësuan ndjeshëm përmes MBP. Po i rendisim më poshtë.

(a) Gjuha e përdorur gjatë komunikimit me anëtarët e grupit

U konstatua se studentët filluan diskutimin e ideve të tyre duke përdorur gjuhën shqipe dhe askush në grup nuk bëri ndonjë përpjekje për të kontrolluar apo kujtuar njëri-tjetrin për të folur në gjuhën angleze. Megjithatë, u vërejt se ndërsa diskutimet përparonin, studentët përdornin më shumë anglisht në diskutime dhe në fund të zgjidhjes së detyrës problemore, të gjithë studentët flisnin në gjuhën angleze. Anglishtja e folur ishte fillimisht, e kufizuar në fjalë që u zhvilluan gradualisht në fraza dhe fjali të shkurtra. Më pas përparuan ngadalë duke folur më shumë në gjuhën angleze dhe me fjalitë e duhura edhe pse të cënuara nga gabimet gramatikore. *Ky ishte hapi më i rëndësishëm në përmirësimin e aftësive gojore gjuhësore,* dhe kjo mund t'i atribuohet rritjes së besimit ndërsa punonin përmes procesit të MBP për zgjidhjen e problemeve. *Allen (1996)* [10]*shpjegon se mësimi bëhet i qëllimshëm, kur njohuria është e integruar me aftësitë e komunikimit.*

[9] (Wainwright, 1994: x).
[10] Allen (1996).

Duhet përmendeur se ne ***në asnjë moment nuk u treguam studentëve*** se çfarë gjuhe të përdornin në diskutime, por ishte i tërë procesi i MBP në klasë që çoi studentët të vendosnin se cila gjuhë duhej përdorur. Ekspozimi i tyre ndaj MBP për zgjidhjen e detyrës problemore në klasën e AQP, kishte sjellë përmirësimin në aftësitë e tyre gjuhësore, veçanërisht, kur duke komunikuar në gjuhën angleze, përdornin shprehje të përshtatshme gjuhësore, karakteristike të kësaj gjuhe.

(b) Efektshmëria në aftësitë gjuhësore gojore

Teksa procesi i MBP përparonte, u vërejt se studentët kishin vështirësi për t'u shprehur në gjuhën angleze. Studentët, që ishin në *nivelin e ndërmjetëm,* përjetuan përmirësim të konsiderueshëm në *nivelin komunikativ* gjuhësor, ndërsa ata që kishin një komandë *më të mirë të gjuhës,* fituan *më shumë besim*.

Përpjekjet e studentëve gjatë bashkëbisedimit në gjuhën angleze nuk u frenuan nga fakti se fjalitë e tyre ishin me gabime gramatikore. Shumica e gabimeve ishin në përshtatshmërinë *kryefjalë-folje* si shembujt e mëposhtëm në fjalitë e tyre. Studenti 4, është shprehur "we ... maintains good business relationship with them ...", dhe studenti 3 ka shqiptuar "... we promotes the product ..." apo "... the problem resolve ...". Të tjera gabime gramatikore janë gjetur në përdorimin e kohëve të kryera , ku mungonin *ose format apo folja "be"* ose *foljet e veprimit* nuk ishin *në formën pjesore*.

Megjithatë, këto gabime nuk ndikuan në transmetimin e mesazhit të paracaktuar nga studentët, pasi ishin në gjendje të kuptonin njëri-tjetrin. Fakti që studentët kryen diskutime në gjuhën angleze ishte një arritje e rëndësishme në vetvete pasi fliste shumë per besimin e vendosmërinë që shfaqnin studentët për të përmirësuar veten.

4. Përgjigjet e studentëve për përdorimin e MBP në të mësuarit e AQP

Të dhënat për ***pyetjen e tretë*** të kërkimit *Si i përgjigjen studentët përdorimit të MBP në mësimin e AQP?*), u mblodhën përmes formave të ndryshme: listëkontrollit, formularëve të vetëvlerësimit, të vlerësimit në grup, formularëve të vlerësimit, listës së plotë të aftësive të përgjithshme, shkrimit të regjistrave të identifikimit të problemit. Të dhënat treguan se studentët reaguan pozitivisht ndaj përdorimit të MBP, veçanërisht në aftësitë e përgjithshme të tilla si:

- ***aftësitë ndërpersonale***
- ***aftësitë e vetëmenaxhimit***
- ***aftësitë e komunikimit***
- ***aftësitë e zgjidhjes së problemeve.***

Gjetjet nga vetëvlerësimet bënë të ditur se të gjithë ju përgjigjën pozitivisht përdorimit të MBP, sepse ranë dakord që t'ua rekomandonin këtë metodë të

mësuari miqve të tyre. Studenti 1 tha se MBP e bënte të mësuarit interesant dhe kjo u mundësonte studentëve të fitonin njohuri dhe përvojë. Kjo pikëpamje u mbështet nga studentja 5. Studenti 1 përdori këtë mundësi për të transferuar informacionin nga lëndët e tjera në Menaxhimin e Biznesit.

Transferimi i informacionit është një karakteristikë e MBP, ku informacioni paraprak ose njohuritë paraprake përdoren për të shërbyer si udhëzues për ndërtimin e njohurive të reja e të pavarura. Nga vlerësimet, u zbulua se kjo detyrë problemore mundësoi studentët të përdorin disa nga aftësitë dhe qëndrimet e tyre. MBP ndihmoi studentët të shohin nevojën për të kuptuar se çfarë u duhej të sillnin në diskutime për t'i ndihmuar të zgjidhnin problemin.

Montgomery, Bull dhe Kimball (1999)[11],argumentojnë se përvojat e të mësuarit mbështesin ndërveprimin mes studentëve, diskutimet dhe shkëmbimin e njohurive përkatëse. Tan (2003) [12]thekson se ***shkaku kryesor pse rekomandohet MBP në kurrikulat e ndryshme, është fakti se në MBP, të mësuarit bëhet pa kufij.*** Pra, studentët ushtrojnë veten se si të mësojnë përmes përafrimit të kësaj qasjeje reale me të mësuarit e pavarur.

I tërë **procesi i MBP i** përfshiu studentët në:

- vendimmarrje
- komunikim ndërveprues
- rritje të qëndrimit tolerant
- bashkëpunim
- pranimin e mendimeve/ kritikave të të tjerëve.

Studentët reaguan pozitivisht ndaj punës në grup. ***Mbi të gjitha MBP mundësoi*** të marrin një renditje më të lartë në ***aftësitë e të menduarit*** të tilla si:

- ofrimin e kritikave konstruktive
- sqarimi, zhvillimi, parashtrimi i ideve
- demonstrimi i të kuptuarit
- sintetizimi ideve të gjeneruara nga diskutimet
- analiza e vendimit të grupit
- vlerësimi për njëri-tjetrin

Këto njohuri paraprake, shërbyen për të ndërtuar njohuritë e mëtejshme e për të mbyllur boshllëqet në këto njohuri. Studentët formuluan disa pyetje të cilat i ndihmuan të hartonin një plan veprimi të përqëndruar në çështje të caktuara, në mënyrë që të mos lihej asgjë e rëndësishme, pa u aplikuar në procesin e zgjidhjes së problemit.

Grafiku IV.9 Vlerësimi i Qasjes MBP, prej studentëve në fund të procesit.

Vlerësimi i Qasjes MBP, prej studentëve në fund të procesit. **Grafiku 1.9**

[11] Montgomery, Bull dhe Kimball (1999).
[12] Tan (2003).

Vlerësimi i qasjes MBP prej studentëve në fund të procesit



Përfundim

Studentët e përfshirë në studim, kontaktuan detyrën problemore në mënyrë sistematike. Bazuar në gjetjet e kërkimit mund të paraqesim në mënyrë të përmbledhur përgjigjet për tri pyetjet kërkimore si vij

- *Së pari*: Studimi dëshmoi se përdorimi i MBP përmirëson aftësitë gjuhësore të studentëve.
- *Së dyti:* Të gjithë studentët, që ishin subjekt i kërkimit përmirësuan aftësitë gjuhësore, madje disa prej tyre, pësuan përmirësime të konsiderueshme në të paktën një aspekt të aftësive gjuhësore. Kjo ishte e dukshme në aftësitë gojore e të shkruara gjuhësore.
- *Së treti:* Përdorimi i MBP nxiti studentët me nivele të ndryshme gjuhësore, të mësojnë së bashku. Kjo siguroi mjedisin e përshtatshëm, që këta studentë të merrnin pjesë në diskutimet në grup dhe të kontribuonin në drejtim të realizimit të detyrave si një ekip. Fokusi kryesor i përdorimit të MBP në një klasë të AQP nuk ishte zgjidhja e problemit. As produkti. Megjithëse zgjidhja apo produkti janë rezultati logjik, *theksi ishte se si procesi i zgjidhjes së problemit do të përmirësonte aftësitë gjuhësore të studentëve.*

Nëpërmjet njohjes së ndryshueshmërisë së personaliteteve mund t'i ndihmojmë studentët të njohin forcat e tyre dhe të mposhtin dobësitë, të pajtojmë këto ndryshueshmëri me detyrimet që pësojnë dhe që imponojnë sistemet arsimore. *MBP si një qasje ndërdisiplinore, tregoi se na e mundëson këtë përshtatshmëri.*

BIBLIOGRAFIA

Achan, P., Philip, B., and Gunjew, M. (2006). *Generic skills for the workplace: A study of graduating students at UiTM Sarawak*. Bureau of Research and Consultancy. Sarawak: UiTM.

Ahlfeldt, S. L. (2004). *Problem-based learning in the public speaking classroom.* North Dakota State University: Ph.D. Dissertation. *Pro Quest Educational Journals*.

Allen, D. E. (1996*). Can undergraduates effectively guide students' problem-based learning groups? ABOUT TEACHING*, 50. http://www.udel.edu/pbl/cte/spr96-bisc.html. Online 26 May 2006.

Allen, D. E., Duch, B. J., Groh, S. E., Watson, G. B., and White, H. B. (2003). *Scaling up research-based education for undergraduates: Problem-based learning*. University of Delaware.

Bosher, S., and Smalkosli, K. (2002). From needs analysis to curriculum development: *Designing a course in health-care communication for immigrant students in the USA.* English for Specific Purpose. 21(1): 59-79.

Dunlap, J. (2005*). Changes in students' use of lifelong learning skills during a problem-based learning project.* Performance Improvement Quarterly. 18(1): 5-33. ProQuest Educational Journals. http://proquest.umi.com/pqdweb?did=866823711&sid=1&Fmt=4&clientld=28403&RQT=309&VName=PQD. Online 10 May 2006.

Lawrence, N. R., and Tebeaux, E. (1982). *Writing communications in business and industry*. New Jersey: Prentice-Hall Inc.

Montgomery, D., Bull, K. S., and Kimball, S. (1999). *Case and problem based learning processes*. OK: Oklahoma State University. http:///www.home.okstate.edu/hompages.nsf/toc/EDU C591 Oiep19. Online 24 April 2006.

Tan, O. S. (2003). *Problem-based learning innovation: Using problems to power learning in the 21st century*. Singapore: Thomson Learning.

Wainwright, G. (1994). *Tricky business letters*. London: Pitman Publishing.

Zhonglei, M. (2004). *A problem-based learning course for fostering generic skills. The China Papers*. July. http://www.science.uniserve.edu.au/pubs/china/vol3/CP3_P2.pdf. Online 17 May 2006.

LEKSIKU NË KANUNIN E LABËRISË, NJË OBJEKT STUDIMI PËR HISTORINË E GJUHËS SHQIPE.

Msc. Zamira Alimemaj
Departamenti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
e-mail: zamiraalimema@gmail.com

Përmbledhje

Kanuni i Labërisë përfaqëson në vetvete monumentin e kulturës të popullit të trevës së Labërisë e më gjerë, prandaj ai ruhet si një thesar i kulturës shpirtërore të saj. Kanuni i Labërisë, ashtu si dhe kanunet e tjerë shqiptarë, merr një rëndësi të veçantë për shkencat albanologjike sepse ai ka të bëjë me lashtësinë e gjuhës e të kultures sonë popullore, me shtrirjen hapësinore, me marrëdhëniet demografike, gjuhësore e kulturore të popullit të kësaj krahine me krahinat e tjera e më gjërë si dhe me rolin që ka luajtur, qysh në lashtësi, në trevat ku kanë jetuar të parët tanë. Normat e këtij Kanuni nuk mund të studjohen vetëm nga këndvështrimi historiko-etnologjik, por edhe në aspektin gjuhësor. Në Kanunin e Labërisë pasuria gjuhësore e shqipes është shpalosur në tërë gjerësinë dhe thellësinë e saj. Forca e fjalës në këtë Kanun është mahnitëse. Përpjekja për të dhënë një mendim sa më të saktë, zakonisht shoqërohet edhe me nevojën e krijimit të fjalëve të reja e të kuptimeve të reja, si edhe me formime të ndryshme para e prapashtesore. Aty gjejmë të ruajtura trajtat origjinale të fjalëve si dhe fjalë duke u dhënë gjuhëtarëve lëndën e parë për punime e studime të mëtejshme.

Fjalë kyçe: fjalëformim, lashtësi, kulturë, gjuhësore, argumentim, e arsyetuar.

Hyrje

Kanuni i Labërisë, ashtu si dhe kanunet e tjerë shqiptarë, merr një rëndësi të veçantë për shkencat albanologjike sepse ai ka të bëjë me lashtësinë e gjuhës e të kultures sonë popullore, me shtrirjen hapësinore, me marrëdhëniet demografike, gjuhësore e kulturore të popullit të kësaj krahine me krahinat e tjera e më gjërë si dhe me rolin që ka luajtur, qysh në lashtësi, në trevat ku kanë jetuar të parët tanë. Në një nga punimet e tij të hershme, gjuhëtari i shquar, Eqerem Çabej, thekson se nga ekzistenca e gjurmëve të forta të kanunit në Labëri na del një vatër e re e këtij ligji në Shqipërinë Jugore, ky kanun duhet krahasuar jo vetëm me ligjet gjermane e të Italisë, por edhe me ligjet e popujve të Ballkanit. (Çabej, 1935) Një nga studiuesit e huaj, japonezi Yamamoto mendon se një shoqëri pa autoritet shtetëror, e përfaqësuar nga Kanuni, nuk përbën thjesht një system vlerash që i përket vetëm së shkuarës, por edhe një sistemi që ka lidhje edhe me të ardhmen e botës njerëzore. (Yamamoto,2002) Kanuni është ligj dhe ligji nuk duhet të ketë ekuivoke. Populli i krahinës së Labërisë, që është autori i këtij Kanuni, i

ka shprehur këto norma kaq qartë sa nuk mund t'u heqësh e as t'u shtosh asnjë fjalë pa prishur kuptimin e tyre. Gjithçka është në vendin e vet e me funksion të caktuar përsosmërisht me objektin që trajton.

Pasuria gjuhësore në Kanun

Në Kanunin e Labërisë pasuria gjuhësore e shqipes është shpalosur në tërë gjerësinë dhe thellësinë e saj. Gjuha shqipe paraqitet e përkryer e në të njëjtën kohë e ndërtuar thjesht, e aftë për të shprehur në mënyrë të plotë norma morale e juridike që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet njerëzve. Eshtë edhe merita e autorit I. Elezaj, që një pjesë të përmbledhjes e ka dhënë duke ruajtur të paprekur formulimin e vetë vendësve.

Në Labëri shumë shprehje të këtij Kanuni janë kthyer në sentenca jo vetëm tejet të sakta, po shpesh edhe të argumentuara e disa herë të dhëna edhe me ngjyrime artistike. Fjala në Kanunin e Labërisë është si një "gur i çmuar", që nuk hidhet në mënyrë të "pa kontrolluar". Prandaj duhet të jesh i matur sepse fjala, është e përdorur mirë dhe në vendin e duhur dhe të orienton si, dhe nga të ecësh. Në këtë mënyrë ajo kthehet në një mjet të fuqishëm ekzekutiv. Forca e fjalës në këtë Kanun është mahnitëse. S'ka asgjë mangut e asgjë tepër. Ka një kursim të tejskajshëm të saj në një ndërtim konciz të përkryer e për t'u pasur zili. Idiomat këtu kthehen në aksioma, të cilat pranohen pa diskutim. “I miri dhe i keqi peshojnë 400 derhem” (neni 21), “Më mirë i vdekur e me nder, sesa i gjallë e i turpëruar”, “Vdekja me nder është kapak floriri” (neni 24), “Besa e burrit- pesha e gurit”, “Kau lidhet për brirësh, burri për fjale”, “Nga del shpirti, del fjala” (neni 29), “Ngordhi kau, u prish penda” (neni 223).

Një vend të konsiderueshëm zënë normat e kuvendeve të burrave, për të cilat mund të themi se ato në Labëri shërbenin si një vend ku, nëpërmjet gjuhës dhe vlerës kulturore të saj si mjet i realizimit të një personaliteti të lartë, përgatiteshin figura të shquara që spikatnin për virtytet e larta, urtësinë, thjeshtësinë dhe forcën e fjalës. Populli i kësaj krahine, me anën e fjalëve të urta dhe të bisedave në odat e burrave apo në kuvende, ka sintetizuar jo vetëm urtësinë, por edhe thjeshtësinë, modestinë, si dhe rolin e fjalës si mjet ndikues në shoqëri. Mënçuria popullore e viseve shqiptare nëpërmjet thënieve diturake që ndjellin harmoni e pajtim, si dhe me anë të aq shumë fjalësh të urta e këshillash për të parapëlqyer gjakftohtësinë ndaj rrëmbimit, qetësinë dhe maturinë ndaj shpërthimit të menjëhershëm, jo vetëm kritikon, por edhe tregon udhën e drejtë që duhet ndjekur në jetë, prandaj, të shumtën e herës, fjalët e urta kanë karakter gjykimesh të padiskutueshme, me vlerë të përhershme; ato formulohen si udhëzime e parime morale të mirëqëna. (Gj. Shkurtaj, 2004).

Le të përmendim ndonjë prej tyre: “Fajin e ka gjuha, belanë e pëson koka”, “Bie një fjalë e nxjerrë një mijë”, “Fjala ndreq, fjala vret”, “Fjala e mire, çel derën e hekurt”, “Gjuha pret hekur”. Të përkryera paraqiten normat

e arsyetuara. Së pari jepet në mënyrë tepër koncize veprimi a fakti; më pas edhe argumentimi i domosdoshmërisë së kryerjes së tij. “Vjedhja e shtëpisë është vjedhje e rëndë, sepse veç dëmit i shkaktohet edhe fyerje të zotit të shtëpisë: “Sot hyn në shtëpi për të vjedhur, nesër për gruan”, (neni 726). Mashtrimi ndaj burrit ose gruas madhore nuk dënohet penalisht, sepse vepron rregulli: “sytë në ballë i ke, mendjen në kokë, mos u gënje, hapi sytë para se të japësh ose të marrësh gjë” (neni 755) “Mikpritësit shikoi vetullat e jo petullat” (neni 43) Disa nene shprehen me një mendim të prerë. Ata janë tepër të qarta, prandaj kërkojnë zbatim pa mëdyshje. “Vatër e shtëpi – mik e mirësi” (neni 42), “Po dhe fjalën-mbaje.” (neni 29) “Miku është i paprekshëm” (neni 43).

Fjalitë eliptike me ndërtime tejet lakonike, do të mbeten si kryevepra të vërteta të sintaksës popullore, ende e studiuar fare pak. Po marrim një shembull: “fshat e zanat, shtëpi e nasihat” Në këto dy fjali mungon kallëzuesi, sepse në këto raste kallëzuesi del i tepërt dhe prej saj janë ndërtuar shprehjet proverbiale si: “Sipas vendit bëhet dhe kuvendi”, apo “Sipas kokës edhe festja”.

Ndërtimet sintaksore në Kanun vlejnë për t’u bërë objekt diskutimi. Shumë këndshëm janë përdorur fjali me numër të paktë fjalësh, ku mungon kallëzuesi, por që mund të konsiderohen si perla gjuhësore, sepse mendimi dhe fjala perputhen përsosmërisht. Për shembull: “Marrja e nuses-çështje zakoni e nderi.”, “Vatër e shtëpi-mik e mirësi”,”Besa e burrit-pesha e gurit”, “ Krushku-krushk, miku-mik” (Krushku nuk barazohet me mikun) Në këto fjali mungon kallzuesi, sepse në këto raste kallzuesi del i tepërt. Përpjekja për të dhënë një mendim sa më të saktë, zakonisht shoqërohet edhe me nevojën e krijimit të fjalëve të reja e të kuptimeve të reja, si edhe me formime të ndryshme para e prapashtesore. Në këtë drejtim Kanuni i Labërisë është minierë e pafund.

Kompozitat

Pasuria e madhe e kompozicionit e deri te përngjitjet, tregon se populli i krahinës së Labërisë e ka kërkuar fjalën dhe ka arritur ta ndërtojë në natyrën e së folmes së vet. Krahas kompozitave si: babëzoti, mëmëzonja, kryekrushku, hakmarrje, gjakmarrje, fatkeqësi, farefis etj., gjejmë të përdorura edhe fjalë të formuara me parashtesa apo prapashtesa si p.sh.: *pritësi, pabesi, hasmëri, moszbatim, krahinor* etj. Shumë prej fjalëve të formuara i gjejmë të përdorura këndshëm në kombinime të ndryshme fjalësh.

Kështu për shembull fjala *gjëri*, e prejardhur nga *gjë* (*Jemi gjë / gjëri me të*?) përdoret për të treguar lidhje farefisnore. Fjala *fare* e *fis* janë sinonime dhe përdoren në shprehjet si: *Jemi një fis e një sua*, apo *Jemi një fis e një farë.*

Tashmë dihet që kompozicioni shpreh gjithnjë vitalitetin e një gjuhe. Neologjizmat në Kanun janë të shumta e mbi të gjitha të ndërtuara bukur p.sh. *vëllamëria, motërma, këpucëgrisuri, qinosar* (nga qinosi), *kanosjer* (nga kanos), *betar* (nga bëj be), *gjobtar* (vendos gjoba) Në Kanun gjejmë një

numër të madh fjalësh të rralla si: *bekshi* (roje), *nome* (stan), *kanusia* (gjoba), *savan* (qefin), *mera* (kullota), *qinosar* (çoban), *kseniti* (dëbim), *mesit* (ndërmjetës) etj.Huazimet në Kanun nuk janë të shumta, gjë që flet në të mirë të autencitetit të tij. Për shembull fjala *kuvend*, ndonëse është huazuar nga latinishtja *conventum*, është nga fjalët më të ngulitura e që është rrënjëzuar së hershmi në shqipen, duke u bërë edhe nga më të pëlleshmet në çerdhëzimet e formuara prej saj, si foljet *kuvendoj, hyj në kuvend, hap kuvendin, lidh kuvend, çel kuvend, shtroj kuvend, mbyll kuvendin* etj. pastaj, fjalëformimet e shumta atributive si: *kuvendëmbël, kuvendues, kuvendshtruar* etj.

Normat e këtij kanuni shprehin vlera të mëdha kulturore e gjuhësore të popullit të kësaj krahine. Me nje gjuhë e ligjëratë të pasur e të zhdërvjellte, ato shprehin urtësinë, mençurinë dhe dijen, si dhe veprimtarinë e gjallë e të larmishme të popullit të kësaj krahine në çdo fushë të jetës. Mendimi dhe forma e shprehjes shkojnë paralel në unitet me njëra-tjetrën.

Sintagmat

Kemi përzgjedhur disa njësi gjuhësore, kryesisht sintagma, (grupe e togje fjalësh) të cilat paraqesin një interes të veçantë nga kuptimi e forma e tyre. Familja, si një organizim i caktuar i jetës dhe i veprimtarisë shoqërore, ka zënë një vend të veçantë e të rëndësishëm ndër kanunet tona. Terminologjia e përdorur në kanun është shumë e pasur e në sfond ka kulturën e popullit të kësaj krahine. Në një vështrim të gjerë mund të themi se në familje hynë: vëllazëria, farefisi, njerëz të lidhur me anë te martesës, krushqitë etj. Nga ana gjuhësore këtu ndeshim terma të tillë si: sëmerja (gruaja e dytë e burrit që bashkëjeton edhe me të parën), thjeshtri, thjeshtra (djali ose vajza ei gruas me burrin e parë që e sjell me vete kur martohet me burrin e dytë), vëllam ose byrazer (kur një person pi gjakun e një personi tjetër dhe behen si vëllezër), babëzoti, nikoqirja, lajmës etj.

a)Sintagma që duhen spjeguar: plaku i barkut (i madhi i fisit), femija për shpirt (birësim), zënie nuse (kërkesë për fejesë).

b) Sintagma me kuptim të qartë (burra zakoni, zonjë shtëpie, breza nga trungu i babës, fis i largët, martesë me dy gra, martese me rrëmbim) Fjala fis përdoret për të treguar përkatësinë në të njëjtën gjini, si "*Jemi një fis*", apo për të treguar prejardhjen nga një familje e dëgjuar për trimëri dhe ndershmëri, si "*Është nga fis i mire* Sintagma *farë* e *fis* përdoren në shprehjet si: Jemi fare e fis. *Jemi një fis e një sua*, apo *Jemi një fis e një farë*.

Kulti i nderit vjen nga kohra shumë të hershme permes kanunit. Nderi dhe dinjiteti personal në Labëri, ashtu si në të gjitha vendet ku banojnë shqiptarë, është ndër vlerat më të larta shoqërore, sepse "Turpi është më i rëndë se vdekja" dhe "S'hahen bashkë turp e bukë". Nderi është personal. Çdo njeri e ka nderin për vete dhe nuk mund të preket nga askush në nder. Bëhet fjalë për një nder të ashpër por dinjitoz e madhështor në ashpërsinë e tij që ndryshon nga kodet e kalorësisë europiane. Nderi në kanun nuk është

thjesht një kategori morale por një vlerë shoqërore për çdo njeri, të varfër e të pasur. Nderi si një nga cilësitë e veçantë të karakterit të labit, ka zënë vend në normat e kanunit, përmes të cilave janë zgjidhur shume situata dhe është vënë në vend nderi i burrit dhe i gruas. Nderi nuk del vetëm në planin personal por edhe në planin shoqëror dhe ndërtimi i këtyre neneve me një gjuhë të thjeshtë e të pasur kanë lehtësuar kuptimin dhe zbatimin e tyre duke ruajtur ekuilibret e nevojshëm të jetës së popullit të kësaj zone. Përpjekja për të dhënë një mendim sa më të saktë, zakonisht shoqërohet edhe me nevojën e krijimit të fjalëve të reja e të kuptimeve të reja, si edhe me formime të ndryshme para e prapashtesore p.sh. *burrëreshë, pamartuar, i pabesë, moslidhje*; të perngjitura: *ndërmjetës, shitblerje, besëlidhja, mospranim, hakmarrje*. Me shumë vlerë janë edhe shumë fjalë e shprehje autoktone të kësaj krahine si: *treme* (fejesë me këmbim), *nishani* (unaza), *karthia* (dru të thata), *duvak* (kurorë), *gjerdhek* (oda e nuses), *mali belik* (prona shtetërore).

Përfundime

Kanuni i Labërisë është burim i vërtetë, një gurrë e pashtershme, ku gjuhëtari mund të shuajë gjithnjë etjen, e për këtë duhet përgëzuar z. Ismet Elezi që me përkushtim ka ruajtur trajtat origjinale, duke u dhënë gjuhëtarëve lëndën e parë për punime e studime të mëtejshme. Pra normat e Kanuni të Labërisë janë të ndërtuar dhe të shkruara me shumë elegancë, me një shqipe të pastër e të pa ndikuar nga barbarizmat gjuhësore dhe vijnë në ditët e sotme si vlerë e pasurisë tonë kombëtare.Kanuni i Labërisë është një thesar i cili i ka rezistuar kohës dhe vjen si një thesar i trashëgimisë tonë kombëtare.

Literatura

Elezi, Ismet, (2002) E drejta zakonore e Labërisë, Toena, Tiranë, ISBN: 99927-1-615-0

Elezi, Ismet, (2006), Kanuni i Labërisë, Toena, Tiranë, ISBN: 99943-1-144-1

Shkurtaj, Gjovalin, (2004) Etnografia e të folurit të shqipes, shblu, Tiranë, ISBN: 99927-0-299-0

Shkurtaj, Gjovalin, (2006), Kundrime gjuhësore, PEGI, Tiranë, ISBN: 978-99943-40-35-4

Çabej, Eqrem, (1974) Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe, Studime Filologjike, Nr.1/ 1974

Çabej, Eqrem, (2008) Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Botimet Çabej, Tiranë, ISBN:99927-33-98-5